



ISBN 978-9928-210-16-6
ISSN 2413-1334

Konferenca VI Shkencore Ndërkombëtare
VËLLIMI I DYTË



Policimi dhe **SIGURIA**

Fenomenet ekstreme të natyrës
dhe çështjet e sigurisë

MAJ
2021

PROCEEDINGS
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021



KONFERENCA VI NDËRKOMBËTARE

Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë

PROCEEDINGS

Vëllimi II

Botimi u financua nga
Trans Adriatic Pipeline



Trans Adriatic
Pipeline

© - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të së drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme. Autorët janë të vetëdijshëm dhe mbajnë përgjegjësi individuale lidhur me problemet e plagjiaturës. Çdo shkelje në këtë drejtim i ngarkon ata me përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë :
konferenca VI ndërkombëtare : proceedings / Akademia
e Sigurisë ; red. shkenc. Albert Hitoallaj. - Tiranë : Akademia
e Sigurisë, 2021

Vol. 2, 231. f. ; 165 x 240 cm.

ISBN 978-9928-210-16-6

1.Siguria kombëtare 2.Policia 3.Konferenca

351.74 (062)

NR 22

MAJ

2021

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Laura TAFARO

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIJA

Dr. Frank HARRIS

Dr. Albert HITOALIAJ

Redaktor shkencor

Dr. Albert HITOALIAJ

Punimet grafike

MP Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

AKADEMIA E SIGURISË
ISBN 978 - 9928 - 210 - 16 - 6
ISSN 2413 - 1334

KONFERENCA VI SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
"Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë"

Komiteti shkencor/ Scientific Committee

Kryetar i Bordit/Chair

Prof. Dr. Ismet ELEZI
Kriminolog

Anëtarë/Members

Prof. Dr. Xhovani ARCUDI
Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata" Itali

Prof. Dr. Vasilika HYSI
Kriminologe, ligjvënëse

Prof. Dr. Artan HOXHA
Rektor i Universitetit të Tiranës

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO
Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

Prof. Dr. TIINA KOIVUNIEMI
Drejtuuese e projektit të BE-së, "Forcimi i Kapaciteteve dhe Efikasitetit të Akademisë së Sigurisë" 18 IPA JH 01 19"

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI
Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë

Prof. Dr. Laura TAFARO
Profesor, Universiteti i Barit, Itali

Prof. Dr. Petrit ZORBA
Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), Tiranë

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA
Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata" Itali

Prof. Dr. Ethem RUKA
Rektor, Universiteti "Luarasi"

Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIAJ
Drejtori i Politikave të Sigurisë në Ministrinë e Brendshme.

Dr. Bilbil MEMAJ
Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë

Dr. Xhavit SHALA
Drejtori i Qendrës Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

Dr. Frank HARRIS
University of Portsmouth

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI
Dekan i Fakultetit të Sigurisë, Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Prof. Asc. Dr. Zaho GOLEMI
Shefi i sektorit të kërkimit shkencor, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Dr. Albert HITOALIAJ
Shefi i sektorit të botimeve, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë.

AKADEMIA E SIGURISË
ISBN 978 - 9928 - 210 - 16 - 6
ISSN 2413 - 1334

KONFERENCA VI SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
"Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë"

Komiteti organizator/Organizational Committee

Kryetar/Chair

Dr. Bilbil MEMAJ, Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë

Zëvendëskryetarë

Dr. Xhavit SHALA, Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Anëtarë/Members

Z. Haki ÇAKO

Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Dr. Bajram IBRAJ

Akademia Profesionale e Biznesit

Z. Malfor NURI

Administrator i Përgjithshëm TAP Albania

Dr. Elton Qendro

Prezenca e OSBE-së, Shqipëri

MSc. Elvita KABASHI

UNDP, Shqipëri

MSc. Klajdi NIKOLLA

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Prof. Dr. Laura TAFARO

Profesoreshë, Universiteti i Barit, Itali

Prof. Asc. Dr. Rezana KONOMI

Dekan i Fakultetit Juridik, Universiteti "Luarasi"

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA

Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata" Itali

Dr. Artur BEU

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Koordinatorët / Coordination

Dr. (proc.) Gjon VORFI, Koordinator i përgjithshëm, QKSH, Akademia e Sigurisë

Dr. (proc.) Anisa HYESANI, Koordinatore, QKSH, Akademia e Sigurisë

MSc. Qetësor GURRA, Koordinator, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

MP. Andi OSMANI, Koordinator, Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

Redaktor shkencor

Dr. Albert HITOALIAJ, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Punimet grafike

MP. Andi OSMANI, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Realizimi teknik: Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2021



**AKADEMIA E SIGURISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE**

KONFERENCA VI SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
FENOMENET EKSTREME TË NATYRËS DHE ÇËSHTJET E SIGURISË

Në bashkëpunim me:

Projektin e Binjakëzimit, financuar nga BE, "Për forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë", 18 IPA JH 01 19, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Universitetin e Romës "Tor Vergata", Universitetin "Luarasi", Tiranë, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Universitetin Polis, Tiranë,



dhe me mbështetjen e:

Trans Adriatic Pipeline,
United Nations Development Programme (UNDP) Albania,
Prezencës së OSBE-së Shqipëri,



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Akademia e Sigurisë, organizon
konferencën VI shkencore ndërkombëtare: "Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë".

31 maj 2021, Tiranë

Përmbajtja

SESIONI I PARË

Siguria, në kuadrin e fenomeneve ekstreme
të natyrës dhe emergjencave civile

Prof. Dr. Kristaq XHARO

Në dilemat e menaxhimit të katastrofave natyrore 16

**Prof. Dr. Petrit ZORBA, MSc. Elsuida HOXHA,
Ing. Rubens MUÇA, Prof. Asc. Dr. Odhise KOÇA**

Moti ekstrem dhe siguria kibernetike në Shqipëri 27

Dr. (proc.) Anisa HYSESANI

Gjeoinxhinieria, në kontekstin e sfidave të sigurisë 34

Dr. (proc.) Gentiana BEKTASHI

Ndryshimet klimatike dhe çështjet e sigurisë 46

SESIONI I DYTË

Kuadri ligjor dhe institucional, eksperiencia kombëtare, rajonale dhe
ndërkombëtare në fushën e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile

Prof. Dr. Shkëlqim ZEQQ

Mësimet e nxjerra nga kolapset e urave: një vështrim për një menaxhim të qëndrueshëm 56

Dr. Fjorida BALLAURI (KALLÇO), MSc. Josi BALLAURI

Siguria kombëtare dhe rreziku nga bioterrorizmi: mbrojtja që ofron legjislacioni shqiptar në këtë
fushë, dhe masat parandaluese 78

MSc. Klajdi NIKOLLA, Dr. Evisa DUKA

Reforma në sistemin e mbrojtjes civile në Shqipëri 96

Inxh. Dr.(proc.) Albina TOÇILLA, Dilan HOXHOLLI, Dionis ULIU, Xhesjana BRAHIMI	
Roli i IoT në menaxhimin e fatkeqësive natyrore	108

MSc. Sheldiana JANO	
Bashkëpunimi rajonal në fushën e emergjencave civile, kuadri ligjor dhe juridik.	122

MSc. Ketjona KAÇUPI, MSc. Edvin MORAVA	
Problematikat, në efikasitet dhe zbatueshmëri, të ligjit nr. 45/2019, për rastet e ndryshme të emergjencave civile	134

MSc. Ina HASANKOLLI, MSc. Enea SHEQI	
Aksesi në drejtësi, në rastet e emergjencave civile.	146

SESIONI I TRETË

Qasje praktike dhe shembuj konkret menaxhimi, në kuadrin e fatkeqësive
natyrore dhe emergjencave civile

MSc. Shemsi PRENÇI, Dr.(proc). Silvana JAKAJ	
Sistemi i zvogëlimit dhe menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në Shqipëri - panoramë dhe analizë e nevojave dhe mangësive strukturore.	154

MSc. Agron HAXHIMALI	
Emergjencat civile në nivel vendor: përballimi nëpërmjet rregullave, procedurave dhe koordinimit.	168

Dr. Blerta DERVISHI, MSc. Erisa RAKIPI	
Roli i Policisë së Shtetit në menaxhimin e krizës shkaktuar nga pandemia COVID-19	180

MSc. Pëllumb DANI, Dr. Bajram IBRAJ	
Planifikimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore në qarkun e Shkodrës.	194

MSc.Taulant SULA	
Pasojat e lumit Shkumbin, në territorin e bashkisë së Rrogozhinës.	208

Abstraktet në anglisht / Abstracts	218
---	------------



KONFERENCA VI SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
“FENOMENET EKSTREME TË NATYRËS DHE ÇËSHTJET E SIGURISË”
maj 2021, Tiranë

Tiranë, maj 2021

Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë (IAL) e të kërkimit shkencor në Shqipëri, si dhe me institucione të tjera kombëtare e ndërkombëtare, organizon konferencën e 6-të shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare, me titull: *“Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”*. Akademikë, studiues, profesionistë nga vendi e bota, studentë e punonjës të Policisë së Shtetit e të gjithë institucioneve ligj zbatuese e më gjerë, janë ftuar që të dorëzojnë punime, projekte, propozime dhe prezantime për konferencën; punime që rrokin fushën e emergjencave civile dhe sigurisë njerëzore. Gjatë punimeve të konferencës për studiuesit e pjesëmarrësit e huaj ofrohet shërbim përkthimi edhe në gjuhën angleze.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

FOKUSI I KONFERENCËS

Në fokus të kësaj konference do të jetë siguria njerëzore në emergjencat civile, pasojë e fenomeneve ekstreme të natyrës dhe jo vetëm. Në dekadat e fundit, çështja e emergjencave civile është shndërruar në një nga shtyllat e rëndësishme dhe jetike të sigurisë publike. “Emergjencë civile” është ajo situatë komplekse që mund të shkaktohet nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, kërcënuese, luftarake, të cilat sjellin dëme të menjëhershme të rënda për jetën, për shëndetin e komunitetit, të gjësë së gjallë, pasurisë private e shtetërore, trashëgimisë kulturore

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*
« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

dhe mjedisin. Fokusi i kësaj konference do të jetë gjithashtu ndërtimi i një kornize mbi sigurinë publike në rastet e emergjencave civile duke sjellë prurje teorike e eksperiencë praktike me informacion të bollshëm mbi përgjegjësinë dhe vetëdijen e institucioneve, agjencive ligjzbatuese dhe Policisë së Shtetit si dhe gjithë shoqërisë në gjeohapësirën shqiptare e më gjerë. Fokusi i gjerë i kësaj konference lidhet pikërisht me specifikat e saj, që mund të ndodhin në hapësirë tokësore, detare e ajrore, te evidentimi i politikave, i strategjive, i legjislacionit dhe i praktikave konkrete të trajtimit të sigurisë njerëzore në këndvështrimin e përgjegjësive dhe detyrimeve. Në këtë aspekt dalin edhe vendi, roli dhe përgjegjësia që duhet të kenë strukturat shtetërore e civile nga situatat e thjeshta deri tek ato më komplekset. Nuk ka aksident, përmbajtje, tërmete, pandemi, ortekë, rrëshqitje, dëborëra, ngrica, erëra të forta, bllokime rrugësh, zjarre, dëmtime nga breshëri, nevoja imediate, ndërhyrje brutale në përditshmërinë e jetës publike, nevoja në situatë emergjence, etj., ku të mos ndihet gjithëpërfshirja e strukturave ligjzbatuese shtetërore, e sidomos e Policisë së Shtetit.

OBJEKTIVAT E KONFERENCËS

- Prezantimi i kërkimeve shkencore, paraqitja e analizave të thelluara mbi politikat, strategjitë, çështjet ligjore që lidhen me fenomenet ekstreme të natyrës, me ndikimin e tyre në çështjet e sigurisë, por edhe me prognozat bazuar në anketime si dhe hartimi i rekomandimeve për strukturat ligjzbatuese, parë nga këndvështrimi i aspekteve të emergjencave civile, por duke i lidhur ato ngushtësisht me aspektet e sigurisë njerëzore.

- Fokus i objektivave do të jenë aspektet teorike e praktike procedurale, ligjore dhe burimore për llojshmërinë e emergjencave e fatkeqësive, por që lidhen në radhë të parë me çështjet e sigurisë, duke i parë emergjencat si përparësi dhe duke bërë vlerësimin e kërcënimit real të tyre.

- Paraqitjen në rritje të formimit akademik, si dhe thithjen e mendimit të kualifikuar në këtë fushë të lidhur ngushtë me sigurinë në kërcënime nga fenomenet ekstreme, emergjenca e fatkeqësi, duke kontribuar përmes punimeve shkencore, objektiv i vijueshëm i Akademisë së Sigurisë në shërbim të përmirësimit të nivelit akademik e profesional, duke sjellë ballafaqime me praktikatat më të përparuara të vendeve të tjera partnere në fushën e emergjencave.

QËLLIMI I KONFERENCËS

Konferenca ka si qëllim:

- Përthithjen e mendimit të kualifikuar akademik, trajtimin në mënyrë shkencore të veprimtarisë teoriko-praktike të rëndësisë së veprimit të koordinuar në emergjencat civile dhe fatkeqësitë si dhe në vijimësi për të mbrojtur e siguruar komunitetin në momentet fillestare; për kuptimin e detajuar të emergjencave civile në tokë, në det dhe në ajër si dhe fatkeqësitë që mund të prekin komunitetin, në kuadrin e sigurisë së tyre; për përgatitjet paraprake në të gjitha nivelet për të amortizuar kërcënimet e pritshme të natyrës dhe trajtimin e kuptimit, veçorive dhe mundësinë e gjendjes së mbështetjes në momentin e parë të emergjencës deri në transferimin e kompetencës në strukturat përgjegjëse etj.

- Përmirësimi i shpejtësisë dhe i efikasitetit përballë emergjencave, përmes kontributit akademik institucional dhe më gjerë, duke përgjithësuar praktikatat më të mira botërore dhe mësimet e nxjerra; duke vendosur ura lidhëse bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh me segmentet e shtetit, duke identifikuar aktorët dhe

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

“ Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë ”

përgjegjësitë, mangësitë në aktet ligjore e nënligjore si dhe duke bërë propozimet dhe rekomandimet për përmirësime në politika, strategji e ndryshime ligjore në të ardhmen, për paraqitjen e gjendjes ekzistenciale si edhe rekomandime të kurrikulave, programeve e trajnimeve për fushën e sigurisë, emergjencave e fatkeqësive.

SYNIMI I KONFERENCËS

Konferenca ka këto synime kryesore:

- ndërgjegjësimin publik për mirinformim dhe njohuri në lidhje me rreziqet nga fatkeqësitë, faktorët, që mund të çojnë në fatkeqësi, por edhe për veprimet e mundshme, që mund të ndërmerren në mënyrë individuale e kolektive për të zvogëluar ekspozimin ndaj kërcënimit dhe rreziqeve nga fenomenet ekstreme të natyrës;

- përforcimin dhe theksimin se emergjenca civile është një element i prekshëm, i vërtetë, i qenësishëm, i përvitshëm, i ndjeshëm i sigurisë kombëtare, i çdo shteti për rrjedhojë edhe Shqipërisë, të ekspozuar ndaj fenomeneve kërcënuese të natyrës në të gjitha stinët;

- zgjerimin e bashkëpunimit të segmenteve përgjegjëse të shtetit për sigurinë njerëzore në rast emergjencash, si dhe bindja në bashkëpunimin e aktorëve ndërshtetërorë në vend, por edhe rajonalë, veçanërisht ata fqinjë;

- rritjen e vetëdijes për çështjet e emergjencave civile, praktikant më të mira dhe mësimet e nxjerra për përmirësimin e aftësisë themelore të sigurisë njerëzore në të gjithë hapësirën shqiptare;

- trajtimin e aspekteve ligjore dhe juridike e historike krahasuese, të emergjencave për tërmetet, përmbytjet, ortehtët, zjarret, aksidentet e rënda në terrene të vështira dhe mundësia e bashkëpunimit e koordinimit të shpejtë, veçanërisht kur problemet janë në kufij me fqinjët;

- ofrimin e rekomandimeve, për përmirësim në politika dhe strategji zgjidhjeje për strukturat e shtetit që trajtojnë problematikën e emergjencave civile, në kuadër të përmirësimit të punës së policisë dhe reduktimit të dëmeve ose parandalimit të përhapjes së dukurisë së emergjencave;

- përfshirjen në studime dhe analiza të thelluara të aspekteve ligjore dhe teknike lidhur me menaxhimin praktik të problemeve të emergjencave në shkallë vendore e rajonale, duke shfrytëzuar praktikën më të përparuar ndërkombëtare në fushën e përballimit të emergjencave dhe të së gjithë faktorëve ekstremë të natyrës.

STRUKTURA E KONFERENCËS

Konferenca organizohet në disa sesione, që do të kenë për bazë politikën, strategjitë, aspektet juridike e të legjislacionit, funksionimin e tyre, kuadrin e plotë të çështjeve të sigurisë duke përfshirë aktorë dhe faktorë brenda e jashtë vendit, qasjet e strukturave dhe agjencive ligjzbatuese ndaj emergjencave civile bazuar në natyrat specifike, që lidhen me komunitetin e jetëve njerëzore, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore e mjedisin; mundësitë e minimizimit të kërcënimeve, pandemive dhe katastrofave.

PJESËMARRJA NË KONFERENCË

Pjesëmarrja në konferencë ishte e hapur: staf akademik, studentë të Akademisë së Sigurisë, ekspertë e studiues nga radhët e strukturave të Policisë së Shtetit e agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, akademikë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë

publik e privat në vend, studiues e ekspertë të çështjeve të hetimit dhe të sigurisë në vend dhe vende partnere, përfaqësues nga organizma ndërkombëtare partnere të Policisë së Shtetit etj.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**



~ Sesiioni I ~

Siguria, në kuadrin e fenomeneve ekstreme
të natyrës dhe emergjencave civile

Në dilemat e menaxhimit të katastrofave natyrore



■Prof. Dr. Kristaq XHARO
Universiteti European i Tiranës
kristaq.xharo@uet.edu.al

Abstrakt

Një koncept më i gjerë dhe i thellë është shfaqur për konceptin e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, që pas Luftës së Ftohtë. Kërcënimet joushtarake, të tilla si keqmenaxhimi mjedisor, shterimi i burimeve natyrore, mbipopullimi dhe pasojat mjedisore të Luftës së Ftohtë, rënia ekonomike, paqëndrueshmëria sociale dhe politike, rivalitetet etnike dhe mosmarrëveshjet territoriale, terrorizmi ndërkombëtar dhe trafiqet ilegale janë përfshirë në përkufizimin e sigurisë. Ndërkohë, koncepti i sigurisë mjedisore ka kuptime të ndryshme dhe shpeshherë kontestohet. Ky kontestim lind nga bashkimi i dy koncepteve të fuqishme, por po aq të gjera, – mjedisi dhe siguria, – që kontribuojnë konsiderueshëm në grupin e larmishëm të disiplinave dhe shkollave të mendimit. Mënyra se si perceptojmë secilin prej këtyre koncepteve ndihmon të kuptuarit e përbashkët të sigurisë dhe mjedisit. Marrëdhënia midis mjedisit dhe sigurisë ka qenë në shqyrtim gati dy dekada. Megjithatë kombet vazhdojnë të jenë aktorë qendrorë në politikën ndërkombëtare, ata gjithnjë e më shumë marrin pjesë dhe janë të angazhuar në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe rajonale për t'iu përgjigjur shqetësimeve jotradicionale të sigurisë, përfshirë mjedisin. Angazhimi në një subjekt të tillë lidhet me vlerësimin e lidhjeve midis mjedisit dhe sigurisë bazuar në modelin e ri konceptual. Përfshirë edhe pandeminë globale, objekti i referimit do të lidhet me faktorë të ndryshëm, me ndikim në marrëdhëniet midis mjedisit dhe sigurisë si shkaktarë, katalizatorë ose bashkëveprues. Këta faktorë ndihmojnë në identifikimin e llojeve të përgjithshme të konflikteve mjedisore. Sipas kësaj tipologjie për konfliktet mjedisore, ekziston një potencial i madh edhe për bashkëpunim midis të gjitha niveleve dhe në fusha të ndryshme të politikave angazhuese me qëllim krijimin e mekanizmave koherentë të konfliktit mjedisor.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

katastrofat natyrore, siguria, siguria mjedisore, tërmeti.

1. Hyrje

- Katastrofat si produkt i natyrës dhe dilemë e sigurisë

Siguria mjedisore ka kuptime të ndryshme dhe shpesh herë të kontestueshme e ndoshta kjo lind nga afrimi i dy koncepteve të fuqishme, por po aq të larmishme: mjedisi dhe siguria, e që njëkohësisht inspirohet edhe nga teoritë dhe shkollat e mendimit. Mënyra se si kuptohen secili prej këtyre koncepteve ndikon në të kuptuarit e konceptit të kombinuar të sigurisë mjedisore. Marrëdhënia midis mjedisit dhe sigurisë ka qenë në shqyrtim gati dy dekada. Megjithëse shtetet vazhdojnë të jenë aktorë qendrorë në politikën ndërkombëtare, ata gjithnjë e më shumë marrin pjesë dhe janë të angazhuar në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe rajonale për t'iu përgjigjur shqetësimeve jotradicionale të sigurisë, përfshirë mjedisin.

Katastrofat natyrore janë faktorë që ndikojnë ndjeshëm përmes sigurisë mjedisore në sigurinë humane. Por efekti i tyre prek thuhet të gjitha nivelet: komunitetin, qytetin dhe shumë herë mund të ndikojë edhe një shtet të tërë. Fatkeqësitë natyrore mund të kenë ndikime të mëdha mjedisore gjithashtu, edhe kur duket se komuniteti nuk preket direkt. Se sa mirë absorbohet ndikimi i një ngjarjeje katastrofe ka të bëjë shumë me intensitetin e ndikimit dhe nivelin e gatishmërisë dhe rezistencës së subjektit të ndikuar. Në nivelin individual, ndikimi shpesh mund të ndihet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht. Fatkeqësitë natyrore shkaktojnë shkatërrim të pronës, humbje të burimeve financiare dhe dëmtime personale ose sëmundje. Humbja e burimeve të jetesës, siguria dhe qasja në strehime mund të çojë në migrime masive të popullsisë. Pasi kanë përjetuar një katastrofë natyrore, shumë individë zhvillojnë çrregullime të rënda të stresit pastraumatik ose tërhiqen në gjendje depresioni. Të tjerët zhvillojnë qasje

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

negative me mjedisin, që gjithashtu mund të çojë në migrime të konsiderueshme të popullsisë.

Është pranuar që siguria nuk është vetëm funksion i kapaciteteve ushtarake ose faktorëve dhe aktorëve gjeopolitike. Jo vetëm shtetet por edhe organizatat dhe institucionet e sigurisë shqetësohen gjithnjë e më shumë me kërcënime jotradicionale të sigurisë në fusha të tjera. Vetë koncepti i ri i sigurisë kombëtare është ndryshuar duke u zgjeruar dhe thelluar. Është zgjeruar për të përfshirë kërcënimet në formën e keqmenaxhimit mjedisor, shterimin e burimeve natyrore, mbipopullimin dhe pasojat ekonomike të Luftës së Ftohtë, si dhe rënien ekonomike, paqëndrueshmërinë sociale dhe politike, rivalitetet etnike dhe mosmarrëveshjet territoriale, terrorizmin ndërkombëtar, dhe droga. Por një vend gjithnjë e më të gjerë po gjejnë dukuritë natyrore të përkufizuara në katastrofa. Tashmë koncepti njihet dhe pranohet që siguria dhe stabiliteti kanë në kontekstin e vet elemente politike, ekonomike, sociale dhe mjedisore

2. Metodologjia

Ky referim paraqet një model konceptual që përshkruan lidhjet midis katastrofave natyrore dhe sigurisë. Ky model përdor faktorë të ndryshëm (d.m.th. nxitës, katalizatorë ose tregues) që ndikojnë në marrëdhëniet midis katastrofave natyrore, ndryshimeve mjedisore dhe sigurisë. Shkalla në të cilën katastrofat kontribuojnë në sigurinë humane apo në përshkallëzimin e konfliktit (natyrë – individë) varet nga marrëdhënia midis pasojave të katastrofave në raport me kontekstin e faktorëve socioekonomikë, politikë dhe të tjerë brenda këtij konteksti. Nëse këta faktorë janë të pafavorshëm, nisja dhe thellimi i konfliktit për shkak të pasojave është e mundshme. Nëse faktorët kontekstualë janë të favorshëm, probabiliteti i një zgjidhje më të lehtë dhe të pranueshme vjen në përmirësim.

3. Marrëdhëniet midis katastrofave natyrore dhe sigurisë

Ndërsa shumica e analizave katastrofave natyrore janë përqendruar në atë se si të përmirësohen përpjekjet humanitare të ndihmës, si të merren me traumat psikologjike dhe sociologjike në komunitetet njerëzore dhe si të përgatiten më mirë për raste të tilla emergjente, ato kryesisht kanë injoruar ndikimin në sigurinë kombëtare apo dhe më gjerë se sa zona apo rajoni ku ato ndodhin. Ky referim përpikëqet të afrojë qasjen e ndikimit të sigurisë nga katastrofat natyrore¹.

Marrëdhënia midis mjedisit dhe sigurisë ka qenë në shqyrtim gati dy dekada si në komunitetin shkencor edhe në atë politik. Çështjet mjedisore dhe të sigurisë janë shumëplanëshe dhe komplekse, në kuptimin kulturor, politik dhe shkencor². Në një mënyrë thelbësore, mjedisi duhet të shihet si një faktor strategjik që duhet vlerësuar me shumë variabël të tjerë që ndikojnë, jo vetëm në sigurinë kombëtare, por edhe më gjerë. Integrimi i veprimtarive njerëzore dhe njohja e rëndësisë së faktorëve mjedisorë tregon përherë e më shumë vartësinë midis mjedisit dhe sigurisë.

Në sistemin e sotëm global, ku njerëzit ndihen të shkëputur dhe të izoluar nga forcat

¹ Robert Mandel, Security and Natural Disasters Vol. XXII No. 2 Fall 2002.

² J. Barnett, in International Encyclopedia of Human Geography, 2009.

e dhunshme të natyrës, katastrofat natyrore kataklizmike kanë potencialin për të forcuar ose për të lëkundur *status quo*-në mbizotëruese³. Pjesë e çdo nocioni kuptimplotë të sigurisë është ideja se ekziston një kontratë midis autoritetit dhe qytetarit, në të cilën qytetari pret mbrojtje nga shteti në këmbim të bindjes dhe detyrimeve: qoftë edhe në kontekstin e katastrofave natyrore, gjë që do të thotë se ka një zgjerim të qartë të agjendës së sigurisë⁴ për të përfshirë pritjet e viktimave të fatkeqësive për përgjigjet e shtetit ndaj gjendjes së tyre të vështirë. Ndërsa katastrofat natyrore qartë kanë potencialin për të vrarë njerëz dhe për të degraduar në mënyrë thelbësore mënyrën e jetës, lindin pyetje në lidhje me mundësinë që ato njëkohësisht të rrisin mbështetjen për regjimet qeveritare dhe promovimin e bashkëpunimit ndërqeveritar.

3.1. Dimensionet ambientale të sigurisë kombëtare

Për shumë lexues, koncepti i “sigurisë mjedisore”, ose integrimi i çështjet mjedisore dhe konsideratat e sigurisë kombëtare në një nivel të politikës kombëtare, mund të jetë e pamundur, mund të duket edhe disi çuditshme. Në fakt, nuk është as njëra as tjetra. Ashtu siç shprehet Braden Allenby, ‘... ajo pasqyron historinë dhe trendet e kohëve të fundit dhe evolucionin domethënës të njohurive tona për të dy fushat⁵. Kjo nuk do të thotë që koncepti është aq i qartë sa edhe i shkruar edhe pse koncepti madje është pranuar botërisht si i nevojshëm. Më tej, mund të argumentohet se debati në lidhje me vlefshmërinë dhe integrimin e katastrofave në konceptin e sigurisë është një pjesë e pasqyrit të një numri të rëndësishëm tendencash që, të marra së bashku, vijnë direkt që pas Luftës së Ftohtë, si një ndryshim më themelor. Prandaj gjatë analizave dhe krahasimit mund të jetë e dobishme të eksplorohet për një kontekst më të gjerë se si u zhvendosën dhe u integruan këto fusha në konceptin e ri të sigurisë.

Integrimi i konsideratave mjedisore e veçanërisht katastrofave natyrorë në sistemin e sigurisë kombëtare mund të shihet si një model transicioni çështjeve të konsideruara si ‘dhimbje koke’ në çështje “strategjike” për gjithë shtetin dhe shoqërinë. Duke i ngritur në nivel të çështjeve “strategjike” tashmë ato shihen si integrale të aktiviteti primar. Në një nivel social, kalimi i çështjeve mjedisore nga ‘dhimbje koke’ në strategjike në mënyrë të pashmangshme nënkupton një ‘konflikt’ me strukturat ekzistuese ligjore dhe të politikave. Struktura të tilla si ato që merren me të drejtat e qytetarit e deri te ekonomia, kujdesi shëndetësor, apo ushqimor kishin një status të ndryshëm kur u krijuan vite më parë pa ndonjë konsideratë të qartë të implikimeve të tyre mjedisore.

3.2. Tipat e katastrofave

Për sa i përket llojit të ngjarjeve të konsideruara, theksi vihet te katastrofat e mëdha, të karakterizuara nga fillimi i papritur dhe kohëzgjatja e shkurtër, ku natyra luan një rol të rëndësishëm nxitës dhe ku potenciali për ndërprerje dhe ndikim duket më i lartë. Fatkeqësitë natyrore paraqesin disa nga problemet më të vështira të sigurisë, sepse ato janë të paktën po aq destabilizuese sa konfliktet politike, ekonomike, etnike ose fetare

³ Robert Mandel, *The Changing Face of National Security: A Conceptual Analysis* (Westport, CT: Greenwood, 1994), p. 21.

⁴ Barry Buzanand, Ole Wæver, *Security: A New Framework for Analysis* (Boulder, CO: Lynne Rienner, 1998) for elaboratin on the politics of the broadening security agenda.

⁵ Braden R. Allenby Environmental dimensions of national security. P.36.

vepër e njerëzve dhe vrasin më shumë njerëz në mesatare sesa përplasjet civile, dhe ato paraqesin më shumë sfida për veprim kontrollues për shkak të vështirësisë⁶. Skeptikët duhet vetëm të krahasojnë shkatërrimet marramendëse të prekshme nga katastrofat natyrore që nga fundi i Luftës së Ftohtë me humbjen e pronës dhe jetës për shkak të përplasjeve të dhunshme në familje dhe ndërkombëtare gjatë së njëjtës periudhë kohe; shifrat krahasuese nuk janë as afër.

Ndërsa ka pak dyshim se dallimi midis katastrofave natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu është artificial, për shkak të amplifikimit të rreziqeve natyrore që vijnë nga sjellja njerëzore e pandjeshme ndaj mjedisit, ndryshimet në qëndrime dhe reagime duken thelbësore kur një fatkeqësi shihet si ekskluzivisht produkt i veprimit të njeriut. Arsyeja për përjashtimin e forcave natyrore kronike që zgjasin muaj ose më shumë me ndikime graduale rritëse sesa të menjëhershme masive, siç është thatësira, është se këto tentojnë të shkaktojnë më pak atmosferë krize që mund të rezultojë në ndryshime dramatike në sigurinë e brendshme dhe të jashtme; për këtë arsye, literatura mbi konfliktin mjedisor dhe të burimeve është kryesisht e kufizuar në këtë rast, përkundër stimulimit të fatkeqësive natyrore në mungesë të tensionit⁷. Zgjedhja për të analizuar katastrofat e fundit është për shkak të dëshirës për të parë dinamikën e veçantë në kontekstin e periudhave më të fundit.

Ndërsa nuk ka një përkufizim të saktë të standardizuar të asaj se çfarë përbën një katastrofë të madhe natyrore, pranohet se standardi i konsekuencave njerëzore shkon te 100 persona, të vrarë apo të plagosur dhe dëmi material mbi 1 milion dollarë, shtuar këtu edhe numrin e madh i të zhvendosurve. Në fund të fundit, megjithatë, duhet të jetë e qartë se lloji i ngjarjeve të zgjedhura përfaqëson rastet më ekstreme, jo shfaqje tipike të ndodhive të përditshme për shkak të forcave të dhunshme të natyrës.

Më konkretisht, ky studim përfshin në këtë vlerësim katër kategori kryesore të katastrofave natyrore: *tërmetet, përmbytjet, zjarret dhe stuhitë e forta të erës*. Megjithëse shumë njerëz i perceptojnë ato si ngjarje që ndodhin një herë në jetë, në të vërtetë ato ndodhin periodikisht, e ndoshta më shpesh duke prekur dhe dëmtuar në pasojë njerëzore dhe materiale⁸. Tërmetet, veçanërisht ai i 2019-s, përmbytjet, përfshirë edhe ato aktuale apo edhe stuhitë e zjarreve kanë pasur impakte të shkaktojnë fatkeqësi dhe të dëmtojnë jetesën e më shumë njerëzve sesa kategoritë e tjera të fatkeqësive natyrore pjesa tjetër, jo vetëm përmes efekteve direkt, por edhe përmes fenomeneve shoqëruese në kërkesat e tjera të jetesës. Kjo kategori e fatkeqësive të ndodhura me një periudhë të shpeshtë kanë goditur goditën veçanërisht rëndë vendbanimet duke shkaktuar pasojë mjaft të rënda përmes veprimit direkt lëkundjeve të rënda të tërmetit, niveleve të larta të përmbytjeve apo zjarreve kryesisht në pyje duke risjellë në vëmendje që mundësia për tu rrizikuar është gjithmonë e lartë.

3.3. Tërmeti si katastrofë natyrore

Vala e lëkundjeve që kaluam gjatë 2019-s do të kujtohet veç pasojave humane e dëmtimeve kolosale edhe për efektet sociale dhe psikologjike. Panik dhe kaos në banesa, në rrugë, në komunitet, në media, në të gjithë shtetin. Për aq sa panë dhe përjetuan edhe

⁶ Thomas Homer-Dixon, *Environment, Scarcity, and Violence* (Princeton, NJ: Princeton University Press, 1999).

⁷ Natural Hazard Research Group in Paul Sussman, Phil O'Keefe, and Ben Wisner, "Global Disasters, a Radical Interpretation," p. 23.

⁸ Oliver-Smith, *Natural Disasters and Cultural Responses*, p. 3.

për të ardhmen tërmetet do të shihen si 'gogol'. Në mungesë të një analize nga specialistët, nga institucionet, nga drejtuesit e nxjerrjes së mësimave nga pësimet nuk përjashtohet që edhe në raste përsëritjesh në të ardhmen njerëzit do të përjetojnë dhe do të veprojnë në të njëjtat forma. Të analizosh një ngjarje, fitore apo humbje apo midis njëres e tjetrës, kur ekziston përherë mundësia e saj e përsëritjes nuk është asnjëherë vonë e as kohë e humbur. A mund të shmangen katastrofat natyrore? Nëse në emergjencat natyrore përfshihen tërmete, stuhi, përmblytje, thatësira apo ngritje të niveleve të ujërave ato kanë qenë, janë e do të jenë pjesë e historisë së njerëzimit. Disa prej tyre mund të parashikohen, disa të tjera më pak e do të ketë vazhdimisht që vijnë papritur, pa kuptuar dhe me dëme të pallogaritshme.

Pyetja shtrohet a do të ketë edhe më tej tërmete? Sipas *Raportit* që përgatitet për OKB, në Universitetin për Mjedis dhe Siguri Njerëzore (UNU-EHS), ekziston një lidhje e fortë midis shpejtësisë së rrotullimit të Tokës dhe aktivitetit sizmik të saj. Është e pamundur të vihet re, natyrisht, por që nga viti 2011, planeti po rrotullohet gjithnjë e më ngadalë, se zakonisht (flitet për disa të mijtat e sekondës). Sipas shkencëtarëve kjo luhet (e vogël) mendohet se po rrit intensitetin e aktivitetit në thellësi të tokës dhe për pasojë numri i tërmeteve do të vijë në rritje. Pra intensiteti i tërmeteve do të vijë në rritje.⁹ *A rrezikohet vendi ynë?* Në po këtë raport, në kapitullin e Rrezikut Botëror, vlerësohet për 173 vende, përqindja e rrezikut për të përjetuar katastrofa natyrore (tërmete, stuhi, përmblytje, thatësira dhe ngritje të nivelit të detit). Në këtë raport, vendi ynë është vlerësuar me koeficientin 10.01, që konsiderohet nivel kritik dhe më i lartë se për Greqinë 7.36, për Turqinë 5.52, dhe Italinë 4.88¹⁰. Pra, i gjithë rajoni konsiderohet me rreziqet të larta për emergjencat natyrore dhe vendi ynë me më të lartën në rajon.

Në logjikë normale, njohja e mundësisë së rreziqeve mundëson njerëzit për ndjeshmëri më të lartë dhe komunitetin e strukturat për tu përgatitur në përballimin e emergjencave. Tërmete, stuhi, përmblytje e thatësira ka pasur e do të ketë. Aftësia është jo në eliminimin, apo mohimin e tyre, por reduktimit të efekteve negative. Duke u fokusuar te tërmeti si një katastrofë më e fundit shtrohet pyetja *nëse mund të përballemi me tërmetin?* Mjaft vende paraqesin histori dhe eksperiencat interesante, që nuk lidhen me fuqinë dhe mundësitë që ato kanë nga ana teknike, ekonomike dhe njerëzore, por nga mënyrë si menaxhohen. Dhe këtu spektri i menaxhimit shkon nga individi, familja deri në nivelin qendror.

Çfarë treguan tërmetet e 21 shtatorit e 26 nëntor, apo edhe 28 janarit? *Panik, lëvizje të çoroditura, mungesë totale organizimi në të gjitha nivelet. Përfshijtur viktimat, gati të gjithë të lënduarit patën shkak panikun.* Edhe pse vendi ka një histori të emergjencave natyrore, gjithçka dukej se ndodhte për herë të parë. Njerëz në panik, mungesë orientimi, organizimi dhe reagimi në situata të tilla. Reagimi në momentet fillestare, por edhe më vonë i njerëzve bazohej në instinkte dhe në njohuri autodidakte. Mungesë totale për veprim në raste emergjente, dhe organizmi të mëvonshëm. Kushdo mund të aktronte të diturin, heroin apo viktimën. Në mungesë të organizimit dhe orientimit që zëri i parë të ishte i sizmologëve, specialistëve të emergjencave dhe të sigurisë, orientimi i medieve për t'i ardhur në ndihmë me informacion komunitetit, vendin e zuri mjedisi kaotik, dhe njerëz të inspiruar për të qenë në qendër të vëmendjes.

Tre tërmetet treguan që ne jemi komuniteti më pak i përgatitur për

⁹ Universitetin për Mjedis dhe Siguri Njerëzore (UNU-EHS) (2018)

¹⁰ Universitetin për Mjedis dhe Siguri Njerëzore (UNU-EHS) (2018)

tërmete apo katastrofa të tjera natyrore. Shteti mund të gjykohej për gatishmërinë e strukturave, për shpejtësinë e organizimit, për gatishmërinë për të dërguar forca, mjekë apo edhe vullnetarë. Por “të jesh i përgatitur” do të thotë edhe më shumë se kaq. Ne na mungojnë jo vetëm njohuritë, por edhe shprehitë e përgatitjes së individit dhe komunitetit për një situatë krize krizë. Nëse njerëzit nuk dinë saktësisht se çfarë të bëjnë në raste emergjence, nuk lëvizin në drejtime të njohura më parë, nuk kryejnë veprime të organizuara, atëherë ne nuk jemi të gatshëm për të kuptuar fenomenin e aq më pak për të vepruar në raste emergjente¹¹. Dhe asnjë emergjencë nuk mund të përballohet kur nuk përgatitesh. Për këtë, nuk e ka fajin çka ishim para 30 viteve, por ajo që jemi tani. Që të mos të themi “...duhet të kishim bërë...” , duhet të praktikojmë veprimet në rast emergjence deri sa ato të bëhen shprehë... si natyrë e dytë... Vendi më i mirë për këtë janë shkollat, por edhe qendrat e punës publike apo private, por edhe ambientet e tjera, që duhet të detyrohen të praktikohen duke simuluar reagime në rast emergjencash. Kjo ndodh kudo në botë, vetëm në planetin tonë *Arbënor*, ato konsiderohen “zbor” ose shenja të diktaturës.

Nëse do të shohësh se ku jemi me përballimin e një emergjence, shih veprimet e njerëzve sapo dalin nga banesat e tyre¹². Kështu shprehet Burton nga Universiteti i Çikagos. Njerëzit largohen nga sytë këmbët, pa u orientuar aspak për në pikat e evakuimit. Luftën në tre rastet e tërmetit, në fazën e parë, atë të reagimit e kemi humbur pa dinjitet. Nuk i di askush ku janë pikat e evakuimit, nëse janë planifikuar. Ato duhet të jenë në çdo zonë banimi. Rruga për atje duhet të jetë e qartë dhe me tregues për në atë zonë. Pikat e evakuimit të tërmetit, të përmbytjeve apo katastrofave të tjera kërkohet të jenë saktësisht të njohura. Në tërmetin e fundit njerëzit nuk dinin asnjë pikë evakuimi, por vetëm rrugën për Elbasan apo për Prishtinë. Jo vetëm tregues për në këto pika si qendra të përcaktuara të evakuimit, por edhe hartat të hollësishme të rrugëve të lëvizjes duhet t’u shpërndahen çdo familje. Këto harta, të pajisen edhe me numra telefoni dhe kontakte urgjente. Me një zonë të caktuar evakuimi për çdo lagje, çdo banor mund të llogaritet shpejt. Mos harroni “sistemin e shokëve?”

Në mungesë të parandalimit të emergjencave, efektet mund të zbuten. Emergjencat natyrore, tërmetet nuk janë arritur të parashikohen, të tjerat: stuhi, përmbytje, thatësira parashikohen me vështirësi. Megjithatë, njerëzit janë të detyruar dhe duhet të përballen me këto fenomene. Të gjitha emergjencat kanë edhe karakteristika të përbashkëta që mund të kategorizohen në periudha: paraprake, e emergjencës; e reagimit dhe e rehabilitimit. Në shtetet dhe shoqëritë e zhvilluara mënyra e reagimit në secilën periudhë tregon edhe shkallën e organizimit e të funksionimit të tyre. Eksperienca dhe organizimi ndihmon vendet për të qenë sa më aktivë dhe të efektshëm në çdo fazë të emergjencave. Në periudhën paraprake subjektet dhe objektet zhvillojnë ndjeshmërinë për rreziqet dhe përgatiten për të reaguar duke ulur në maksimum më së paku efektet anësore të emergjencave natyrore.

Përgatitja nuk lidhet vetëm me programet për fëmijë në shkollë, por për të gjitha kategoritë. Nuk është rikthim në periudhën e mëparshme nëse funksionojnë alarmet e organizuara (sirenat), mënyrat dhe vendet e lëvizjes, grupet orientuese, pikat e kontaktit etj. Nuk është vetëm Japonia model i organizimit, por gjithë vendet e organizuara. Kujtojmë se sa të lënduar, vetëm nga paniku. A do të krijohet ajo situatë kaotike nga lajmi i çmendur “për tërmetin e orës 23.30”. Ishte një shans që “lajmi” u përhap disa orë

¹¹ Stephen Green, *International Disaster Relief* (NewYork: McGraw-Hill, 1977), p. 36.

¹² Burton, Kates, and White, *The Environment as Hazard*, pp. 189-95.

përpara. Po nëse intervali do të ishte vetëm 10 minuta ose më pak. A do të kishte efekt një “fakenews” i tillë nëse radio, televizorët, operatorët celularë do të kishin atributin e vetëm për të dhënë sinjalet e emergjencës? Askush deri 30 minuta para orës se tërmetit të madh nuk përgënjeshtroi këtë lajm ogurzi. Nëse do të kishte organizim edhe altoparlantët që shpërndajnë ujë nëpër lagje mund të ndihmonin njerëzit në trotuare apo në trafikun e emigrimit drejt Elbasanit. Janë të gjitha mundësitë që të parandalohen rreziqet anësore e jo të rilindim pas kaosit. Edhe për tre periudhat e tjera (emergjencës; e reagimit dhe e rehabilitimit) mund të gjenden mjaft mënyra ndryshe për tu organizuar dhe drejtuar. Kujtojmë që dje, mënyra e veprimit të çdo qytetari ishte kaotike, referuar në instinkt apo në njohuri të fituara në mënyrë spontane dhe autodidakte.

Tërmeti është një thirrje që siguria ka në esencë individin. U ngrit një debat nëse tërmeti dhe gjithë dukuritë e tjera të lidhura me atë përbënin cenim të sigurisë. Në konceptin klasik ku me siguri supozohet sovraniteti, cenimi i kufijve shtetërorë apo përdorimi i mjeteve ushtarake tërmeti nuk e cenoi sigurinë. Në konceptin bashkëkohor ku mbrojtja e individit është në esencë të sigurisë, tërmeti e cenoi dhe e tronditi sigurinë. Në këtë kontekst edhe rreziqet e tjera. Koncepti i sigurisë, ndryshe nga më parë, sot paraqitet si një trekëndësh që në kulmet e veta ka: sigurinë (mbrojtjen) kombëtare, sigurinë (marrëdhëniet) ndërkombëtare dhe sigurinë humane (individin). Prioritetet për pozicion kulmor varen nga konteksti i ngjarjeve. Tomas Hobs, një nga krijuesit e filozofisë moderne shprehet se “... pa siguri nuk ka vend për industri... për art, për letërsi, për shoqëri dhe çfarë është më e tmerrshme... pa siguri reflektohet një ankth i pandërprerë, dhe rreziku i dhunshëm për jetën, vetmi, varfëri, mizerje, brutalitet dhe pamjaftueshmëri...”¹³. Kishte kohë që te njerëzit, kur flitej për siguri, mendohej diçka më formale: ideja e mbrojtjes kombëtare apo situatës ndërkombëtare dhe me përdorimin e mjeteve kryesore të luftës.

Tërmeti tregoi se ka ardhur koha që çështjet e sigurisë të trajtohen nga profesionistë dhe vetë siguria të kapërcejë dilemën për tu njohur si profesion. Nëse zhvillimi tenton drejt zgjerimit të mundësive, atëherë siguria (humane/njerëzore) krijon shtratin e vet për si objekt dhe subjekt që trajton shmangien, zbutjen dhe përballimin e kërcënimeve. Siguria humane sot, pranuar në këtë standard edhe nga OKB që në vitin 1994 i referohet shtatë drejtimeve kryesore që përfshijnë: sigurinë ekonomike, ushqimore, shëndetësore, ambientale, fizike, komunitare dhe politike. Pra, siguria njerëzore, si një qasje ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare u jep përparësi qenieve njerëzore dhe ndërveprimeve të tyre komplekse sociale dhe ekonomike. Vendosja e agjendës së sigurisë përtej sigurisë shtetërore nuk do të thotë ta zëvendësosh atë, por të plotësosh dhe të ndërtosh atë. Ajo që tërheq vëmendjen, në këtë rast është fakti që veç e veç ekzistojnë pjesët e mozaikut të sigurisë, por vetë mozaiku është i shpërndarë dhe do të jetë pak efektivë deri në momentin që ky mozaik funksion si një ansambël.

Vendosja e agjendës së sigurisë përtej sigurisë shtetërore nuk do të thotë ta zëvendësosh atë, por të plotësosh dhe të ndërtosh atë. Në përfundim mund të konstatohet fakti që ashtu si çdo fushë tjetër edhe më shumë siguria ka nevojë për profesionistë, njerëz që menaxhojnë çështjet e sigurisë. Forcat e armatosura, forcat e rendit dhe strukturat e tjera ndihmojnë në menaxhimin e situatave të sigurisë humane, por nuk kanë mbrojtjen nga humane, mbrojtjen nga rreziqet natyrore si objektin e tyre kryesor¹⁴. Drejtimet që

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹³ Hobs, Thomas, *Human Nature: or The fundamental Elements of Policie*.

¹⁴ Qendra Rajonale Mjedisore për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) Katastrofat dhe Rreziqet: Informacioni dhe Komunikimi (2015).

përfshijnë: ambientale, fizike, shëndetësore, ushqimore, ekonomike dhe politike nuk janë objekti kryesor i tyre. Fusha kërkon specialistë, profesionistë që analizojnë situatat emergjente që kërcënojnë sigurinë, përgatisin politika dhe doktrina për vendimmarrësit. Ata menaxhojnë struktura dhe zbatojnë plane për të minimizuar apo shmangur pasojat ndaj sigurisë. Po, ku përgatiten specialistët e sigurisë? Kjo mbetet një sfidë për institucionet arsimore. Alvin Tofler shprehet se fitorja i buzëqesh atij që parashikon ndryshimin në natyrën e rrezikut, jo tek ata që presin të adaptojnë veten pasi ndryshimi ndodh.

Në mes të tërmetit... dhe strategjia...! Ka pasur thirrje të pandërprera nga aleatët në të dy anët e Atlantikut, për të gjetur apo ndërtuar një konsensus apo pakt mbarëkombëtar për të kapërcyer krizat dhe tragjeditë. Leximi nga elitat tona ka qenë nga më të skajshëm deri në “shkelje të sovranitetit”, kuptohet të merakosur për veten jo për vendin. Në një gjuhë më të plotë konsensusi apo pakti shpreh atë që mund të konsiderohet si themeli i një strategjie të madhe kombëtare. Me rastin e tërmetit, më së miri modelin e paktit/konsensusit/strategjisë e demonstrojnë dy aktorë të mëdhenj: së pari populli ynë me solidaritetin e shkëlqyer, dhe së dyti, ndërkombëtarët, gati me të njëjtin solidaritet. Ndërsa, klasa politike edhe njëherë “mbeti në klasë”. Tërmeti ndoshta është thirrja e më e fundit, por mos qoftë e fundit. *Kombi nuk shuhet, por elitat që nuk arrijnë nivelin e popullit*, - shprehej Dritëroi i Madh, - *shpejt ose vonë mbarojnë*. Është koha më e mirë për të formuluar një pakt/strategji me konsensus për çështjet më të rëndësishme kombëtare. Ky është moment historik dhe shmangia e elitave nga përgjegjësia do të jetë po aq gabim historik.

4. A po ndryshojnë dimensionet e sigurisë kombëtare?

Me çfarë diskutuam më lart e mbi atë sfond, tani është e dobishme t'i drejtohem pyetjes së shtruar që në fillim: a po ndryshojnë dimensionet e sigurisë kombëtare? Konteksti i çështjeve që mbështesin, ose kërcënojnë, strukturat e një shteti dhe integritetin e tij territorial janë, praktikisht përtej një çështje të përkufizimit, por që shqetësojnë më shumë. Dy supozime kryesore dhe të qarta që mbështesin pikëpamjen tradicionale janë: 1) se siguria e një shteti është relativisht absolute; dhe, 2) që konflikti midis ideologjive që në forma të ndryshme përcaktonin gjeopolitikën po bëhen më pak të vlefshme. Shkalla në të cilën këto ndryshime shihen si reale ose të qëndrueshme varjon ndaj nuk mund të jetë e lehtë për të nënkuptuar konsensus në këtë pikë. Si në çdo mjedis që ndryshon me shpejtësi, ka dallime të konsiderueshme në perceptimin individual dhe institucional, dhe rëndësia e dhënë trendëve dhe zhvillimeve të ndryshme të mundshme. Jessica Mathews (1977) dhe mjaft të tjerë besojnë se jetojmë në një botë tjetër¹⁵.

5. Përfundim

Në nivelin konceptual, pra, fillimisht mund të paraqesim një parashtrim me tre pjesë për të përcaktuar nëse një çështje apo shqetësim mjedisor përfshirë katastrofat natyrore duhet të konsiderohet si çështje “e sigurisë mjedisore”:

1. A janë ndikimet e mundshme të shqetësimit mjedisor në fjalë mjaft të konsiderueshme për t'u konsideruar një kërcënim i sigurisë kombëtare?

2. A janë lidhjet midis katastrofave natyrore dhe ndikimit të tyre në nivelin e çështjeve

¹⁵ Mathews, J. T.. 1989. Redefining security, *Foreign Affairs* 68:162-177.

të sigurisë kombëtare deri në nivelin e argumentimit të një kolapsi dhe që mund të ketë deri ndikime politike e mund të gjenerojë trazira sociale?

3. Edhe nëse kërcënimi dhe rreziku nga katastrofat natyrore, janë thelbësorë, të sigurt apo të afërt, a janë institucionet dhe instrumentet e sigurisë kombëtare më së shumti të aftë për të dhënë një përgjigje efektive? Dhe, nëse është e mundur, a vlen kjo për të gjithë rreziqet apo vetëm për dukuritë dhe dimensionet të caktuara të kërcënimit? Është e vështirë të merren parasysh këto pyetje pa njohur pasigurinë e nënkuptuar në konceptin e “sigurisë nga katastrofat natyrore”. Po aq, sidoqoftë, është e qartë edhe nga ky material se ndërthurja midis dy koncepteve janë të pashmangshme.

Bibliografi

1. Allenby, B. R. In press. *Industrial Ecology: Policy Framework and Implementation*. Boston.
2. Alexander, *Natural Disasters*, Burton, Kates, and White, *The Environment as Hazard*,
3. Christopher, W. 1996. American diplomacy and the global environmental challenges of the 21st century, speech at Stanford University, April 9.
4. David Alexander, *Natural Disasters* (London: UCL Press, 1993), Fleishman, R., 1995 (summer), Environmental security: concept and practice, *National Security Studies Quarterly*, Goldstone, J. A., 1996, “Debate,” Environmental Change and Security Project Report
5. Hartwell, R. V. III and L. Bergkamp. 1994. Environmental trade barriers and internacional competitiveness, 24 *E.L.R.* 10109-10115.
6. Homer-Dixon, T., J. H. Boutwell, and G. W. Rathjens. 1993. Environmental changeand violent conflict, *Scientific American*
7. Ian Burton, Robert W. Kates, and Gilbert F. White, *The Environment as Hazard*, 2nd ed. (New York: GuilfordPress, 1993),
8. Janet N. Abramovitz, “Unnatural Disasters,” *World Watch* 12 (July/August 1999),
9. Mathews, J. T.. 1989. Redefining security, *Foreign Affairs*
10. Mjedisi Sot Katastrofat natyrore si politikë dhe (pa) drejtësi sociale Editorial (2015)
11. Oliver-Smith, *Natural Disasters and Cultural Responses*, p. 3
12. Qendra Rajonale Mjedimore për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) Katastrofat dhe Rreziqet: Informacioni dhe Komunikimi (2015)
13. Raul, A. C., and P. E. Hagen. 1993. The convergence of trade and environmental law, *Natural Resources and Environment*
14. Renner, M., 1989. National security: the economic and environmental dimensions,
15. World watch Paper Number 89.
16. Stephen Green, *International Disaster Relief* (NewYork: McGraw-Hill, 1977).

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Moti ekstrem dhe siguria kibernetike në Shqipëri

■ **Prof. Dr. Petrit ZORBA**
*Instituti i Gjeoshkencave,
Energjise, Ujit dhe Mjedisit
(IGJEU), Tiranë, UPT
petrit.zorba@gmail.com*

■ **MSc. Elsuida HOXHA**
*Instituti i Gjeoshkencave,
Energjise, Ujit dhe Mjedisit
(IGJEU), Tiranë, UPT
elsahoxha639@gmail.com*

■ **Ing. Rubens MUÇA,**
*"R. M. CRYPTONET"
r.muca@cryptonet.al*

■ **Prof. Asc. Dr. Odhise KOÇA**
*Fakulteti i Mekanikës, UPT
odisekoca2008@hotmail.com*

Abstrakt

SNdonëse në dukje të parë pa ndonjë lidhje, në ditët e sotme, dukuritë ekstreme të motit, shpeshherë, për hir të mungesës në kohën e duhur të informacionit, zotërimit të parashikimit të përshtatshëm profesional meteorologjik, shpëmdarjes së informacionit tek të interesuarit, para ngjarjes, gjatë apo edhe pas, janë bërë burim jo vetëm për dëme ekonomike, por dhe për humbje jetësh njerëzore. Gërshetimi i dukurive ekstreme me tipologji nga më të ndryshmet natyrore, por jo vetëm, që pasojnë njëra-tjetrën dhe shoqërohen më tej, me bllokimin e rrjedhës së informacionit, tjetërsimin e funksionimit të teknologjive prodhuese, që bazohen gjithnjë e më shumë në sisteme informatike të automatizuara, apo fshirje të bazës së të dhënave, përbëjnë humbje të mëdha për ekonominë dhe shoqërinë. Në këtë material prezantohen sektorët më të prekshëm, të cilët në rast se dëmtohen nga dukuri të caktuara ekstreme natyrore, me ose pa qëllim, mund të shoqërohen edhe me emergjenca kibernetike, të cilat mund të përkeqësojnë ndjeshëm situatën, të vështirësojnë rikuperimin e gjendjes dhe sjellin dëme ekonomike, sidomos në ato veprimtari që funksionimin e tyre e kanë të lidhur me serverë dhe komunikim informatike, siç janë sistemet e ndryshme të prodhimit dhe të transmetimit të energjisë elektrike, bankat, minierat, apo industri përpunuese, transporti ajror brenda hapësirës së Shqipërisë, fusha ushtarake, platforma pune me bazë, ose jo, në "clouds", etj. Ndikime të tjera me pasojë negative mund të vijnë si pasojë e daljes jashtë kontrollit nga sulme kibernetike ndaj sistemeve dhe platformave të modifikimit të motit, të cilat e shtrijnë efektin e tyre në hapësira të gjera, ku mund të preket edhe territori i vendit tonë. Për më tepër, edhe në kushte normale, në mjaft raste moti i keq apo moti i hapësirës përkeqëson lidhjet satelitore dhe për rrjedhojë hapësirat rriten, ku ndërhyrjet keqdashëse kibernetike të fshihen nën këto aspekte, ndaj njohja, analizimi dhe prezantimi i këtyre opsioneve janë me interes për institucionet përkatëse të sigurisë.

Fjalëkyçe:

moti, siguria kibernetike, meteorologjia, klima, dukuri ekstreme natyrore.

1. Hyrja

Në ditët e sotme kompjuterët janë prezentë kudo dhe automatizimi është pjesë e jetës tonë me mënyrat nga më të ndryshmet. Teknologjitë e fundit kanë krijuar mundësinë që një pjesë e madhe e infrastrukturës të kontrollohet në mënyrë të automatizuar, duke nisur që nga prodhimi e shpërndarja e energjisë, furnizimi me ujë, transporti në hapësirën ajrore, detare dhe rrugore, institucionet financiare, spitalet, sistemet e kontrollit në pikat kufitare, etj. Të gjitha këto përfitime që njerëzimi po jeton, mbartin në vetvete gjithnjë e më shumë rrezeqe, duke na bërë shumë të prekshëm prej sulmeve të mundshme kibernetike. Përparimi i teknologjisë me galop mbart dhe një pasiguri të shumëfishtë, e cila po bëhet një normalitet tanimë. Ndaj, që të mund të jemi të sigurt, e gjithë kjo duhet marrë shumë seriozisht duke krijuar një nivel të lartë sigurie kibernetike.

Pjesa më e madhe e veprimtarisë njerëzore lidhet drejtpërdrejt me internetin, i cili kontrollon gjithçka, duke filluar që nga llogaritë bankare e deri te veprimtaritë më normale, si rrjetet sociale, apo *show-t* televizive, të cilat në vetvete përbëjnë një rrjet me të cilin njerëzimi vepron dhe ndërvepron në mënyrë të pashmangshme. Për të pasur një stabilitet në sigurinë kibernetike duhet që në mënyrë të vazhduar ai të mbikëqyret. Zhvillimi shumë i shpejtë i teknologjisë me një sërë lehtësirash nga pas, mbi njerëzimin shton dhe rëndësinë e kibernetikës. Informacione dhe të dhëna të shumta ruhen në nivel si individual, ashtu dhe institucional, lokal apo shtetëror, duke imponuar dhe nevojën e padiskutueshme për të pasur një rritje të sigurisë kibernetike në fushën digjitale, si një parapritë ndaj sulmeve kibernetike. Sot, bota ka provuar mundësinë dhe ekzistencën e sulmeve kibernetike edhe në fushën e meteorologjisë, duke ndërhyrë në

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

“weather cyberspace” e duke shkaktuar në vijim një sërë dëmsh duke nisur që nga ushtria, ekonomia, infrastruktura, etj. Sulmet kibernetike janë akte që kryhen nga “atentatorë”, të cilët mbeten të paidentifikuar në mjaft raste për shkak se është shumë e vështirë të përcaktohet vendndodhja e tyre, ndaj kundërpërgjigja në këto raste nuk ka vend. Sulmet kibernetike kanë përparësi kundrejt mbrojtjes, ndaj dështimi minimalist, në rrjetin kibernetik, i hap rrugën një sulmi të suksesshëm kibernetik.

Studimet dhe praktikat kanë vërtetuar që siguria kibernetike është nga çështjet më kritike, dhe njëkohësisht edhe sfidë, për gjithë infrastrukturën digjitale, e cila është e një rëndësie të veçantë për çdo shtet. Por, ajo që duhet të theksohet si më e veçantë në këtë punim, ka të bëjë me gërshetimin dhe mbivendosjen ndaj pasojave të përcjella nga një dukuri natyrore (cilado qoftë ajo, jo vetëm nga moti, por dhe të tjera), e një problematike tjetër, e cila mund të vijë dhe t’i mbivendoset përkohësisht një problematike të krijuar më parë prej dukurive natyrore ose jo vetëm, dhe që lidhet ngushtësisht me fushën kibernetike. Kjo mund të jetë me, ose pa qëllim.

2. Meteorologjia, moti, klima dhe kibernetika

Nga viti 1900 deri në vitin 1950, meteorologjia kuptohej si një shkencë që merrej me zbulim, me teori dhe me eksperimentime për të studiuar sa më mirë atmosferën dhe dukuritë që vrojttoheshin në të. Më pas, ajo përshkruhet si një fushë pune shkencore, që kërkonte përpjekje nga shumë vende, për të krijuar një “bazë të dhënash” të pasur me të dhëna, e cila duhej të ofronte qasje për të realizuar infrastruktura parashikuese mbi motin. Ngjashëm me meteorologjinë, para vitit 1950, historia e sigurisë kompjuterike ka qenë gjithnjë e lidhur me inovacionin.

Në ditët e sotme kompjuterët më të fuqishëm realizohen nga vendet më të zhvilluara, çdo 6 muaj dhe janë të dedikuar për meteorologjinë dhe platformat e parashikimit të motit në tokë si dhe për motin e hapësirës, produkte të cilat mundësojnë informacione me mjaft rëndësi për sektorë të ndryshëm të ekonomisë botërore, siç janë sistemet e transmetimit të energjisë (elektrike, gazit, atomike, etj.), transportit ajror, detar, komunikimeve satelitore, atyre mediatike në shkallë planetare, mbrojtjes, etj.

Edhe gjatë viteve të Luftës së Ftohtë, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik raportuan modelet e motit tek njëri-tjetri dhe pjesa tjetër e botës. Ky është një shembull i mrekullueshëm i bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërkombëtar për të mirën më të madhe, në interes të marrjes së vendimeve të duhura në lidhje me sigurinë publike, bujqësinë, sigurinë civile, transportin, sigurimet, etj.

Siç dihet rreth 100 vjet më parë, bashkësia ndërkombëtare vendosi se ishte e dobishme për të gjithë vendet, rajonet dhe hemisferat - të ndanin informacionin dhe teknologjinë e lidhur me motin për t’u përgatitur dhe për të trajtuar rreziqet e mundshme. Bashkë me këtë nisi dhe bashkëpunimi në fushën e telekomunikimit dhe transmetimit të dhënave, nga sistemi mors, telefonik, faks, e deri te ai nëpërmjet internetit, satelitëve dhe kompjuterëve në ditët e sotme.

Pikërisht për humbjen e të dhënave në raste aksidentale ose prej sulmeve kibernetike, “British Met Office” e ruan informacionin bazë meteorologjik si në versionin digjital ashtu dhe në “hard copy”, në letër, ashtu siç bëhej para një shekulli e deri në fund të viteve ‘90. Kjo kish lindur si domosdoshmëri pikërisht prej një precedenti humbje “bazë me të dhëna”, në një prej sistemeve dhe arkivave të NASA-s, disa vite më parë.

Në botë ka pasur shumë përpjekje zyrtarisht të dështuara për modifikimin e motit

por që përpjekjet vazhdojnë pasi shtete të fuqishme në botë po investojnë me buxhete të dedikuara sa i takon modifikimit të motit. Ajo çka është mjaft e sigurt është përdorimi i motit në favor si dhe parashikimi se si moti do të ndikojë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe në industri. Moti ndikon gjithashtu dhe operacionet ushtarake, por nevojat me specifike dhe ndryshimet më të ndjeshme janë te ushtria, marina dhe forcat ajrore. Ndërsa flota detare dhe ato ajrore kanë një nevojë në rritje për parashikim të saktë strategjik global. Persona të posaçëm sipas fushave si energjetika, aviacioni, ushtria, marina, etj., përdorin dhe shfrytëzojnë parashikime të sakta, në kohë reale, të ecurisë së motit. Ndaj zhvillimi i teknologjive dhe strategjive të ndara dhe të pavarura sipas fushave duke ndarë elementët e përbashkët, ndihmon në zhvillimin e mëtejshëm, hartimin e strategjive individuale me një siguri më të lartë dhe minimizimin e dëmeve ndaj sulmeve kibernetike. Shërbimet meteorologjike punojnë me stacione të përbashkëta moti duke siguruar paralajmërime dhe këshilla, buletine ditore apo dhe orare mbi rrezikshmërinë e motit, parashikime të motit për operacione ushtarake tokësore dhe ajrore, etj. I gjithë ky rrjet bashkëpunimi, sa i takon shërbimit meteorologjik të shkëmbimit të bazave së të dhënave dhe informacioneve mbi motin dhe kushtet atmosferike të pritshme, mund të bjerë pre e sulmeve kibernetike, duke shkaktuar dëme të parikuperueshme dhe me pasoja fatale për vetë organizmat që operojnë mbi bazën e këtij rrjeti, por rrjedhimisht dhe vetë shoqëria. Nëse i referohemi aviacionit parashikuesit marrin një qasje globale për të analizuar motin kundrejt parashikuesve të industrisë energjetike, transportit etj., por kurrësi nuk mund të përcaktojnë me siguri se nga mund të na vijnë dëmet më të mëdha. Sulmet kibernetike nuk respektojnë kufij gjeografik apo territore të caktuara, sidomos në sulmet kibernetike të motit.

Elementi më i rëndësishëm që e ka çuar përpara parashikimin e motit, monitorimin e ngjarjeve ekstreme dhe parashikimin e motit ekstrem është aftësia e përmirësuar e të ashtuquajturve superkompjuter, të cilët kanë bërë të mundur rritjen e të dhënave, disponueshmërinë e tyre në pjesë të ndryshme të botës, duke gjeneruar informacione shumë nevojshme dhe të rëndësishme. Nëse e gjithë baza e të dhënave do prekej nga një sulm kibernetik pasojat mund të jenë deri në katastrofike, pasi mundësia e parashikimit të një tornadoje, stuhie shiu, breshëri, etj., nuk do ishte e mundur ose dhe mund të manipuloheshin të dhënat gjë e cila mund të sillte pasoja të rënda deri dhe në humbje jete, dëmtime të infrastrukturës, dëmtime të digave, mungesë elektriciteti, pezullim të fluturimeve, pezullim të transportit detar, e një sërë efektesh të tjera.

Siguria kibernetike është një nga çështjet më të rëndësishme po aq sa vetë ndryshimi klimatik, i cili po i sjell njerëzimit dëme kolosale. Indirekt parandalimi i mëtejshëm i ndryshimit klimatik mund të mbështet dhe nga një siguri e lartë kibernetike. Vendi ynë bashkëpunon duke shkëmbyer të dhëna dhe informacione me një sërë qendrash europiane të parashikimit dhe vlerësimit të motit ndaj si e tillë mund të jetë e ndjeshme ndaj sulmeve kibernetike meteorologjike në çdo moment. Për më tepër sidomos në fushën e meteorologjisë sulmet kibernetike nuk njohin kufij shtetërorë, siç dhe vetë frontet atmosferike nuk konsiderojnë kufij tokësor.

Por, po të imagjinohet për një moment se i gjithë ky informacion i rëndësishëm meteorologjik mbi masën ajrore të keqpërdoret nga një aplikim jo korret i teknologjive mbi modifikimin e motit apo në se këto platforma të devijohen nga hakerët duke maksimalizuar dukuri atmosferike që sjellin situata dhe dukuri ekstreme të motit, atëherë dëmet mund të jenë të pallogaritshme. Në vendin tonë në vitin 1986 u krijua Instituti i Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar (INIMA). Një prej argumenteve bindëse

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

që influençoi në miratimin e ngritjes së saj ishte pikërisht përpunimi i informacionit meteorologjik, pasi për atë kohë një qendër e tillë dukej si e parakohshme, për palën e huaj që do ta ofronte duke pasur parasysh zhvillimin e vendit tonë. Në prill 2021 një marrëveshje midis kompanisë *Microsoft* dhe "British Met Office" synon realizimin e një prej super kompjuterëve më të fuqishëm për momentin në botë.

3. Fushat dhe sektorët më të prekshëm në Shqipëri nga sulmet kibernetike dhe problematikat

Natyrisht fushat më të prekshme janë ato që e kanë domosdoshmëri funksionale përdorimin e kompjuterëve dhe sistemeve të caktuar teknologjike apo komunikimit.

- Sektori i prodhimit dhe transmetimit, jo vetëm brenda vendit, por dhe ai në lidhje me jashtë, ku një problematikë e krijuar mund të sjellë nga humbje të dhënash dhe humbje financiare, deri në çështje të tjera më të komplikuar.

- Sistemi i transportit ajror jo më shumë për ato avionë që ngrihen e ulen në aeroportin e Tiranës (Rinas), që maksimumi janë 40 apo 50 në stinën e verës dhe rreth 20 në dimër (fluturime në ditë), por për ata mbi 1000 që fluturojnë mbi hapësirën e vendit tonë dhe duhet të komunikojnë me kullën e kontrollit dhe shkëmbejnë informacionet e duhura, jo vetëm meteorologjike, sa i takon kalimit brenda hapësirës së Shqipërisë.

- Sistemi bankar, është më se e qartë se jo vetëm transaksionet bankare, baza me të dhëna por dhe ndërveprimet bankare me jashtë, e shumë aspekte të tjera profesionale të këtij sektori do të komprometoheshin rëndë nëse do të kishte një sulm kibernetik.

- Sistemi i kontrollit të pikave kufitare për njerëzit dhe mallrat si në kufijtë tokësorë, ashtu dhe në porte e aeroporte, do të pësonte një paralizim dhe mbrojtja dhe pasja në dispozicion e alternativave funksionale të tjera do të duhet të jetë një prioritet.

- Industri të caktuara nxjerrëse të mineraleve, por dhe ato përpunuese të industrisë ushqimore, apo degëve të tjera të industrisë, të cilat me teknologjitë e reja e kanë të pashmangshme përdorimin e platformave dhe sistemeve kompjuterike profesionale, do të pësonin dëme duke filluar që nga një bllokim i përkohshëm e deri në dëme më të komplikuar ku zbulimi i problematikës, dhe rregullimi i tyre do të kërkonin kohë dhe shpenzime ekstra, në mos dëmet do të kërkonin dhe shpenzime shtesë për blerje pajisjesh apo pjesësh këmbimi të reja.

- Telekomunikacioni me gjithë komponentët dhe sektorët që mbulon, përfshi dhe medien do të ishin me pasojë të shumanshme, ndonëse për ato vetë mund të mos jetë dëm i madh, por mosfunksionimi i tyre do të përbënte një mungesë në informimin e popullatës dhe përshkrimin e situatës, duke mos ndihmuar në evidentimin e dëmeve dhe hapësirës së prekur nga dukuria ekstreme, por duke e vonuar me tej dhe ndërhyrjen në kohën e duhur dhe vendin e duhur.

Për vendin tonë, ndonëse ekziston një bazë ligjore, e cila mbulon aspekte të kimit në fushën e kibernetikës, duhet thënë se në përgjithësi kjo tematikë dhe problematika e saj nuk ka pasur interesin e duhur nga drejtuesit si të kompanive e bizneseve private ashtu dhe atyre të institucioneve të shtetit. Kjo për shumë arsye, së pari mungesa e njohurive të duhura nga drejtuesit për të kuptuar rëndësinë e problematikës, së dyti mungesa e infrastrukturave të duhura qoftë në harduer, e po ashtu dhe në staf të trajnuar të kësaj fushe. Në sektorin shtetëror, vlen të theksohet fakti, se për shkak të një pagese më të vogël, ekspertët e kësaj fushe largohen drejt sektorit privat ose jashtë

vendit, duke krijuar një hapësirë më të cenueshme ndaj sulmeve kibernetike në infrastrukturën shtetërore kritike.

Koncepti i politikave të sigurimit, siç bëhet për një makinë, një objekt, apo një pronë për të qenë e mbrojtur nga aksidentet, zjarri, përmblytjet, tërmetet apo dukuri të tjera natyrore, duhet të shtrihet dhe në fushën e kibernetikës. Kësisoj subjektet do të duhet të plotësojnë dhe përmbushin standardet e punës në këtë fushë duke bërë të mundur minimizimin e pasojave në raste të tilla. Kësisoj, herë pas here problematika të caktuara janë shfaqur në vendin tonë. Duke nisur nga ato më të fundit, por të evidentuara dhe parë;

- referuar dhe medias në ditët e fundit të prillit 2021, u evidentuan sulme dhe hakerime ndaj procesit dhe aplikacioneve që kishin të bënin me zgjedhjet;

- po ashtu, shpërndarja e bazës me të dhëna personale, gjithashtu është një rrjedhje, ndonëse jo kibernetike në pamje të parë, por që mund të sjellë në një moment të dytë lehtësira për sulme më të ngushta dhe specifike kibernetike;

- gjithashtu në mjaft institucione Kontrolli i Shtetit në vitet e fundit ka evidentuar dhe lënë detyra për standardet dhe plotësimin e disa kriterëve në fushën e sigurisë së të dhënave, mbrojtjes së tyre, shfrytëzimit dhe sigurimit të “back-up” të nevojshme si për funksionin normal në rast problematikash dhe sulmesh kibernetike ashtu dhe për ruajtjen e të dhënave. Disa të dhëna nga më të fundit në fushën e ndërlidhjes së informacionit meteorologjik dhe fushës së kibernetikës dhe sigurisë që duhet siguruar do të ishin me mjaft interes në fushën e digave. Përkundër faktit që digat mund të jenë në rrezik kryesor prej reshjeve dhe prurjeve të shumta, monitorimi i tyre dhe vënia në dijeni për situatën është mjaft e rëndësishme, pasi eksperiencia të caktuara si precedent negative në vende të tjera, kanë evidentuar problematika kibernetike dhe mos funksionimi dhe transmetimi *online* direkt ka çuar në situata vërtet problematike që kanë kërkuar zgjidhje të momentit të fundit.

4. Këndvështrimi në botë sot për këtë problematikë

Sulmet kibernetike ndonjëherë mund të shfaqen duke mos u marrë vesh fare se nga vinë, duke shkatërruar bizneset dhe duke dëmtuar të gjitha nivelet e qeverisjes. Por, si ngjarjet ekstreme të motit, edhe ato kanë shenja paralajmëruese, nëse dikush di se ku t’i kërkojë ato dhe kë të informojë për ndonjë ndodhi të dyshimtë. Aktiviteti i dyshimtë në një aeroport në një vend ta caktuar disa javë më parë mund të shndërrohet nesër në një çështje problematike dhe me pasoja në një aeroport tjetër, gjë që mund të lidhet me luftën ekonomike midis kompanive ajrore, me rënie aksionesh në bursë, apo me veprimtari terroriste dhe në rastin më të keq, duke kushtuar jetë njerëzish. Këto lloj sfidash kibernetike do të jenë problemet e shekullit 21.

Për të mbrojtur njerëzit dhe për të ndihmuar bizneset, bordet ekzekutive dhe komuniteti global duhet të përshtaten me realitetin e ri të drejtuar nga kibernetika; dhe për të marrë vendime të mira, drejtuesit dhe bashkësia globale duhet të kenë të dhëna të sakta dhe në kohë.

Duke e parë nga dy këndvështrime të ndryshme, nga industria dhe teknologjitë si dhe nga politika ndërkombëtare, është e qartë për ne se ndarja e informacionit kibernetik midis bizneseve, qeverive dhe përtej kufijve është zgjidhja e duhur. Mund të jetë, po aq efektiv sa ka qenë dhe vijon, edhe shkëmbimi i informacioni meteorologjik sot.

Gjithsesi duhet thënë se ndryshe nga të dhënat për modelet e parashikimin të dukurive

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

të rrezikshme të motit, të dhënat kibernetike dhe mësimet e parashikimet që mund të mbliidhen prej tyre, nuk ndahen gjerësisht. Në fakt, grumbullimi i informacionit është normë.

Kjo qasje e fshehtë ndaj të dhënave kibernetike mund të jetë përfundimisht vdekjeprurëse. Kjo është arsyeja pse mbi 20 vjet më parë, SHBA-ja filloi të formojë qendrat e ndarjes dhe analizës së informacionit (ISACS) për të lehtësuar ndarjen e informacionit për infrastrukturën kritike, si financat, nafta dhe gazi dhe baza industriale e të mbrojtjes. ISACS janë organizata jofitimprurëse që mbledhin, analizojnë dhe shpërndajnë informacion të dobishëm në lidhje me fushën e kërcënimeve kibernetike midis anëtarëve, duke siguruar mjete dhe gjetur mënyrat për të zbutur rreziqet dhe për të rritur qëndrueshmërinë.

Po ashtu në vitet që vinë një ngritje e niveleve teknologjike në çdo fushë të jetës duke përfshirë me shumë përdorim të inteligjencës artificiale për të rritur performancën dhe efektivitetin e punës dhe veprimtarisë së njeriut në çdo sektor do të jetë pashmangshmërisht e ndërlidhur dhe me komponentin paralel të sulmeve, apo ndërhyrjeve kibernetike, të sofistikuara të cilat mund të alternonin veprimtarinë, apo edhe të çonin deri në vetasgjësim të vetë pajisjeve (dëmtime të riparueshme). Në pamje të parë, mund të duket si fantazi, por mundësitë do të jenë të tilla që pajisjet teknologjike me AI do të jenë të afta të ndjekin një proces teknologjik të caktuar në një veprimtari ekonomike (industri përpunimi, etj.) nga fillimi deri në fund pa ndihmën e njeriut. Pikërisht një ndërhyrje (kibernetike) në mënyrën e të "mëduarit" të tyre (vetë programimit) do të mundësonte një prodhim skarco ose jocilësor, në rastin më të mirë, dhe në rastin më të keq, një dëmtim serioz të së gjithë infrastrukturës teknologjike.

Në këto kushte, duhet që nga ana tjetër, edhe fusha në sektorin e sigurisë kibernetike të përqafojë dhe përfshijë edhe inteligjencën artificiale, e pikërisht, për të rritur nivelin e mbrojtjes në çdo sektor, përfshi edhe rastet me hipotetike që kanë lidhje me ndikime indirekte të dukurive ekstreme të motit, etj.

- Disa të dhëna të fundit tregojnë se 65% e shpërblimeve të paguara për kriminelët, bëhet nëpërmjet internetit, në Francë.

- Telekomunikimi është bërë një realitet i ri në shumë industri, i cili ka krijuar disa dobësi që nuk ekzistonin më parë. Me rritjen e punës nga shtëpia pasojë e krijuar nga situata e pandemisë u reflektua dhe me një rritje me 768% të sulmeve kibernetike përmes RDP-së (Remote Destop Protocol).

5. Siguria kibernetike, përgjatë vitit 2021 dhe në vijim do të jetë gjithnjë e më shumë problematike

Pas një viti 2020 të shënuar nga sulme kibernetike rekord, parashikimet e ekspertëve të sigurisë kibernetike për vitin 2021 nuk janë aspak optimiste. Informacionet deri më sot sugjerojnë që do të ketë gjithnjë e më shumë sulme dhe sulme më të sofistikuara kibernetike.

6. Përfundime

- Zbatimi i standardeve teknike në çdo sektor të veprimtarisë ekonomike të Shqipërisë apo BE-së (kur ato nuk ekzistojnë në vendin tonë) do të ishte një barrierë e mirë mbrojtëse, ndaj çdo dukurie natyrore ekstreme, qoftë meteorologjike apo e fushave

të tjera.

- Zbatimi i standardeve dhe kriterëve në fushën e kibernetikës, sa i takon ruajtjes dhe transferimit së të dhënave, gjithashtu do të duhej të ishte detyruese për çdo institucion shtetëror dhe privat.

- Sigurimi pranë kompanive të sigurimit pikërisht për këtë sektor, ndoshta e padëgjuar në vendin tonë, por e njohur jashtë. Kjo, do të bënte të mundur, që kompanitë dhe institucionet, të merrnin masat e duhura dhe të siguronin të dhënat e tyre sipas standardeve ndërkombëtare, duke minimizuar rrezikun dhe duke pasur mbrojtjen e duhur në rast dëmi.

- Ndonëse në dukje larg në lidhje, informacioni meteorologjik, në nivele te caktuara të shtetit për situatën e motit të hapësirës, apo motit ekstrem në tokë, është i një rëndësie parësore, kur është fjala për të mbrojtur ato struktura që janë më të prekshme deri në momentin kur rreziku të kalojë.

- Nuk duhet të presim që të ndodhin ngjarje të tilla ekstreme, që shumë herë mund të jenë gërshetim i dukurive ekstreme të motit me problemet kibernetike, por t'i paraprijnë me marrjen e masave të duhura, duke synuar plotësimin e standardeve dhe stafeve të nevojshme.

- Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar aplikimeve të teknologjive të modifikimit të motit jashtë territorit të Shqipërisë, për ndikimet që ato përcjellin në hapësirat e vendit tonë.

Bibliografia

1. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë".
2. Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore".
3. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
4. <https://www.cybersecurity-insiders.com/ransomware-attack-disrupts-the-weather-channel-for-90-minutes/>
5. <https://www.cybertalk.org/2019/10/02/cyber-weather-forecast-here/>
6. <https://magoo.medium.com/next50-ea33c5db5930>
7. <https://www.cybersecurityexe.com/single-post/2018/08/21/when-the-cyber-weather-forecast-gets-gloomy-everyone-should-get-prepared>
8. <https://blogs.scientificamerican.com/observations/what-do-hurricanes-and-cybersecurity-have-in-common/>
9. <https://www.uscybersecurity.net/csmag/whats-the-weather-enhancing-cybersecurity-with-external-intelligence/>
10. <https://www.uscybersecurity.net/csmag/enhancing-cybersecurity-with-artificial-intelligence/>
11. <https://www.militaryaerospace.com/communications/article/16709729/focusing-the-militarys-weather-eye>
12. <https://isdpeu/content/uploads/2020/01/Climate-Change-Environmental-Threats-and-Cybersecurity-in-the-European-High-North.pdf>
13. <https://www.hebergementwebs.com/te-paklasifikuar/65-inate-paguar-per-kriminelet-ne-internet-ne-france>
14. <https://bluecerts.eu/sq/siguria-kibernetike-si-do-t%C3%AB-duket-2021/>
15. <https://bluecerts.eu/sq/telework-i-ri-i-krimet-kibernetik-%C3%ABsht%C3%AB-viktima-e-re/>

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Gjeoinxhinieria, në kontekstin e sfidave të sigurisë



■Dr. (proc.) Anisa HYESANI
Qendra Kërkimore Shkencore
anisa.hysesani@asp.gov.al

Abstrakt

Ndërsa degëzimet e sigurisë kombëtare të ndryshimit të klimës rriten shumë më të theksuara, teknologjitë e manipulimit të klimës, të quajtura gjeoinxhinieri, do të bëhen më tërheqëse si një metodë për të shmangur emergjencat e sigurisë lidhur me klimën. Gjeoinxhinieria përfshin metodat e heqjes së dyoksidit të karbonit dhe/ose menaxhimit të rrezatimit diellor dhe mund teorikisht të arrijë suksese të konsiderueshme në mjedis lidhur me ngrohjen globale, por ato janë të paprovuara shkencërisht. Teknologjitë e gjeoinxhinierisë, kanë potencial për të prishur status quo-në ekologjike globale dhe të vendosë një kërcënim potencialisht shtrëngues me implikime aq serioze sa ato në kohën e luftës. Disa nga këto teknologji mund të vendosen në të përbashkëtat globale, por e drejta ndërkombëtare nuk ofron më shumë se udhëzime indirekte se si duhet të qeverisen ato si çështje të sigurisë ndërkombëtare. Në këtë punim, argumentohet se duke mos pasur udhëzime të qarta shkencore ose ligjore, vetëm teoria e luftës ofron një kornizë të dobishme normative për frenimin e përdorimit të forcës mjedisore. Fillimisht, në këtë punim janë shpjeguar llojet e teknologjive të gjeoinxhinierisë të konsideruara të mundshme për ndryshimin e klimës. Më tej, analizohen udhëzimet ekzistuese ligjore. Në fund, artikulli paraqet një “teori të drejtë gjeoinxhinierike” për të konsideruar modifikimin e qëllimshëm të klimës.

Fjalëkyçe:

gjeoinxhinieri, siguri, ndryshime klimatike, “teori e drejtë gjeoinxhinierike”, klimë globale.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

1. Çfarë është gjeoinxhinieria?

Dyoksidi i karbonit atmosferik është 411 pjesë për milion dhe në rritje dhe bota po sheh gjithnjë e më shumë efektet e sigurisë ndërkombëtare si pasojë e një klime në ndryshim. Këto efekte variojnë nga humbja e territorit fizik për shkak të ngritjes së nivelit të detit deri tek efektet e rendit më të lartë siç janë migrimi i drejtuar nga klima, përhapja më e madhe e sëmundjeve infektive, paqëndrueshmëria gjeopolitike në shkriren e Arktikut dhe konfliktet në rritje të burimeve. Përveç kësaj, zbulimi i fundit i liqeneve që rrjedhin metan në Arktik paraqesin mundësinë alarmante të ngrohjes së klimës me një datë të panjohur fillimi. Një vështrim i shpejtë, na tregon se njerëzit nuk kanë jetuar kurrë më parë në këtë botë. Ndërsa kombet dështojnë të përmbushin planet e tyre të zbutjes së gazeve serë dhe kostoja e adaptimit ndaj dëmeve bëhet jashtëzakonisht e lartë, teknologjitë e qëllimshme të manipulimit të klimës, të njohura gjerësisht si gjeoinxhinieria gjithnjë e më shumë do të duken si një opsion i zbatueshëm për të shmangur efektet më të këqija të ndryshimit të klimës. Sipas zakonit aktual ndërkombëtar, kombi që së pari zhvillon teknologji të re shkencore dhe e bën atë operacionale ka të drejtën e supozuar ta përdorë atë siç u duket e përshtatshme, veçanërisht për sigurinë e tyre kombëtare. Kjo do të thotë që, ndërsa ndryshimi i klimës bëhet më shumë një kërcënim, gjeoinxhinieria mund të bëhet një përgjigje e vlefshme e mbrojtjes kombëtare.

Kombet, më parë, kanë përdorur zhvillime të tjera shkencore dhe teknologjike për mbrojtjen kombëtare. Kimisti gjerman Fritz Haber e ktheu punën e tij shkencore në efekt vdekjeprurës me zhvillimin e armëve fosgjene në Luftën e Parë Botërore.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Shkencëtarët e *Projektit Manhattan* e dinin mirë zbulimet e tyre mund të përdoren për prodhimin e energjisë ose bomba me vdekshmëri të pashembullt. Aktualisht, teknologjitë me përdorim të dyfishtë si satelitët, sistemet kibernetike dhe madje edhe robotët janë vendosur për mbrojtjen kombëtare. Megjithëse rrethanat e përdorimit të tyre mund të frenohen nga doganat, traktatet dhe organizatat shumëpalëshe, e drejta për t'i përdorur ato nuk ka qenë kurrë në diskutim. A do të ishte ndryshe gjeoinxhinieria?

Me *gjeoinxhinieri* do kuptojmë ato lloje teknologjish të manipulimit të klimës që janë vendosur në të përbashkëtat globale (stratosfera ose detet e hapura), dhe ato përfshijnë:

- *injektimin e aerosolit stratosferik*,
- *fekondimin e hekurit në oqean*, dhe
- *ndriçimin e reve me bazë detare*.

Teknikat gjeoinxhinierike, nuk rregullohen ende në mënyrë gjithëpërfshirëse nga e drejta ndërkombëtare; ligjet mjedisore dhe ligjet e luftës zbatohen vetëm në mënyrë indirekte ose në kushte specifike. Sidoqoftë, korniza e sigurisë kombëtare është e pandashme nga pyetjet shkencore, ligjore dhe etike që rrethojnë gjeoinxhinierinë, ashtu siç ishte për zhvillimin e bombës atomike. Nëse një komb i fuqisë së madhe, si Shtetet e Bashkuara, vendos të përdorë teknika gjeoinxhinierike, kjo mund të shihet si leje e heshtur për fuqitë e tjera të mëdha, si Kina ose fuqitë e mesme, me aftësi shkencore si Mbretëria e Bashkuar, për të bërë të njëjtën gjë, veçanërisht nëse e konsiderojnë këtë teknologji si sigurimin e një avantazhi strategjik ose taktik. Kjo, më pas, mund të rezultojë në një lloj gare armatimesh klimatike për të parë se cili shtet mund të manipulojë më parë klimën për përfitimin e tyre.

Shtetet në sistemin aktual ndërkombëtar mbajnë sovranitetin si vlerën e tyre themelore - në të vërtetë i gjithë sistemi është strukturuar rreth sovranitetit dhe bashkëpunimit vullnetar. Siguria kombëtare në këtë kontekst është një përpjekje për të ruajtur sovranitetin territorial dhe për të mbrojtur një komb nga kërcënimet e jashtme. Vetë potenciali i teknikave gjeoinxhinierike për të ndryshuar me sukses klimën globale e bën përdorimin e tij një shkelje të sovranitetit sepse bën që një komb të mos jetë në gjendje të mbrojë territorin e tij kundër ndërhyrjes së një shteti tjetër.

Për më tepër, kombet që po përballen me pak me kërcënimin e ndryshimit të klimës duhet të mësojnë të reagojnë me një përgjigje, qoftë edhe pa armik, por mungesa e luftës nuk do të thotë mungesë e dëmit indirekt të kohës së luftës. Deri në vitin 1963, Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Sovjetik dhe kombet e tjera bërthamore kryen mbi pesëqind prova bombe midis tyre dhe pasojat e mëvonshme radioaktive u zbuluan në bimë, kafshë dhe ekosisteme larg vendeve të provës. Ndërsa gjeoinxhinieria, nuk pritet të përfshijë radioaktivitet, efektet e saj te era, ose në oqean, mund të shkaktojnë një ndryshim material në kushtet e jetesës për miliona njerëz, gjë që e bën përdorimin e teknikave të gjeoinxhinierisë, një çështje për të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Politikëbërësit e sigurisë duhet të pyesin veten nëse ekzistenca e një kërcënimi të sigurisë lidhur me klimën i jep ndonjë kombi të drejtën të përpiqet të manipulojë ekologjinë globale me teknika gjeoinxhinierike. Në kohën e luftës, një kombi i lejohet të përdorë çdo mjet për të mbrojtur veten si një çështje e marrëdhënieve ndërkombëtare normative, por një kërcënim i lidhur me ndryshimet klimatike, të tilla si pasiguria e ushqimit që rezulton nga një korreje e goditur nga thatësira, mund të jetë ende e egër në kohë paqeje. Meqenëse doktrina tradicionale e sigurisë ndërkombëtare nuk jep llogari për kërcënimin pa armiq, ne duhet të mendojmë më tej për të drejtat dhe përgjegjësitë

që kombet kanë në balancimin e sovranitetit dhe sigurisë kombëtare kundër stabilitetit të klimës globale. Studimi i përdorimit të ardhshëm të teknologjisë mund të mos duket urgjent përballë kërcënimeve më të njohura të sigurisë, por duhet të marrim parasysh përdorimin e teknikave gjeoinxhinierike, tani përpara se të detyrohemi të marrim një vendim të nxituar me pasojë potencialisht katastrofike¹.

2. Kostot dhe implikimet

Për sa i përket ndryshimeve në lidhje me sigurinë në mjedis, dëmtimi indirekt ekologjik gjatë luftimeve është një nga kostot më të rëndësishme të luftës, sepse përçarja ose shkatërrimi i mjedisit dhe burimeve të tij pengon shërimin e popullatës civile. *Programi i mjedisit i OKB-së* ka kryer vlerësime mjedisore pas konfliktit në Afganistan, Irak, Gaza dhe Sudan. Ndonjëherë ekosistemi mund të rimëkëmbet nga efektet e një konflikti, ndonjëherë jo². Vlerësimet pasuese të kostove ekologjike, ekonomike dhe shëndetit të njerëzve të luftërave të fundit përfshijnë 450 milion dollarë për pastrimin e dioksinës në zona të caktuara të Vietnamit, 6.5 miliard dollarë për të luftuar zjarret dhe për të bërë riparime të infrastrukturës së naftës në Kuvajt pas Luftës së Parë të Gjirit dhe 27 miliard dollarë në humbi fitimin e naftës/gazit dhe afërsisht 44 milion dollarë dëmtim mjedisor në Gaza që nga përshkallëzimi i konfliktit në 2009³.

Çdo teknologji gjeoinxhinierike në një shkallë mjaft të madhe për të ndryshuar klimën globale ka potencialin për të shkaktuar dëme të së njëjtës madhësi. Meqenëse këto teknologji nuk janë testuar në raport me përshkallëzimin, krahasimi i drejtpërdrejtë i kostos mund të jetë i vështirë, por me anë të të dhënave të autorizuara, shpërthimi i vullkanit Eyjafjallajuktl (Eyjafjallajökull) në 2010, i kushtoi qeverisë islandeze 7.5 milion dollarë në pastrim dhe riparime, dhe ekonomia globale përjetoi rreth 5 miliard dollarë humbje në fluturime, turizëm dhe mallra konsumi⁴. Kostot totale të shpërthimit të malit 1980 St. St. Helens në Uashington, dhe shpërthimit të malit Pinatubo 1991 në Filipine, u vlerësuan përkatesisht 1.1 miliard dollarë (dollarë të 1980-s) dhe 700 milion dollarë (dollarë të 1991-shit).⁵ Meqenëse qeveritë kanë aftësi të kufizuara për të llogaritur humbjet e ekosistemit, mund të ketë dëme të zgjeruara ose sinergjike që nuk kapen. Për më tepër, ky dëm do të kryhej me vetëdije mbi shtetet e tjera pa pëlqimin e tyre. Gjeoinxhinieria globale e bazuar në të përbashkëtën nuk është sinonim i përdorimit të forcës së dhunshme.

Por, varësisht nga lloji i teknologjisë së përdorur, ajo mund të shkaktojë të njëjtin nivel të shkatërrimit mjedisor ndërkufitar dhe humbjes së sovranitetit si një luftë. Lufta zhvillohet me qëllim dëmtimi; gjeoinxhinieria mund të vendoset pa atë qëllim, por ne argumentojmë se kur flasim për atë shkallë të ndryshimit të paqëndrueshëm mjedisor atëherë është një dallim pa ndonjë ndryshim. Meqenëse ekosistemi dhe atmosfera globale janë të pandashme, një shtet mund të shkaktojë ndryshime materiale në mjedisin e një tjetri që kanë mundësi të ndikojnë negativisht në territorin, ekonominë dhe sigurinë e

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹ <https://www.cfr.org/blog/can-we-use-geoengineering-defend-ourselves>

² Programi i mjedisit i OKB (UNEP), "Disasters and Conflicts" (website), aksesuar- www.unep.org/disastersandconflicts/

³ Charles Bailey, *Agent Orange in Vietnam Program 2012 Report* (New York: Aspen Institute, 2013)

⁴ "Ask IR: How Much Did the Volcanic Eruptions in Iceland in 2010 Cost?," Iceland Review, last updated 30 January 2014, <http://icelandreview.com/stuff/ask-ir/2010/12/06/how-much-did-volcanic-eruptions-iceland-2010-cost>; and Oxford Economics, *The Economic Impacts of Air Travel Restrictions Due to Volcanic Ash* (New York: Oxford Economics, 2010), <http://www.oxfordeconomics.com/publication/open/240242>.

atij shteti. Këto ndryshime do të ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien materiale të shteteve, ashtu si ndikon në përdorimin e forcës së dhunshme. Kështu, rregullat dhe normat në lidhje me gjeoinxhinierinë kanë paralelet e tyre në rregullat dhe normat në lidhje me përdorimin e forcës. Përdorimi i teknologjive të gjeoinxhinierisë ngre njëkohësisht çështje të sigurisë kombëtare dhe të trajtimit etik të mjedisit global.

3. Rreziqet ekologjike dhe ekonomike të gjeoinxhinierisë

Kërkimi mbi këto metoda të gjeoinxhinierisë nuk është zhvilluar mirë dhe është e lehtë të dallosh rreziqet ekologjike dhe ekonomike. Ndërsa FHO⁶ mund të ketë një efekt pozitiv në rezervat e peshkut, ai gjithashtu mund të rezultojë në ndryshime në strukturën e rrjetit ushqimor detar dhe zvogëlim të mundshëm të oksigjenit nën sipërfaqe⁷. Eksperimentet e mëparshme të FHO kanë rezultuar në prodhimin e gazrave që rritin serën si dimetilsulfidi, oksid azoti dhe metani⁸. Çdo lloj gjeoinxhinierie që nuk heq karbonin do të lejojë acidifikimin e vazhdueshëm të oqeanëve⁹. Efektet e tilla do të ndryshojnë në varësi të vendit në oqean dhe në cilën kohë të vitit janë vendosur anijet *Flettner*¹⁰.

Rreziqet ekologjike të vendosjes së aerosolit janë të konsiderueshme. Produktiviteti parësor neto është një masë e sasisë së energjisë kimike të prodhuar nga bimët dhe lidhet drejtpërdrejt me sasinë e dritës së diellit që ata marrin. Nëse MRD¹¹ zvogëlon sasinë e dritës së diellit që arrin në tokë, atëherë bimët nga të korrat në pyje mund të bëhen më pak produktive. Gjithashtu, me një rënie prej 3 për qind të dritës së diellit në hyrje nën një skemë të MRD-së, energjia diellore nga panelet fotovoltaike dhe grumbulluesit do të bëheshin më pak efikase. Aerosolet e squfurit në veçanti mund të përshpejtojnë shterimin e shtresës së ozonit stratosferik dhe meqenëse dyoksidi i squfurit është përbërësi kryesor gjërryes në reshjet e acidit, çdo squfur i shtuar artificialisht në atmosferë përmes gjeoinxhinierisë, përfundimisht do të bjerë në ndonjë formë, duke shkaktuar dëmtime të lokalizuara në ekosistem dhe shqetësimet në shëndetin e njeriut. Përveç kësaj, modelet e hershme kompjuterike sugjerojnë që ndriçimi i reve mund të ndërhyjë në modelet ekzistuese të reshjeve. Nëse emetimet globale të GS¹² nuk zvogëlohen, atëherë çdo metodë e MRD do të duhej të vazhdojë për një kohë të pacaktuar sapo të fillonte. Nëse MRD-ja ndalet dhe plotësimi i plotë i dritës së diellit arrin në tokë përmes një atmosfere të trashë me GS, temperatura globale do të rritet shpejt, një fenomen i njohur

⁵ Remigio T. Mercado, Jay Bertram T. Lascamana, and Greg L. Pineda, "Socioeconomic Impacts of the Mount Pinatubo Eruption," in *Fire and Mud: Eruptions and Lahars of Mount Pinatubo, Philippines*, ed. Christopher G. Newhall and Raymond S. Punongbayan (Seattle: University of Washington Press, 1999), <https://pubs.usgs.gov/pinatubo/mercado/>.

⁶ Fekondimi i Hekurit në Oqean

⁷ Doug W. R. Wallace, Cliff S. Law, Philip W. Boyd, Yves Collos, Peter Croot, Ken Denman, Phoebe J. Lam, Ulf Riebesell, Shigenobu Takeda, and Phil Williamson, *Ocean Fertilization: A Scientific Summary for Policymakers* (Paris: Intergovernmental Oceanographic Commission, 2010), 3; and Canadian Science Advisory Secretariat, *Ocean Fertilization: Mitigating Environmental Impacts of Future Scientific Research* (Ottawa: Fisheries and Oceans Canada, 2010), 2.

⁸ Wallace et al., *Ocean Fertilization: A Scientific Summary*, 8, 11.

⁹ NRC, *Reflecting Sunlight to Cool Earth*, 6.

¹⁰ Meinhard Doelle, "Climate Geoengineering and Dispute Settlement under UNCLOS and the UNFCCC: Stormy Seas Ahead?" in *Climate Change Impacts on Ocean and Coastal Law: U.S. and International Perspectives*, ed. Randall A. Abate (New York: Oxford University Press, 2015), 345–65.

¹¹ Menaxhimi i Rrezatimit Diellor

¹² Gazra serë

si efekti i përfundimit. Kjo mbart rrezikun më shumë se të mundshëm të ngrohjes së menjëhershme dhe të rrezikshme, shumë larg kufijve të ndryshueshmërisë së klimës së shekullit XX. Duhet të theksohet se përfitimet e mundshme të gjeoinxhinierisë në klimë mund të jenë gjithashtu të rëndësishme, por ashtu si në luftë, ata do të shpërndareshin në mënyrë të pabarabartë.

Ndoshta shqetësimi më i madh në lidhje me gjeoinxhinierinë është rreziku moral. Çdo lloj metode gjeoinxhinierike mund të ketë një rrezik moral, por MRD-ja është veçanërisht e rrezikshme; për shkak se metodat MRD-së kanë potencialin për të punuar shpejt, efektet e tyre mund të ndjehen shpejt. Kjo mund ta çojë publikun në përfundimin se problemi i ngrohjes globale është “rregulluar” dhe se puna e vështirë dhe përçarëse e dekarbonizimit të furnizimit me energji në botë nuk ka nevojë të vazhdojë. Pa presionin e publikut, politikëbërësit nuk kanë gjasa të ndjekin masa të mëtejshme për zbutjen e ndryshimeve klimatike, veçanërisht nëse ato janë të kushtueshme krahasuar me një regjim MRD. Tashmë, me pjesëmarrjen e SHBA-së në marrëveshjen e bllokuar të Parisit, ligjvënësit në Kongres kanë prezantuar një projektligj për të formuluar një agjendë kërkimore për “strategjitë e modifikimit të *albedos*,¹³ që përfshijnë ndërhyrje atmosferike” (MRD), duke përmendur efektet që ndryshimi i klimës ka edhe në sigurinë kombëtare të SHBA-së.

4. Gjeoinxhinieria në *limbo* ligjore ndërkombëtare

Nga tre teknologjitë që do të vendosen nga të përbashkëtat globale, secila vuan nga një lloj i caktuar neglizhence ligjore. Për shembull, asgjë nuk e ndalon përdorimin e teknologjive të modifikimit mjedisor në kohë paqeje, siç është shpërndarja e aerosolit ose ndriçimi i reve. Kjo do të thotë që çdo shtet ose aktor joshitetor që përdor një teknologji të tillë mund të pretendojë (me të vërtetë apo jo) se ata po veprojnë për të mirën e vendit të tyre ose të njerëzimit dhe si pasojë nuk kishin qëllim armiqësor. Një pretendim i tillë do të bënte të pazbatueshëm ligjet si *Protokolli I i Gjenevës*. Këto veprime të njëjta mund të jenë të paligjshme sipas ligjit të brendshëm, por meqenëse ligjet e brendshme ndryshojnë në fushën dhe specifikën nga traktatet ndërkombëtare, një teknologji e veçantë siç është fekondimi i hekurit në oqean që mund të jetë i paligjshëm në ujërat territoriale nuk mund të kundërshtojë automatikisht ligjin ndërkombëtar nëse vendoset nga deti i hapur. Si pasojë, secila prej 3 teknologjive e “të përbashkëtave globale” (*Global Commons*), mund të konsiderohet e ligjshme nga një perspektivë pozitive.

Më në fund, asgjë në ndonjë ligj, konventë, traktat ose zakon nuk e ndalon një shtet të mbrojë veten dhe territorin e tij nga një kërcënim real për sigurinë e tij kombëtare. Ndërsa përçarja nga ndryshimi i klimës bëhet më e paracaktuar dhe kërcënimet ndërkombëtare të sigurisë që vijnë nga këto efekte bëhen më të dukshme, një shtet mund ta gjejë veten duke konsideruar një përpjekje në gjeoinxhinieri për mbrojtjen ose ruajtjen e vet.

5. Vetëm teoria e gjeoinxhinierisë

Nën çdo teori të pranuar të marrëdhënieve moderne ndërkombëtare, një shteti i

¹³ *Albedo* quhet ajo pjesë e rrezatimit diellor që reflektohet prej sipërfaqes tokësore dhe ujore.

lejohej, madje është i detyruar, të mbrojë sigurinë e tij kombëtare. Nëse efektet fizike të ndryshimit të klimës antropogjene prodhojnë ose kontribuojnë në kërcënime ndaj sigurisë kombëtare, atëherë zvogëlimi i tij ose kompensimi i pasojave të tij negative mund të shihet si një kërkesë e nevojshme e sigurisë, ndoshta edhe mbi një bazë paraprake ose parandaluese. Tashmë, forcat ushtarake nga vendet rreth botës po ndërmarrin hapa për të adresuar kërcënimet e lidhura me klimën. Kërcënimet në rritje të sigurisë nga ndryshimi i klimës janë krahasuar me Luftën e Tretë Botërore dhe nevoja për mobilizim për të prodhuar teknologji të energjisë së rinovueshme krahasuar me periudhën industriale Amerikane për të mposhtur Fuqitë e Boshtit¹⁴.

Nëse gjeoinxhinieria do të konsiderohet si një opsion i mbrojtjes dhe e drejta ndërkombëtare nuk parashikon ndonjë ndalim specifik, ne mund të kërkojmë vetëm në teorinë e luftës për udhëzime të mëtejshme. Teoria e luftës siguron udhëzime etike për vendimmarrje në lidhje me forcat shkatërruese të luftës. Ndiemon në përcaktimin e koncepteve “e drejtë” dhe “e gabuar” në luftë dhe e bën të zakonshme idenë se lufta është e kufizuar në fushën dhe metodën. Prandaj, vetëm kriteret e luftës mund të hedhin disi dritë mbi konsideratat e rëndësishme etike dhe të sigurisë për vendosjen e teknologjisë gjeoinxhinierike. Përdorimi i gjeoinxhinierisë për mbrojtje dhe siguri do të thotë një nga dy gjërat: ose një shtet po manipulon klimën si “shkelje”, si një mjet lufte; ose problemet e sigurisë kombëtare të krijuara nga ndryshimi i klimës janë bërë aq të ashpra sa që politikëbërësit kanë filluar të shohin gjeoinxhinierinë si një mjet të mundshëm të “mbrojtjes”. Nëse e para, veprime të tilla janë qartë të ndaluara nga ENMOD dhe *Protokolli i Gjenevës I*.

Nëse i dyti, vendimmarrja bëhet pak më e errët. Si pasojë, ne mund të shohim përpjekje të mundshme “mbrojtëse” të gjeoinxhinierisë përmes lentave të teorisë së drejtë të luftës dhe të pyesim veten nëse përpjekje të tilla mund të jenë ose jo, të pranueshme nga etika, dhe një fitim neto i sigurisë. Duke vepruar kështu, ne përdorim të dy kriteret *jus ad bellum* (ligji i përdorimit të forcës) dhe *jus in bello* (ligji i luftimit të luftës). Ndërsa jo të gjithë elementët e teorisë së luftës së drejtë lidhen drejtpërdrejt me shqyrtimin e gjeoinxhinierisë, tre prej kriterëve hedhin dritë të dobishme për dobinë e saj si një mundësi e mundshme për vetëmbrojtje kombëtare.

5.1 Autoriteti kompetent

Ky kriter *jus ad bellum* zakonisht kuptohet se do të thotë se lufta nuk mund të ndërmerret vetëm, pa lejen e një autoriteti të njohur publik që vepron në përputhje me shtetin e së drejtës, të drejtën hyjnore ose burim tjetër të rëndësishëm të legjitimitetit politik. Nocionet e hershme perëndimore të luftës së drejtë u artikuluan përmes teologjisë së krishterë, por vetëm mendimi i luftës është rritur përtej këtij themeli. Për çështjet e luftës, shtetet ndajnë me organizatat ndërqeveritare (ONQ) si Kombet e Bashkuara dhe NATO aftësinë për të folur në mënyrë autoritare kur lejohet përdorimi i forcës është dhe kur nuk lejohet. Prandaj, është e arsyeshme që shtetet dhe ONQ-të, në konsultim me ekspertët e klimës, të mund të flasin me autoritet për përdorimin e forcës përmes gjeoinxhinierisë.

Sidoqoftë, shtetet sovraane, individualisht ose në grupe, janë akoma aktorët e vetëm që mund të përdorin ligjërisht forcën në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke e legjitimuar

¹⁴ Bill McKibben, “A World at War,” *New Republic*, 15 August 2016, <https://newrepublic.com/article/135684/declare-war-climate-change-mobilize-wwii>.

si mbrojtje të qytetarëve të tyre. Prandaj, ata duhet të bëjnë një angazhim domethënës dhe aleancë për të parandaluar çdo vendosje të paligjshme të gjeoinxhinierisë nga aktorë të paautorizuar. një ndjenjë e gabuar e eksperimentimit.

5.2 Proporcionaliteti

Kjo kërkesë e njëjtë për gjykimin shkencor ekspert informon jus ad bellum dhe jus in bello parimet e proporcionalitetit. Këtu, proporcionaliteti do të thotë që e mira ekologjike që shteti veprues synon të arrijë përmes përdorimit të tij të gjeoinxhinierisë duhet të tejkalojë çdo pasojë ekologjike negative që ajo sjell. Konsiderimi i proporcionalitetit në gjeoinxhinierinë është i komplikuar si për shkak se ndryshimi i klimës është një objektiv ekologjik në lëvizje dhe sepse testet kuptimplota të teknologjisë janë aktualisht joefektive ose të pamundura. Kjo do të thotë që një vendosje “e drejtë” do të duhet të rivlerësohet rregullisht gjatë kohëzgjatjes së tij, sepse ndryshimi i kushteve mjedisore me kalimin e kohës do të thotë që gjeoinxhinieria mund t’i bëjë gjërat më keq, jo më mirë.

5.3 Diskriminimi

Së fundmi, parimi i diskriminimit bën dallimin midis shënjestrave të pranueshme moralisht dhe atyre të papranueshme: luftëtarët janë shënjestra legjitime; ata që nuk janë luftëtarët, nuk janë shënjestra të tilla. Ky dallim nuk është gjithmonë i lehtë për t’u bërë, pasi lufta guerile dhe kryengritëse shpesh përfshin trupa të parregullta, civilë të cilët me dëshirë ose pa dëshirë shërbejnë si platforma armësh dhe taktika të tilla si mjete shpërthyesë të improvizuara që mund të jetë e vështirë t’i atribuohen një burimi specifik. Në raste të tilla, është e vështirë të bëhet diskriminimi midis shënjestrave legjitime dhe atyre jolegjitime, sepse kufiri është megjulluar midis kush është një luftëtar dhe kush jo. Kategoritë e vjetra nuk përshtaten lehtë me realitetin e ri të luftës, megjithëse imperativi moral i diskriminimit mbetet. Sidoqoftë, ekzistojnë dy pika për t’u marrë parasysh kur zbatohet ky parim në gjeoinxhinierinë: si të identifikohen “luftëtarët” në këtë rast, dhe nëse teknologjitë globale të gjeoinxhinierisë ngrenë çështje dëmtimi indirekt të ngjashëm me atë të armëve të shkatërrimit në masë.

Duke e konsideruar gjeoinxhinierinë si një përdorim të forcës, parimi i diskriminimit na detyron të ripërcaktojmë ata që konsiderohen luftëtarë, dhe ata joluftuesit. Luftëtarë janë përgjithësisht forcat e armatosura, të dy ose më shumë kombeve ndërluftuese, dhe janë shënjestra të ligjshme nën teorinë e luftës; joluftuesit nuk kanë caqe legjitime. Sidoqoftë, kur autoriteti i duhur i një shteti po shqyrton gjeoinxhinierinë, kjo politikë synon të përfitojë nga qeveria dhe qytetarët e saj. Meqenëse ata janë ata që ndërmarrin veprimet e propozuara për përfitimet e tyre, ata mund të quhen lirshëm si “luftëtarët” në këtë paralele të luftës. Në të kundërt, “joluftuesit” janë normalisht ata civilë që nuk janë palë në konflikt; në këtë paralele, ne mund të themi që të gjithë të tjerët në Tokë janë joluftuesit, pasi veprimi nuk është ndërmarrë për përfitimin e tyre, dhe as që janë konsideruar domosdoshmërisht.

6. Ndryshimi i klimës për mbrojtjen kombëtare

Lufta përfshin lëshimin e forcave të fuqishme jo vetëm në popullatën e synuar, por

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

“ Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë ”

edhe në popullatën jo të synuar gjithashtu. Normat aktuale të luftës lejojnë një nivel të dëmit indirekt gjatë luftimeve, por luftëtarët duhet të parashikojnë dhe minimizojnë dëmtimet e tilla. Ndërsa teknologjitë gjeoinxhinierike dhe ASHM-të¹⁵ ndryshojnë në mënyra të rëndësishme, ato të dyja janë instrumente të forcës që nuk mund të synohen saktësisht. Për më tepër, gjeoinxhinieria e bazuar në bashkësi nuk do të jetë efektive nëse nuk testohet ose vendoset në një shkallë globale, e cila shton një nivel tjetër të pasigurisë ekologjike në çdo përpjekje për të minimizuar dëmet indirekte. E drejta zakonore ndërkombëtare, siç thuhet nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, dhe riafirmuar në *Statutin e Romës*, të vitit 1998 të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, parashikon që sulmet pa kriter janë të ndaluara dhe se përdorimi i armëve pa shënjestër, përbën një krim lufte.

Atëherë qëndron arsyetimi, se një masë paraprake e ngjashme do të kishte të bënte me instrumentet e shënjestruara pa dallim të ndryshimit masiv mjedisor. Nëse shtetet e konsiderojnë gjeoinxhinierinë nga të përbashkëtat globale si një metodë e mbrojtjes kombëtare, ne mund të ndërtojmë një kornizë të re për të funksionuar në vendimmarrjen gjeoinxhinierike pasi funksionon vetëm teoria e luftës në vendimmarrjen e konfliktit. Për shkak të efekteve globale dhe ndoshta të pakthyeshme, të gjitha masat paraprake duhet të merren nga vendimmarrësit për të maksimizuar transparencën dhe për të përfaqësuar të gjitha pikëpamjet e palëve të interesuara.

7. Konkluzione

Shtetet që kërcënohen nga efektet e sigurisë për shkak të ndryshimit të klimës dhe duke konsideruar gjeoinxhinierinë si rezultat përballen me një zgjedhje të papëlqyeshme: të përfshihen në një rrezik serioz ose madje shkatërrues të sigurisë ose të vendosin ndonjë metodë të gjeoinxhinierisë, duke shpresuar që ajo të mos rezultojë në katastrofë klimatike dhe të përballen me kritika nga komuniteti ndërkombëtar nëse ky vendim nuk ka miratimin e OKB-së. Secila prej këtyre zgjedhjeve sjell rrezeqe për një shtet, meqenëse kërcënimet e sigurisë të drejtuara nga ndryshimet klimatike shpesh janë rrezeqe shumëvjeçare, me shumë sisteme që nuk janë lehtësisht të matshme dhe mund të mos rezultojnë nga një kundërshtar i drejtpërdrejtë.

Nëse adresimi i kërcënimeve që lidhen me ndryshimet klimatike është bërë pjesë e procesit të vendimmarrjes së sigurisë, a ka kuptim të përpiqemi të operacionalizojmë parimet që qëndrojnë prapa teorisë së gjeoinxhinierisë? Në vendimmarrjen tradicionale të mbrojtjes dhe sigurisë, parimet prapa teorisë së luftës janë zyrtarizuar në traktate të tilla si Konventat e Gjenevës dhe në të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe vihen në praktikë në formën e rregullave të angazhimit (REA)¹⁶ që forcat ushtarake duhet të ndjekin në luftime. Meqenëse e drejta ndërkombëtare nuk e adreson gjeoinxhinierinë si një masë sigurie, a mund të ndërtojmë një konventë ndërkombëtare mbi teknologjitë e manipulimit të klimës dhe të ndërtojmë REA përkatëse nga atje? Kjo është problematike për dy arsye.

Së pari, ka të ngjarë të ketë rezistencë nga komuniteti shkencor, i cili ka argumentuar

¹⁵ Armët e shkatërrimit në masë.

¹⁶ Rregullat e angazhimit.

¹⁷ Jane C. S. Long, Frank Loy, and M. Granger Morgan, "Policy: Start Research on Climate Engineering," *Nature* 518 (5 February 2015): 29–31, <http://doi.org/ck3g>; and NRC, *Carbon Dioxide Removal and Reliable Sequestration and Reflecting Sunlight to Cool Earth*.

për eksperimente me arsyetimin se, nëse kjo do të ishte e nevojshme në rast urgjence, nuk do të ishim të mençur të vendosnim një teknologji të paprovuar¹⁷. Është e vërtetë që eksperimentet në shkallë të vogël mund të japin të dhëna të vlefshme, lokale, mbi mënyrën se si funksionojnë teknologjitë e veçanta, por këto rezultate mund të mos shkojnë deri në nivel planetar. Nëse tentohet një vendosje në shkallë më të gjerë nën maskën e “eksperimentimit”, të dhënat mund të jenë më të dobishme, por rreziku për ekosistemin është proporcionalisht më i madh. Për këtë qëllim, nuk do të kishte asnjë dallim të justifikueshëm midis eksperimentimit dhe përdorimit aktual.

Së dyti, tendosja në rritje e nacionalizmit në botë po tregon për më pak traktate dhe më pak bashkëpunim mbi çështjet globale dhe sinjalizon një tërheqje nga rendi liberal ndërkombëtar i nevojshëm për të bërë një konventë gjeoinxhinierike të funksionojë. Ajo që ne shpresojmë të arrijmë me këtë zhvillim të vetëm të teorisë së gjeoinxhinierisë është të krijojmë një sërë normash dhe zakonesh që mund të përdoren për të drejtuar vendimmarrjen nga shtetet dhe bashkësia ndërkombëtare në mungesë të ligjit të qartë ndërkombëtar.

Tani për tani, kërcënimet e sigurisë që lidhen me ndryshimet klimatike janë në rritje, ndërsa përpjekjet për zbutjen dhe adaptimin nuk kanë ritmin e duhur. Në të njëjtën kohë, inxhinieria gjeoinxhinierike (veçanërisht tre metodat e përbashkëta globale të diskutuara këtu) do të fillojë të duket si masë e mundshme e manipulimit të klimës, e veshura me “vellon” e sigurisë kombëtare. Sidoqoftë, ligji dhe zakonet kërkojnë nga shtetet për të frenuar dëmtimin e mjedisit nga ndikimi negativ i shteteve të tjera, dhe këto tre metoda të gjeoinxhinierisë nuk ofrojnë mundësi të kufizimit të efekteve në një vend ose rajon. Këto metoda janë pa kriter, joproporcionale dhe ndoshta të pakthyeshme, dhe rreziqet mjedisore globale janë shumë të larta për asgjë më pak sesa vendimmarrja etike e qëllimshme. Si pasojë, ne ofrojmë këto udhëzime të përdorimit të drejtë të gjeoinxhinierisë si thelbësore për vendimmarrjen.

Bibliografia

1. “Ask IR: How Much Did the Volcanic Eruptions in Iceland in 2010 Cost?,” Iceland Review, last updated 30 January 2014, <http://icelandreview.com/stuff/ask-ir/2010/12/06/how-much-did-volcanic-eruptions-iceland-2010-cost>; and Oxford Economics, *The Economic Impacts of Air Travel Restrictions Due to Volcanic Ash* (New York: Oxford Economics, 2010), <http://www.oxfordeconomics.com/publication/open/240242>.
2. Bill McKibben, “A World at War,” *New Republic*, 15 August 2016, <https://newrepublic.com>
3. Can We Use Geoengineering to Defend Ourselves? <https://www.cfr.org/blog/can-we-use-geoengineering-defend-ourselves>
4. Charles Bailey, *Agent Orange in Vietnam Program 2012 Report* (New York: Aspen Institute, 2013)
5. Doug W. R. Wallace, Cliff S. Law, Philip W. Boyd, Yves Collos, Peter Croot, Ken Denman, Phoebe J. Lam, Ulf Riebesell, Shigenobu Takeda, and Phil Williamson, *Ocean Fertilization: A Scientific Summary for Policymakers* (Paris: Intergovernmental Oceanographic Commission, 2010), 3; and Canadian Science Advisory Secretariat, *Ocean Fertilization: Mitigating Environmental Impacts of Future Scientific Research* (Ottawa: Fisheries and Oceans Canada, 2010), 2.
6. ICRC, “Treaties, State Parties and Commentaries, Protocol Additional to the Geneva Conventions of 12 August 1949 and Relation to the Protection of Victims of International Armed Conflicts (Protocol I), 8

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

- June1977," <https://www.icrc.org/ihl.nsf/INTRO/470>.
7. International Maritime Organization, "Marine Geoengineering: Guidance and Amendments under the London Convention/Protocol," accessed 28 February 2018, <http://www.imo.org/en/OurWork/Environment/LCLP/EmergingIssues/geoengineering/Pages/default.aspx>.
 8. Jane C. S. Long, Frank Loy, and M. Granger Morgan, "Policy: Start Research on Climate Engineering," *Nature* 518 (5 February 2015): 29–31, <http://doi.org/ck3g>; and NRC, *Carbon Dioxide Removal and Reliable Sequestration and Reflecting Sunlight to Cool Earth*.
 9. Mark Douglas, "Changing the Rules: Just War Theory in the Twenty-First Century,"
 10. Meinhard Doelle, "Climate Geoengineering and Dispute Settlement under UNCLOS and the UNFCCC: Stormy Seas Ahead?" in *Climate Change Impacts on Ocean and Coastal Law: U.S. and International Perspectives*, ed. Randall A. Abate New York: Oxford University Press, 2015), 345–65.
 11. NRC, *Reflecting Sunlight to Cool Earth*, 6.
 12. Programi I mjedisit i OKB (UNEP), "Disasters and Conflicts" (uebsite), aksesuar- www.unep.org/disastersandconflicts/
 13. Remigio T. Mercado, Jay Bertram T. Lascamana, and Greg L. Pineda, "Socioeconomic Impacts of the Mount Pinatubo Eruption," in *Fire and Mud: Eruptions and Lahars of Mount Pinatubo, Philippines*, ed. Christopher G. Newhall and Raymundo S. Punongbayan (Seattle: University of Washington Press, 1999), <https://pubs.usgs.gov/pinatubo/mercado/>
 14. UN Environment Programme (UNEP), "Disasters and Conflicts" (website), accessed 16 October 2017, www.unep.org/disastersandconflicts/; see also Jay E. Austin and Carl E. Bruch, *The Environmental Consequences of War: Legal, Economic, and Scientific Perspectives* (New York: Cambridge University Press, 2000).
 15. UN, Convention on the Prohibition of Military or Any Other Hostile Use of Environmental Modification (ENMOD) Techniques, Article I, accessed 7 March 2018, <http://www>
 16. UN, *Rome Statute of the International Criminal Court* (Rome: UN Diplomatic Conference of Plenipotentiaries on the Establishment of an International Criminal Court, 17 July 1998), https://www.icc-cpi.int/nr/rdonlyres/ea9aeff7-5752-4f84-be94-0a655eb30e16/0/romestatute_english.pdf.
 17. Wallace et al., *Ocean Fertilization: A Scientific Summary*, 8, 11.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Ndryshimet klimatike dhe çështjet e sigurisë



■Dr. (proc.) Gentiana BEKTASHI

Ministria e Brendshme

gbektashi@yahoo.com

Abstrakt

Në këtë punim prezantohen disa këndvështrime dhe analiza se si shikohen ndryshimet klimatike duke u fokusuar në marrëdhëniet midis ndryshimit të klimës dhe çështjes së sigurisë. Pyetja kryesore që shtrohet në këtë artikull është: A sjell ndryshimi i klimës pasiguri dhe konflikt? Faktorët që luajnë rol në rritjen e rrezikut të konfliktit mund të forcohen nga ndryshimi i klimës. Ndryshimi i klimës nuk ka karakter kombëtar, dhe e parë në këtë kontekst, siguria duhet të shërbejë si koncept integruar. Analizimi i raportit klimë-migrim dhe konflikt na ndihmon të kuptojmë dhe të trajtojmë efektet komplekse dhe afatgjata të fenomenit, duke kontribuar në hartimin e të politikave të qëndrueshme. E parë dhe në fokusin e politikave të qeverive dhe organizmave ndërkombëtare, vendet do të duhet të përqafojnë një koncept të sigurisë që i vendos njerëzit në qendër të tij dhe të ndërmarrin veprime të menjëhershme për t'u mbrojtur nga efektet klimatike. Ndryshimi i klimës është një "shumëzues i krizës" që ka implikime të mëdha në paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar, ndaj kërkohet partneritet mes vendeve, për të minimizuar efektet e saj duke hartuar politika të qëndrueshme.

AKADEMIA
E SIGURISË

Fjalëkyçe:

ndryshime klimatike, konflikt i dhunshëm, koncepti i sigurisë, rezolutë e Këshillit të Sigurisë së OKB-së.

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

1. Hyrja

Ky punim fokusohet në analizën e fenomeneve ekstreme të natyrës në raport me sigurinë e një vendi dhe më gjerë. Për sa i takon strukturës, ndahet në tre pjesë. Pjesa e parë e punimit, përmes analizave të disa raporteve, tenton të sqarojë se faktorët që luajnë rol në rritjen e rrezikut të konfliktit mund të forcohen nga ndryshimi i klimës. Ndryshimi i klimës nuk ka karakter kombëtar, dhe e parë në këtë kontekst, siguria duhet të shërbejë si koncept integruar. Analizat tentojnë të analizojë edhe raportin klimë-migrim e konflikt si dhe, të adresojnë efektet komplekse dhe afatgjata të fenomenit dhe të kontribuojnë në hartimin e të politikave të qëndrueshme. Në pjesën e dytë, është bërë një prezantim i shkurtër i katër konflikteve që u ndikuan në një farë mënyre dhe nga ndryshimi i klimës. Pjesa e tretë e punimit analizon ndryshimin e klimës, parë në fokusin e politikave të qeverive dhe organizmave ndërkombëtare, duke u fokusuar te debatet në Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, mbi klimën dhe sigurinë. Konkluzioni është se vendet do të duhet të përqafojnë një koncept të sigurisë që i vendos njerëzit në qendër të tij dhe se nevojiten veprime të menjëhershme, për të mbrojtur vendet nga efektet klimatike gjithnjë e më të shpeshta dhe të rënda. Në përfundim nxirret konkluzioni se ndryshimi i klimës sjell pasoja të rënda në paqen dhe stabilitetin e vendeve, dhe në atë ndërkombëtar, ndaj partneriteti dhe politikat afatgjata janë rrugët për t'u përballuar me të.

2. Ndryshimet klimatike në fokusin e raporteve/analizave

Çështjes së ndryshimit të klimës si një rrezik i sigurisë, kohëve të fundit po i kushtohet

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

vëmendje e shtuar. Ky diskutim ka qenë pjesë e raporteve dhe analizave të ndryshme, por kohët e fundit po merr gjithmonë e më shumë rëndësi. Studimi i implikimeve të ndryshimit të klimës te siguria, ka evoluar me shpejtësi nga një fushë e pak e njohur në kërkimin akademik, në një fushë të rëndësishme të tij. Nina von Uexkull dhe Halvard Buhaug në studimin *Security implications of climate change: A decade of scientific progress*¹, bëjnë një përmbledhje të progresit të studimit shkencor në këtë fushë, duke krahasuar dekadën e fundit. Mbi bazën e këtij vlerësimi, ata nxjerrin konkluzionin se bota akademike ka bërë hapa të rëndësishëm në specifikimin, vlerësimin dhe gjetjen e rrugëve shkakësore mes kushteve klimatike dhe rezultateve të lidhura me konfliktin si dhe të kushteve që formojnë këtë marrëdhënie. Sipas analizës, kontributet në këtë çështje të veçantë e shtojnë kufirin e kërkimit më tej, duke i lidhur ndikimet klimatike me trazirat shoqërore në mjediset urbane. Në të njëjtën kohë ato tregojnë tërësinë e lidhjes mes klimës-migrimit-konfliktit; identifikojnë se uljet e prodhimit bujqësor, si pasojë e ndryshimeve klimatike, rrisin rrezikun e konfliktit; analizojnë lidhjet e ndryshimit të klimës, me pretendimet ndërshtetërore. Në të njëjtën kohë, identifikojnë dhe boshllëqet që lidhen me implikimet afatgjata si pasojë e ndryshimit të klimës dhe mungesën e përgjigjeve të politikave, si një fushë ku duhet të orientohen kërkimet e ardhshme.

Raportet analizojnë gjendjen aktuale dhe ofrojnë një sërë përfundimesh, përmes pyetjeve kryesore që shtrojnë dhe analizojnë si: A çon ndryshimi i klimës në konflikt të dhunshëm? A sjell ky ndryshim mungesë burimesh dhe konkurrencë të pakontrollueshme? A shkakton tension dhe mungesë kontrolli popullsisë që largohet për shkak të rritjes së nivelit të detit, thatësirës etj., në zona të reja ku migrojnë?

Andrea Warnecke, Dennis Tänzler dhe Ruth Vollmer² analizojnë lidhjet e mundshme midis ndryshimit të klimës, migrimit dhe konfliktit. Sipas tyre ka disa faktorë që mund ta kthejnë migrimin e shkakuar nga dukuritë mjedisore në një burim konflikti. Sipas studimit, literatura shkencore akoma nuk ka arritur në një përfundim, në lidhje me konfliktin e migrimit të shkakuar nga mjedisi dhe mekanizmat që potencialisht e lidhin atë me fillimin e konfliktit. Ka një mori faktorësh që shkaktojnë konfliktin nga migrimi i shkakuar nga mjedisi, të lidhura këto me zonën pritëse, si dhe shkaqet apo llojin e migracionit. Analiza eidenton se ndikimet aktuale dhe të ardhshme të klimës, mund të rrisin presionin dhe të dobësojnë stabilitetin dhe bazën e burimeve natyrore të komuniteteve pritëse, duke e bërë kështu më të vështirë për ta që t'i përgjigjen migrimit në mënyrë më adekuate. Analiza arrin në përfundimin se, qeveritë dhe donatorët, duhet të investojnë në kryerjen e studimeve afatgjata dhe në gjetjen e mekanizmave mbështetës për komunitet, përmes hartimit të strategjive për menaxhimin e migracionit që buron nga arsyet e ndryshimeve klimatike.

Po ashtu Colin Raymond³, në artikullin e tij *Understanding and managing connected extreme events*, bën një analizë të kësaj lidhje duke vënë në dukje se ngjarjet ekstreme të motit dhe klimës dhe ndikimet e tyre mund të ndodhin si pasojë e kombinimeve komplekse. Në këto situata, sipas saj, qeverisja dhe strukturat e tjera vendimmarrëse, - paralelisht me ekspozimin dhe cenueshmërinë e popullatës mund të influencojë në zhvillimin e ngjarjeve duke pasur ndikimin e tyre, me efekt pozitiv ose negativ.

¹Security implications of climate change: A decade of scientific progress" January 2021

²Climate Change and Migration", June 2010

³Nature Climate Change volume 10, pages 611–621(2020)

Toy Fenton në artikullin *National Security and the Threat of Climate Change*, bën një analizë më të detajuar duke u ndalur në mënyrën se si duhet parë siguria kombëtare në rastet kur vendi përballet me fenomene ekstreme të natyrës. Ai argumenton se ndërsa ndryshimi i klimës kërcënon dukshëm sigurinë kombëtare, mënyra se si mund ta garantojmë këtë siguri, është e diskutueshme. Garantimi i sigurisë kombëtare në konceptin tradicional përqendrohet në militarizmin, kontrollin territorial dhe sovranitetin. Në të vërtetë, ndryshimi i klimës nuk ka karakter kombëtar. Sipas Barnett, “kuptimi i ndryshimit të klimës thjesht si një çështje sigurie rrezikon ta shndërrojë atë më shumë si një problem sovraniteti sesa problem global të përbashkët”. E parë në këtë kontekst, siguria do të duhet të shikohet dhe shërbejë si një koncept integruar.

Sidoqoftë, ajo që tashmë është pranuar, është fakti se ndryshimi i klimës kërcënon sigurinë kombëtare, rrezikon aftësinë ushtarake dhe aftësinë e shteteve për mbrojtje. Këto faktorë gjithashtu mund të përkeqësohen nga migrimi/flukset e refugjatëve dhe mungesat e burimeve, të cilat në vetvete mund të jenë një kërcënim si dhe favorizojnë rritjen e dhunës dhe konfliktit. Referuar kësaj analize, këto çështje nuk mund të vendosen brenda kornizave të sigurisë kombëtare, pasi këto janë dinamika tejkombëtare që i kalojnë kufijtë territorialë dhe korniza të tilla mund të pengojnë bashkëpunimin e gjerë. Ndryshimet klimatike sjellin gjithashtu probleme dhe në planifikimin e politikave. Analizimi i shkallës se si ndryshimi i klimës kërcënon sigurinë kombëtare është shumë kompleks, pasi ndryshimi i klimës nuk është një ndryshore me vlerë konstante: ajo mund të sjellë kërcime, por koha dhe madhësia e të cilave janë të paparashikueshme.

3. Analizat, si mundësi për të kuptuar efektet komplekse dhe afatgjata të fenomenit dhe zhvillimit të politikave të qëndrueshme

Në vitin 2017, SIDA⁴ bëri një raport vlerësues, duke analizuar marrëdhëniet midis mjedisit dhe ndryshimit të klimës dhe rreziqeve që sillnin zhvillimin e konfliktit. Ky raport konkludonte se mjedisi dhe ndryshimi i klimës sjell rrezikun e konfliktit të dhunshëm. Ky raport, mbështetur dhe në përvojat e mëparshme, planifikonte në të njëjtën kohë edhe rrugët e bashkëpunimit dhe zhvillimit të politikave në këtë fushë në të ardhmen.

Studimet në këtë fushë kërkojnë të kuptojnë shkaqet e ngjarjeve të së kaluarës, për të projektuar ato që mund të ndodhin në të ardhmen. Instituti Ndërkombëtar i Kërkimit të Paqes (SIPRI)⁵, në Stokholm, ka kryer një studim të detajuar mbi disa aspekte mes ndryshimit të klimës dhe rrezikut të konfliktit. SIPRI e paraqiti analizën e tij në një raport sintezë në vitin 2016. Disa nga konkluzionet e raportit kanë rëndësi për gjetjen e mekanizmave të zhvillimit. Sfidat e madhe, që shtrohet aktualisht, lidhet me faktin që ndikimet në ndryshimin e klimës mund të sjellin pasoja gjithnjë e më të gjera, e cila e kalon përvojën historike. Shoqëritë mund të përballen me ngjarje dhe procese komplekse.

Analizat tregojnë se si ndryshimet klimatike po ndikojnë mbi shoqëritë e caktuara. Këto ndryshime lidhen me elemente të tillë si mungesa e ujit, ngritja e nivelit të detit, migrimi, fenomenet ekstreme të motit etj. Pasja e burimeve ujore për shoqërinë dhe

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁴ SIDA, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

⁵ SIPRI, Instituti Ndërkombëtar i Kërkimit të Paqes, në Stokholm

bujqësinë po bëhet gjithnjë e më e pasigurt, veçanërisht në rajonet tropikale dhe rajonet e thata dhe gjysmë të thata. Po ashtu, ulja e sasisë së reshjeve dhe ndryshimi në rritje i shpërndarjes së tyre në kohë dhe hapësirë tashmë ndikojnë në produktivitetin e bujqësisë dhe blegtorisë. Përdorimi i tepërt i ujëmbajtësve dhe infrastruktura e dobët e shpërndarjes së ujit krijon stres uji në zonat urbane. Të gjitha aspektet e sigurisë ushqimore ndikohen nga ndryshimi global i klimës. Prodhimi bie në zona ku ka mungesë të ujit, ku temperaturat tejkalojnë tolerancën e të korrave. Luhatjet e çmimeve ndikojnë në ushqim, evidente kjo veçanërisht për familjet e varfra ku ushqimi përfaqëson një pjesë të madhe të buxhetit të tyre, gjë që çon në konsumimin e më pak ushqimeve. Kriza e ushqimit në vitin 2008 dhe vitet në vijim, demonstruan se si thatësira ose përmbytjet në vendet kryesore prodhuese të grurit, të lidhura me ndryshimin e klimës, mund të kenë ndikime të mëdha në çmimet dhe në sigurimin e ushqimit. Kriza pati pasoja afatgjata për grupet më të marginalizuara. Ajo çoi gjithashtu në trazira shoqërore në shumë vende, veçanërisht aty ku autoritetet nuk ishin në gjendje të shuanin efektet e saj.

Në të njëjtën kohë, efektet e ngritjes së nivelit të detit janë të vështira të parashikohen dhe njerëzimi nuk ka përballuar asgjë të ngjashme në kohët moderne. Shumë nga qytetet më të mëdha të botës ndodhen pranë brigjeve ashtu si vendet e vogla ishullore në Paqësor, Oqeanin Indian dhe Karaibet. Ndaj këto çështje kërkojnë planifikim afatgjatë. Në disa rajone bregdetare të ekspozuara, qytetarët dhe autoritetet lokale kanë filluar programe për zhvendosjen e planifikuar në zona më të larta dhe të mbrojtura.

Migrimi. Çështjes së njerëzve që migrojnë si rezultat i ndryshimit të klimës i është kushtuar shumë vëmendje. Refugjatët e zhvendosur si rezultat i ndryshimeve klimatike, nganjëherë përshkruhen si një kërcënim i sigurisë kundër vendeve ku ata kërkojnë strehim. Megjithatë, nuk ka shumë tregues që të vërtetojnë se migrantët janë kërcënim i sigurisë ndaj vendeve në të cilat ata lëvizin, përkundrazi vetë migrantët shpesh jetojnë një ekzistencë të pasigurt kur shtetet përpiqen të parandalojnë migrimin. Ata mund t'i nënshtrohen shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë udhëtimit të tyre të mundimshëm dhe të rrezikshëm. Lëvizshmëria dhe migrimi janë ndër strategjitë më të vjetra dhe më themelore të adaptimit të njerëzimit me shumë efekte pozitive në zhvillim.

Konflikti i dhunshëm. Duket se ekziston një konsensus në komunitetin kërkimor se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ndryshimit të klimës dhe shpërthimit të konflikteve të dhunshme, veçanërisht konflikteve të gjera brenda shtetit, po dhe në atë ndërshtetërore.

Sekuencat e ngjarjeve që çojnë në shpërthime të dhunës janë gjithmonë shumëfaktoriale dhe komplekse dhe zakonisht nuk është e mundur të identifikohen vetëm me faktorë nxitës. Hipoteza se thatësira e lidhur me ndryshimet klimatike gjatë viteve para 2011 ishte një faktor kryesor i luftës civile në Siri, i është kushtuar shumë vëmendje, por gjithnjë e më shumë po vihet në diskutim. Në këtë pikë, ekspertja Francesca de Châtel argumenton se politikat bujqësore jofunksionale, heqja e papritur e subvencioneve të karburantit si dhe një rritje e menjëhershme e çmimeve globale të ushqimit, çuan në pasoja katastrofike. Pas viteve të thatësirës dhe në mungesë të mbrojtjes sociale nga qeveria, familjet e varfra braktisën fermat e tyre dhe u transferuan në qytetet ku trazirat shoqërore ishin në rritje.

Thatësira e gjatë, e cila mund të ketë qenë rezultat i ndryshimit të klimës, ndoshta u bë një faktor kontribuues në konflikt, por situata politike ishte ajo që luajti rolin kryesor. Vendet fqinje të ekspozuara ndaj të njëjtës thatësirë nuk përjetuan konflikt të brendshëm. Nga ana tjetër, shumë studime tregojnë se mund të ketë lidhje indirekte midis ndryshimit

të klimës dhe rrezikut të konfliktit. Me fjalë të tjera, faktorët që luajnë një rol në rritjen e rrezikut të konfliktit mund të forcohen nga ndryshimi i klimës. Prandaj është veçanërisht e rëndësishme të kuptohet se si dhe në cilat rrethana këto ndryshime mund të çojnë në konflikt të dhunshëm.

Konflikti i dhunshëm. Shembulli i Afrikës Lindore, si pjesë e studimit të SIPRI-t, përfaqëson një analizë të veçantë, mbi marrëdhëniet midis ndryshimeve të lidhura me klimën dhe konflikteve lokale të dhunshme. Kjo analizë tregon se konfliktet rreth burimeve natyrore: toka, kullota, uji, janë veçanërisht të shpeshta kur në to përfshihet popullsia që rrit bagëti. Ndonjëherë këto konflikte shfrytëzohen nga palët në kërkimin e pushtetit. Bazuar në analizën e tyre gjithëpërfshirëse, identifikohen pesë shpjegime se si ndryshimet e lidhura me klimën mund të çojnë në konflikt të dhunshëm: i) përkeqësimi i mjeteve të jetesës, ii) rritja e migrimit, iii) ndryshimet në modelet e lëvizjes së popullsisë baritore, iv) konsideratat taktike midis grupeve të armatosura, dhe v) shfrytëzimi nga elitat e pakënaqësisë lokale.

4. Konfliktet si rezultat dhe i ndryshimit të klimës: rastet

Megjithëse analizat studimore, kur merren me raportin mes ndryshimeve klimatike dhe sigurisë, theksojnë se këto janë çështje komplekse dhe ku ndërhyjnë shumë faktorë, (*referuar dhe analizës te cituar më sipër të CIPRI*), është fakt, se ka pasur katër konflikte që u ndikuan në një farë mënyre edhe nga ndryshimi i klimës.

Lufta Civile Siriane, ku rezultojnë të vrarë rreth gjysmë milioni njerëz dhe janë larguar rreth 11 milion të tjerë. Kjo luftë ka shkatërruar plotësisht infrastrukturën e vendit. Para fillimit të luftës, thatësira e jashtëzakonshme bëri që 75% e fermave të Sirisë të falimentojnë dhe 85% e bagëtive të ngordhin (kjo mes viteve 2006 dhe 2011). Kjo thatësi gjithashtu shkaktoi një valë migracioni që kërkonin punë në zonat urbane, duke përfshirë paqëndrueshmëri në të gjithë vendin.

Pushtimi i ISIS në Irak. Ndërsa Siria u fut në një luftë brutale civile, Iraku u përball me ngjarje të fuqishme të motit. Thatësira, përmbytjet ekstreme dhe erërat shkaktojnë trazira ekonomike për shumë fermerë, barinj dhe biznese të tjera. ISIS⁶ përfitoi nga varfëria që solli kjo situatë për të rekrutuar anëtarë brenda Irakut dhe për të krijuar mosmarrëveshje. Kur grupi terrorist pushtoi vendin në 2014, shumë prej tyre ndihmuan luftën.

Lufta Civile në Jemen. Lufta civile e Jemenit⁷ dhe vendeve rreth tij, janë konsideruar si kriza më e rëndë humanitare në botë. Në të gjithë vendin, pllakosi kriza e kolerës, miliona njerëz pa ushqim të mjaftueshëm dhe më shumë se 10 000 njerëz të vrarë në konflikt. Gjatë luftës, thatësira përkeqësoi konfliktin duke rrezikuar më shumë se gjysmën e popullsisë nga mungesa e ujit.

Konflikti i Sudanit të Jugut. Sudani i Jugut, ishte vendi me krizën më të shpejtë të refugjatëve. Uria përfshiu të gjithë vendin, duke sjellë pasiguri ushqimore për miliona njerëz. Zija e bukës ishte kryesisht rezultat i keq menaxhimit të efekteve që solli lufta civile e vitit 2013, por u përshpejtua nga mungesa e reshjeve në zonat bujqësore të vendit. Kjo paqëndrueshmëri, solli një eksod masiv, duke i vendosur grupet etnike

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁶ Investigim i bërë nga *National Geographic*.

⁷ Sipas Gazetës *The New York Times*.

rivale në afërsi të njëri-tjetrit.

Lufta Civile në Libi. Libia është një vend tjetër që u përfshi në konflikt midis fraksioneve ndërluftuese në të gjithë vendin dhe ku efektet e ndryshimit të klimës, reshjet të pakta, dobësuan përpjekjet për paqe në vend.

5. Ndryshimi i klimës në fokusin e politikave të qeverive/organizmave ndërkombëtare

Siç e cituam dhe më lart, vitet e fundit ka pasur një vëmendje të shtuar ndaj çështjes së ndikimit që kanë ndryshimet klimatike mbi paqen dhe sigurinë. Ndryshimet klimatike janë vënë në fokusin e politikave të vendeve të zhvilluara për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm. Për shembull, qeveria suedeze e ka ndërtuar kornizën e saj të politikave për bashkëpunim, zhvillimin dhe ndihmë humanitare, duke cituar se “*ndryshimi i klimës rrit rrezikun e konflikteve, varfërisë dhe urisë, minon të drejtat e njeriut dhe është një shkak në rritje i migrimit të detyruar*”.

Së fundmi, Këshilli i Sigurisë, miratoi *Rezolutën 2349*, e cila identifikonte qartë ndryshimin e klimës si një faktor kontribuues i paqëndrueshmërisë. Rezoluta e Këshillit evidenton efektet e ndryshimit të klimës dhe thekson nevojën për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut. Këshilli i Sigurisë ka zhvilluar disa debate mbi këtë çështje. Debati i parë, u zhvillua më 17 prill 2007. Pas shumë diskutimesh në takim e parë, u arrit në përfundimin se çështja është komplekse dhe se ndryshimi i klimës, është një sfidë me të cilën përballen, dhe do të duhet të përballen, të gjitha kombet. Kjo temë ka vijuar të jetë pjesë debati në Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, mbi klimën dhe sigurinë, në vitin 2011, 2018 dhe 2019 e së fundmi, në shkurt 2021.

Në takimin e fundit, natyralisti David Attenborough⁸, do ta quante ndryshimin e klimës si “*kërcënimin më të madh të sigurisë me të cilën njerëzit modernë janë përballur ndonjëherë*”.

Sipas tij, bota nuk do të kthehet më kurrë në klimën e qëndrueshme që lindi qytetërimin, por nëse qeveritë e njohin ndryshimin e klimës si një kërcënim global të sigurisë, “*ne ende mund të veprojmë në mënyrë proporcionale dhe me kohë*”.

Në këtë konferencë, duke lëshuar një thirrje për veprim, Nisreen Elsaïm⁹, theksoi se në secilin prej katër takimeve të organit për këtë çështje: në 2007, 2011, 2018 dhe 2019, “janë referuar rreziqe serioze të lidhura me klimën në Somali, Darfur, Afrikën Perëndimore Sahel, Mali etj.”

Duke shtuar se, “Mbijetesa e njeriut, në një situatë të degradimit të burimeve, urisë, varfërisë dhe migrimit të pakontrolluar të klimës, do ta bëjë konfliktin një rezultat të pashmangshëm”.

Boris Johnson, kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar dhe president i Këshillit, u kërkoi delegatëve të merrnin në konsideratë të riun apo të renë, *si një nga 16 milion njerëzit e zhvendosur nga katastrofat e lidhura me motin çdo vit*, si pre e ekstremizmit të dhunshëm, apo trafikut të qenieve njerëzore. Sipas tij “*ndryshimi i klimës është sa mjedisor aq edhe gjeopolitik*”.

Diskutimet parashtruan shembujt e Afganistanit ku korrjet e pakta i çojnë njerëzit

⁸ Deklarata e David Attenborough në Konferencën e 26 të Palëve të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës, shkurt 2021

⁹ Nisreen Elsaïm, Kryetare e Organizatës së Rinisë për Ndryshimet Klimatike dhe Grupit Këshillues Rinor të Kombeve të Bashkuara

në varfëri, duke i bërë njëkohësisht më të prirë ndaj rekrutimit nga grupe të armatosura; po ashtu, zhvendosjen e detyruar të komuniteteve në disa vende dhe ishuj të vegjël të Paqësorit, si lëvizje që rrit qartë mundësinë për konflikt dhe pasiguri. Nga diskutimet u nxor përfundimi se atje ku ndryshimi i klimës, shkakton tharje të lumenjve, redukton të korrat, shkatërron infrastrukturën kritike dhe zhvendos komunitetet, shtohet edhe rreziku i konfliktit. Ndikimi është më i madh në këtë drejtim, dhe ndodh në ato vende, ku nuk ka mekanizma të përballimit, ku njerëzit varen nga kapitali natyror për jetesën e tyre dhe ku gratë që mbajnë barrën e ndryshimit të klimës nuk gëzojnë të drejta të barabarta. Ndaj ky lloj alarmi, u nxor përfundimi se do të duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për të trajtuar rreziqet e sigurisë që lidhen me klimën, duke filluar me parandalimin dhe se nevojiten veprime të menjëhershme për të mbrojtur vendet nga efektet klimatike. Donatorët dhe bankat kombëtare dhe ato ndërkombëtare duhet të rrisin pjesën e financimit duke siguruar mbështetje.

Diskutimet, vunë në dukje se vendet do të duhet të përqafojnë një koncept të sigurisë që i vendos njerëzit në qendër të tij, pasi pandemia COVID-19 dhe krizat e tjera të fundit, vërtetuan edhe një herë nevojën që shtetet duhet të forcojnë solidaritetin e tyre dhe theksuan nevojën për veprim të shpejtë dhe se kjo çështje do të duhet të adresohet tek institucionet financiare ndërkombëtare, organizatat rajonale, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike etj. Nga diskutimet ju kërkua Këshillit që të miratojë një qasje të re, më gjithëpërfshirëse dhe burime të mjaftueshme për të gjitha agjencitë e specializuara dhe u nënvizua nevoja për sisteme të paralajmërimit të hershëm dhe strategji më të mira parandaluese.

6. Përfundim

Ndryshimi i klimës është një “shumëzues i krizës” që ka implikime të mëdha në paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar, ndaj kërkohet partneritet mes vendeve, për të ulur efektet e tij akute të sigurisë ushqimore, burimet natyrore, migracioni, tensionet në të gjitha vendet e rajonet si dhe, në hartimin e politikave afatgjata.

Bibliografia

1. Busby JW, Climate Change and Insecurity: Mapping Vulnerability in Africa International Security 37 (4), 132-172
2. Busby, J. W. (2008) 'Who Cares about the Weather?: Climate Change and U.S. National Security', Security Studies
3. Deudney, D. (1990) 'The Case Against Linking Environmental Degradation and National Security', Millennium: Journal of International Studies, 19(3), pp461-476
4. Toby Fenton(2014) National Security and the Threat of Climate Change
5. Dalby, S. (2013) 'Climate Change and Environmental Security', pp311-323, in Williams, P. Security Studies: An Introduction (2nd edition)
6. Trombetta, M. J. (2009) 'Environmental security and climate change: analyzing the discourse', Cambridge Review of International Affairs,
7. Barnett, J. (2003) 'Security and Climate Change', *Global Environmental Challenge* Global Environmental Change 13 (2003) 7-17
8. Barnett, J. &Adger, W. N. (2007) 'Climate change, human security and violent conflict', *Political Geography*,
9. Nature Climate Change volume 10, pages 611-621(2020)
10. Security implications of climate change: A decade of scientific progress" January 2021

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

~ *Sesioni II* ~

Kuadri ligjor dhe institucional, eksperiencia
kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në fushën
e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Mësimet e nxjerra nga kolapset e urave: një vështrim për një menaxhim të qëndrueshëm



■Prof. Dr. Shkëlqim ZEQU
Universiteti Europian i Tiranës
zeqoshkelqim@gmail.com

Abstrakt

Shembjet e urave janë një fenomen i shpeshtë sidomos në 20 vitet e para të shekullit XXI. Nga viti 2000 deri në 2020, në botë, numërohen mbi 120 kolapset të urave, pavarësisht se shembja e tyre konsiderohet si katastrofa më e rëndë në ndërtimet infrastrukturore. Në katër vitet e fundit, vetëm Italia përjetoi shembjen e pesë urave rrugësh, si: mbikalimet e viaduktit të Petrulla-s (2014), Annone-s (2016) dhe Ancona-s (2017), ura e rrugës Fossano (2017) dhe Polcevera (2018). Edhe pse ato kanë ndodhur për shkaqe thellësisht të ndryshme, shembjet e ndodhura, sipas analizave që bëhen zakonisht në raste të tilla, mund të përmbledhen të gjitha rreth të njëjtave shkaqe të përbashkëta, siç janë: mungesa e njohjes së gjendje efektive strukturore të tyre, në vijimësi, një problem serioz ky, që prek ndërtimet ekzistuese të urave të infrastrukturës rrugore në të gjithë botën; mungesa e njohurive adekuate në kompozimin dhe llogaritjen e projektit, për kohën në të cilën janë projektuar dhe ndërtuar, duke përfshirë parashikimin e saktë të flukseve të trafikut dhe kontrollin e peshave të automjeteve të rënda; monitorimi i prishjes së materialit, i cili mund të trajtohet si një njohuri joadekuate që ndodh në strukturat e urave; shumica e këtyre dështimeve kanë të bëjnë me faktorë njerëzorë; për shkak të mungesa e menaxhimit të qëndrueshëm që lidhet me domosdoshmërinë e realizimit të analizave të pemës së dështimit (FTA) dhe vlerësimi strategjik mjedisor (VSM) për dështimin e urave dhe ndikimet social-ekonomike të pasojave që mbarten në shoqërinë njerëzore.

Në pjesën e parë të këtij punimi, do të japim një përshkrim të shkurtër të dështimeve për pesë urat e shembura së fundi në Itali, ndërsa në pjesën e dytë do të përmbledhim një grup kryesor problemet e shfaqura nga analiza e tyre [dështimeve], mbi të cilat mund të nxjerrim mësim të rëndësishëm për sigurinë dhe mirëmbajtjen e urave edhe në vendin tonë. Në fund të këtij referimi, do të bëhet një rishikim mbi teknikat novatore dhe të veçanta të kontrollit dhe monitorimit të urave. Rezultatet e mbledhura mund të hedhin dritë mbi të ardhmen dhe perspektivat për sektorin e inxhinierisë civile, sektor i cili duhet të jetë gati të përballë me sfidat e ruajtjes, restaurimit dhe/ose zëvendësimit të ndërtimeve ekzistuese të urave në infrastrukturën rrugore, në të gjithë botën.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

shembje ure, ndërtime ekzistuese infrastrukturore, dështim i betonit të parander, fortësi e urës, "Analizë e pemës së dështimit" (FTA), "Vlerësim strategjik i mjedisit" (VSM).

1. Hyrje

Trashëgimia infrastrukturore italiane (pse jo dhe ajo shqiptare), e përbërë nga një numër dukshëm i madh urash, viaduktesh dhe mbikalimesh të nevojshme për koreografinë e territorit dhe për dendësinë e lartë urbane, është shumë e brishtë dhe shumë e prekshme, siç është tashmë e faktuar. Kjo brishtësi është shfaqur në mënyrë dramatike në 4 vitet e fundit: ku ka pasur disa shembje të urave, viadukteve dhe mbikalimeve, të cilat kanë shqetësuar jetën sociale, kanë ndarë qytetet dhe kanë ndikuar shumë në lëvizshmërinë e njerëzve dhe mallrave¹.

Ky fenomen kërkon, një vëmendje të veçantë për vlerësimin e infrastrukturave ekzistuese dhe për planifikimin e punëve të përmirësimit dhe të modifikimit të tyre. Në veçanti, vëmendja duhet të përqendrohet në nevojën për të vlerësuar degradimin dhe vlerësimin e kapacitetit të mbetur të strukturave në kushte operacionale. Infrastrukturat rrugore janë shumë të prekshme, pasi preken nga mungesa e modelit (strukturor e teknologjik), në thelb, të lidhura me periudhën e ndërtimit të tyre, në teknologjitë e aplikuara, e me materialet e përdorura, dhe, me mungesën e mirëmbajtjes së duhur, veçanërisht vitet e fundit. Shumica e urave dhe viadukteve në Itali (po ashtu edhe në Shqipëri) u ndërtuan midis viteve '50 dhe vitet '60, kur "bumi" ekonomik gjeneroi besim të pakufizuar në përdorimin e betonit si një material i qëndrueshëm në përjetësi. Për më tepër, shumica e këtyre strukturave të rrjetit rrugor italian janë realizuar përmes teknologjisë - akoma jo të arrirë në atë kohë, - me betonim të armuar të paratensionuar, *jo shumë i përshtatshëm, me konceptet aktuale të besueshmërisë dhe kontrollit.*

Këto struktura janë të vështira për t'u analizuar sepse nuk kanë pasur atë që sot përcaktohet si rezervë plastike: në momente para shembjes, në përgjithësi, ku nuk ka prova të dështimit strukturor. Kjo mungesë e "duktilitetit" nuk mund të konsiderohet si një gabim në projektim. Do të ishte më e përshtatshme të nënvizohej, se në vitet

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

gjashtëdhjetë, kishte dy faktorë themelorë që çuan në këtë situatë:

1. nuk kishte asnjë njohuri që *betoni i armuar mund të kishte një jetë kaq të shkurtër* dhe mund të pësonte sulme dhe përkeqësime për shkak të agjentëve atmosferikë dhe mjedisorë;

2. nuk kishte *instrumente automatike të llogaritjes*, prandaj, aty ku ishte e mundur, ekzistonin skema të preferuara, të përcaktuara, statistikore, për t'u llogaritur shumë më thjeshtë. Madje, është rekomanduar që ato duhej të preferoheshin nga ato të papërcaktuara statistikore, sepse ato ishin të adaptueshme ndaj ndryshimeve të temperaturës dhe vend banimeve.

Në realitet, siç do të tregohet në vijim, edhe realizimet më të fundit (*viadukt Fossano*) vazhduan me këto mangësi teknologjike, me një besim të tepruar në këto teknologji, që padyshim që janë përdorur gjerësisht dhe në Shqipëri duke u konsideruar se po ndiqej një teknologji bashkëkohore e përparuar. Mund të pohohet pa asnjë dyshim se strukturat e betonit të paratërhequra kanë nevojë për një shtesë të kontrollit gjatë fazave të realizimit të punimeve. Prandaj, qëllimi kryesor i këtij punimi, është që, *duke u mbështetur fort në punën dhe reflektimin e bërë nga institucionet më të besueshme në botë mbas dështimeve të fundit në urat e infrastrukturës rrugore në mbarë botën janë rishqyrtuar* dhe analizuar shkaqet e mundshme kritike në lidhje me sigurinë strukturore të *infrastrukturave rrugore*, në mënyrë që të stimulojnë përpjekjet për të vendosur metoda të reja hetimi, veçanërisht për një shkallë të gjerë diagnozash, dhe menaxhimi strategjik. Ndërsa ne, në veçanti, mbështetur konkluzionet e nxjerra nga dështimet në mbikalimet e *Petrulla viadukt-s* (2014), *Annone-s* (2016), *Ancona-s* (2017), *Fossano-s* (2017) dhe ura *Polcevera* (2018) do të diskutojmë shkurtimisht për të nxjerrë në pah ndryshimet në aspektin e shkaqeve të shembjes, të cilat janë një shembull i qartë i asaj se pse i duhet kushtuar vëmendje më e rritur sistemit infrastrukturor në Shqipëri në analogji me atë në Itali dhe më gjerë.

Një tjetër qëllim i referimit është të stimulojmë ndjeshmërinë e inxhinierëve të infrastrukturës rrugore të cilët janë thirrur të përballen me sfidën e madhe të të diturit, si të studiojnë infrastrukturën ekzistuese, duke vendosur një lidhje midis së kaluarës (kuptimi i plotë i projektit, detajimi analizave, etj.) dhe të ardhmes, përmes përdorimit të teknikave novatore diagnostike. Për ta bërë këtë, duhet të sjellin “ushqim”, për një sektor, i cili nuk kishte një evolucion të rëndësishëm teknologjike në vitet e fundit. Për më tepër, kjo temë nuk ka tërhequr në mënyrë të veçantë interesin e botës shkencore për një periudhë të gjatë dhe për këtë shkaqe ka një diferencë të madhe të rritje, dhe, në të njëjtën kohë, një nevojë të madhe për teknologji novatore. Është gjithashtu koha të mësojmë nga gabimet e të kaluarës dhe t'i përdorim ato si një sfond për të përcaktuar kërkesat e një paradigme të re kulturore.

2. Shkaqet kritike të shfaqura në kolapset e fundit të urave në infrastrukturën rrugore

Shkurtimisht do të rreshtojmë nëpërmjet fotove dhe një historiku të shkurtër, 4 aksidentet e para dhe konkluzionet e nxjerra për shkaqet e tyre, duke analizuar në vazhdim pak me gjerësisht konkluzionet e kolapsit të Urës Polcevera-Morandi.

2.1 Viadukti “Petrulla”: ndërtimi dhe qëndrueshmëria

Viadukti konsiston në një seri prej 12 trarësh të mbështetur thjesht, secila prej tyre

me një hapësirë (fig. 1a). Më 7 korrik 2014, u shemb një hapësirë prej 40 metrash e viaduktit. Shembja ndodhi në mes të hapësirës, dhe më pas, ndodhi dështimi i seksionit, atje ku toka u ndikua nën kuvertë (fig. 1b). Kuverta, me gjerësi 11,30 m ishte bërë prej 4 trarëve të betonit të parafabrikuar dhe të paraforcuar në mënyrë të barabartë në një hapësirë prej 2.850 m. Pesë trarë tërthorë realizonin traversën që mbështeste pllakën e karexhatës (fig. 1c). Hetimi, i kryer pas shembjes, evidentoi *një gjendje tejkaluese të prishjes së materialit për përbërësit e çelikut: oksidim të shpërndarë në shufrat e paranderjes, korrozion të forta të mbështjelljes metalike dhe mungesë e madhe e finos mbrojtëse përreth shufrave* (fig. 2a), (fig. 2 b). U

ra u ndërtua në mes të viteve '80, prandaj ky degradim kaq i shpejt nuk i përgjigjej 30 viteve jetë të shërbimit të saj, veçanërisht sepse betoni shfaq shenja të mira ruajtjeje (fig. 2c). *Hetimet kanë evidentuar disa defekte të ndërtimit, veçanërisht në lidhje me përfundimin e operacioneve të paranderja. Injeksioni i finos u krye në mënyrë sipërfaqësore dhe shufrat e shfryrjes nuk u mbyllën me saktësi* (Fig. 2 (d)). Në këto rrethana, lagështia gjeti një mënyrë rrugë preferenciale për tek shufrat prej hekuri, dhe ndryshimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së saj që gjeneroi një mjedis agresiv për oksidimin e çelikut. Mangësi të tjera shtesë si shkaktar të këtij degradim të veçantë ishin:

- mbulesë jo e mjaftueshme për shkak të keqpozicionimit të shufrave të paranderjes;
- jo punueshmëri adekuate dhe rrjedhshmëri e betonit;
- mbulesë joadekuate e papërshtatshme e hidroizolimit të nyjeve.




Figura 1: Pasqyrë e viaduktit të Petrulla (a); struktura e shembur (b); projektimi original i kuvertës (c, d)

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**



Figura 2: Gërryerja e përbërësve të çelikut, fijeve (a), mbështjellja metalike (b); gjendja e betonit (c); tuba shfryrës të pa vulosur (d).

Në fig. 3a, jepet vendi i inspektimit vizual me shkallën e tij relative të dëmtimit për urën dhe në fig. 3b, janë përmbledhur rezultatet për të gjithë viaduktin. Vlen të përmendet se, edhe nëse më pak se 7% e rasteve kishin një shkallë të lartë dëmtimi (shënuar me blu dhe të kuqe), ato përfaqësonin 8 inspektime të ndryshme vizuale, që do të thoshte të 8 trarëve të mundshëm pa forca parapresuese aktive. Ky viadukt ka qenë objekt i dëmtimeve dhe pas katër vitesh dhe është bërë përsëri operativ.




Figura 3: Shembull i inspektimeve vizuale në kuvertë (a); studimi i rezultateve të shkallës së dëmit (b).

2.2 Mbikalimi “Annone”: projektimi i mirëmbajtjes dhe kontrolli i ngarkesës

Shembja e mbikalimit *Annone*, ndodhi më 18 tetor 2016. Dështimi pati një ndikim të lartë në shoqërinë italiane. Ura u ndërtua midis viteve 1960 dhe 1962, me një skemë me *Gerbert* të vendosur mbi 4 mbështetëse (fig. 4a). Kuverta qendrore, 24,60 m e gjatë dhe 4,40 m e gjerë, përbëhej nga 5 trarë të parafabrikuara dhe të paranderura I. Mbështetësit *Gerbert* ishin 0,575 m të lartë, me përforsim të zakonshëm siç tregohet në fig. 4b dhe fig. 4c. Para shembjes, ura iu nënshtroi disa ndikimeve nga automjetet në lëvizje themelore². Kjo ishte për shkak të një lartësie joadekuate të lirë të mbikalimit (<

5 m). Pas këtyre ngjarjeve, shala (kuverta) u riparua me armim dhe instalime CFRP (fig. 5a). Megjithatë, ato ndërhyrje nuk mund të rinovonin thyerjen e seksionit së përhapur mbi kuvertë dhe praninë e konsiderueshme të lagështisë që zbulohesh shpesh gjatë inspektimeve (fig. 5b). Kjo ishte kryesisht për shkak të mosrregullimit të prodhuar në fundet e dëmtuara (2.5 cm) për shkak të riparimeve, të cilat përbënin një pikë stanjacioni për rrjedhjen e ujit³.




Figura 4: Pasqyrë e mbikalimit Annone (a); përforcimi i mbështetjes Geber, projektimi (b) dhe hetimi (c).

Shembja ndodhi kur një kamion i rëndë me 10 akse 107,6 t kaloi nëpër kuvertë me një shpejtësi të ulët lëvizëse (fig. 5c). Sapo ngarkesa u transportua tërësisht nga trau qendror, shiriti fundor të rralluar dhe i riparuar nga jashtë u shemb për shkak të ngarkesës vertikale të vendosur ndërmjet mbështetjes të trarëve. Peshë totale e strukturës ishte afërsisht 172 t, e cila është 10% më e lartë sesa ngarkesa maksimale e projektimit e barabartë me 155 t. Sidoqoftë, kjo tepriçë duhet të ishte kapërcyer si faktor i sigurisë Kjo urë ishte kataloguar si e kategoris II nga *Kodet italiane të ndërtimit*, por kërkesat e sigurisë nuk ishin përmbushur nga vetitë strukturore. Hetimet⁴ kanë demonstruar se ky dështim u komprometua nga:

- një e metë fillestare e projektimit në shtyllën me fund të thyer që uli ndjeshëm ngarkesën përfundimtare;
- përforcimi në trarët e parapërgatitur nuk ishte i mjaftueshëm për të siguruar një klasifikim të urës në kategorinë II;
- prania e një frakture qethjeje përgjatë shiritit fundor të thyer promovoi oksidimin e kavove të armaturës në bashkim;
- kalimi i ngarkesave të kategorisë II (më shumë se 100 në vit) e vë shpesh strukturën afër kufirit së saj përfundimtar të kapacitetit;
- ekscentriciteti i prodhuar nga një transit i pavendosur nga linja qendrore e karrexhatës rriti ndjeshëm ngarkesën në nyjën fundore të jashtme të thyer;
- këto rezultate janë prodhuar nga analiza të hollësishme shkatërruese që nuk mund të kryhen për një strukturë ekzistuese.

Këto rezultate do të thonë që parametri i vetëm i kontrollit që mund të adoptojmë në këto raste është pajisja kontrolluese e ngarkesës dhe vendosja e pajisje mbrojtëse për pjesët delikate, siç janë mbështetësit *Gerber*.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »



Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Gjermania naziste ndërmori një veprimtari të gjerë në përdorimin e sëmundjes “këmbë-gojë”⁵ si një armë sulmuese, duke testuar ekspozimet në ajër dhe duke e hedhur mbi bagëtitë dhe drerin verior, në Rusinë Veriperëndimore. Regjimi nazist gjithashtu eksperimentoi me brumbujt e patates duke i hedhur nga aeroplanët në tetor 1943, si dhe përdorimi i tenjës së drerit dhe barërat e këqija të ndryshme⁶. Edhe francezët gjithashtu kanë aplikuar programe kundër kulturave dhe kafshëve, të përqendruara në brumbujt e patates dhe viruse e dëmtues të ndryshëm për bagëtinë, të drejtuara ndaj Gjermanisë. Japonezët kanë qenë të angazhuar në zhvillimin e teknikave të sofistikuar për të shpërndarë nëpërmjet ajrit kërpudha, baktere në drithërat dhe perimet veçanërisht në Manchuria dhe Siberi, gjatë 1940 dhe 1941, duke synuar prodhime kokrrave të infektuara të melit të grurit dhe pambukut etj.

Pavarësisht përdorimit që kanë pasur armët biologjike, udhëheqësit dhe ekspertët ushtarakë, sqarojnë se armët biologjike nuk janë një armë efikase, për sa kohë që nuk mund të përdoret në një mënyrë të tillë që nga kjo armë të preken vetëm trupat armiqësorë⁷.

Ndërkohë, bioterrorizmi mbetet një armë tërheqëse për grupet terroriste⁸, sepse agjentët biologjikë gjenden më lehtësisht, janë më të lira për t'u siguruar dhe mundësia e përhapjes është më e madhe. Pandemia e COVID-19 dhe përhapja që mori kjo sëmundje në një kohë shumë të shkurtër, tregon sa rrezik paraqet një sulm i mundshëm terrorist me agjentë viralë më të rrezikshëm. Mutacionet që pësoi virusi i COVID-19, nga ana tjetër e bën akoma më të pasigurt hapat e ndërmarra për të zhvilluar një vaksinë efikase për ta luftuar këtë virus.

Në një artikull mediatik⁹, publicisti dhe eksperti Gordon Chang, ka deklaruar se Kina sot ka mbi 80 milionë profile shëndetësore të ADN-së. Kina ka sipas tij, bazën më të madhe të të dhënave të ADN-së në mbarë globin dhe po vazhdon ta zgjerojë atë. Në një intervistë me Fox News, Chang paralajmëron se sëmundje edhe më të rënda se COVID-19 do të mbërrijnë. Të gjitha informacionet e kësaj të grumbulluara në kohë, nga sa pretendon ai do të përdoren për krijimin e armëve biologjike që do të shënjestrojnë grupe të caktuara etnike.

“Koronavirusi nuk është patogjeni i fundit që do të dalë nga toka kineze. Duhet të shqetësohemi, sepse sëmundja tjetër do të ketë fuqi edhe më të madhe transmetimi e do të jetë më vdekjeprurëse se koronavirusi i ri”, - ka thënë Chang në deklaratat e tij.

Në një kohë që zhvillimet teknologjike po ecin me ritme shumë të shpejta, shëndeti

⁴ Jonathan Ban. “Agricultural Biological Warfare: An Overview.” Chemical and Biological Arms Control Institute. The Arena 9 (June 2000).

⁵ Sëmundje e shkaktuar nga virusi coxsackievirus A16.

⁶ See Erhard Geissler and J.E. Moon. Biological Warfare from the Middle Ages to 1945. New York: Oxford University Press. 1999.

⁷ Of Biologics as Weapons Bioterrorism: A threat to National Security or Public Health Defining Issue? University of Wisconsin-Madison and Wisconsin State Laboratory of Hygiene, September 30, 2008.

⁸ “Bioterrorism Overview” Centers for Disease Control and Prevention. 2008.

⁹ <https://top-channel.tv/2020/12/05/almari-i-ekspertit-kina-po-mbledh-adn-ne-e-botes-per-nje-arsye-temershme/>

dhe jeta e njeriut është vënë në shënjestër të veprimeve të grupeve kriminale dhe terroriste, për të vënë në zbatim qëllimet e tyre kriminale.

Sulmet bioterroriste mund të shkaktohen nga pothuajse çdo mikroorganizëm patogjen. Mikroorganizmat (si virusi, bakteret, kërpudhat ose toksinat) për t'u konsideruar si agjent bioterrorist duhet të prodhojnë vazhdimisht një efekt të dhënë, vdekje ose sëmundje. Agjenti duhet të jetë shumë ngjitës, të ketë një periudhë të shkurtër dhe të parashikueshme të inkubacionit. Popullsia e synuar duhet të ketë pak ose aspak imunitet ndaj organizmit. Agjenti duhet të jetë i vështirë për t'u identifikuar në popullatën e synuar dhe duhet të jetë në dispozicion me ose pak profilaksi ose trajtim me popullsinë vendase¹⁰.

Në rast të një sulmi bioterrorist hapi më i rëndësishëm është identifikimi i ngjarjes. Shkaku i një sëmundjeje apo edhe ekzistenca e diçkaje të pazakontë mund të jetë shumë e vështirë të përcaktohet, veçanërisht nëse rastet fillestare janë të pakta. Çdo shpërthim i vogël ose i madh i sëmundjes duhet të vlerësohet si një sulm i mundshëm bioterrorist. Mjekët në departamentet e pacientëve në spital, mjekët privatë dhe mjekët e familjes mund të luajnë një rol jetësor në njohjen fillestare të një sulmi të mundshëm të bioterrorizmit. Një sulm bioterrorist mund të jetë i vështirë të dallohet nga një shpërthim i sëmundjes infektive që ndodh natyrshëm. Një rast i vetëm i diagnostikuar ose i dyshuar i lisë, antraksit inhalues [përmes frymëmarrjes], antraksit lëkuror (*pa asnjë faktor të njohur rreziku të pajtueshëm me sëmundjen që ndodh natyrshëm*), ëthe hemorragjike virale (*në një pacient pa histori ndërkombëtare të udhëtimit*) ose më shumë se një rast murtaje, tularaemia pneumonike, ose një numër më i lartë sesa pritej i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së pashpjegueshme në një periudhë të shkurtër kohore brenda një rajoni të përcaktuar gjeografik, duhet të tregojë drejt mundësisë të një sulmi bioterrorist¹¹.

Çdo shtet ka të ngritur plane veprimi, strategji dhe institucione për identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e situatave të riskut ku siguria kombëtare vihet në shënjestër. Pas sulmeve të 11 shtatorit të vitit 2001, së bashku me përhapjen e qëllimshme të formave të fuqishme të bakteve të antraksit përmes postës amerikane, Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndërmorën një sërë masash mobilizuese në nivel lokal dhe kombëtar për të parandaluar, zbuluar dhe për t'u mbrojtur kundër akteve terroriste. Akademiti Kombëtar filluan një projekt duke u bazuar në përvojën e më shumë se 100 ekspertëve të shquar nga fusha të ndryshme për të ndihmuar qeverinë federale të përmbushë sfidat e reja komplekse të paraqitura nga terrorizmi. *Bërja e kombit më të sigurt: Roli i shkencës dhe teknologjisë në luftën kundër terrorizmit (2002)* përshkruan një strategji kombëtare me të cilën pikat e forta të shkencës, mjekësisë dhe inxhinierisë amerikane mund të renditen në mënyrë të vazhdueshme për të ndihmuar kombin në parashikimin, parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit¹². Në vijim, një numër i madh studimesh është kryer nga Instituti i Mjekësisë së pari për një kuptim më të plotë të kërcënimeve të terrorizmit dhe identifikimin e mënyrave për të parandaluar sulmet terroriste ose për të zvogëluar pasojat e tyre.

Agjentët bioterroristë me përparësi më të lartë për t'u mbajtur nën kontroll dhe vëzhgim janë shkaktarët e antraksit (*Bacillus anthracis*), botulizmit (*Clostridium botuli-*

¹⁰ Bioterrorism: A Public Health Perspective, <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4921253/>

¹¹ Robinson JPP, editor. Public health response to biological and chemical weapons: WHO guidance. 2nd ed. World Health Organization; 2004. Annex 3. Biological agents; pp. 229–276. [Google Scholar]<http://whqlibdoc.who.int/publications/2004/9241546158.pdf>, aksesuar ne web date 18.02.2021.

¹² Human Security and Bioterrorism, <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK216161/>, aksesuar ne web date 20.02.2021.

num), murtajës (Yersinia pestis), lisë (variola madhore), tulareemisë (Francisella tularensis) dhe etheve hemorragjike virale (filovirusët dhe arena viruse). Ka shumë ushqime të tjera të zakonshme ose agentë të transmetuar nga uji që mund të përdoren potencialisht në një sulm bioterrorist. Armët biologjike sipas klasifikimit që ka bërë Qendra e Kontrollit dhe Parandalimit të Sëmundjeve në SHBA (CDC) të cilat klasifikohen në tre kategori: kategoria A, B dhe C¹³, bazuar në përparësinë e agentëve për të paraqitur rrezik për sigurinë kombëtare dhe lehtësinë me të cilën ato mund të përhapen.

Vlen për t'u theksuar fakti që në kategorizimin e sëmundjeve dhe patogjeneve të cilat do të jenë në ndjekje dhe monitorim periodik nga ky ekipet mjekësore parësore, vlerësohen periodikisht në bashkëpunim me ekspertët dhe institucionet federale të sigurisë. Format se si armët biologjike mund të hyjnë në trupin e njeriut janë kryesisht nëpërmjet inihimit [frymëmarrjes/ajrit], kontaktit (lëkura/mukoza) dhe traktit gastrointestinal. Metodot e transmetimit mund të bëhen përmes bombardimeve të hedhura nga aeroplanët ose përdorimit të tankeve me spërkatje të montuara në aeroplanë/ ndërtesa të larta. Agentët e antraksit, murtajës, brucelozës, lisë, encefalitideve virale dhe etheve hemorragjike virale mund të aerosolizohen [gazifikohen] dhe shpërndahen në zona të mëdha gjeografike. Metodot e tjera përfshijnë shpërndarjen me postë ose me infiltrim të qëllimshëm të kafshëve, vektorëve dhe dëmtuesve të infektuar përmes kufirit ndërkombëtar. Në përgatitje kundër sulmeve të armëve biologjike, metoda më të reja për zbulimin/paralajmërimin e hershëm janë shpikur nga vende të caktuara p.sh. programi *Bio Watch* në SHBA, i cili përdor një seri detektorësh patogjenë të bashkuar me monitorë të cilësisë së ajrit. Këta detektorë mbledhin grimcat e ajrit në filtra, të cilët më vonë grumbullohen manualisht në intervale të rregullta dhe analizohen për patogjenë të mundshëm të armëve biologjike duke përdorur teknikat e reaksionit zinxhir polimerazë (PCR). Ky sistem mund të sigurojë paralajmërim të hershëm të një çlirimi të patogjenit, duke vënë në alarm autoritetet përpara se viktimat të fillojnë të shfaqin simptoma dhe duke siguruar mundësinë për të dhënë trajtim më herët, apo izoluar rastin¹⁴.

Sulmet e 11 shtatorit 2001 dhe ato me antraks nëpërmjet postës kanë bërë që strukturat shtetërore në SHBA të mobilizohen dhe të marrin masa për identifikimin dhe parandalimin e tyre. Situata ka bërë që të shtohen kontrollet në kufi dhe në shërbimin postar, duke përdorur pajisje dhe teknologji të posaçme për identifikimin e agentëve dhe patogjenëve të ndryshëm. Por, sa është i përgatitur një vend si Shqipëria, duke marrë parasysh pozicionin gjeografik dhe ekonomik, për t'iu përgjigjur dhe reaguar në kohë dhe me mjetet e duhura ndaj një sulmi të mundshëm biologjik, ardhur drejtpërdrejt apo dhe indirekt për shkak të afërsisë së madhe me shumë vende të tjera evropiane?

3. Masat parandaluese dhe gjendja e gatishmërisë që duhet të ketë sektori shëndetësor dhe institucionet e tjera ligjzbatuese në Shqipëri

Në kuadrin e planit legjislativ, Shqipëria ka marrë një sërë masash parandaluese dhe

¹³ Për më shumë shiko: Bioterrorist agents: Differential diagnosis, initial laboratory tests, and public health actions. Available from URL: <http://www.stanfordhospital.com/PDF/BTAagentsDifferentialDiagnosis.pdf>.

¹⁴ Shea DA, Lister SA. Congressional Research Service. 2003 November 19. The BioWatch Program: Detection of Bioterrorism. [Google Scholar] <http://www.fas.org/sgp/crs/terror/RL32152.html> Report No. RL 32152.

strategjike për parandalimin, identifikimin në kohë të rasteve që mund të kërcënojnë sigurinë e shëndetit publik. Në vitin 2019 është miratuar *ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile"*¹⁵, ligji i cili është përfshirë me një sërë direktivash të BE-së në fushën e mbrojtjes civile, parashikon masat ndaj fatkeqësive natyrore dhe bashkëpunimin midis shteteve me qëllim parandalimin.

Në nenin 3 pika 10 e ligjit nr.45/2019, në konceptin e fatkeqësive të tjera brenda fushës së veprimit të ligjit për mbrojtjen civile përfshihen dhe sulmet terroriste.

10. "Fatkeqësi të tjera" janë aksidentet teknologjike, rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore ekologjike ose industriale dhe aksidente të tjera të shkaktuara nga veprimi njerëzor, lufta ose gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste, si dhe lloje të tjera të dhunës masive.

Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, në dispozitat e kreut VII, ka parashikuar disa dispozita të posaçme që lidhe me veprat terroriste.

Në nenin 230 të *Kodit penal* "Vepra me qëllime terroriste" janë sanksionuar format e terrorizmit, duke dhënë në mënyrë të detajuar sipas elementët e veprës penale se cilat janë rastet që përfshijnë veprat terroriste. Konceptin e bioterrorizmit si formë e veprave terroriste, nuk e gjejmë të trajtuar shprehimisht në nenin 230 të *Kodit penal*, por e gjejmë në elementët e veprës penale të parashikuar në germen "j" të tij.

Konkretisht, në germen "j" të nenit 230 të *Kodit penal* është parashikuar se veprat me qëllime "terroriste përfshijnë ndër të tjera edhe:

j) *prodhimin, mbajtjen, blerjen, transportin apo tregtimin e lëndëve plasëse, të armëve të zjarrit, biologjike, kimike apo bërthamore, si dhe kërkimin shkencor për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë;*

Ndërsa në nenin 282/c¹⁶ të *Kodit penal* janë sanksionuar në një dispozitë të posaçme rastet e importimit, eksportimit, transitimit, tregtimin, prodhimin, mbajtjes, transportimit ose shpërndarjes së substancave kimike që mund të përdoren si armë biologjike ose kimike.

"Importi, eksporti, transitimi, tregtimi, prodhimi, mbajtja, transportimi ose shpërndarja e substancave kimike bazë ose e substancave të tjera të çfarëdoshme, të teknologjive, të pajisjeve e materialeve, në rast se dihet që ato përdoren ose do të përdoren për prodhimin ose trafikimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe armëve kimike e biologjike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohet me burgim nga dhjetë deri nëzetë vjet".

Kjo dispozitë synon që të parandalojë në kohë, transportimin dhe tregtimin e substancave kimike apo biologjike, të cilat potencialisht mund të përdoren për prodhimin ose trafikimin e armëve të shkatërrimit në masë apo armëve kimike dhe biologjike. Patjetër që kjo dispozitë të gjejë zbatim efektiv në praktikë, kërkon që strukturat e kontrollit kufitar dhe ato ligjzbatuese të jenë të pajisur me teknologjinë e nevojshme për identifikimin dhe zbulimin e këtyre substancave të rrezikshme.

Një tjetër ligj që lidhet me masat parandaluese të bioterrorizmi është dhe *ligji nr.15/*

¹⁵ Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 8756 datë 26.3.2001, "Për emergjencat civile".

¹⁶ Shtuar me ligjin nr.135/2015, datë 5.12.2015

2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”¹⁷. Zbatimi i masave parandaluese dhe ndjekja e rasteve të dyshuara të sëmundjeve infektive, patjetër që lidhet dhe me masat dhe kujdesin e shtuar për raste të dyshuara të bioterrorizmit. Kjo sepse format me të shumta se si mund të kryhen sulmet bioterroriste lidhen me mikroorganizma patogjenë, që shkaktojnë infeksione të ndryshme të pazakonta tek njerëzit.

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksionet dhe sëmundjet infektive, duke përcaktuar rregullat dhe aktivitetet për zbulimin në kohë, evidentimin, parandalimin dhe kontrollin e tyre, për eliminimin dhe zhdukjen e sëmundshmërisë dhe të vdekshmërisë nga këto sëmundje. Ligji përcakton përgjegjësitë dhe rolin e shërbimeve shëndetësore, shërbimeve të shëndetit publik, si dhe aktorëve të tjerë të të gjitha niveleve, publike e jopublike, në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësie.

Nga ana tjetër, në kuadër të luftës dhe parandalimit të terrorizmit janë miratuar strategji ndërsektoriale¹⁸ dhe plane veprimi. Në zbatim të tyre, ka vazhduar puna për parandalimin e terrorizmit nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me të gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit që marrin pjesë në luftën kundër terrorizmit si SHISH-i, AIM-i, DPPPP-ja, etj. si dhe me agjencitë rajonale dhe ndërkombëtare si OKB-ja, SECI, EUROPOL-i, INTERPOL-i etj. Por, nga shqyrtimi i këtyre akteve strategjike konstatohet se terrorizmi trajtohet në një plan të përgjithshëm pa u ndalur në format e shfaqjes së tij, siç mund të jetë bioterrorizmi. Në planin institucional dhe organizativ janë ngritur një sërë institucionesh me qëllim marrjen e masave për parandalimin dhe përballimin e ngjarjeve si fatkeqësi natyrore ose fatkeqësive të tjera të cilat mund të venë në rrezik jetën dhe shëndetin e popullsisë.

Strukturat operacionale të mbrojtjes civile, që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera, në zbatim të ligjit nr. 45/2019 janë:

- a) Forcat e Armatosura;
- b) Policia e Shtetit;
- c) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;
- ç) Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor;
- d) Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile.

Në kuadër të masave parandaluese për sëmundjet infektive ligji 15/2016 ka parashikuar ngritjen e strukturave të survejancës [mbikëqyrjes]. *Spektori i Survejancës Kombëtare të Sëmundjeve Infektive*, është qendra kombëtare e koordinimit të survejancës së sëmundjeve infektive, e cila grumbullon, përpunon, analizon në kohë

¹⁷ Ky ligj është përfshirë pjesërisht me:

- Vendimin nr.1082/2013/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 22 tetor 2013, “Mbi kërcënimet serioze ndërkufitare për shëndetin, i cili shfaqet vendimin nr. 2119/98/KE”, Numri CELEX: 2013D1082, Fletorja Zyrtare e BE-së, L, nr. 293, datë 5.11.2013, faqe 1-15.

- Vendimin e Komisionit (2000/96/KE), datë 22 dhjetor 1999, “Mbi sëmundjet e transmetueshme që do të mbulohen në mënyrë progresive nga rrjeti i Komunitetit, sipas vendimit nr.2119/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit”, (të shënuar sipas numrit të dokumentit C (1999) 4015), Numri CELEX 32000D0096, Fletorja Zyrtare e BE-së, L, nr. 28, datë 3.2.2000, faqe 50-53, për sëmundjet infektive dhe ngjarjet me rëndësi për shëndetin publik.

¹⁸ - VKM nr.1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit, 2021-2025 dhe të Planit të Veprimit 2021-2025.

VKM nr. 675, datë 06.07.2011, Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit 2011 - 2015 si dhe Plan i veprimit për implementimin e saj.

- VKM nr. 663, datë 17.7.2013 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016”.

dhe në vijueshmëri të dhënat mbi sëmundshmërinë infektive, të dërguara në ISHP (në departamentin e kontrollit të sëmundjeve infektive) nga shërbimet epidemiologjike e të gjitha rretheve të vendit dhe ndërhyjnë apo vepron në bazë të këtyre të dhënave. Burimi i të dhënave përfshin kujdesin parësor, spitalor dytësor dhe spitalor tretësor si në shërbimin publik dhe atë privat. Ky sektor ka detyrimin të vlerësojë çdo ngjarje të pazakontë në vend duke njoftuar menjëherë Drejtorinë e Institutit të Shëndetit Publik (ISHP-së).

Për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive një emergjence shëndetësore ose katastrofe, departamentet shëndetësore në nivel qendror dhe lokal duhet të jenë në gjendje gatishmërie për të identifikuar dhe parandaluar një përhapje infeksioni për shkak të një sulmi bioterrorist, duke izoluar në kohë dhe raportuar rastin. Përhapja që mori COVID-19, i cili në një kohë të shkurtër u kthye në pandemi erdhi si pasojë e faktit që nuk u raportua në kohë, madje u fsheh nga strukturat shëndetësore të Wahanit në Kinë. Nëse strukturat përgjegjëse do të kishin raportuar në kohë, me shumë mundësi, do të ishte parandaluar pandemia e një përhapje të tillë globale.

Së pari, vendi jonë duhet të vlerësojë gjendjen e sistemit të tij shëndetësor, në kuadër infrastrukturor dhe profesional, si dhe të jenë në gjendje gatishmërie për të identifikuar, trajtuar rastet e dyshuara. Në këtë pikë është thelbësor fakti, që mjekët në nivelin parësor të kenë njohuritë e duhura për të bërë dallimin midis simptomave të një gripi të thjeshtë dhe një infeksioni nga agjentë të bioterrorizmit. Trajtimi, nga ana tjetër kërkon ndjekje epidemiologjike të rastit të dyshuar, ekspertizë laboratorike, fillimi i masave parandaluese, kurative dhe specifike të kontrollit për të ndaluar përhapjen e mëtejshme të sëmundjes tek pjesa tjetër e popullsisë.

Në nenin 5 pika 7 e ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" parashikohet se:

"7. Çdo institucion publik apo jopublik ka detyrimin për të raportuar agjentët shkaktarë në mostrat humane apo të tjera si më poshtë:

a) çdo laborator diagnostik publik apo jopublik raporton dhe njofton Shërbimin Kombëtar të Inteligjencës Epidemike, autoritetet vendore të shëndetit publik dhe Institutin e Shëndetit Publik kur ai identifikon, në mostrat humane apo në mostra të tjera, një agjent shkaktar, që përbën rrezik për njeriun dhe shëndetin publik;

b) raportimi dhe njoftimi përfshin informacionin e caktuar sipas standardeve të miratuara nga Shërbimi Kombëtar i Inteligjencës Epidemike;

c) raportimi kryhet brenda 1-7 ditëve, duke filluar që nga momenti i identifikimit të agjentit shkaktar, sipas procedurës së ndjekur dhe sipas listës përkatëse të agjentëve shkaktarë dhe sëmundjeve infektive, por, nëse laborator diagnostik e konsideron rastin urgjent, raportimi dhe njoftimi kryhen edhe me gojë, sa me shpejt të jetë e mundur, sipas mjeteve përkatëse dhe praktike të komunikimit;

ç) për të përcaktuar nëse rasti është urgjent ose jo, laborator diagnostik vlerëson:

i) llojin dhe natyrën e agjentit shkaktar;

ii) natyrën e sëmundjes që shkakton agjenti shkaktar;

iii) lehtësinë dhe shpejtësinë e përhapjes së agjentit shkaktar; iv) mënyrat me të cilat përhapet agjenti shkaktar;

v) mënyrat me të cilat parandalohet apo kontrollohet përhapja e agjentit shkaktar;

vi) rrethanat për pacientin (përfshirë seksin, moshën dhe llojin e punës) kur ato janë të njohura".

ISHP-ja ka detyrimin që të ndërhyjë ndaj të gjitha shpërthimeve epidemike, apo ndodhive jo të zakonshme në vend ose rajon, duke funksionuar edhe si qendër e

koordinimi për *Rregulloren ndërkombëtare të shëndetit*, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 24.9.2010 “Për zbatimin e *Rregullores ndërkombëtare të shëndetit*”, ku ISHP-ja përcaktohet si *pika kombëtare fokale* e kësaj rregulloreje. Pavarësisht faktit që ligji ka parashikuar detyrimin e strukturave shëndetësore publike dhe private për të raportuar raste të dyshuara të agjentëve që mund të shkaktojnë sëmundje infektive, stafi mjekësor dhe parësor është i paspecializuar dhe i patrajnuar plotësisht në identifikimin e agjentëve dhe simptomave që mund të shkaktohen nga kategoritë e agjentëve të lidhur me sëmundjet efektive që vijnë si pasojë e agjentëve të bioterrorizmit.

Në ligj dhe aktet nënligjore është parashikuar që të raportohet krahas të tjerave edhe çdo ndodhi e pazakontë në të gjitha shërbimet shëndetësore. Në vlerësimin tonë, janë pikërisht rastet e pazakonta që kërkojnë një vëmendje dhe vigjilencë më të zgjeruar, për arsye se mund të jenë të lidhura jo vetëm me raste risku epidemiologjik, por edhe risku tjetër, siç mund të jetë bioterrorizmi. Në këtë pikë, është shumë e rëndësishme që stafi mjekësor parësor të ketë njohuri të mjaftueshme për të dalluar simptomat e sëmundjeve që vijnë nga agjentët dhe patogenët që mund të përdoren si armë të bioterrorizmit.

Në nenin 16 pika 13 të ligjit nr. 15/2016 është parashikuar se sëmundjet infektive, të cilat duhet të mbulohen nga rrjeti i mbikëqyrjes epidemiologjike, përzgjidhen sipas kriterëve bazë të mëposhtme:

a) të jenë sëmundje që shkaktojnë apo kanë mundësi të shkaktojnë sëmundshmëri dhe/ose vdekshmëri të lartë në vend dhe rreth tij dhe për të cilat duhet të ketë një koordinim kombëtar, ndërkufitar e global;

b) të jenë sëmundje, për të cilat shkëmbimi i informacionit siguron njoftim të hershëm të kërcënimeve për shëndetin publik;

c) të jenë sëmundje të rralla dhe serioze, që nuk dallohen menjëherë, në nivel kombëtar, por për të cilat grumbullimi i informacionit lejon zhvillimin e hipotezave dhe zbulimin e shpërthimeve epidemike;

ç) të jenë sëmundje për të cilat ekzistojnë masa parandalimi efektive, që sjellin përfitime në mbrojtjen e shëndetit;

d) të jenë sëmundje, ngjarja e të cilave, kur krahasohet me ngjarjen në vende të tjera, mund të kontribuojë në vlerësimin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Lista e sëmundjeve infektive, nën monitorim dhe ndjekje nga ISHP (survejanca e sëmundjeve infektive) janë sëmundjet si më poshtë:

1. tifo abdominale,
2. salmonelozë,
3. shigelozë (disenteri bacilare),
4. dizenteri amebike,
5. helmime ushqimore,
6. gastroenterite,
7. sëmundje diarreje.

Numri total i rasteve të sindromave tëurvejancës “ALERT”, raportohet dhe publikohet çdo muaj nga ISHP. Në listën e simptomave të detyrueshme¹⁹ për raportim

¹⁹ Sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të ISHP, www.ishp.gov.al

janë rastet e evidentuara me:

1. diarre pa gjak,
2. diarre me gjak,
3. infeksione respiratore të sipërme,
4. infeksione respiratore të poshtme,
5. rast me temperaturë,
6. verdhëza,
7. hemorragji me temperaturë,
8. meningjit i dyshuar,
9. ethe të pashpjegueshme.

Referuar të dhënave të publikuar në faqen zyrtare të Institutit të Shëndetit Publik, sëmundjet infektive që mbulohen nga rrjeti i mbikëqyrjes epidemiologjike janë relativisht të kufizuara në raport me sëmundjet infektive që shkaktohen nga patogjenet dhe mikroorganizmat që potencialisht mund të përdoren në sulmet bioterroriste. Për këtë, i jemi referuar listës me agjentet shkaktare të bioterrorizmit sipas të dhënave nga Qendra Amerikane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve²⁰ (shiko më poshtë tabela nr. 1).

Faktikisht është e nevojshme që strukturat të cilat do të raportojnë rastet e dyshuara dhe që përfshihen në rrjetin e mbikëqyrjes epidemiologjike, duhet të kenë informacionin e nevojshëm dhe njohuritë e duhura për të identifikuar simptomat përkatëse. Kuptohet që nëse do të kemi një koordinim të mirë në nivelin parësor, mund të parandalohet një sulm bioterrorist, veçanërisht të tipit infektiv që përhapet nga personi në person.

Nga një perspektivë e shëndetit publik dhe sigurisë, mbikëqyrja në kohë, ndërgjegjësimi për simptomat që rezultojnë nga agjentët e bioterrorizmit, kapaciteti i hetimit epidemiologjik, kapaciteti laboratorik dhe aftësia për të koordinuar dhe komunikuar me organet përgjegjëse dhe informimin në kohë të publikut për masa parandaluese, janë thelbësore.

3. Strukturat përgjegjëse për t'u përgjigjur ndaj një sulmi të mundshëm bioterrorist duke përdorur agjentë kimikë dhe biologjikë.

*Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)*²¹ është organi përgjegjës për zbatimin e drejtimeve strategjike dhe objektivat e përcaktuar nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile. Gjithashtu koordinon dhe bashkërendon punën për hartimin e *Strategjisë kombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, Planit kombëtar për emergjencat civile dhe vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë në nivel qendror*; si dhe bashkëpunon me organizmat ndërkombëtarë dhe organizatat homologe ndërkombëtare në kuadër të mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.

Aktualisht është ende në fuqi *Plani kombëtar për emergjencat civile*, miratuar me VKM nr. 835, datë 3.12.2004 në zbatim të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për

²⁰ Centers for Disease Control and Prevention, USA.

²¹ Neni 23 i Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile".

emergjencat civile” i cili është shfuqizuar me ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Ndërkohë, vet ligji nr. 45/2019 ka parashikuar detyrimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për të koordinuar dhe bashkërenduar punën për hartimin e *Strategjisë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, Planit kombëtar për emergjencat civile dhe vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë në nivel qendror. Planit kombëtar për emergjencat civile dhe vlerësimin e rrezikut*, në përputhje me kërkesat e ligjit të ri, nuk është miratuar ende.

Në raportin e KLSH-së të datës 25.6.2020 “Për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në AKMC”, është konstatuar se nuk është draftuar/hartuar apo miratuar, *Strategjia kombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë (neni 10 i ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”)* (sipas të dhënave të Raportit të KLSH-së faqe 10-21).

-Nga auditimi u konstatua se, *Plani kombëtar i emergjencave civile* (PKEC) si dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile, për një kohë të gjatë nuk ka pasur asnjë përditësim (viti 2004), ku të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile duke mos iu përshtatur realitetit me ndodhitë që kanë ndodhur për 16 vite në Shqipëri. Për këtë arsye, KLSH-ja ka rekomanduar që AKMC-ja dhe MM-ja në bashkëpunim me strukturat përbërëse të emergjencave civile, të marrin masa për përditësimin dhe miratimin e *Planit kombëtar të emergjencave civile* ku të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile duke u mbështetur edhe në ndryshimet e ndodhura me bazën ligjore dhe nënligjore²².

Drejtoria e Hetimit të Akteve Terroriste, që me krijimin e saj ka pasur prioritet të punës, ndalimin e rekrutimeve dhe arrestimin e personave që përgatisin rekrutë për grupin terrorist ISIS, si dhe shpërthimet me eksploziv, të klasifikuara si akte terroriste. Pavarësisht specializimit në fushën e antiterrorit, këto struktura nuk janë përgatitur dhe nuk janë të pajisura me mjete dhe infrastrukturë logjistike për t’u përballur me sulme kimike dhe biologjike. Për këtë arsye, do të ishte e rëndësishme përfshirja në trajnime dhe specializime specifike të këtyre strukturave edhe në fushën e bioterrorizmit. Në këtë kuadër, mund të shërbejë dhe krijimi i ekipeve të specializuara për sigurinë e shëndetit publik pranë këtyre strukturave, ose bashkëpunimi institucional në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Në funksion të strukturave antiterror është krijuar dhe Njësia për Verifikimin e Terrorizmit dhe Sigurinë, e cila shërben për shkëmbimin e informacioneve me Qendrën Ndërkombëtare Kundër Terrorizmit (TSC) dhe me Qendrën Evropiane Kundër Terrorizmit (ECTC) në Europol, për verifikimin e shtetasve shqiptarë dhe të huaj të përfshirë në veprimtari terroriste, si dhe Njësia për Hetimin e Financimit të Terrorizmit.

Shërbimi Informativ Shtetëror dhe agjenci të tjera inteligjente, në funksion të mbledhjes së informacionit nga jashtë, në funksion të sigurisë kombëtare, kryejnë veprimtari kundërzbulimi për ruajtjen e integritetit, të pavarësisë e të rendit kushtetues. SHISH-i mbledh informacion në kuadër të luftës kundër terrorizmit, trafikut të narkotikëve, prodhimit të armëve të dëmtimit në masë, për krimet kundër mjedisit,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

²² Shiko faqe 33 Raporti i KLSH “Për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në AKMC”, datë 25.06.2020.

krimin e organizuar, krime që cenojnë sigurinë kombëtare etj. Në këtë mënyrë, informon strukturat përgjegjëse dhe bashkërendon veprimtarinë për parandalimin dhe goditjen e akteve kriminale. Në kuadër të bashkëpunimit institucional, me qëllim parandalimin e ngjarjeve kriminale, SHISH-i ka një rol të rëndësishëm në informimin dhe koordinimin e informacioneve të strukturave të inteligjencës.

Policia e Shtetit ka një rol të rëndësishëm në funksion të ruajtjes së rendit dhe sigurisë. Gjendja e emergjencës shëndetësore që shkaktoi pandemia e COVID-19 tregoi se sa i rëndësishëm është roli i strukturave të Policisë së Shtetit në ruajtjen e sigurisë publike. Së pari, duke siguruar zbatimin e protokolleve të izolimit për personat e karantinuar, dhe së dyti, për marrjen e masave administrative për personat që shkelin rregullat e vendosura në kushtet e një emergjence shëndetësore, me qëllimi sigurimin e respektimit të tyre nga ana e shtetasve.

Policia, nuk është e stërvitur në mënyrë rutinë për t'iu përgjigjur incidenteve kimik/biologjike, megjithatë ajo luan një rol vendimtar në ruajtjen e rendit. Pajisja e njësive të policisë me mjete mbrojtëse është, një mënyrë që mund të përdoret për të shtuar numrin e strukturave që mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në reagimin ndaj një incidenti kimik/bioterrorist.

Shërbimet zjarrfikëse, mund të kenë një rol të rëndësishëm, veçanërisht në rastet e sulmeve me armë kimike, ose helmuese për shkak se kanë mjetet dhe njohuritë si të trajtojnë situatat emergjente që kërkojnë mjete gazmbrojtëse. Shërbimet e zjarrfikësve kanë personel të trajnuar dhe të pajisur për të punuar me aparate për frymëmarrjen dhe mjete gazmbrojtëse (pasi avujt e rrezikshëm janë gjithmonë pjesë e zjarreve), dhe sigurisht që ata janë të trajnuar për të trajtuar raste emergjente.

Ekipet e specializuara për toksinat industriale (Agjencia Kombëtare e Mjedisit). Ekipet e trajnuar dhe të pajisur për t'u marrë me derdhjet aksidentale dhe çlirimet e kimikateve toksike industrial, janë struktura të nevojshme që duhet të kenë pajisjet dhe laboratorët për të identifikuar llojin e ndotjes dhe substancave kimike që mund të ndikojnë në shëndetin e popullsisë apo ndotjen e mjedisit dhe gjësë së gjallë. Por, përgjithësisht këto struktura nuk janë të specializuara për tu përballuar me incidente të krijuara nga një sulm terrorist, veçanërisht ato të bioterrorizmit nga agjentë biologjikë (si viruset, bakteret, kërpudhat ose toksinat e tyre).

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe koordinimit të strukturave ligjzbatuese me qëllim luftën kundër terrorizmit, Shqipëria edhe për shkak të pozicionit gjeografik, ka pasur një rol të rëndësishëm në rajon e më gjerë. Si pjesë e organizatave të rëndësishme ndërkombëtare, ashtu dhe si nënshkruese e një sërë konventash në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme etj, Shqipëria ka marrë përsipër angazhime serioze dhe është një aleat i rëndësishëm kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar i vendeve të rajonit e më gjerë.

Shqipëria ka marrë angazhime në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar edhe në fushën e shëndetit publik. Ligji nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" i miratuar në datë 10.03.2016 nga Parlamenti shqiptar, është përafëruar pjesërisht me *vendimin nr. 1082/2013/KE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit, datë 22 tetor 2013*. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për mbikëqyrjen epidemiologjike, monitorimin, paralajmërimin e hershëm dhe luftën kundër kërcënimeve serioze ndërkufitare për shëndetin, duke përfshirë planifikimin e gatishmërisë dhe përgjigjes në lidhje me këto veprimtari, me qëllim koordinimin dhe plotësimin e politikave kombëtare. Nga ana tjetër, ky vendim synon të mbështesë

bashkëpunimin dhe koordinimin mes shteteve anëtare për të përmirësuar parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së sëmundjeve të rënda tek njerëzit midis kufijve të shteteve anëtare, dhe për të luftuar kërcënime të tjera serioze ndërkuftare për shëndetin, duke kontribuar kështu në arritjen e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik në BE.

Në kuadër të zbatimit të këtij vendimi të KE-së, shtetit shqiptar i linden disa detyrime për raportim dhe veprim parandalues, sidomos sa i takon situatave emergjente të shëndetit publik.

Konkretisht në nenin 26 të ligjit nr. 15/2016 është parashikuar se:

1. Instituti i Shëndetit Publik njofton ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, OBSH-në, ECDC-në dhe strukturat përkatëse të Komisionit Europian e ato ndërkuftare rajonale për ngjarjet dhe përgjigjen e hershme e të shpejtë për emergjencat apo zhvillimet e lidhura me kërcënimet serioze ndërkuftare për shëndetin, që përmbushin kriteret si më poshtë:

a) ngjarje jo e zakonshme apo e papritur, për vendin dhe kohën, ose që shkakton ose mund të shkaktojë sëmundshmëri dhe vdekshmëri të lartë te njerëzit, apo sëmundje që pëson rritje të shpejtë ose mund të ketë një shkallë rritjeje të shpejtë, ose që i tejkalon apo mund t'i tejkalojë kapacitetet kombëtare të përgjigjes;

b) prek apo mund të prekë më shumë se një vend;

c) kërkon apo mund të kërkojë një përgjigje të koordinuar.

Në nenin 27, pika 1 e ligjit nr. 15/2016 me titull “Vlerësimi i rrezikut dhe përgjigja ndaj kërcënimeve” është parashikuar se:

“Për çdo alarm të deklaruar, Instituti i Shëndetit Publik duhet, sa herë që është e nevojshme, të kryejë vetë apo në koordinim me OBSH-në, ECDC-në apo agjenci të tjera europiane e ndërkombëtare, si dhe struktura të tjera, një vlerësim të rrezikut, për mundësinë e kërcënimit serioz për shëndetin publik, përfshirë këtu edhe masat e mundshme të shëndetit publik. Çdo vlerësim rreziku, përpara se të bëhet publik, duhet të aprovohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë”.

Instituti i Shëndetit Publik²³ merr pjesë në rrjetin e mbikëqyrjes së sëmundjeve infektive të vendeve të BE-së dhe atyre të Europës Juglindore dhe koordinon veprimet e saj me ECDC (Qendrën Europiane të Kontrollit të Sëmundjeve), OBSH-në dhe ato përkatëse të Europës Juglindore. Këto rrjete krijojnë platformën për komunikim ndërmjet autoriteteve kompetente përgjegjëse për survejancën epidemiologjike në nivel kombëtar, Komisionin Europian, ECDC-në dhe OBSH-në. Instituti i Shëndetit Publik nga ana tjetër, kërkon informacione të ngjashme nga vendet e tjera dhe Komisioni Europian apo strukturat rajonale ndërkuftare për kërcënimin serioz ndërkuftar për shëndetin dhe masat përkatëse të shëndetit publik, nëpërmjet sistemit të vendosur të shkëmbimit të informacionit për njoftimin e hershëm e të shpejtë dhe për të koordinuar përgjigjen përkatëse²⁴.

Shqipëria gjithashtu, ka nënshkruar dhe po zbaton një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me vende të rajonit, Evropës dhe SHBA-të, në fushën e sigurisë dhe shkëmbimit të informacionit për verifikimin dhe luftën kundër terrorizmit, konkretisht me Francën, Gjermaninë, Italinë, SHBA-në, Kosovën, Slloveninë, Kroacinë, Hungarinë, Egjiptin, Rumaninë, Malin e Zi, Maqedoninë, Bullgarinë, Bosnjë Hercegovinë, Sllovakinë, Serbinë dhe Letoninë etj.

²³ Shiko nenin 25 pika 8 të ligjit nr.15/2016.

²⁴ Shiko nenin 26, pika 4 e ligjit nr.15/2016

4. Konkluzione

Bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të parandalimit nga strukturat e inteligjencës kombëtare ashtu dhe në asistencën teknike dhe profesionale për identifikimin dhe trajtimin në kohë të kërcënimeve ndaj shëndetit publik, pavarësisht origjinës së tyre, përbën një element thelbësor në parandalimin e rrezikut nga bioterrorizmi, por edhe të infeksioneve virale apo bakteriale me rrezik përhapjeje pandemike.

Bashkëpunimi intensiv në nivel ndërkombëtar i strukturave të inteligjencës dhe ato të shëndetit publik me qëllim parandalimin dhe identifikimin në kohë të sulmeve të mundshme terroriste (bioterroriste) mbetet thelbësore për parandalimin dhe goditjen në kohë të tyre.

Mbështetja financiare dhe logjistike për strukturat e kontrollit kufitar me mjete të avancuara të teknologjisë për identifikimin dhe parandalimin e futjes në kufi të substancave të dyshuara si agjentë kimikë apo biologjikë, me risk të shtuar në kuadër të luftës kundër terrorizmit, sot paraqet një domosdoshmëri për vendin.

Përmirësimi i infrastrukturës logjistike dhe pajisja me mjete e teknologji të avancuar për Institutin e Shëndetit Publik dhe Departamentit të Survejancës të Sëmundjeve Infektive, me qëllim identifikimin dhe analizimin në kohë të rasteve të dyshuara për patogjenë dhe agjentë viralë ose bakteriologjike, me risk për sëmundje infektive.

Rishikimi dhe përditësimi periodik i listës së sëmundjeve infektive dhe simptomave të detyrueshme për raportim nga strukturat vendore, në kuadër të mbikëqyrjes së sëmundjeve infektive, duke zgjeruar listën e sëmundjeve infektive për raportim. Gjithashtu, caktimi i një personi kontakti, të specializuar në këtë fushë në çdo njësi mjekësore publike apo private, që ka detyrimin për raportim të rasteve të dyshuara pranë ISHP, do të ishte një masë efektive për identifikimin e rasteve të dyshuara me risk nga bioterrorizmi.

Trajnimi i vazhdueshëm i këtyre strukturave raportuese dhe përditësimi i njohurive për të rejtat e shkencës dhe vigjilencës së zgjeruar që duhet të kenë në ndjekjen e rasteve në territorin e tyre.

Informimi i publikut dhe ngritja e vetëdijes mbi rreziqet që lidhen me sulmet terroriste dhe format e tij (bioterrorizmi) duhet të jenë pjesë integrale e aktiviteteve të organizmave dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse për të arritur efikasitetin në masat parandaluese dhe trajtimin në kohë të rasteve të dyshuara.

Strukturat e Policisë së Shtetit, të cilët janë të parët që përballen me një sulm të mundshëm bioterrorist, duhet të jenë të trajnuar dhe të pajisur me mjetet e nevojshme së pari si të mbrojtur veten e kolegët nga një infektim i mundshëm dhe së dyti, të marrim masa të menjëhershme për izolimin e rastit, deri sa organet e specializuara të shëndetit publik të kenë analizuar rastin e dyshuar.

Gjithashtu, strukturat e patrullës së përgjithshme të Policisë së Shtetit, duhet të trajtohen dhe kenë një protokoll të qartë të konsultuar nga specialistë të shëndetit publik, se si duhet të veprojnë në rast dyshuar sulmi bioterrorist, me qëllim sigurinë e tyre shëndetësore dhe izolimin në kohë të rastit të dyshuar.

Bioterrorizmi të vlerësohet me seriozitet si element rreziku për t'u përfshirë në *Planin e veprimt për gjendjet e emergjencës*, në zbatim të ligjit nr. 45/2019.

Patogjenët e kategorisë A - janë ata organizma/agjentë biologjikë që paraqesin rrezikun më të lartë për sigurinë kombëtare dhe shëndetin publik sepse ata:

Klasifikimi i patogjenëve sipas përparësive	Llojet e patogjenëve
Patogjenët me përparësi Kategoria A	- Bacillus anthracis (antraks) - Toksina e clostridium botulinum (botulizëm) - Yersinia pestis (murtaja) - Variola madhore (lisë) dhe virusë të tjera të lidhura me dhentë - Francisella tularensis (tularemia) - Ethet hemorragjike virale - Arenaviruset - Junin, Machupo, Guanarito, Chapare (i ri në vitin fiskal (FY14), Lassa, Lujo (i ri në FY14) - Viruset bunjaviruse - Hantavirusët që shkaktojnë sindromën pulmonare Hanta, ethet e luginës Rift, ethet hemorragjike të Kongos - Flaviviruset - Dënga - Filoviruset - Viruset Ebola dhe Marburg
Patogjenët me përparësi Kategoria B	- Burkholderia pseudomallei (melioidoza) - Coxiella burnetii (ethe Q) - Speciet e Brucelës (bruceloza) - Burkholderia mallei (gjëndra) - Chlamydia psittaci (Psittacosis) - Toksina Ricin (Ricinus communis) - Toksina epsilon (Clostridium perfringens) - Stafilokoku enterotoksina B (SEB) - Ethet e tifos (Rickettsia prowazekii) - Patogjene ushqimore dhe ujore - Bakteret - E.coli diarregjenik - Vibriot patogjene - Speciet Shigella - Salmonella - Listeria monocitogjene - Campylobacter jejuni - Yersinia enterocolitica - Viruset - Kalciviruset - Hepatiti A - Protozoarë - Cryptosporidium parvum - Cyclospora cayatanensis - Giardia lamblia - Entamoeba histolytica - Toxoplasma gondii - Naegleria fowleri - Balamuthia mandrillaris - Kërpudhat - Mikrosporidia - Viruse të transmetuara nga mushkonjat - Virusi i Nilit Perëndimor (WNV) - Encefaliti LaCrosse (LACV) - Encefaliti i Kalifornisë - Encefaliti i kuajve Venezuelës (VEE) - Encefaliti i kuajve lindorë (EEE) - Encefaliti i kuajve perëndimorë (WEE) - Virusi japonez i encefalitit (JE) - Virusi i encefalitit St. Louis (SLEV) - Virusi i etheve të verdha (YFV) - Virusi Chikungunya
Patogjenët me përparësi Kategoria C	- Viruset Nipah dhe Hendra - Hantaviruset shtesë - Viruset e etheve hemorragjike të këpushave - Viruset bunjaviruse - Ethet e Rënda me virusin e Sindromës Thrombocytopenia (SFTSV), virusi Heartland - Flaviviruset - Virusi i Etëve Hemorragjike Omsk, virusi Pyjeve Kyasanur - Flaviviruset komplekse të encefalitit të këpushave - Viruset e encefalitit nga kunjat - Nëntipi evropian - Nëntipi i Lindjes së Largët - Nëntipi siberian - Virusi Powassan / Deer Tick - Tuberkulozi, përfshirë tuberkulozin rezistues ndaj ilaçeve - Virusi i gripit - Rickettsias tjera - Virusi i tërbimit - Prionet - Coccidiosis spp. - Sindroma e rëndë akute e frymëmarrjes e shoqëruar me koronavirus (SARS-CoV), MERS-CoV dhe koronavirusë të tjerë shumë patogjenë njerëzorë (i ri në FY14).

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë »

- mund të përhapen ose transmetohen lehtësisht nga personi në person;
- rezultati në nivele të larta të vdekshmërisë dhe kanë potencialin për ndikim të madh në shëndetin publik;

- mund të shkaktojë panik publik dhe përçarje shoqërore;
- kërkon veprim të veçantë për gatishmërinë e shëndetit publik.

Patogjenët e kategorisë B - janë organizmat/agentët biologjikë të përparësisë së dytë:

- janë mesatarisht të lehtë për t'u shpërndarë;
- rezultati në nivele të moderuara të sëmundshmërisë dhe shkallë të ulët të vdekshmërisë;

- kërkon përmirësime specifike për kapacitetin diagnostik dhe mbikëqyrjen e përmirësuar të sëmundjes.

Patogjenët e kategorisë C- janë përparësia e tretë më e lartë dhe përfshijnë patogjenë në zhvillim që mund të projektohen për shpërndarje masive në të ardhmen për shkak të:

- disponueshmërisë;
- lehtësia e krijimit dhe shpërndarjes;
- potencial për nivele të larta sëmundshmërie dhe vdekshmërie dhe ndikim të madh në shëndet.

Literatura

1. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
2. Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" datë 18.07.2019.
3. Ligji nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" datë 10.03.2016.
4. "Mbi kërcënimet serioze ndërkufitare për shëndetin, i cili shfuqizon vendimin nr. 2119/98/KE", Numri CELEX: 2013D1082, Fletorja Zyrtare e BE-së, L, nr. 293, datë 5.11.2013.
5. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 772, datë 24.9.2010 "Për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit.
6. Jonathan Ban. "Agricultural Biological Warfare: An Overview." Chemical and Biological Arms Control Institute. The Arena 9 (June 2000).
7. Erhard Geissler and J.E. Moon. Biological Warfare from the Middle Ages to 1945. New York: Oxford University Press. 1999.
8. Of Biologics as Weapons Bioterrorism: A threat to National Security or Public Health Defining Issue? University of Wisconsin-Madison and Wisconsin State Laboratory of Hygiene, September 30, 2008.
9. Bioterrorism Overview, Centers for Disease Control and Prevention. 2008.
10. Bioterrorism: A Public Health Perspective, <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4921253>
11. Human Security and Bioterrorism, <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK216161/>
12. Bioterrorist agents: Differential diagnosis, initial laboratory tests, and public health actions. Available from URL: <http://www.stanfordhospital.com/PDF/BTAgentsDifferentialDiagnosis.pdf>
13. Shea DA, Lister SA. *Congressional Research Service*. 2003 November 19. The BioWatch Program: Detection of Bioterrorism. [Google Scholar]<http://www.fas.org/sgp/crs/terror/RL32152.html> Report No. RL 32152
14. <http://www.au.af.mil/au/awc/awcgate/crs/rs20412.pdf>
15. <http://www.bt.cdc.gov/bioterrorism/overview.asp>
16. <https://top-channel.tv/2020/12/05/alarmi-i-ekspertit-kina-po-mbledh-adn-ne-e-botes-per-nje-a-rsyete-tmerreshme/>



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Reforma në sistemin e mbrojtjes civile në Shqipëri



■ **MSc. Klajdi NIKOLLA**
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
knikolla15@gmail.com



■ **Dr. Evlisa DUKA**
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
evisduk@gmail.com

Abstrakt

Shqipëria renditet në një nga vendet me rrezikshmëri të lartë në Evropë për sa i takon fatkeqësive natyrore, vlerësim i cili mbështetet edhe nga Raporti vjetor mbi rrezikun botëror për vitin 2020, në të cilin pohohet se vendet me cënueshmërinë më të lartë në Evropë janë Bosnja dhe Hercegovina, Moldavia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Azerbajxhani¹. Kryesisht, Shqipëria është e ekspozuar ndaj rezeqeve si: tërmete, rrëshqitje e dheut, rënie e shkëmbinjve dhe ortekëve, përmytje nga lumenjtë e nga përrrenjtë, zjarre në pyjeve, epidemi etj. Së fundmi, Shqipëria është prekur tre ngjarje fatkeqësive natyrore, përkatësisht: tërmeti i datës 1 qershor i vitit 2019 në rrethin e Korçës; tërmeti i datës 21 shtator 2019 me qarqet më të prekura Tiranë dhe Durrës; tërmeti i datës 26 nëntor 2019, me tre qarqet më të prekura, Durrës, Tiranë dhe Lezhë, si dhe, është pasuar nga pandemia e Sars COVID-19, me pasoja të mëdha ekonomike dhe sociale në nivele globale. Për rrjedhojë, ndikimet e këtyre ngjarjeve ishin të paimagjinueshme në shoqërinë e brishtë shqiptare, të cilat reflektojnë nevojën për një qasje më të integruar të bashkëveprimet ndër-institucional kombëtar e rajonal për të ulur rrezikun nga fatkeqësitë në vendin tonë dhe për të rritur e përmirësuar kapacitetet tona njerëzore dhe institucionale. Ky studim synon të shpjegojë dhe analizojë aparatin konceptual e funksional, dhe atë ligjor, të sistemit të mbrojtjes civile në Shqipëri duke nisur që nga origjina e tij e deri në ditët e sotme. Në fokus të tij qëndron evoluimi i sistemit të mbrojtjes civile me të gjitha sfidat e tij të ndërveprimet njerëzor e institucional, të rritjes dhe së kapaciteteve njerëzore dhe institucionale. Metodologjia e përdorur është analiza e të dhënave dytësore e cila konsiston në shqyrtimin dhe analizën e thelluar të një literature të gjerë si studime dhe raporte të realizuara nga institucionet të niveleve ndërkombëtare për Shqipërinë, legjislacione në fushën e mbrojtjes civile, plane strategjike, informacione dhe materiale zyrtare të mbledhura ndër vite nga strukturat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Fjalëkyçe:

fatkeqësi natyrore, mbrojtja civile, sistemi i mbrojtjes civile, reduktim i rrezikut.

1. Hyrje

Në dekadën e fundit Republika e Shqipërisë është e prekur nga fatkeqësi natyrore të ndryshme. Sipas *Raportit vjetor mbi rrezikun botëror*, të publikuar nga Universiteti i Kombeve të Bashkuara i cili llogarit *indeksin e rrezikut nga fatkeqësitë* nga pikëpamja statistikore për 181 vende, bazuar te ekspozimi, prekshmëria, ndjeshmëria dhe kapacitet përballuese e përshtatëse, për vitin 2020 Shqipëria renditet e 60-ta ndër 181 shtete, me një indeks 8.46 e me një ekspozim ndaj rrezikut prej 20.14; dhe me prekshmëri 42.00 (WorldRiskReport2020, 2020), krahasuar me vitin 2018-n ku renditet në vend të 45-të me indeksin e rrezikut 9.22 me një ekspozim ndaj rrezikut 22.83 (WorldRiskReport2018, 2018). Të gjitha fatkeqësitë dhe krizat e shumta që shoqërojnë zhvillimin e shoqërisë njerëzore gjithmonë janë shoqëruar me pasoja të mëdha ekonomike, shoqërore dhe politike të vendit, për sa kohë ato zgjasin shumë (kam parasysh pandeminë, bilanci i të cilës, nga pikëpamja ekonomike, njerëzore e politike do të mbyllet në përfundim të saj). Edhe për Shqipërinë, ky argument është evidentuar edhe tek *Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020*, në të cilën është vlerësuar fatura e dëmeve ekonomike, në raport me PBB-në kombëtare. Referuar burimit të sipërpërmendur: “Shqipëria ka një nivel të lartë të rriskut ekonomik nga rreziqe të shumta, me 86% të territorit të saj të prirë për dy ose më shumë katastrofa, ku gjenerohet 88.5% e PBB-së kombëtare” (*Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020*, 2016). Në këto kushte, ndërtimi i një sistemi nga pikëpamja e ligjore dhe

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹ WorldRiskReport2020, Marrë nga: <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/WorldRiskReport-2020.pdf>

² Në mars të vitit 2020, Organizata Ndërkombëtare e Shëndetësisë klasifikoi Covid-19 Pandemi Globale.

institucionale, për të dhënë një përgjigje të shpejtë ndaj situatave të emergjencës, njëherazi për të ulur kostot ekonomike, shoqërore dhe njerëzore shërben si një parakusht dhe domosdoshmëri për rritjen e performancës së këtij sistemi ende të pakonsoliduar.

1.1 Qëllimi dhe metodologjia

Qëllimi i këtij studimi është të shpjegojë dhe analizojë aparatën konceptual-funksional dhe atë ligjor të sistemit të mbrojtjes civile në Shqipëri, duke nisur që nga origjina e tij e deri në ditët e sotme. Në mbështetje të këtij qëllim qëndron trajtimi i evoluimit të sistemit të mbrojtjes civile me të gjitha sfidat e tij të ndërveprimit njerëzor dhe institucional.

Për të realizuar këtë studim është përdorur metoda e analizës së të dhënave dytësore, e cila konsiston në shqyrtimin dhe analizën e thelluar të një literature të gjerë si, studime dhe raporte të realizuara nga institucionet të niveleve ndërkombëtare për Shqipërinë, legjislacione në fushën e mbrojtjes civile, plane strategjike si dhe informacione e materiale zyrtare të mbledhura ndër vite nga strukturat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Përdorimi i burimeve dytësore është i rëndësishëm për të shpjeguar dhe analizuar të gjithë tablonë e fushës së mbrojtjes civile, që në gjenezën e saj, për të vazhduar me evoluimin dhe zhvillimin e saj, në përmbytje të së cilës qëndrojnë sfidat dhe të gjithë problematikat që janë shfaqur përgjatë zhvillimit të sistemit të saj të mbrojtjes civile.

1.2 Një vështrim historik i sistemit të mbrojtjes civile

Mbrojtja civile, si shërbim (në garantimin e sigurisë së jetës dhe mbrojtjes së saj) dhe si fushë ndërveprimi me aktorë të ndryshëm, në kontekstin ligjor dhe institucional, është e re dhe në proces konsolidimi në realitetin shqiptar. Për rrjedhojë, Republika e Shqipërisë ka një bazë ligjore dhe konceptuale të re në fushën e mbrojtjes civile, e cila gradualisht po shkon drejt kristalizimit dhe konsolidimit të saj në përputhje me kuadrin ligjor të vendeve të BE-së.

Periudha historike 1925-1945.

Kjo periudhë, ka nisur që në kohën e Ahmet Zogut i cili në vitin 1926 e inkorporoi atë në disa drejtori të Ministrisë së Punëve të Brendshme, deri në vitin 1945.

Periudha historike 1946-1994.

Në periudhën kohore 1946-1994 ky shërbim u identifikua me strukturën e zjarrfikëseve, brenda Drejtorisë së Policisë së Shtetit, në një sektor me emërtimin *Policia e mbrojtjes nga zjarri*, ndërsa në raste fatkeqësish ky shërbim zhvillohej nga Ushtria Popullore. Kuvendi Popullor, më dt 7.12.1964 me numër dekreti nr. 3924 e vendosi shërbimin e mbrojtjes civile, në varësi të Ministrisë së Brendshme, e cila ka funksionuar si një strukturë ushtarake (Shërbimi i Emergjencave, Bashkia Vlorë).

Periudha historike 1995-2000.

Nga viti 1994 deri në vitin 2001, ky shërbim operonte në tre ministri.

a. në Ministrinë e Mbrojtjes ishte një sektor i MCR-së;

b. në Ministrinë e Rendit Publik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, vepronte një sektor autonom i MNZ-së;

c. në Ministrinë e Pushtetit Lokal, një drejtori me personel të reduktuar, me emërtimin Drejtoria e Situatave të Jashtëzakonshme ose Emergjente.

Nisur nga fakti që shërbimi i mbrojtjes civile nuk ishte i përqendruar në një institucion të vetëm, por në departamente e zyra të institucioneve të ndryshme e bëri edhe më të vështirë efektshmërinë e këtij shërbimi për t'iu përgjigjur në kohë situatave emergjente.

Kriza e vitit 1998-1999 evidentoi më së miri të gjithë problematikën dhe vështirësinë e menaxhimit dhe koordinimit të së gjitha strukturave të tija, duke ndërthurur shumë faktorë: planifikimin e emergjencave, mbrojtjen civile dhe menaxhimin e krizës. Në këtë kontekst, lindi si nevojë dhe domosdoshmëri hartimi i një ligji të mirëfilltë, i cili do të parashtronte të gjithë funksionet dhe koordinimin institucional të shërbimit në fushën e mbrojtjes civile. Në tërësi, qëllimi i kësaj fushe të re është garantimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së jetës, për të gjithë shoqërinë. Për të përmbushur këtë qëllim, legjislacioni shqiptar ka ndërtuar një mekanizëm ligjor në ligjin themeltar të shtetit, *Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*, në të cilën u sanksionua garantimi i rendit kushtetues dhe sigurisë publike nëpërmjet marrjes së masave të jashtëzakonshme të cilat mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore (*Kushtetuta e Shqipërisë*, neni 170).

Në vijim, me ndihmën e NATO-s, dhe mbështetur në bazën kushtetuese, në nenet 78, 83, pikat 1, 170 dhe 174 të *Kushtetutës së Shqipërisë*, Kuvendi i Shqipërisë me propozim të Këshillit të Ministrave, miratoi ligjin nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile” i cili do të përditësohej me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009. Në këto dy ligje të miratuara, është evidentuar detyrimi i shteti shqiptar për të menaxhuar situatat e krijuar emergjente me anë të mirëpërdorimit të të gjithë burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, si edhe sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin kundër efekteve të një emergjence civile (neni 1 pika b dhe c).

Paralel me këtë ligj u punua edhe projektligji për fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe një muaj më pas aprovohet nga Kuvendi edhe ligji nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, misioni i të cilit është mbrojtja e jetës së njerëzve, dhe e pronës, nga rreziku i zjarrit dhe i fatkeqësive të tjera në raste të emergjencave. Në këtë periudhë, shërbimi i mbrojtjes civile ka funksionuar në një drejtori të përgjithshme të emergjencave civile në Ministrinë e Brendshme, struktura përgjegjësitë dhe detyrat e të cilës përcaktoheshin nga Këshilli i Ministrave. Legjislacioni në fushën e mbrojtjes civile mori formën ligjore dhe konceptuale në përputhje me qëllimin dhe misionin e saj të mbrojtjes me miratimin e ligjit mbi nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, i cili do të sillte ndryshime dhe risi nga ana organizative-operacionale dhe strukturore institucionale.

2. Reforma në sistemin e mbrojtjes civile

2.1 Detyrime në kuadër të anëtarësimit në BE

Në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në fushën e mbrojtjes civile për Shqipërinë janë evidentuar një sërë masash dhe detyrimesh në raporte dhe dokumente të niveleve ndërkombëtare të fokusuara kryesisht në forcimin e aparatit ligjor, institucional e funksional të tij. Përmendim këtu: “Kuadrin Sendai për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015-2030”, “Plani i veprimit i OKB-së për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, për aftësinë ripërtëritëse (resilience)”, detyrimet ndërsektoriale që burojnë nga “Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm 2030”, “Marrëveshja e Parisit mbi ndryshimin e klimës” dhe “Agjenda e re urbane”.

Referuar *Strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020*, miratuar me

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

VKM nr. 348, datë 11.5.2015, në kuadër të zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat dhe mirëmenxhimit të të gjithë hallkave dhe strukturave të sistemit të mbrojtjes civile me anë të forcimit të kapaciteteve nga pikëpamja organizative dhe institucionale, hapat kryesor që duhet të ndërmerren në këtë drejtim janë: Integrimi i çështjeve të gatishmërisë emergjente në strategjitë dhe planet sektoriale në nivelin qendror dhe lokal, forcimi i legjislacionit dhe rregulloreve që mbulojnë ato fusha, hartimi i një dokumenti strategjik për gatishmërinë e emergjencave (*Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020*, Kapitulli 8.5).

Argumentet në fjalë, gjejnë mbështetje edhe në *Projektraportin për Shqipërinë 2020* nga Komisioni Evropian i cili vë theksin tek nevoja imediate për të përditësuar legjislacionin në fushën e mbrojtjes civile (*Strategjinë kombëtare dhe Planin kombëtar*) në përputhje me ndryshimet e fundit institucionale dhe organizative. Duke iu referuar kontekst në fjalë, për të përmbushur detyrimet e saj ligjore dhe institucionale për t'u anëtarësuar në BE, Shqipëria ka bërë progres në fushën e mbrojtjes civile. Kështu, në funksion të ligjit nr. 45/2019 janë miratuar edhe ligje e akte nënligjore si:

- VKM nr. 741, datë 20.11.2019 “Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të AKMC-së”;

- VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e AKMC-së”;

- VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitutional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”;

- VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive”;

- ligj nr. 97/2019 për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Për të kuptuar e vlerësuar të gjithë punën dhe arritjet që janë bërë nga të gjitha strukturat institucionale të fushës së mbrojtjes civile, nga pikëpamja organizative, institucionale dhe ligjore, duhet të theksojmë dhe të marrim në konsideratë faktin se ligji nr. 45 “Për mbrojtjen civile” është miratuar në muajin korrik të vitit 2019, dhe vetëm përgjatë një periudhë kohore 4-mujore brenda të njëjtit vit Shqipëria është goditur nga dy tërmete të fuqishme me dëme të mëdha materiale dhe njerëzore. Kjo situatë u pasua edhe nga pandemia e Sars COVID-19. Nisur nga ky kontekst, duhet parë e vlerësuar qëndrimi i Komisionit Evropian në *Progresraportin 2020* i cili thekson nevojën urgjente të ndërtimit efikas të mbrojtjes civile duke forcuar kuadrin ligjor dhe kapacitetet institucionale si edhe burimet njerëzore dhe financiare të autoriteteve të mbrojtjes (Komisioni Evropian, Raporti i Shqipërisë 2020:107).

Duke marrë në konsideratë faktin e ndodhisë së ngjarjeve të fatkeqësive natyrore në një frekuencë të shpeshtë, brenda një afati të shkurtër në Shqipëri, në fushën e mbrojtjes civile puna ka vazhduar në pasurimin e kuadrit ligjor, për t'u bërë pjesë e ERCC-së³ dhe janë në proces shumë akte nënligjore; përmendim këtu:

- projektvendimi “Kriteret dhe procedurat për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, përcakton kriteret sipas llojit të fatkeqësisë;

³ Ndryshe Qendra e Koordinimit të Reagimit Emergjent e cila është zemra e mekanizmit të mbrojtjes civile të BE-së. Kjo qendër ofron shërbimin e ndihmës emergjente të shpejtë me anë të ekspertizave, ekupeve të mbrojtjes së tyre dhe pajisjeve të specializuara për vëndet e goditura nga katastrofat. Ajo vepron si një qendër koordinimi midis të gjithë Shteteve Anëtare të BE-së. Marrë nga: https://ec.europa.eu/echo/what/civil-protection/emergency-response-coordination-centre-ercc_en

- projektvendimi “Përbërja e pozicioneve të punës dhe detyrat deri në nivel sektori për mbrojtjen civile në çdo ministri”, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e sektorëve në institucionet qendrore për mbrojtjen civile;

- projektvendimi “Kriteret dhe procedurat e akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile”, përcakton kriteret dhe procedurat për akordimin e fondeve që lidhen me marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, si dhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile;

- projektvendimi “Miratimi i flamurit, stemës dhe uniformës së AKMC-së”;

- projektvendimi “Për vërtetimin mbi riskun”, përcakton kriteret dhe autoritetet që japin vërtetimin mbi riskun [rrezikun].

2.2 Analiza ligjore

Ligi “Për emergjencat civile” me nr. 8756, i datës 26.3.2001 ishte ligji i parë që hodhi themelet në legjislacionin e fushës së mbrojtjes civile. Ai kishte si qëllim planëzimin dhe përballimin e emergjencave civile si një detyrë e shtetit shqiptar me synim për të parandaluar çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile (neni 1, pika a). Ky ligj përcakton edhe detyrimin institucional për hartimin dhe zbatimin e *Planit kombëtar për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile* i cili u miratua me VKM nr. 835, dt. 3 dhjetor 2004. Në këtë dokument (i pari në llojin e tij), përcaktohen përgjegjësitë institucionale në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave civile. Në mënyrë specifike, në të parashtrohet politika dhe drejtimet kryesore të punës së shtetit, duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë civile, në përballimin e emergjencave civile, rregullat e bashkërendimit të strukturave dhe institucioneve për përballimin e emergjencave civile dhe kapacitetet dhe resurset ekzistuese që mund të angazhohen në raste të emergjencave civile (MPVD, *Plani kombëtar për emergjencat civile*, 2004).

Ai është përgatitur e bazuar në një procedurë dhe metodologji mjaft korrekte dhe logjike, në të cilën përfshihen vlerësimi i rreziqeve, konsultat, shkëmbimi i informacionit, gjithëpërfshirja dhe konsensusi i institucioneve dhe strukturave që kanë rol në këtë proces. Është një dokument i cili duhet përditësuar referuar kushteve dhe realitetit të sotëm të zhvillimit.

Ligi “Për emergjencat civile”, i datës 26.3.2001, edhe pse i përditësuar në vitin 2009, mori formën dhe karakterin e tij më të plotë e gjithëpërfshirës në përcaktimin e të gjithë strukturave dhe bashkëveprimit ndërinstitutional, me miratimin e ligjit nr. 45 të dt 18.7.2019 “Për mbrojtjen civile”. Ky ligj përfaqëson shumë risi në fushën e mbrojtjes civile, të cilat identifikohen më si miri duke u nisur që në emërtimin e tij ligji “Për mbrojtjen civile” ndryshe nga ligji i vjetër me emërtimin ligji “Për emergjencat civile”, dhe pasurimin e tij me terminologjinë specifike në fushën e mbrojtjes civile, si termat “risk”, “mbrojtje civile”, “gjendja e fatkeqësisë natyrore”, “infrastrukturë kritike”, “menaxhimi i fatkeqësive”, “menaxhim i emergjencave”, “përgjigje”, “rehabilitim”, “rimëkëmbje”, dhe 75% e përkufizimeve i referohen atyre të Zyrës së OKB-së për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësive/UNDRR etj.

Në mënyrë më të përmblodhur risitë e ligjit nr. 45, datë 18.7.2019 “Për mbrojtjen civile” janë si më poshtë:

- është në linjë me SFDRR 2015-2030, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

OKB-së më datë 3.6.2015 dhe për këtë ka një kapitull të dedikuar me titull, “Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë”;

- ligji ka përcaktuar strategjinë kombëtare për DRR (“Disaster Risk Reduction”) si dokumentin bazë strategjik të RSH-së në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë;

- operon në bazë të parimeve të së drejtës për mbrojtje në rastet e fatkeqësive, të informimit, të përgjegjësisë dhe parimi i subsidiaritetit (neni 5, 6, 7);

- planifikon buxhetin vjetor për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore (ministritë dhe institucionet qendrore) 2%-4% % e totalit të buxhetit vjetor (neni 22);

- parashikon hartimin e strategjisë për DRR (reduktimin e riskut [rrezikut]) në NJVV, vlerësimin e rrezikut dhe planeve të emergjencave civile në të tre nivelet. Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë, si edhe plani për emergjencat civile, janë të detyrueshme edhe për infrastrukturën kritike;

- ka një kre të dedikuar mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore;

- përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve, të subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile, të shtetasve, në tërësi dhe të detyrimeve specifike që lidhen me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, janë parashikuar referuar “Kuatrin Sendai për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015-2030”.

Pra, në dispozitat ligjore të tij janë vendosur shtyllat e themelit të aparatit funksional dhe institucional të sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar përgjegjësitë institucionale dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin (ligji nr. 45/2019, neni 1).

2.3 Sistemi në mbrojtjen civile dhe funksionimi institucional

Sot bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fushën e mbrojtjes civile, sistemi i mbrojtjes civile, përbëhet nga:

- institucione dhe struktura qendrore të mbrojtjes civile;
- institucione dhe struktura vendore të mbrojtjes civile;
- struktura operacionale të mbrojtjes civile.

2.3.1 Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile

1. *Kuvendi*, i cili miraton buxhetin e AKMC-së, si pjesë e buxhetit të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen civile; ushtron kontroll parlamentar për çështje që kanë lidhje me mbrojtjen civile; ratifikon marrëveshje ndërkombëtare mbi mbrojtjen civile; vendos për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve të shpallura nga Këshilli i Ministrave (ligji nr. 45/2019 “Për Emergjencat Civile”, neni17).

2. *Këshilli i Ministrave*, i cili miraton dhe siguron zbatimin e politikave për DRR-në dhe mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë. Ndër përgjegjësitë e tij janë: miratimi i strategjisë kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë [DRR (Disaster Risk Reduction)], planin kombëtar për emergjencat civile, mund të vendosë për një periudhë d’30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit dhe informon Kuvendin e RSH për situatën e krijuar, rreziqet që paraqiten dhe masat e marra për menaxhimin e situatës, si dhe kërkon pëlqimin e tij për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve(ligji nr. 45/2019 “ Për emergjencat civile”, neni18).

3. *Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile*, i cili është organi më i lartë për

koordinim dhe bashkërendim të veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private si dhe të burimeve materiale e financiare për përballimin e fatkeqësisë natyrore. Ai krijohet nga Këshilli i Ministrisë për çdo rast të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Kryetari i tij mund të jetë kryeministri, zëvendëskryeministri ose një ministër, në varësi të llojit të fatkeqësisë. Ndër funksionet dhe detyrat e tij janë të thërrasë ekspertë për këshillime në lidhje me menaxhimin e fatkeqësive, të bashkërendoj të gjithë veprimtarinë e institucioneve dhe të strukturave të mbrojtjes civile, të përcaktoj mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale e financiare, të vendos shpërndarjen e fondeve për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore, të caktojë drejtuesin qendror të operacionit për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore, të kryej detyra të tjera që burojnë nga ky ligj dhe detyra të veçanta të caktuara nga Këshilli i Ministrave për përballimin e fatkeqësisë (ligji nr. 45/2019 “Për emergjencat civile”, neni 19).

4. *Komiteti i Mbrojtjes Civile (KMC) dhe Zyra Operacionale e Situatës (ZOS)* janë dy struktura organizimi dhe funksionimi i të cilave vendoset me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Komiteti i Mbrojtjes Civile është organi më i lartë, i përhershëm, përgjegjës për zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa Zyra përgjegjëse për situatën është strukturë pranë kryeministrit, për mbledhjen e informacionit për emergjencat civile, krizat dhe hartimin e raporteve analitike periodike për kryeministrin, Këshillin e Ministrave dhe KMC-në, si dhe mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe strukturave të tjera të ngarkuara me funksione të emergjencave civile dhe krizave (shih po aty, neni 20).

5. *Ministri përgjegjës për mbrojtjen civile* ka detyra dhe përgjegjësi, si: përcakton drejtimit strategjike dhe objektivat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, harton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, dhe ato të mbrojtjes civile; informon, periodikisht, Këshillin e Ministrave në lidhje me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, dhe në lidhje me mbrojtjen civile; mbikëqyr menaxhimin e buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas legjislacionit financiar në fuqi (shih po aty, neni 21).

6. *Ministritë dhe institucionet qendrore* janë përgjegjës për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore apo të kompetencave të tyre. Disa nga detyrat e tyre janë: të hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe ta dërgojnë atë në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analize dhe planifikimi; të planifikojnë buxhet vjetor për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe për mbrojtjen civile, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore. Për ministritë përgjegjëse për mbrojtjen civile, mbrojtjen, punët e brendshme, transportin, infrastrukturën, bujqësinë, shëndetësinë, energjetikën, arsimin, mjedisin dhe kulturën, planifikimi buxhetor duhet të jetë nga 2% deri në 4% e totalit të buxhetit vjetor, të organizojnë dhe mirëmbajnë sistemet e monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në fushën e veprimtarisë së tyre, të informojnë në mënyrë të vazhdueshme AKMC-në lidhur me aktivitetet e ndryshme në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile (po aty, neni 20).

7. *Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile* është institucion qendror në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile dhe përgjigjet për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e RSH-së. AKMC-ja ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

fushën e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe për mbrojtjen civile. Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e saj janë: Zbaton drejtimit strategjike dhe objektivat e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile, koordinon dhe bashkërendon punën për hartimin e strategjisë kombëtare për DRR, planit kombëtar për emergjencat civile dhe vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë në nivel qendror, bashkëpunon me organizmat ndërkombëtare dhe organizatat homologe ndërkombëtare në kuadër të DRR&CP. Nëpërmjet Qendrës së Trajnimeve për mbrojtjen Civile, ajo kryen trajnimet e strukturave shtetërore, subjekteve private dhe vullnetare dhe lidh marrëveshje me organizata jofitimprurëse, ose subjekte të tjera juridike në lidhje me mbrojtjen civile. AKMC-ja organizohet si drejtori e përgjithshme në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas qendrave të mbrojtjes civile në qark. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AKMC-së, në nivel qendror dhe vendor, rregullohen sipas legjislacionit për statusin e nëpunësit civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të AKMC-së, në nivel qendror dhe vendor, rregullohen sipas dispozitave të *Kodit të punës*. E gjithë struktura dhe organika e AKMC-së, në nivel qendror dhe vendor, miratohet me urdhër të kryeministrit, me propozimin e ministrit (shih po aty, neni 23).

8. *Komisioni Teknik Këshillimor* kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe ka në përbërje përfaqësues të strukturave me përgjegjësi në fushën e mbrojtjes civile. Ai këshillon për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive (shih po aty, neni 25).

9. *Qendrat e mbrojtjes civile* janë degë territoriale në varësi të AKMC-së, me seli në çdo qark, dhe përbëjnë rrjetin institucional të specializuar, që zbaton detyrat për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe për mbrojtjen civile në qark (shih po aty, neni 26).

2.3.2. Institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile

1. *Prefekti i qarkut* luan një rol parësor në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe për mbrojtjen civile në nivel qarku. Disa nga detyrat më të rëndësishme të tij janë: koordinon veprimtarinë e organeve, institucioneve dhe strukturave që veprojnë në nivel qarku, me qëllim zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe për mbrojtjen civile dhe pas ezaurimit të të gjitha kapaciteteve brenda qarkut për përballimin e emergjencës civile ose të fatkeqësisë; i kërkon ndihmë për ndërhyrje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; bashkëpunon me bashkitë për realizimin e vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në qark, si dhe për informimin e publikut e të komunitetit të rrezikuar nga fatkeqësitë, në lidhje me to; harton, miraton dhe përditëson planin për emergjencat civile në qark dhe e dërgon në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllim analizimi dhe planifikimi; grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe strukturat e tjera që veprojnë në nivel qarku, për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe për mbrojtjen civile, si dhe informon në mënyrë të vazhdueshme Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (neni 28).

2. *Komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkitë* të cilët krijohen në çdo qark, nën drejtimin e prefektit të qarkut, dhe në çdo bashki nën drejtimin e kryetarit të bashkisë (neni 29).

3. *Bashkitë*, si strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe strukturave qendrore të mbrojtjes civile, të cilat referuar ligjit me nr. 45/2019, kanë detyra të ndryshme, si:

2.3.3. Strukturat operationale të mbrojtjes civile të parashikuara, si struktura operationale

1. Forcat e Armatosura;
2. Policia e Shtetit;
3. Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH);
4. *Shërbimi i urgjencës mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor;*
5. *Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile.*

The diagram illustrates the institutional framework for the implementation of the National Strategy for Sustainable Development. It shows the relationships between various entities:

- KESHILLI I MINISTRAVE** (Ministerial Council) is at the top, connected to **MINISTRIËTË** (Ministries), **KOMITETI I MC / KNEC** (National Council for Sustainable Development), and **INSTITUCIONET MONITORUESE** (Monitoring Institutions).
- MINISTRIËTË** are connected to **INSTITUCIONET QENDRORE** (Central Institutions).
- KOMITETI I MC / KNEC** is a central body, connected to **MINISTRIA E MBROJTJES** (Ministry of Defense), **AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE** (Civilian Protection Agency), and **KQOEC** (State Election Commission).
- INSTITUCIONET MONITORUESE** are connected to **NGO dhe ORGANIZATA NDERKOMBËTARE SI OKB, BE, BB, KKSH ETJ** (International NGOs like UN, EU, OSCE, etc.).
- MINISTRIA E MBROJTJES** is connected to **AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE**.
- AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE** is connected to **KOMISIONI TEKNIK KËSHILLIMOR** (Technical Advisory Commission).
- KQOEC** is connected to **PREFEKTI** (Prefect) and **KOMISIONI I MC NE QARK** (Regional Council for Sustainable Development).
- PREFEKTI** is connected to **KRYETARI I BASHKISË** (Municipal Mayor) and **KOMISIONI I MC NE BASHKI** (Municipal Council for Sustainable Development).
- KRYETARI I BASHKISË** is connected to **Struktura të EC në Bashki** (Local EC Structure) and **NJËSITË ADMINISTRATIVE** (Administrative Units).
- KOMISIONI I MC NE QARK** is connected to **KOMISIONI I MC NE BASHKI** and **NJËSITË ADMINISTRATIVE**.
- KOMISIONI I MC NE BASHKI** is connected to **NJËSITË ADMINISTRATIVE**.
- NJËSITË ADMINISTRATIVE** is connected to **DEGE TERRITORIALE TË MINISTRIVE/INSTITUCION EVE TË VARESISE** (Territorial Branches of Ministries/Institutions or their Subordinate Entities).

Fig. 1 Sistemi i Menaxhimit të Mbrojtjes Civile

3. Përfundime dhe rekomandime

Duke iu referuar gjithë analizës së parashtruar më sipër, zhvillimit të sistemit të mbrojtjes civile në të gjithë fazat historike, sfidat dhe problematikat e saj të krijuara ndër vite, mund të parashtrojmë disa përfundime dhe rekomandime për të rritur efektshmërinë nga pikëpamja institucionale dhe funksionale, të cilat vijojnë si më poshtë:

- Ndjekja e hartimit të *Strategjisë kombëtare për reduktimin e rrezikut*, referuar ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në nivel kombëtar dhe lokal;
- ndjekja e hartimit të *Dokumentit të vlerësimit të rrezikut*, referuar ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” në nivel kombëtar dhe lokal;
- përditësimi i *Planit kombëtar* referuar ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” në nivel kombëtar dhe lokal;
- ndjekja e përditësimit, hartimit, dhe harmonizimit të akteve nënligjore me synim përmirësimin e kuadrit ligjor në tërësinë e saj për arritjen e objektivit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në UNCPM (*Union Civil Protection Mechanism*), si një nga kushtet e anëtarësimit në BE.

Biblografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007, nr. 9904, datë 21.4.2008, nr. 88/2012, datë 18.9.2012, Nr. 137/2015, datë 17.12.2015, nr. 76/2016, datë 22.7.2016, nr. 115/2020, datë 30.7.2020).
2. Ligji Nr. 8756, datë 26.3.2001 Për Emergjencat Civile
3. Ligji Nr. 45, datë 18.07.2019 “ Për Mbrojtjen Civile”
4. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, 2004., “Plani Kombëtar i Emergjencave Civile”
5. Këshilli i Ministrave, “Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020”, Maj 2016., marrë nga <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim>
6. Komisioni Evropian, “Raporti i Shqipërisë 2020”, 2020. Marrë nga: https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf
7. UNDRR. (2020). Global Assessment Report on Disaster Risk Reduction. Geneva: United Nations Office for Disaster Risk Reduction (UNDRR).
8. WorldRiskReport 2020, Focus: Forced Displacement and Migration, Bündnis Entwicklung Hilft and Ruhr University Bochum – Institute for International Law of Peace and Armed Conflict (IFHV)
9. WorldRiskReport 2018, Focus: Forced Displacement and Migration, Bündnis Entwicklung Hilft and Ruhr University Bochum – Institute for International Law of Peace and Armed Conflict (IFHV)
10. http://new.bashkiavlore.org/wpcontent/uploads/2016/11/1SHERBIMI_i_Emergjencave.pdf
11. https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf
12. https://ec.europa.eu/echo/what/civil-protection/emergency-response-coordination-centre-ercc_en

**Shënim i redaktorit:**

Fjala "risk", e përdorur nga autorët në këtë shkrim, është zëvendësuar me fjalën "rrezik". Nuk është bërë kjo gjë, vetëm në rast citimi të drejtpërdrejtë të një burimi. Gjej me vend të sqaroj, se ky shënim po vendoset për shkak se autorët, kanë përdorur një gjuhë e stil të shkruari korrekt. Për më tepër, në lidhje me këtë term, mund të lexohet në fund të vëllimit të parë të botimit të punimeve të kësaj konferencës.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Roli i IoT^{*} në menaxhimin e fatkeqësive natyrore



■ **Inxh. Dr. (proc.) Albina TOÇILLA**
Universiteti Polis
albina_tocilla@universitetipolis.edu.al

■ **Dilan HOXHOLLI**
Student, Universiteti Polis
dilan_hoxholli@universitetipolis.edu.al

■ **Dionis ULIU**
Student, Universiteti Polis
Dionis_uliu@universitetipolis.edu.al

■ **Xhesjana BRAHIMI**
Student, Universiteti Polis
xhesjana_brahimi@universitetipolis.edu.al

Abstrakt

Shpërthimi i vullkanit të Vezuvit në vitin 1979 me 10 000 viktima njihet si fatkeqësia e parë natyrore e regjistruar dhe është pasuar me mijëra të tjera ndër vite. Fatkeqësitë natyrore janë shumë të fuqishme për t'u përballuar nga njerëzit. Këto ngjarje kanë sjellë pasoja të shumta, por kjo gjë mund të zbutet apo të shmangej në qoftë se njerëzit do mund të paralajmëroheshin apo të dinin si të menaxhonin në mënyrë sa më të mirë situatën. Prandaj, lind nevoja e teknologjisë për t'i mbledhur e analizuar të dhënat, që të na ndihmojnë në këto situata. Këtu futet koncepti "Interneti i Gjërave" (IoT) për të paralajmëruar, monitoruar nga distanca, analizuar situatën, njerëzit, etj. Ky artikull prezanton skenarët aktualë se si trajtohen këto fatkeqësi natyrore. Gjithashtu do të nënvizohen edhe sfidat e hasura në përballje me këto fenomene, do të përmbledhen teknologjitë e disponueshme të bazuara te IoT-i për menaxhimin e katastrofave dhe përshtatshmërinë e tyre për t'u zbatuar në situatat katastrofike. Qëllimi i këtij studimi është të sigurojë bazat në lidhje me sistemet e menaxhimit të katastrofave të bazuara te IoT-i që na ndihmojnë të kuptojmë kontributet e kërimit të mëparshëm dhe drejtimin e ardhshëm, për zgjidhjen e këtyre sfidave.

Fjalëkyçe:

fatkeqësi natyrore, IoT, "cloud", parashikim.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

* Internet of things (IoT) / "Interneti i Gjërave"

1. Hyrje

Shumicën e rasteve, fatkeqësitë natyrore ndodhin pranë vendbanimeve të njerëzve, gjë që nënkupton shkatërrim midis tyre. Disa nga fatkeqësitë e viteve të fundit, si zjarret në Australi në 2020, tërmeti në Haiti në 2010, së bashku me shumë të tjera, kanë sjellë mbi 10 milionë njerëz të prekur. Shpesh njerëzit kanë qenë të pafuqishëm ndaj tyre pasi nuk kishin as njohuritë apo pajisjet e duhura për lajmërimin e rrezikut. Fatmirësisht, krijimi i IoT-it hap një dritare të re në këtë pjesë¹. Ky sistem lidh në kohë reale pajisjet inteligjente për monitorim, analizim të të dhënave si edhe për veprim. Rrjetet e sensorëve [ndijorëve] pa tel ose WSN, janë konsideruar si pjesa kryesore e IoT, ku elementët janë vendosur në vendet e caktuara sipas strukturave të ndryshme topologjike për të vepruar sipas rrethanave të situatës që ndodh. Komunikimi i elementëve mbështetet në Protokollin TCP/IP ose në modelin standard OSI. Në këtë studim do të prezantojmë protokollet kryesore mbi çështjet e menaxhimit të katastrofave të bazuara në IoT. Gjithashtu kemi një analizë mbi produktet e nevojshme dhe sfidat kryesore që hasen në këto sisteme të bazuara te IoT-i.

1.1 Protokolle të mbështetura nga IoT-i për menaxhimin e fatkeqësive natyrore

Protokollet janë të ndara në shtatë lloje, të tilla si: të infrastrukturës, të zbulimit, të së dhënave, të komunikimit, të logjikës, *framework* me shumë shtresa dhe të sigurisë.

¹Yang, Lili; Yang, Shuang-Hua; Plotnick, L. (2013): How the internet of things technology enhances emergency response operations. Loughborough University. Journal contribution. pp.3.

Fatkeqësitë kërkojnë protokolle të ndryshme në varësi të ngjarjes, tipit apo aftësisë shkatërruese². Është i nevojshëm shqyrtimi i disa çështjeve gjatë zgjedhjes së infrastrukturës dhe protokolleve, pasi situatat e fatkeqësive natyrore shpesh, ndërpresin edhe komunikimin e vendit me pjesën tjetër. Në figurën e mëposhtme jepen protokollat e komunikimit të mbështetura nga IoT-i, të përshtatshme për menaxhimin e katastrofave. Shtatë shtresat e protokolleve janë të ndërlidhura pa ndërprerje me njëra-tjetrën për të trajtuar ngjarjet katastrofike. Shumica e protokolleve përdoren përgjithësisht në modelet OSI ose TCP / IP në jetën reale.




Fig. 1. Protokollat e komunikimit të mbështetur nga IoT-e të përshtatshme për menaxhimin e katastrofave

- Shtresa e infrastrukturës

Protokolli *QUIC* ose *Quick User Datagram* është i përshtatshëm për menaxhimin dhe ndihmën në katastrofa sepse:

- mbështet multipleksimin [shumëfishimin] e rrjedhave të lidhjes midis dy njejeve P2P mbi UDP;

- siguron mbrojtje të sigurisë si TLS / SSL;

- ka vonesë të ulët transmetimi;

- vlerëson gjerësinë e brezit për të shmangur mbingarkesën në komunikimin midis të dyja anëve.

Protokolli i shtresës së transportit të datagramit (The Datagram Transport Layer ose DTLS) merret me pjesën e privatësisë në komunikimin e të dhënave. Vepron si një pengesë e nevojshme për falsifikimin e mesazheve, përgjimet, dhe ndërhyrjeve në aktivitetet e menaxhimit të katastrofës.

Protokolli i rrjetit të sinkronizuar në kohë (Time Synchronized Mesh Protocol ose SYMP) është i nevojshëm për të hartuar një protokoll të sinkronizuar në kohë për organizimin efikas të pajisjeve pa tel. Është një formë e veçantë e sistemit TDM (multipleksimi i ndarjes në kohë) për të komunikuar në çdo situatë kufizuese të burimeve, siç janë ngjarjet katastrofike.

- Shtresa e të dhënave

Protokolli XMPP ose *Extensible Messaging and Presence*, është një protokoll me burim të hapur që ka disa të mira:

- *Software* [program] i lehtë;

²M. Kamruzzaman, N. I. Sarkar, J. Gutierrez and S. K. Ray, "A study of IoT-based post-disaster management," 2017 International Conference on Information Networking (ICOIN), Da Nang, Vietnam, 2017, pp. 405.

- komunikim në kohë reale;
- thirrje me zë/video;
- bisedë me shumë palë;
- kontroll i përmbytjes së të dhënave XML;

Shërbimi i shpërndarjes së të dhënave ose Data-Distribution Service (DDS) përdoret si një program i mesëm për të ndihmuar daljen/leximin e vazhduar të komunikimeve në kohë reale për sistemet e kohës reale.

Protokoll i lehtë i automatizimit lokal ose LLAP është krijuar për të lehtësuar transmetimin e mesazheve të shkurtra mes pajisjeve *smart* të IoT.

- *Shtresa e komunikimit*

WiMAX: World wide Interoperability for Microwave Access ose *Ndërveprimi në të gjithë botën për mikrovalët*, standardi i aksesit, siguron shpejtësinë e të dhënave nga 1.5 Mbps në 1 Gbps.

Bluetooth: Funksionon në brez frekuence 2.4 GHz. Maksimumi i transmetimit të të dhënave është rreth 3 Mbps dhe diapazoni i komunikimit është rreth 30 m.

Eddystone: Eddystone, i cili është një variant i *Bluetooth*, përdor protokollin *Bluetooth* me energji të ulët për të komunikuar me fenerë lokalë.

ZigBee: Zigbee është një nga protokollat më të njohur që janë zhvilluar bazuar në standardin IEEE. Shtrirja e frekuencës së tij është 2.4 GHz dhe shpejtësia e transmetimit e të dhënave është 250 kbps.

EnOcean: Është i përshtatshëm për menaxhimin e ngjarjeve katastrofike, për shkak të veçorisë së tij e cila është konsumi i ulët i energjisë elektrike. Zakonisht, punon në frekuencë 868MHz në Evropë dhe frekuencën 315MHz në Amerikë.

NB-IoT: Narrow Band IoT është protokoll i më i fundit i bazuar në IoT, i krijuar për të punuar në frekuenca e brezit të ngushtë. Është më e përshtatshme për komunikimin e tipit LTE dhe pritet që viktimat të mundën të lokalizohen dhe të komunikohen duke përdorur këtë protokoll.

EC-GSM-IoT: Extended Coverage-GSM-IoT përforcon komunikimin ekzistues celular duke zgjeruar më tej zonën aktuale të mbulimit.

LoRa WAN: LoRa, i cili është një nga protokollat më të fundit të komunikimit pa tel që preferohet për instalim në WAN. Ai synon të sigurojë një komunikim me rreze të gjerë pasi mbulon deri në 15 km.

Parametrat	WiMAX	Bluetooth	Eddystone	ZigBee	EnOcean	NB-IoT	EC-GSM-IoT	LoRa-WANs
Standardi	IEEE 802.16	IEEE 802.15.1	IEEE 802.15.1	IEEE 802.15.4	ISO/IEC 14543-3-10	3GPP	ETSI GS LTN 001-003	IEEE 802.15.4
Brezi i frekuencës	2-66 GHz	2.4 GHz	2.4 GHz	2.4 GHz	315/868 MHz	180 kHz	433/868 MHz, 2.4 GHz	868/915 MHz, 2.4 GHz
Data rate	1 Gbps (Fixed) and 30-40 Mb/s (mobile)	1-24 Mbps	1-24 Mbps	250 kbps	125 kbps	250 kbps	< 300 bps	40-250 kbps
Brezi i përhapjes	50 km	8-10 m	8-10 m	10-100 m	30-300 m	10-15 km	5-40 km	10-20 m
Konsumimi i energjisë	Mesatare	Bluetooth: Mesatare BLE: Shumë pak	Bluetooth: Mesatare BLE: Shumë pak	E ulët	E ulët	E ulët	Shumë pak	E ulët
Kostoja	E lartë	E ulët	E ulët	E lartë	Mesatare	Mesatare	Shumë e ulët	E ulët

Tab. 1. Standardet e shtresës së komunikimit

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

- *Shtresa e zbulimit*

mDNS: Zbulimi i pajisjes është i rëndësishëm kur lokalizoni një viktimë në katastrofë. *Protokolli Multi-cast Domain Name System (mDNS)* zgjidh çështjen e konvertimit të emrave të *host*-it në adresa IP brenda një gamë të vogël të rrjetit.

HyperCat: Që të merret pa probleme komunikimi në një situatë katastrofike, një numër i madh i pajisjeve janë të lidhura duke përdorur URI-të e tyre.

- *Shtresa logjike*

SensorML: *Sensor Model Language (SensorML)* është një qasje e përgjithësuar për të siguruar modele standarde semantike për sa i përket kodimit XML për të përshkruar sensorët.

SENML: Në ngjarje katastrofike, sensorë të ndryshëm si p.sh. sensori i temperaturës dhe akselerometri mund të përdorin *Media Types for Sensor Markup Language* së bashku me HTTP dhe CoAP për të transmetuar ose konfiguruar vlerat e matura.

LsDL: është gjuhë kodimi për pajisjet e zgjuara bazuar në *Extensible Markup Language (XML)*-që lexohet si gjuha e pajisjes inteligjente *Lemonbeat (LsDL)*. Në përgjithësi, gjërat inteligjente (pajisjet) e orientuara drejt shërbimit IoT punojnë me të.

- *Multi-Layer*

Alljoyn: Është një program me shumë shtresa me burim të hapur për të ndihmuar pajisjet inteligjente dhe APP-të në zbulimin, si dhe komunikimin mes tyre.

IEEE P2413: Është një standard IEEE i kohëve të fundit. Është projektuar si mbështetje për pajisjet dhe aplikacionet IoT.

Weave: Është një përfshirje e re në protokollat e bazuara në IoT që kryen detyrat e mëposhtme:

- konfigurimin e pajisjes inteligjente,
- mënyrën hibride të komunikimit (telefon-pajisje-*cloud*).
- *Shtresa e sigurisë*

OTrP: Besimi është një pjesë thelbësore e menaxhimit të konfigurimit të sigurisë në pajisjet heterogjene të bazuara në IoT, OTrP ndihmon përdoruesit të konfiguruar (si p.sh. instaloni, modifikoni dhe fshini) pajisjet.

X.509: Është një nga protokollat më të njohur të sigurisë në *domain*-in e infrastrukturës me çelës-publik që menaxhon dy detyrat kryesore të tilla si kriptimi me çelës publik dhe trajtimi i nënshkrimeve digjitale. Ajo integron më tej shtresën e transportit për menaxhim të sigurt të paketave të bazuara në internet dhe mesazhet përkatëse.

1.2 Zgjidhje aktuale të bazuara në IoT për menaxhimin e fatkeqësive

Më poshtë kemi disa shembuj të zgjidhjeve aktuale të bazuara në IoT për menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Krahason këto zgjidhje në lidhje me dizajnin që kanë dhe aplikimin e tyre. Ky krahasim paraqet skenarë aktualë, ku pajisjet që bëjnë pjesë në zgjidhjet IoT janë lehtësisht të disponueshme për qytetarin e zakonshëm.

- *Programi "Aarogya Setu"*

Situata e pandemisë Covid-19 është cilësuar gjithashtu si një fatkeqësi natyrore me ndikim shumë të madh në shoqëri. Problemi në këtë rast është ndalimi i kontaktit fizik, gjë që ka bërë "ndihmëse" të vetme programet. Zgjidhja që ndikoi shumë pozitivisht në shtetin e Indisë, që ka mbi 1.3 miliardë qytetarë, ishte programi *Aarogya Setu*, që përdorte lidhjen *bluetooth* për transmetimin e informacionit. Ai mbledh informacione për njerëzit me të cilët keni pasur kontakt dhe ju lajmëron në çastin që një prej tyre rezulton pozitiv. Programi, me këto të dhëna tregon edhe vendet me rrezikshmëri të

lartë, në mënyrë që të shmangen.




Fig. 2. Programi Aarogya Setu

- “Brinco”

Është feneri i parë që është krijuar për të njoftuar përdoruesin e tij në lidhje me tërmetet ose cunamet e mundshme. Sistemi i sensorit përbëhet nga akselerometër, njësie e përpunimit të sinjalit dhe njësitë e alarmit audio. Nëse percepton një dridhje të tokës, ajo dërgon këtë informacion në *Brinco Data Center* (BDC), një shërbim privat *cloud*. Kjo DC e asimilon këtë informacion me informacionet në rrjetet e tjera sizmike për të marrë perceptimin e tij. Nëse gjykimi është pozitiv, bën tingull alarmues dhe dërgon njoftime tek përdoruesit e telefonave (Android ose iOS) në çast. Ky informacion ndahet midis banorëve dhe të tjerëve duke përdorur rrjetet sociale.



Fig. 3. Sistemi i sensorit “Brinco”

- “Grillo”

Grillo është një pajisje që bën të mundur lajmërimin e njerëzve në rast tërmeti. Pajisja instalohet në shtëpi ose biznese, fabrika, shkolla dhe në rast se ka ndonjë lëkundje sizmike Grillo lëshon një alarm. Gjithashtu Grillo lidhet në rrjet me pajisje të tjera Grillo,

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

në një *network* dhe verifikon vërtetësinë e këtij informacioni, para se të japë sinjal. Një avantazh tjetër është dhe aplikacioni i Grillo, i cili bën të mundur në rast se jeni larg ambientit të monitoruar nga Grillo t'ju njoftojë nëpërmjet aplikacionit.

- *Rrjeti i detektimit të përmbytjeve*

Janë një bashkësi pajisjesh të cilat janë të krijuara nga një *Raspberry Pi*, një kapës valësh dhe një *router* transmetues. Kjo pajisje montohet poshtë urave dhe kap lëvizjen e nivelit të ujit në interval 5 minutash. Kjo pajisje merr informacion nëpërmjet rrjetit dhe e shpërndan atë nëpër pajisjet e tjera në këtë rrjet, bën një përlllogaritje dhe një parashikim se kur mund të ketë një rritje të nivelit të ujit në nivele të cilat mund të sjellin rrezik për përmbytje. Ky është një prototip të cilin po e teston universiteti Oxford në disa vende.

- *Faret kundër përmbytjeve oqeanike*

Këta janë disa fare lundruar të cilët vendosen në oqean dhe luajnë një rol të ngjashëm me eksperimentin e Oxfordit. Këta farë aktualisht janë të aplikuar dhe masin nivelin e ujit duke dërguar valë zanore në fund të oqeanit dhe duke përlllogaritur ndryshimet që ka pësuar. Çdo informacion i kalon autoriteteve përkatëse dhe ruhen në një *cloud* i cili quhet *Xively*, që bën përpunimin e këtij informacioni të marrë nga fare lundruar.

- *Zbuluesit e rrufeve*

Rrufetë janë të rrezikshme dhe çdo vit rrezikojnë rreth 24000 jetë njerëzish. Për këtë ka lindur nevoja e krijimit të një zbuluesi rrufesh. Ky zbulues i ndihmuar dhe nga një *Raspberry Pi* bën të mundur matjen e rrezatimit Gama që krijojnë shpërthimet e rrufeve deri në 40 km larg. Çdo e dhënë ruhet në një server dhe përditësohet çdo 15 minuta. Gjithashtu mund të dallojë sinjalet e radios ose reze të tjera duke i veçuar nga ato rrufetë edhe duke e bërë më të saktë sinjalizimin. Pasi merret një informacion, atëherë njoftohen banorët e zonës.

- *Alarmet geologjike*

Alarmet geologjike janë disa sisteme monitorimi për vlerësimin e lëvizjes së sipërfaqes së tokës (rrëshqitjen e dherave). Këto alarme në formë shufrash vendosen në tokë në zonat ku ka rrezikshmëri për rrëshqitje të tokës dhe njofton nëse ka ndryshime ose ka probabilitet që toka të rrëshqasë.

- *"My Shake"*

Është një program që pritet të instalohet në celularët *smart* dhe do të zbulojë tërmetet, zjarret, përmbytjet, vullkanet dhe gjithashtu dhe sulmet terroriste. Të gjitha këto duke shfrytëzuar sistemin GPS të celularëve, sistemin ndijor si mikrofoni, orientimi 3D, kamera, etj. Pra sipas disa standardeve, çdo informacion që do të mblidhet nga aplikacioni do u dërgohet autoriteteve përkatëse që do të bëjnë vlerësimin dhe njoftimin e popullatës.

1.3 Menaxhimi i katastrofave natyrore përmes IoT³

IoT-i është një subjekt i madh⁴ dhe si rrjedhojë ka lindur nevoja e ndarjes së tij dhe katastrofave për të pasur një efikasitet të lartë në parandalimin e tyre, si natyrore dhe gjithashtu ato të shkaktuara nga vetë njeriu⁵. Në sistemin e menaxhimit të katastrofave është bërë një ndarje siç paraqitet në figurë⁶.

³Julie Seto, (2018), "Using AI and IoT for disaster management"

⁴Kris Tremaine, Kyle Tuberson, (2017), "How the Internet of Things Can Prepare Cities for Natural Disasters".

⁵ArigeSumanth, N. Ome, (2018), "Natural Disasters Management Using Internet of Things (IoT)". International Journal for Research in Engineering Application & Management (IJREAM) ISSN: 2454-9150 Vol-04, Issue-03, June 2018. pp 343.

⁶Digital India ActionGroup – Whitepaper. "Internet of Things (IoT) for Effective Disaster Management".




Fig. 4. Menaxhimi i katastrofave përmes IoT

a) *Menaxhim katastrofash të bazuara në shërbim* që ka të bëjë me menaxhimin e pajisjeve dhe me strukturimin e njësive të cilat merren me parashikimin dhe mbrojtjen e popullatës.

b) *Menaxhim katastrofash natyrore* që ka të bëjë me katastrofat siç janë përmbytjet vullkanet, tërmetet dhe zjarret e ndryshme.

c) *Menaxhim katastrofash të shkaktuara nga njeriu* që ka të bëjë me katastrofat urbane, industriale dhe sulmet terroriste.

d) *Menaxhim i pas-katastrofave* ka të bëjë me menaxhimin e situatës dhe lokalizimin e viktimave. Me poshtë do të analizojmë vetëm katastrofat natyrore.

1.4 Menaxhimi i fatkeqësive vullkanike

Shpërthimet vullkanike kanë marrë miliona jetë njerëzish dhe për pasojë ka lindur nevoja të bëhet diçka më tepër për të parandaluar një fatkeqësi. Kohët e fundit kompania *General Electric* po merret me një teknologji të re sensorësh të bazuar në platformën *Libelium* dhe duke përdorur IoT. Eksperimenti i parë është bërë në vullkanin *Masaya* në Nikaragua. 80 sensorë të vendosur brenda kraterit, të cilat lidhen në *cloud* me qendrat e kontrollit, nga ku bëhen përlllogaritjet dhe parashikimi i një shpërthimi të mundshëm vullkanik. Japonia po kryen eksperimente të ngjashme në 47 vullkane aktive, ku dhe këtu mblidhet një numër i madh të dhënash që mblidhen nga WSN, bazuar në IoT. Inteligjenca artificiale ka dhënë një shtysë të madhe në këtë projekt pasi bën të mundur shfaqjen 3D të vullkanit; gjithashtu edhe sensorët e shumtë, të cilët masin nivelin e gazrave të lëshuar nga vullkani. Ky sistem përmban teknologji si, GIS DB, *Spring MVC*, *Spring iBatis* dhe *Postgre SQL* për të monitoruar, parashikuar dhe menaxhuar alarmet që do të njoftojnë popullsinë e zonës.

1.5 Menaxhimi i përmytjeve

Përmytjet janë nga katastrofat më të rrezikshme që ndodhin në mbarë botën. Eksperimente të ndryshme janë bërë për t'i bërë ballë kësaj katastrofe dhe për të lajmëruar njerëzit në zonën e rrezikut. Një pajisje e quajtur *Netduino plus 2* është një miniqark kontrollues i cili lidhet me disa sensorë valorë. Është dizajnuar për të matur nivelin e ujit nëpër liqene, lumenj, laguna, etj. Kur merret sinjal rreziku, përpunohet nga qendra e kontrollit e u dërgohet mesazh me anë të internetit në telefonat *smart* të banorëve të zonës. Gjithashtu duke përdorur rrjetin GSM mund të dërgohen SMS në kohë reale në një rreze më të gjerë. Kjo gjë do të rriste efikasitetin dhe sigurinë dhe kohën e nevojshme për evakuim. Eksperimente të tjera me IoT kanë çuar në diçka të re dhe efektive në lidhje me përmytjet duke përdorur sistemin vizual të menaxhimit të përmytjeve i cili është CCTV-ja që bën të mundur filmimin në kohë reale të zonës së përmytjes dhe transmetimin në televizion në kohë reale. Ky eksperiment vazhdon dhe mbledh informacione ku gjithçka ruhet, dhe pritët që në një të ardhme të afërt, të zbatohet gjerësisht.




Fig. 5. Bllokskema për menaxhimin e përmytjeve

1.6 Menaxhimi i zjarreve në pyje

Me qindra zjarre ndodhin nëpër botë ku më i fundit ishte zjarri i madh në pyllin e Amazona-s. FWI (indeksi i motit në pyje) është një njësi statistikore e cila merret me grumbullimin e informacionit në lidhje me katastrofat pyjore dhe problematikat që hasen në të. Duke përdorur IoT, merret informacion nga FWI për kampet e zjarrit, llojin e bimësisë, zonat më të rrezikuara, lëvizjet e hijeve nëpër pyll, temperaturën e motit lokal, etj. Pastaj, krijohet strategjia e vendosjeve të sensorëve dhe shfrytëzohet një platformë e quajtur *Open MTC*, e cila është një platformë *open source* që bën të mundur integrimin në *cloud* të të gjitha paisjeve dhe sensorëve të nevojshëm për të siguruar banorët e zonës së rrezikut. Duke përdorur një qark *Arduino* dhe sensorë të tipit DHT11, LM35, MQ7 të cilët janë *sensorë* që masin sasinë e monoksidit të karbonit. Çdo informacion që merret dërgohet në GSCL e cila shërben si një organizues dhe analizues informacioni në kohë reale dhe me anë të platformës *Open MTC* bëhet

lajmërimi i autoriteteve në kohë reale.

1.7 Menaxhimi i rrëshqitjeve të dheut

Rrëshqitjet e dheut janë të rrezikshme dhe shkaktojnë shume dëme, si materiale, dhe në jetën e njerëzve. Një pajisje e quajtur *Zig Bee*, bën të mundur krijimin e një *cloud* personal, ku mund të lidhen të gjitha pajisjet të cilat duhet të komunikojnë me njëra tjetrën. Pajisjet e tjera të përdorura janë *Arduinot*, sensorët *Mica Z* të cilët janë sensorë që vendosen në të gjithë zonën që do të monitorohet dhe ndjekin në kohë reale të gjitha lëvizjet e dheut. Informacioni që mblidhet, përpunohet nga MFK (qendra e menaxhimit të terrenit) dhe me anë të satelitit INSAT 3A dërgohet tek DMC (qendra e menaxhimit të të dhënave në distancë). Duke përdorur GPS dhe HSDPA (modem transmetues me shpejtësi të lartë) atëherë do të dërgohet informacioni në kohë reale në pajisjen *Zig Bee*, e cila, në rast se në bazë të përpunimit të të dhënave është konstatuar rrezik, do të japë njoftim me SMS duke përdorur GPRS (paketat e shërbimeve të radiove).

1.8 Menaxhimi i tërmeteve

Tërmeti është një dukuri natyrore e cila ndodh gati çdo ditë në pjesë të ndryshme të Tokës, ku të fuqishmit shkaktojnë shumë dëme. Tërmeti i fundit në Shqipëri u regjistrua pranë qytetit të Durrësit në nëntor të vitit 2019, me 51 humbje jetësh dhe 3100 persona të lënduar. Sidoqoftë, studiuesit vazhdimisht angazhohen në hartimin dhe zhvillimin e formave të reja të sistemeve të bazuara në IoT, për të njoftuar viktimat e mundshme para se të ndodhi tërmeti. “Nerve Net”, një sistem i përdorur në Japoni, është një nga avancimet më të fundit të integritetit të IoT për monitorimin e tërmeteve. Ky sistem është bazuar në konceptin e rrjetit bajpas, i cili është provuar të jetë rezistues ndaj kësaj fatkeqësie natyrore. Ky rrjet është shpërndarë gjeografikisht përgjatë disa kilometrave të një rajoni ku zhvillohen komunikimet lokale dhe të largëta duke përfshirë WiFi, satelit, internet me fibër optike. Sidoqoftë, njohuria paraprake që një sistem ka për tërmetin është një pikë kryesore për suksesin e këtij sistemi. Për këtë çështje është krijuar një sistem paralajmërimi të hershëm i bazuar në IoT.

Sistemi i propozuar është ndërtuar bazuar në komunikimin e *Zig Bee*, ku mikrokontrolluesi PIC bën të gjitha llogaritjet e nevojshme. Disa sensorë akselerometër mbledhin të dhëna të papërpunuara të dridhjeve nga vende të ndryshme të tokës dhe mblidhen së bashku në server. Më pas, nëse matja e mbledhur është mbi nivelin e pragut, sistemi njofton të gjithë njerëzit të cilët ndodhen pranë zonës së parashikuar nga sistemi për rrezikun e mundshëm të një tërmeti. Gjithashtu, informacioni i mbledhur për tërmetin duhet të dërgohet dhe të analizohet për përpunimin e mëtejshëm dhe për nxjerrjen e konkluzioneve. Prandaj u propozua një algoritëm i ri i cili mbështetet në protokollin e sinjalizimit SIP (*Session Initiation Protocol*), që sjell besueshmëri të lartë për shpërndarjen e mesazheve tek pajisjet që mbështeten te IoT.

2. Sfidat që shoqërojnë zgjidhjet e lartpërmendura⁷

- *Kostoja*

Studiuesit në të gjithë botën janë përqendruar kryesisht në uljen e kostove të harduerit

⁷ H. N. Saha et al., “Disaster management using Internet of Things,” 2017, 8th Annual Industrial Automation and Electromechanical Engineering Conference (IEMECON), Bangkok, Thailand, 2017, pp. 83.

dhe softuerit në pajisjet e IoT ndërsa maksimizojnë efikasitetin e sistemit. Supozohet se menaxhimi i katastrofës është një detyrë për të shpëtuar jetën. Prandaj, duhet të marrë në konsideratë zhvillimi i teknologjive më të fundit në këtë drejtim, për të ulur më tej koston. Metodat e aktuale nuk përfaqësojnë efektivitetin e koston në pjesën e tyre të modelit.

- Standardizimi

Punimet aktuale nuk janë në përputhje me formatin e standardizuar të përfaqësimit të të dhënave, si dhe përpunimin e tyre. Megjithatë është e kuptueshme që lloje të ndryshme të katastrofave kanë nevojë për zgjidhje të ndryshme, nga ana tjetër, standardizimi mund të jetë i vështirë për tu asimiluar në këtë formë. Sidoqoftë, standardet e sigurisë, standardi i komunikimit dhe standardi i identifikimit janë tre pjesët kryesore të kësaj sfide që duhet të zhvillohen me përhapjen e teknologjive të IoT.

- Të qenit i informuar rreth kontekstit

Kur miliarda të dhëna të mundësuar nga sensori janë të lidhura në rrjet, mundet që përdoruesit të mos i trajtojnë të gjitha të dhënat e mbledhura. Teknikat e bazuara në analizimin e kontekstit duhet të përdoren në një mënyrë më të saktë për të bërë më të lehtë vendosjen e të dhënave që duhet të përpunohen. Siç u përmend më lartë, sistemet e ndërlidhura për katastrofat nuk janë të vetëdijshme për kontekstin e çështjeve që trajtojnë.

- Ndërmarrja e mesme

Shumica e sistemeve të deritanishme janë të dizajnuara për një qëllim të vetëm. Një program i përgjithshëm i orientuar drejt menaxhimit të katastrofës mund të sigurojë një platformë të përbashkët për të arritur qëllime specifike duke përfshirë module të shpërndara gjeografikisht. *Middleware* hap rrjedhën horizontale të informacionit midis pajisjeve, protokolleve dhe programeve qendrore të katastrofave në lidhje me vetveten.

- Toleranca e gabimeve

Toleranca ndaj gabimeve është një nga çështjet më të rëndësishme që mungon në zgjidhjet e deritanishme. Për të bërë një sistem të përsosur, niveli i tolerancës ndaj defektit të një sistemi duhet të mbahet shumë i lartë, në mënyrë që pavarësisht nga çdo defekt i pajisjes fizike (harduerit) ose programit (softuerit) (d.m.th., Sinjal i ulët i baterisë, ndërprerjeve të sinjalit nga sensorët, shoku elektrik i pajisjes, etj.), sistemi duhet të vazhdojë të funksionojë. Pajisjet mund të dështojnë për shkak ikjes së energjisë elektrike ose për ndonjë arsye tjetër. Në mënyrë të ngjashme, gjenerimi i vlerës së gabuar nga një sensor, kalibrimi i gabuar dhe dështimi në komunikim mund të zhvillojë një situatë kritike. Përdorimi i protokolleve të shumta të komunikimit mund të rrisë konsumin e energjisë, por gjithmonë siguron lidhje pa ndërprerje. Kalibrimi i duhur duhet të bëhet para instalimit përfundimtar. Përveç konsumit të energjisë, dizajni i ngurtë i sensorit është një tjetër përfshirje. Fabrikimi dhe sigurimi i sensorëve duhet të bëhet para katastrofës në mënyrë që uragani, përmbytja, ose tërmeti të kenë më pak ndikim në të, duke rezultuar në marrjen efektive të informacionit.

- Analiza e të dhënave

Kjo është pika kyçe e zgjidhjeve ekzistuese të sistemeve IoT të orientuara për katastrofat. Bazuar në karakteristikat e problemeve katastrofike, sistemet e zhvilluara duhet të analizojnë bazat e të dhënave që janë grumbulluar nga vende të ndryshme të katastrofave në momente të ndryshme⁸. Kjo është edhe e vështirë kur formatet,

⁸M. Herlich and S. Yamada, (2015), "Motivation for a Step-by-Step Guide to Set up Wireless Disaster Recovery Networks", 2nd International Conference on Information and Communication Technologies for Disaster Management (ICT-DM), pp. 65.

madhësitë dhe kontekstet janë të pabarabarta në formë dhe formate. Prandaj, një platformë e pandërprerë e analizës së të dhënave për sa i përket shërbimit *cloud*, duhet të shoqërohet në mënyrë efikase me skenarin aktual.

- *Modeli i të dhënave gjenerike*

Zbulimi i njohurive rreth disa ngjarjeve katastrofike ka nevojë për përdorimin e të dhënave nga zgjidhjet ekzistuese të IoT. Në këtë drejtim, një model i përgjithshëm i të dhënave mund të jetë i përshtatshëm për të trajtuar të dhëna të ndryshme, kompleksitetin dhe kërkesat e privatësisë.

- *Dizajnimi i një modeli të sigurt dhe të besuar*

Çështjet e sigurisë janë shumë të rëndësishme në menaxhimin e fatkeqësive pasi grumbullohen në të dhëna marramendëse, informacionet personale dhe private. Të dhënat e mbledhura duhet të jenë shumë të sigurta nga sulmet e piratëve (haker) të ndryshëm.

- *Media sociale e sinkronizuar me komunikimet emergjente*

Kohët e fundit *Facebook* ka nisur “kontrollin e sigurisë” një shërbim që u mundëson viktimave të bllokuara nga tërmeti dhe fatkeqësi të tjera natyrore të informojnë vendin ku ndodhen dhe statusin e tyre të sigurisë për familjen dhe fqinjët e tyre. Një zgjidhje e tillë është në fazën fillestare të testimit. Kështu, *Facebook* dhe *Twitter* mund të mbështesin këto shërbime të sinkronizuara të parakorporuara me faqet e mundshme katastrofike me shënime më efektive.

3. Drejtimi i së ardhmes

Po përmbledhim disa nga udhëzimet e ardhshme në sistemet e menaxhimit të fatkeqësive të bazuara në IoT ⁹ si më poshtë:

- *Kosto*

Zgjidhjet me kosto të ulët janë të dëshirueshme për rritjen dhe përdorimin e zgjidhjeve të bazuara në IoT në sistemet e menaxhimit të katastrofave. Minimizimi i kostonë së prodhimit është thelbësor për vendosjen në shkallë të gjerë të zgjidhjeve të bazuara në IoT. Paneli i kontrollit të përdoruesit Në një ngjarje katastrofike, ndërfaqja e përdorimit duhet të jetë e përshtatshme dhe për viktimën. Duhet të synohet krijimi i ndërfaqeve të cilat janë të lehta në përdorim.

- *Energjia*

Zakonisht në katastrofa ka mungesë të burimeve të energjisë. Kështu, zgjidhjet e mundësuar nga IoT duhet të projektohen për të punuar me energji të ulët. Përveç kësaj, për të kapërcyer çështjet e kufizimit të energjisë në një rrjet, rekomandohet përdorimi i energjisë nga burime të ripërtërishme.

- *Ndërveprimi*

Ndërveprimi është një nga çështjet më të domosdoshme në pajisjet e IoT. Zgjidhjet e vendosura të mundësuar nga IoT duhet të zhvillohen në mënyrë të tillë që të mund të transmetojnë dhe të marrin të dhëna dhe nga pajisje të tjera lokale ose në distancë .

- *Inteligjenca artificiale*

Teknikat Machine learning dhe teknikat e inteligjencës artificiale duhet të ndërlihen së bashku për funksionimin e analizës parashikuese të sjelljes duke përdorur sistemin e

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁹ Partha Pratim Ray, Mithun Mukherjee and Lei Shu, (2017), “Internet of Things for Disaster Management: State-of-the-Art and Prospects”

përparuar të mbajtjes së vendimeve dhe vlerësimet në kohë reale.

- *Mirëmbajtja*

Meqenëse mirëmbajtja e sensorëve në ngjarjet katastrofike është shumë e vështirë, në sistemin e menaxhimit të katastrofave të bazuar në IoT preferohet përdorimi i pajisjeve që kërkojnë mirëmbajtje të ulët.

- *Cilësia*

Arkitektura e bazuar në IoT duhet të jetë e fortë dhe tolerante ndaj gabimeve në mënyrë që aplikacionet të jenë të qëndrueshme gjatë funksionimit të tyre në katastrofa.

- *Përpunimi në kohë reale*

Përpunimi në kohë reale është shumë e rëndësishme tek pajisjet IoT për të trajtuar natyrën dinamike të katastrofës. Kështu që dhe sistemi i menaxhimit të katastrofave i bazuar në IoT duhet të konsiderojë përpunimin e të dhënave në kohë reale.

- *Struktura e të dhënave*

Meqenëse sensorët që mbështesin IoT vendosen në zona të ndryshme, për të trajtuar ngjarje të mundshme katastrofike, duhet të përdoret vetëm një lloj formati i të dhënave. Kjo do të sjellë minimizimin e kohës së përpunimit dhe do të reduktojë kostot.

- *Ndërfaqja ndërmjet moduleve*

Ndërveprimi midis moduleve të brendshëm është një nga çështjet kryesore në menaxhimin e katastrofave të bazuara në IoT për të përmirësuar performancën e përgjithshme të rrjedhës së punës.

- *Algoritmet e mbledhje së të dhënave*

Në një sistem të menaxhimit të fatkeqësive grumbullohen në mënyrë të pashmangshme lloje të ndryshme të të dhënave. Konteksti dhe koha e tyre janë gjithmonë të vështira për tu matur për shkak të faktorëve të ndryshëm. Përzgjedhja e duhur e algoritmeve të mbledhjes së të dhënave do të rrisë efektivitetin e sistemeve të bazuara në IoT. Për shembull, monitorimi dhe analizimi i të dhënave në një zonë kodrinore të prirur për rrëshqitje mund të parashikojë sjelljen e tokës, pas kësaj, ndodhjen e mundshme të incidentit të katastrofës siç është rrëshqitja e tokës.

- *Antena tekstile*

Një antenë përçuese me bazë tekstili është propozuar për situata emergjente. Antena e tekstilit e fuqizuar nga *Ultra Wide Band* përdoret për të siguruar komunikime midis viktimave në ngjarje katastrofike. Një fletë përçellëse si *Velostat* dhe *Linqstat* është efektive. Për më tepër, meqenëse antena e UWB punon në intervalin e frekuencës ndërmjet 3.1-10.6 GHz, është e përshtatshme të ndërlidhet me komunikime të tjera gjatë këtij intervali.

4. Konkluzionet

Duke qenë se fatkeqësitë natyrore nuk mund të ndalen, jemi ne ata që duhet të përkatemi për t'i trajtuar. IoT shihet si zgjidhja, që faktikisht ka filluar të përdoret. IoT, lejon ndërlidhjen pa ndërprerje midis pajisjeve me funksione të ndryshme dhe ka treguar se është një zgjidhje e vlefshme për menaxhimin e katastrofave.

Duke aplikuar analizën e të dhënave dhe mjeteve të inteligjencës artificiale, sistemet e menaxhimit të katastrofave të mundësuar nga IoT mund të përdoren për paralajmërimin e hershëm të një fatkeqësie natyrore, për të gjetur viktimën dhe për të ndihmuar në operacionet e shpëtimit. Përmirësimi në teknologji si robotika, inteligjenca artificiale dhe analiza e të dhënave do të ndihmojë përmirësimin e mëtejshëm të aftësive të IoT, në menaxhimin e katastrofave, duke minimizuar pasojat.

Bibliografi

1. A. Zelenkauskaitė, N. Bessis, S. Sotiriadis and E. Asimakopoulou, "Interconnectedness of Complex Systems of Internet of Things through Social Network Analysis for Disaster Management," 2012 Fourth International Conference on Intelligent Networking and Collaborative Systems, Bucharest, Romania, 2012, pp. 503-508, doi: 10.1109/INCoS.2012.25.
2. ArigeSumanth, N. Ome, (2018), "Natural Disasters Management Using Internet of Things (IoT)". International Journal for Research in Engineering Application & Management (IJREAM) ISSN: 2454-9150 Vol-04, Issue-03, June 2018. pp 339-345.
3. Digital India Action Group – Whitepaper. "Internet of Things (IoT) for Effective Disaster Management". http://icities4greengrowth.in/sites/default/files/documentfiles/%5Bnid%5D/final-iot-report-revised-v4-%2829_06_16%29.pdf (Aksesuarmëdatë: 16/02/2021).
4. H. N. Saha et al., "Disaster management using Internet of Things," 2017, 8th Annual Industrial Automation and Electromechanical Engineering Conference (IEMECON), Bangkok, Thailand, 2017, pp. 81-85.
5. Julie Seto, (2018), "Using AI and IoT for disaster management" <https://azure.microsoft.com/en-us/blog/using-ai-and-iot-for-disaster-management/> (Aksesuarmëdatë: 24.02.2021)
6. Kris Tremaine, Kyle Tuberson, (2017), "How the Internet of Things Can Prepare Cities for Natural Disasters" <https://hbr.org/2017/12/how-the-internet-of-things-can-prepare-cities-for-natural-disasters> (Aksesuarmëdatë: 22/02/2021).
7. M. Herlich and S. Yamada, "Motivation for a Step-by-Step Guide to Set up Wireless Disaster Recovery Networks", 2nd International Conference on Information and Communication Technologies for Disaster Management (ICT-DM), pp. 64-70, 2015.
8. M. Kamruzzaman, N. I. Sarkar, J. Gutierrez and S. K. Ray, "A study of IoT-based post-disaster management," 2017 International Conference on Information Networking (ICOIN), Da Nang, Vietnam, 2017, pp. 406-410, doi: 10.1109/ICOIN.2017.7899468.
9. ParthaPratim Ray, Mithun Mukherjee and Lei Shu, (2017), "Internet of Things for Disaster Management: State-of-the-Art and Prospects"
10. Yang, Lili; Yang, Shuang-Hua; Plotnick, L. (2013): How the internet of things technology enhances emergency response operations. Loughborough University. Journal contribution. <https://hdl.handle.net/2134/14812>.

Bashkëpunimi rajonal në fushën e emergjencave civile, kuadri ligjor dhe juridik



■ MSc. Sheldiana JANO

Avokate

sheldaagaraj@yahoo.com

Abstrakt

Shqipëria është vend i ekspozuar ndaj rreziqeve të shumta natyrore, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek ato, me origjinë hidrometeorologjike dhe gjeologjike, si tërmetet, përmbytjet, thatësitrat, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e tokës. Ndryshimet klimatike, veçanërisht frekuenca e ngjarjeve ekstreme të motit dhe luhatjet e temperaturave që parashikohen të ndodhin si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike, mund të ndikojnë negativisht në sektorin bujqësor, dëme masive në ndërtesa banimi, rrëshqitjet e tokës, bllokimi dhe vështirësia në rrugë kalimi automjetesh në zona të thella të Shqipërisë. Për shkak të një numri gjeofaktorësh, vendet e Ballkanit Perëndimor kërcënohen nga fatkeqësi natyrore të ngjashme. Shumë prej fatkeqësive kanë efekte ndërkufitare, si p.sh, thatësira të zgjatura, përmbytje, tërmete, zjarre në masive pyjore, kështu që mund të përfitohet shumë nga një qasje rajonale gjatë menaxhimit të tyre. Natyrshëm, kur dy vende goditen nga e njëjta fatkeqësi, ndihma reciproke midis tyre mund të vështirësohet, megjithatë, një qasje rajonale në "bashkimin dhe shkëmbimin" e kapaciteteve, do të rezultonte në kursim të konsiderueshëm të burimeve të secilit vend. Rëndësia e bashkërendimit del më në pah veçanërisht në fazën e reagimit të menjëhershëm, në të cilën nevojitet koordinim efektiv për të minimizuar boshllëqet, për të shmangur dublimet, asistencën dhe ndërhyrjet jo të përshtatshme, vonesat, pengesat si dhe ngadalësia në reagim, e veçanërisht në vendimmarrje. Legjislacioni shqiptar përmban, standarde për sigurinë në objekte të veçanta, si: porte dhe aeroporte, të cilat, gjithashtu, duhet të përputhen me standardet e pranuar ndërkombëtare të sigurisë. Kodet e ndërtimit dhe ligjet për përdorimin e tokës janë të detyrueshme për nivelin qendror dhe lokal të cilat, në disa fusha, janë në proces hartimi apo rishikimi për përafrimin me standardet e BE-së.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

emergjenca civile, shkëmbim kapacitetesh, bashkërendim, zhvillim/konsolidim.

1. Hyrje

Sistemi i emergjencave civile në Shqipëri ka evoluar me kohën, por në mënyrë jolineare. Progresi është shoqëruar herë pas here me ndalesa, bile edhe me hapa prapa. Ky fakt si dhe mungesa e të dhënave të mjaftueshme e bëjnë analizën e tij të vështirë. “Vlerësimi i rrezeve nga fatkeqësitë i vitit 2003” dhe *Plani kombëtar i emergjencave civile*, 2004 (PKEC-04) përbëjnë dy hapa të rëndësishëm që hodhën bazat e këtij procesi, ndërsa një numër projektesh të sponsorizuara nga Banka Botërore, OKB-ja dhe BE-ja, midis viteve 2010 e 2014, të fokusuara në vlerësimin dhe ngritjen e kapaciteteve qenë hapa të rëndësishëm përpara, dhe ofruan gjithashtu, informacion të rëndësishëm mbi mënyrën se si ky sistem funksionon në Shqipëri dhe ç’mbetet për të bërë në të ardhmen.

2. Kuadri ligjor dhe konceptor

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenet 170 e 174 trajton çështjet e emergjencave dhe të fatkeqësive, aktet që nxirren dhe masat që merren në raste të tilla. Gjithashtu është miratuar “Ligji për emergjencat civile”¹ dhe “Plani kombëtar i emergjencave civile”². Përveç tyre, ka një numër ligjesh dhe vendimesh qeverie, të tjera, që trajtojnë aspekte të veçanta, si p.sh: “Kriteret për deklarimin e gjendjes së

¹ Ligji 8756/2001

² VKM 835/ 2004

³ VKM 664/2002

emergjencës”³; “Mbrotjtja dhe shpëtimi nga zjarri”⁴; “Pjesëmarrja e qytetarëve në mbrojtjen civile”⁵, etj. Megjithatë, çështjet që i takojnë fazës së *rikuperimit* nga një fatkeqësi, pothuajse nuk janë mbuluar në asnjë nga aktet e deritanishme ligjore. Për më tepër, në asnjë prej tyre nuk ka një renditje të “infrastrukturës kritike”, mbajtja në funksionim e së cilës është esenciale në situata emergjencash civile⁶.

Në lidhje me kuadrin ligjor “[...] implementimi [i ligjeve] është një sfidë e madhe, për shkak të një numri faktorësh, përfshi financimin”⁷. Sidoqoftë autoritetet shqiptare po ndërgjegjësohen për nevojën e formulimit të qasjeve të reja afatgjata për reduktimin e rrezikut. Sfida kryesore është konsolidimi i kuptimit për të lidhur “reagimin” (kur fatkeqësia ka ndodhur) me “reduktimin e rrezikut”. Kjo duhet gjithashtu të përfshihet në planet afatgjata të zhvillimit të vendit. Pas disa tentativash, më në fund është përgatitur një projektstrategji. Bazuar në “projektin për diskutim”, të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (DPEC), vizioni i vendosur nga kjo strategji, për t’u arritur, është: “Shqipëria – një vend i sigurt për të jetuar, punuar e vizituar”. Bazuar në këtë dokument, ky vizion do të synohet të arrihet nëpërmjet dy rrugëve: 1) zhvillimi e integrimi i vendit dhe reduktimi i varfërisë; 2) krijimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të nevojshme për reagim ndaj fatkeqësive në nivel kombëtar, rrethi, bashkie/komune. Projektstrategjia parashtrohet gjithashtu principet që duhen ndjekur gjatë gjithë procesit për parapërgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave civile: a) mbështetja mbi sistemin dhe kapacitetet ekzistuese dhe avancimi i mëtejshëm i tyre; b) gjithëpërfshirja; c) adaptimi ndaj ndryshimeve klimaterike; d) zhvillimi ekonomik; e) përgjegjshmëri në rritje.

Në këtë kontekst, është i nevojshëm përcaktimi i një vizioni të përbashkët (ende i munguar)⁸. Agjencitë shtetërore në nivel qendror, rajonal e komunal, si edhe aktorët jositetërorë, duhet të kuptojnë nevojën për të vepruar së bashku. Kjo do të reduktonte rreziqet dhe pasojat e tyre. Po aq e rëndësishme: popullsia duhet të edukohet e të kuptojë se çfarë duhet të bëjë vetë, që, njëherazi, të reduktojë mundësinë e katastrofave dhe të rrisë aftësinë e familjes së vet për të përballuar një fatkeqësi natyrore. *Plani kombëtar i emergjencave civile, 2004* (PKEC-04) është një nga dokumentet kyçe për të zbrëthyer vizionin strategjik në aktivitete praktike. Ai përcakton organizimin e sistemit kombëtar të menaxhimit të emergjencave civile dhe përgjegjësitë e ndërveprimit në nivel kombëtar, rajonal e komunal. Ai gjithashtu trajton çështjet e informimit publik, bashkëpunimit dhe asistencës së jashtme, implikimet financiare, vlerësimin dhe raportimi e dëmeve, bashkëpunimin me OJQ-të në situata të tilla, etj.

Në thelb ai është një mjet koordinimi. Megjithatë, deri tani, megjithëse është reflektuar në disa strategji apo politika sektoriale dhe në plane veprimi, qasjet e adoptuara nuk janë “organikisht një”, për rrjedhojë nuk është integruar plotësisht në plane sektoriale e shumësektoriale. Shqipëria nuk ka ende një *platformë kombëtare*, si një “forum të menaxhuar e drejtuar kombëtarisht, të së gjithë aktorëve”. Në krijimin e zbatimit e saj duhet të mbahet parasysh që “reduktimi i rreziqeve” është një proces afatgjatë, i lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik të vendit (bile një parakusht për RRF)⁹. Ajo duhet të kuptohet si një përgjegjësi kombëtare dhe si një proces ndërdisiplinor e

⁴ Ligji 8756/2001, amenduar nga Ligji 11/2013

⁵ VKM 533/2003

⁶ 4 Projekt-ligji aktual (në pritje të miratimit) në Nenin 10.1 përcakton një listë të “infrastrukturës kritike” në rast emergjencash civile.

⁷ UN (CADRI) DRR Capacity Assessment, 2011, f.4.

⁸ <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/03/Menaxhimi-i-Emergjencave-Civile-ne-Shqiperi.pdf>

⁹ Projekt-Strategji për RRF&MC, 2014-2018, f. 6.

ndërinstitucional, që udhëheq vendimarrjen dhe pjesëmarrjen e gjithë aktorëve përkatës, ekzistues apo që mund të dalin në të ardhmen.

Për shkak se ligji “Për emergjencat civile” dhe PKEC-04 janë miratuar përpara “Kuatrit për aksion të Hyogos – 2005”¹⁰ (HFA) të dy këtyre dokumenteve u mungon referenca me disa principe të rëndësishme dhe mekanizma praktike, që HFA-ja, i konsideron vendimtarë për qëndrueshmërinë ndaj fatkeqësive. Përpjekjet e përmendura më lart, për rishikimin e kuadrit ligjor dhe të planeve kombëtare, duhet të harmonizohen me synimin e HFA-së, për reduktimin në mënyrë drastike të humbjeve nga fatkeqësitë, në një të ardhme afatmesme, duke ndërtuar qëndrueshmërinë e nevojshme ndaj fatkeqësive në nivel kombëtar e komunitar. Në veçanti, këto dokumente të rishikuara duhet të adoptojnë prioritetet e HFA-së, si: a) bërja e RRF-së një prioritet kombëtar e lokal, zbatuar mbi baza të forta institucionale; b) krijimi i kulturës së sigurisë dhe të qëndrueshmërisë (nga fatkeqësitë) në të gjitha nivelet; c) konsolidimi i përgatitjes për reagim efektiv ndaj fatkeqësive në të gjitha nivelet e vendit; d) reduktimi i faktorëve shtesë të rrezikut.

Një kulturë e re sigurie dhe qëndrueshmërie ndaj fatkeqësive duhet të futet jo vetëm në të gjitha nivelet e institucioneve, por edhe në popullsinë shqiptare në tërësi, sepse asaj “i mungon ndërgjegjësimi ndaj RRF, për rrjedhojë, rreziqet dhe dobësitë nuk kuptohen si duhet”. Gjithashtu, urbanizimi kaotik (përgjithësisht në injorim të kodeve sizmike dhe zonave të rrezikshme) mungesa e mirëmbajtjes të infrastrukturës, sidomos të sistemeve të drenazhimit, etj., ndikojnë në rritjen e frekuencës dhe pasojave të fatkeqësive. Nga ana tjetër, mungesa e kulturës dhe skemave publike/private të sigurimeve nga fatkeqësitë natyrore e përkeqësojnë më tej efektin negativ të fatkeqësive si dhe mundësinë e kohën për rikuperim. Gjithashtu, në popullsinë shqiptare ekziston “pritsmëria që në rastin e dëmtimit nga fatkeqësia natyrore të shtëpive, pasurisë, gjësë së gjallë apo produktit bujqësor, qeveria do të kompensojë gjithë dëmet”, - në fakt, bazuar në legjislacionin shqiptar, kompensimi i mundshëm është për jo më shumë se 40% të humbjeve”.

2.1 Argumentimi i projektaktit lidhur me përparësitë, problematikën, efektet e pritshme¹¹

Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, ka hedhur baza kryesisht në fushën e planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile, por ai nuk ka asnjë përcaktim për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse ka mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, siç janë: paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi. Me projektligjin e ri synohet vendosja e koncepteve moderne, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me terminologjinë evropiane e botërore, duke synuar zbatimin më efektiv të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, të cilat nga ana e tyre do të kishin një ndikim thelbësor në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Përgatitja e projektligjit “Për mbrojtjen civile” është bërë në zbatim të urdhrat të kryeministrit nr.

¹⁰ Konferenca ndërkombëtare për reduktimin e fatkeqësive, u mbajt në Janar 2005, në Hyogo, Japoni. Ajo adoptoi “Kuatrin për aksion 2005-2015” – “Krijimi i qëndrueshmërisë së kombeve dhe komuniteteve ndaj fatkeqësive”. Konferenca theksoi nevojën dhe identifikoi rrugët për krijimin e qëndrueshmërisë së kombeve e komuniteteve ndaj katastrofave dhe përfaqëson një mundësi të rrallë për promovimin e një qasje strategjike dhe sistematike për këtë qëllim.

¹¹ Relacion për projektligjin “Për mbrojtjen civile”.

78, datë 24.5.2018.

Me qëllim marrjen edhe të një shembulli të një ligji të ngjashëm të një vendi anëtar të BE-së, por edhe me karakteristika të ngjashme me Shqipërinë, është shfrytëzuar ligji slloven “Mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera”, ligje të tjera si ai i Kosovës “Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera” dhe i Malit të Zi “Mbi mbrojtjen dhe shpëtimin” janë marrë gjithashtu në konsideratë. Gjithashtu, projektligji është hartuar me këshillimin e Departamentit të Mbrojtjes Civile italiane. Nëpërmjet projektligjit synohet të realizohet modernizimi i sistemit të mbrojtjes civile, i cili do të duhet të jetë në gjendje të përmbushë të gjitha sfidat me të cilat Shqipëria përballlet, si një anëtar i NATO-s dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe një aspirant për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Modernizimi i synuar i sistemit të mbrojtjes civile do të kishte si arritje të tij të parë madhore anëtarësimin e shpejtë në mekanizmin e mbrojtjes civile evropiane.

2.2 Parandalimi dhe lehtësimi ¹²

Plani kombëtar i emergjencave civile i Republikës së Shqipërisë merr në analizë çështje të emergjencave civile nëpërmjet katër fazave të ciklit të emergjencave civile. Faza e parë e këtij cikli, është ajo e parandalimit dhe e lehtësimit. Për qëllimin e PKEC-së, parandalimi përkufizohet, si: tërësia e masave për shmangien e situatave të emergjencave civile që mund të prekin jetën, pasurinë dhe trashëgiminë kulturore. Lehtësimi përkufizohet, si: tërësia e masave për zvogëlimin e prekshmërisë sociale, ekonomike dhe mjedisore ndaj dukurive të mundshme të rrezikut, që mund të vijnë nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të aktivitetit njerëzor. Për menaxhimin me sukses të emergjencave civile është mjaft i rëndësishëm krijimi i shumë lidhjeve të drejtpërdrejta midis aktiviteteve të strukturave dhe institucioneve pjesëmarrëse, si në etapat e një faze, ashtu dhe gjatë katër fazave të ciklit të emergjencave.

Për arritjen e këtij qëllimi, çështjet e parandalimit dhe të lehtësimit nuk janë të lidhura vetëm me përgatitjen dhe mbrojtjen, përgjigjen e menjëhershme ndaj situatave të emergjencave civile, por edhe me çështjet kyç të fazës së rikthimit në gjendjen normale. Faza e rikthimit në gjendjen normale është një mundësi për të riparë dhe për të vlerësuar shkaqet dhe mënyrat e reagimit ndaj një situatë emergjence. Kjo është periudha më e mirë për të ndërmarrë aktivitete lehtësimi, paralelisht me aktivitetet e rehabilitimit dhe të rindërtimit dhe shpesh është koha kur disponohen burimet e nevojshme për të investuar në masat parandaluese dhe lehtësuese, gjë e cila nuk do të mund të bëhej gjatë kohës së emergjencës.

Në këtë seksion përmbledhen faktorët e përgjithshëm që duhen marrë në konsideratë në parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera dhe për lehtësimin e pasojave të tyre. Ka, gjithashtu, edhe elemente të veçanta në lidhje me dukuritë e mundshme të rrezikut me të cilat Shqipëria përballlet, të cilat janë analizuar në bazë të metodave shkencore në studimin “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri”. Nga analiza e përgjithshme del qartë se në Shqipëri ekzistojnë burime dhe kapacitete të cilat mund të zvogëlojnë dukshëm rreziqet me pasoja tek njerëzit, pasuria dhe mjedisi. Gjithashtu, këto kapacitete, në mënyrë të konsiderueshme dhe/ose të dukshme, mund të lehtësojnë efektet e pashmangshme të situatave të emergjencave civile, tek njerëzit dhe pasuria e tyre.

¹² *Plani kombëtar i emergjencave civile i Republikës së Shqipërisë.*

3. Analiza “Swot”

Më sipër u soll një pasqyrë e sistemit të menaxhimit të emergjencave civile në Shqipëri, duke bërë edhe analizën dhe evidentuar disa nga sfidat me të cilat ndeshet dhe problemet e brendshme që ka ky sistem aktualisht. Përveç kësaj, kjo analizë nuk mund të lejë pa përfillur një numër gjetjesh të rëndësishme të evidentuara nga institucione të tjera, që janë marrë me sistemin shqiptar të emergjencave civile, duke aplikuar ndaj tij të ashtuquajturën *analiza “SWOT”*. Në esencë ajo konsiston në vlerësimin e vënien në balancë të anëve të forta e të dobëta, boshllëqeve dhe mundësive të një sistemi. Si qasje metodike, ajo ka një aplikim të gjerë, në ndihmë të vendimmarrësve për gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme për një problem të caktuar.

3.1 Dobësitë/mungesat ¹³

Institucionet shqiptare të angazhuara, konceptualisht dhe praktikisht kanë adoptuar një qasje “reaktive” në vend të asaj “proaktive”. Në këto kushte ato fokusohen më shumë në reagim dhe më pak (ose aspak) në komponentët e tjerë si “zbutja” (e efekteve) “parandalimi”, apo “rikuperimi”. Masat zbatuese përbëjnë një nga problematikat kryesore në lidhje me menaxhimin e krizave. RRF nuk është integruar ende siç duhet në politikat qendrore, sektoriale e lokale.

Gjithashtu ekziston hendeuku midis detyrimeve ligjore dhe obligimeve të marra përsipër nga ministritë e linjës apo institucione të tjera në lidhje me RRF&MC, kurse komunikimi midis tyre ose me DPEC vijon të mbetet problematik. Janë një numër masash në kuadrin e RRF&MC që rezultojnë në vjetruara apo të papërshtatshme si: a) teknikat parashikuese, b) masat mjedisore, c) trajnimi/ndërgjegjësimi për parandalim e mbrojtje nga fatkeqësitë, d) përfshirja e komuniteteve lokale e vullnetarëve, e) mekanizmat e tregut (përfshi dhe tregun e sigurimeve) për të amortizuar e mos lejuar shtimin e efektit të fatkeqësive. Problematike mbetet gjithashtu mungesa e sistemeve të paralajmërimit të hershëm, pa ndërprerje (24 orë/7 ditë) dhe mungesa e edukimit në shkolla për përballimin e fatkeqësive (në të gjitha ciklet).

3.2 Anët e forta dhe mundësitë

Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe politikash, që me gjithë mangësitë, ofron një bazë për përmirësime të mëtejshme në kuadr të RRF&MC¹⁴. Studimi i rreziqeve natyrore, i ndërmarrë në 2003, dhe *Plani kombëtar i emergjencave civile*, i vitit 2004 (PKEC-04) japin informacion të rëndësishëm cilësor e sasior (statistikor) për kërcënimet nga fatkeqësitë si dhe për rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve shqiptare. Qeveria po tregon një ndërgjegjësim në rritje për masat parandaluese të rrezikut, megjithëse ka shumë për të bërë për vënien në jetë të tyre.

Vlerësimi në rritje nga nivelet më të larta vendimmarrëse të reduktimit të rreziqeve nga fatkeqësitë (RRF) krahas masave reaguese për mbrojtjen civile (MC), përveç të qenit pozitiv në vetvete, ka gjetur edhe mbështetjen dhe sponsorizimin nga aktorë

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

“ Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë ”

¹³ <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/03/Menaxhimi-i-Emergjencave-Civile-ne-Shqiperi.pdf>

¹⁴ See more at: IPA assessment-2011, p.16

ndërkombëtarë (Banka Botërore) me programe të veçanta, si fuqizimin e sistemeve monitoruese hidrometeorologjike, adoptimin e eurokodeve për ndërtimet, futjen e sistemeve të sigurimeve etj. Mbi të gjitha, vlen të theksohet fakti se fatkeqësitë e viteve të fundit (kryesisht përmbytje e zjarre), me gjithë dëmet (në ekonomi por për fat të mirë jo në njerëz), kanë evidentuar një farë kapaciteti të institucioneve dhe popullsisë shqiptare për t'i përballuar ato. Mësimet e nxjerra prej tyre, si dhe një aftësi në rritje e institucioneve për të bashkëpunuar e mbështetur njëri-tjetrin, në kundërpërgjigje ndaj emergjencave, përbëjnë një bazë të mirë për sfidat e kësaj natyre, në të ardhmen.

3.3 Bashkërendimi ¹⁵

Bashkërendimi është mjaft i gjerë dhe i domosdoshëm në të gjithë fazat e një emergjence civile. Bashkërendimi ka të bëjë me shkëmbimin e informacionit si dhe me koordinimin e një sërë aktiviteteve të strukturave të ndryshme për të bashkuar përpjekjet në menaxhimin e situatave emergjente. Rëndësia e bashkërendimit del më në pah veçanërisht në fazën e reagimit të menjëhershëm, në të cilën nevojitet koordinim efektiv për të minimizuar boshllëqet, për të shmangur dublimet, asistencën dhe ndërhyrjet jo të përshtatshme, vonesat, pengesat si dhe ngadalësisë në reagim e veçanërisht në vendimmarrje.

Bashkërendimi i dobët sjell përgjigje jo të kënaqshme ndaj situatës së emergjencës. Në këto raste rritet zhgënjimi i panevojshëm nga ana e të mbijetuarve për strukturat zyrtare dhe atyre që merren me dhënien e asistencës. Situata emergjente shpesh karakterizohet nga një gjendje kaotike dhe paniku, qoftë nga masat e gjera të popullsisë së prekur, ashtu edhe nga strukturat të cilat merren me menaxhimin e kësaj situatë, prandaj aktivitetet dhe kapacitetet duhet të jenë në mënyrë sa më të harmonizuar që përgjigjja dhe efektet të jenë sa më pozitive. Situata mund të duket e rrëmujshme, por duhet të kuptohet që bashkërendimi lind nga veprimet e menduara për të harmonizuar përgjigjet e individëve dhe të grupeve të ndryshme, për të maksimalizuar ndikimin dhe sjelljen e situatës në një gjendje të tillë ku efektet dhe ndikimet negative në jetesën e komunitetit të jenë sa më të pakta. Për këtë arsye, bashkërendimi, edhe pse më pak i dukshëm, është po ashtu njëloj i rëndësishëm si në fazën e përgjigjes edhe gjatë fazave të tjera të ciklit të menaxhimit të emergjencave.

Për shembull, në fazën e lehtësimit të situatës, bashkërendimi i mirë midis institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e ujëmbledhësve, mirëmbajtjen e kanaleve tretësore, dytësore dhe parësore, stacioneve të pompimit, furnizimit me energji elektrike dhe menaxhimit të tokës për përdorim në nivel lokal, mund të sjellë si rrjedhojë zvogëlimin në mënyrë të dukshme të numrit të njerëzve të prekur nga përmbytjet ose, dhe në disa raste, parandalimin e përmbytjes.

Prandaj, në rastin më të mirë, bashkërendimi përbëhet nga një sërë aktiviteteve të cilat shtojnë në maksimum efektivitetin në menaxhim, duke sjellë rezultate më të mira të pritshme, shërbime të shpërndarjes në kohën e duhur dhe kërkon burime të mjaftueshme për arritjen e rezultateve të pritshme, të tilla, si: sa më pak vuajtje njerëzore dhe dëme materiale, rikthim i shpejtë në kushtet normale të jetesës dhe përmirësim i masave parandaluese dhe lehtësuese të pasojave, përkundrejt situatave të emergjencave në të ardhmen, të cilat shihen gjithashtu si përbërës të procesit të zhvillimit. Rolet,

funksionet bashkërenduese, dhe *Plani kombëtar*: themeli i bashkërendimit është krijimi i raporteve të ndërsjella dhe shkëmbimi i hapur dhe i vazhdueshëm i informacionit ndërmjet institucioneve dhe strukturave të emergjencës.

Për shkak të kërkesave që vijnë si rezultat i situatës së emergjencës civile dhe përfshirjes së menjëhershme të tyre në shkëmbimin e informacionit, këto institucione dhe struktura duhet të marrin sa më shpejt rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Si rezultat i bashkërendimit duhet të evidentohen dhe të trajtohen problemet më me përparësi, por njëkohësisht të mos neglizhohen edhe problemet dytësore, në mënyrë që rezultati të jetë sa më i plotë. Në këtë mënyrë, interesi i institucioneve për rivendosjen e shërbimeve ose të kushteve për të cilat ata kanë përgjegjësi funksionale, paraqitet në një tablo më të gjerë nëpërmjet vendosjes së radhës së përparësive dhe përdorimit të drejtë dhe efektiv të burimeve.

4. Bashkëpunimi rajonal në fushën e emergjencave civile

Për shkak të një numri gjeofaktorësh, vendet e Ballkanit Perëndimor kërcënohen nga fatkeqësi natyrore të ngjashme. Shumë prej fatkeqësive kanë efekte ndërkufitare, si p.sh, thatësira të zgjatura, përmytje, tërmete, zjarre në masive pyjore, kështu që mund të përfitohet shumë nga një qasje rajonale gjatë menaxhimit të tyre. Natyrshëm, kur dy vende goditen nga e njëjta fatkeqësi, ndihma reciproke midis tyre mund të vështirësohet, megjithatë, një qasje rajonale në “bashkimin dhe shkëmbimin” e kapaciteteve, do të rezultonte në kursim të konsiderueshëm të burimeve të secilit vend, veç e veç, duke bërë të panevojshme që secili prej tyre të krijonte kapacitete e rezerva të specializuara për çdo lloj fatkeqësie, apo në atë sasi që do të duhej po t’i përballonte i vetëm këto fatkeqësi. Një kooperim i tillë midis institucioneve/agjencive do të ishte me vlerë sidomos në fushën e vlerësimit të dobësive, observimit e informimit, paralajmërimit të hershëm të proceseve hidrometeorologjike e sizmike, parandalimit të epidemive, zbutjes së efektit të ndryshimeve klimaterike, etj. Kontaktet paraemergjencë dhe komunikimi i ndërsjellët mund të realizohen nëpërmjet takimeve ndër-institucionale, planifikimit dhe zhvillimit të stërvitjeve të përbashkëta, shkëmbimit rutinë të informacionit e të raporteve që lidhen me RRF&MC, etj.

Në esencë, çdo aktivitet i kryer në fazën paraemergjencë që krijon besim, miqësi e lidhje profesionale midis personelit e institucioneve kyçe në këtë fushë, ndihmon reagimin e menaxhimin rajonal efektiv të fatkeqësive. Deri tani, disa nga iniciativat rajonale më të spikatura, ku Shqipëria është vend anëtar, janë: Iniciativa për Parapërgatitjen dhe Parandalimin e Fatkeqësive të Vendeve të Evropës Juglindore; Iniciativa Adriatik-Joniane; Parapërgatitja Civilo-Ushtarak për Emergjencat e Këshillit të Evropës Juglindore; Rrjeti i Simulimeve i Evropës Juglindore; Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi; etj. Qëllimi i deklaruar i tyre, në përgjithësi, është të mbështesin vendet anëtare për të zhvilluar/adoptuar legjislacionin, rregullat dhe kodet, në linjë me direktivat dhe praktikrat e përbashkëta ndërkombëtare (sidomos BE).

Ato kanë natyrë *network*-u, në shërbim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira në lidhje me RRF-në. Qysh në nisje, fokusi i tyre ka mbetur i kufizuar. Në fakt, kur emergjencat civile kanë ndodhur, vendet e prekura, për të fuqizuar masat e tyre kundërvepruese, kanë preferuar të kontaktojnë direkt vendet e tjera, bazuar në marrëveshjet bilaterale të lidhura më parë, në vend që t’u hyjnë procedurave të rënduara

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

e të ngathëta të organizatave rajonale apo multilaterale. Një nga problemet kryesore në lidhje me bashkëpunimin rajonal për RRF&MC mbetet “pronësia”. Përjashtuar disa iniciativave në këtë kontekst, të mbështetura/sponsorizuara nga OKB-ja, BE-ja apo Banka Botërore, organizimet e tjera rajonale nuk janë parë aq sa duhet, si një domosdoshmëri nga vetë vendet e rajonit. Si të tilla, atyre nuk u është kushtuar mjaftueshëm vëmendje, burime njerëzore e materiale. Në vitin 2007, Banka Botërore, Organizata Botërore e Meteorologjisë dhe PNUD-i filluan *Programin e Europës Juglindore për zbutjen dhe adaptimin ndaj fatkeqësive*. Programi synonte zhvillimin/konsolidimin e kapaciteteve kombëtare te:

- 1) menaxhimi i fatkeqësive, kapacitetet institucionale dhe të qeverisjes;
- 2) shërbimet hidrometeorologjike;
- 3) mekanizmat e transferimit financiar për shkak të fatkeqësive, me qëllim ndihmën e vendeve pjesëmarrëse për reduktimin e pasojave.

Në Shqipëri, Banka Botërore po kontribuon në RFF nëpërmjet disa projekteve, midis të cilëve, më i rëndësishmi është “Projekti për zbutjen dhe adaptimin ndaj fatkeqësive”, prej rreth 10 milionë dollarë (USD)¹⁶, me Ministrinë e Brendshme si koordinatorin kryesor.

Që nga marsi 2014, Shqipëria po përfiton nga të dhënat e siguruara nëpërmjet “DEWETRA”, një nga sistemet më të avancuara për vlerësimin e katastrofave hidrometeorologjike. Që nga viti 2011, në rang rajonal, nëpërmjet programeve IPA, janë zhvilluar një numër seminaresh, *workshop*-ësh, stërvitje në kompjuter me temë emergjencat civile, si tërmete (Slloveni) përmbajtje (Kroaci) etj. Një grup përfaqësuesish nga institucione të ndryshme shqiptare ka marrë pjesë rregullisht në to. Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq ka qenë aktive në disa iniciativa rajonale me fokus RRF, sidomos për “parapërgatitje” dhe “trajnim”, kurse sektori privat ka ofruar ndihmë, rast pas rasti, gjatë “reagimit” (ndaj fatkeqësisë)¹⁷.

Bashkëpunimi rajonal për monitorimin dhe menaxhimin e lumenjve ka një rëndësi të veçantë për Shqipërinë në rastin e Lumit Drin (më i gjati dhe më i rëndësishmi për Shqipërinë nga pikëpamja e prodhimit të energjisë). Për shkak se dy degët e tij kalojnë në territorin e Maqedonisë e Kosovës, ndërsa Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna shfrytëzohen edhe nga Mali i Zi, ka qenë e rëndësishme për Shqipërinë dhënia jetë e një numri projektesh të përbashkëta me këto vende fqinje, projekte të cilat deri tani nuk kanë dhënë rezultatet e pritshme, ndërsa pasojat kryesore në një numër përmbajtjesh (të përmendura më lart) i ka vuajtur kryesisht Shqipëria. Sidoqoftë, ekzistojnë të gjitha mundësitë, që në të ardhmen, të bëhet më shumë bashkërisht për disa nga fazat e RRF&MC, konkretisht për “zbutjen” (e pasojave), “parapërgatitjen” dhe “reagimin” në rast përmbajtjesh nga sistemi Lumi Drin-Lumi Buna – Liqeni i Shkodrës. Duke qenë se kapacitetet e brendshme nuk përmbushin standardet e nevojshme, Shqipëria i është drejtuar rregullisht komunitetit ndërkombëtar për ndihmë në rast fatkeqësish natyrore, duke përdorur si Qendrën e NATO-s për Koordinim të Reagimit ndaj Fatkeqësive, ashtu dhe Qendrën për Monitorim e Informim të BE-së.

Gjatë zjarreve masive të vitit 2007, përmbajtjeve të janarit e dhjetorit 2010,

¹⁶ Ky projekt ka pasur 5 komponentë: 1) Menaxhimi dhe përgatitja për fatkeqësitë - 4.89 milionë USD; 2) Konsolidimi i shërbimit hidro-meteorologjik - 2.09 milionë USD; 3) Vendosja e kodeve të ndërtimeve - 0.36 milionë USD; 4) Sigurimi nga katastrofat - 2.65 milionë USD; 5) Menaxhim projekti - 0.01 milionë USD (IPA assessment - 2011, f.15).

¹⁷ South Eastern Europe Disaster Risk Mitigation and Adaptation Program. Përfutuese të tij janë Shqipëria, Bosnja, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Moldova, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Turqia.

emergjencave dimërore të shkurt-marsit 2012, një total prej 22 vendesh, plus një numri organizatash ndërkombëtare dhe OJQ-sh kontribuan me asistencë për Shqipërinë. Të gjitha vendet fqinje (përjashtuar Malin e Zi) dhanë asistencë në një rast apo në tjetrin. Shqipëria është aktualisht pjesë e disa marrëveshjeve trelaterale si, marrëveshja me Agjencinë Kosovare për Menaxhimin e Emergjencave, dhe Qendrën e Maqedonisë për Menaxhimin e Krizave. Në bazë të saj, është nënshkruar *Deklarata e Përbashkët*¹⁸, si dhe një program, midis ministrive të Brendshme dhe të Mbrojtjes, të së tre vendeve, për bashkëpunimin trelateral në fushën menaxhimit të krizave dhe të emergjencave. Kjo marrëveshje mbështetet nga USAID-i. Për sa i përket bashkëpunimit bilateral në fushën e emergjencave civile, Shqipëria ka vendosur marrëdhënie të tilla me Italinë, Austrinë, Greqinë (maj 2005), Kroacinë (dy marrëveshje, përkatësisht shkurt 2010 dhe shtator 2012), Bosnjën (maj 2013), etj.

Marrëveshjet bilaterale janë në proces miratimi me Turqinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Një bashkëpunim i ngushtë është vendosur midis shërbimeve meteorologjike ushtarake të Shqipërisë dhe Italisë, që nga gushti 1997, sidomos në shkëmbimin e të dhënave për parashikimin e motit. Një progres të rëndësishëm ka njohur bashkëpunimi i Shqipërisë me Kosovën në fushën e emergjencave civile. Kosova dha asistencë në tre raste përmbajtjes në Shqipëri (2010, 2011 e 2015). Më e ndjeshme, kjo gjë ishte në vitin 2011, kur dy ekiye kërkim-shpëtimi (16 veta) u dërguan nga Kosova, së bashku me pajisjet mbështetëse (4 motobarka, automjete, etj). Duke filluar nga janari 2015, personeli zjarrfikës nga Shqipëria ndjek kurse trajnimit 3-mujore në Qendrën Rajonale të Kosovës për Luftën ndaj Zjarreve¹⁹.

E ndërtuar kohët e fundit, me mbështetjen amerikane, kjo qendër është parashikuar si një fushë bashkëpunimi afatgjatë midis Shqipërisë e Kosovës, për shkak të standardeve të larta të trajnimit që ofron. Nga ana tjetër, Shqipëria do të ofrojë trajnim për përmbajtjet, një obligim që për palën shqiptare është ende në fazën e planeve. Deri tani ka vetëm një rast kur Shqipëria ka dhënë asistencë jashtë vendit për emergjencat civile. Ajo dërgoi 5 grupe SAR (kërkim-shpëtim) gjithsej 20 veta, me pajisjet e nevojshme (përfshi 5 motobarka e një autoambulancë) në Bosnjë, për të ndihmuar në përmbajtjet e majit 2014. Në operacionin e tyre 8-ditor, ekipet shqiptare evakuuan 290 veta, ndërsa disa muaj më vonë, qeveria shqiptare akordoi nga 100 mijë euro asistencë, veçmas, për Bosnjën dhe Serbinë (gjithashtu e goditur nga përmbajtjet e majit 2014). Në lidhje me përmbajtjet e majit 2014 në Bosnjë e Serbi, një aksion interesant u ndërmor nga shoqëria civile në Shqipëri, për të ndihmuar popullsinë e Serbisë. Nisma u realizua në baza vullnetare, nga studentë e aktivistë të rinj, të organizuar nëpërmjet rrjeteve sociale, forumeve të medieve, banderolave të publikuara në vende të dukshme (kryesisht në Tiranë) etj. Ndihma konsistoi kryesisht në ushqime të paketuara, materiale higjienike, veshje të ngrohta e batanije etj. Një tjetër OJQ, *Këshilli Rinisë Shqiptare*, organizoi gjithashtu grumbullim ndihmash ushqimore. Të gjitha materialet u transportuan në zonat e prekura, në Serbi, nëpërmjet KKSJ-së.

5. Përfundime e rekomandime

Shqipëria është një vend i ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore. Efekti i tyre ka

¹⁸ Nënshkruar në Dhjetor 2012, në Prishtinë (DPEC, HFA monitoring report, 2011-2013)

¹⁹ Kosovo Regional Fire Fighting Training Facility (RFFTF)

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

tendencën të përkeqësohet për shkak të urbanizimit të shpejtë, të shoqëruar me praktika të pakontrolluara të ndërtimit në injorim të kodeve përkatëse, keqpërdorimit të tokës, burimeve natyrore, veprimtarisë ndaj mjedisit dhe një numër faktorësh të tjerë që karakterizuan kalimin nga një ekonomi e centralizuar në atë të tregut të lirë. Me gjithë progresin e Shqipërisë në menaxhimin e emergjencave civile, është e domosdoshme të bëhet më shumë për përsosjen e legjislacionit, koncepteve doktrinarë dhe planeve zbatuese, për përmirësimin e rolit dhe kontributit të çdo institucioni me përgjegjësi ligjore ndaj emergjencave civile, fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe krijimin e kapaciteteve të nevojshme për të përballuar një spektër të gjerë fatkeqësish natyrore apo të shkaktuara nga njeriu²⁰. Fatkeqësitë e viteve të fundit, me gjithë dëmet e shkaktuara, kanë evidentuar një farë kapaciteti të institucioneve dhe të popullsisë shqiptare për t'i përballuar ato.

Mësimet e nxjerra prej tyre, si dhe një aftësi në rritje e institucioneve për të bashkëpunuar e mbështetur njëri-tjetrin e kundërpërgjigjur ndaj emergjencave, përbëjnë një bazë të mirë për sfidat e kësaj natyre në të ardhmen. Në përpjekjet për kompletimin dhe përsosjen e kapaciteteve kombëtare në interes të RRF&MC, Shqipëria duhet të reduktojë gradualisht pjesën ushtarake të tyre. “Demilitarizimi” i kapaciteteve dhe masave të RRF&MC do t’u krijonte institucioneve të tjera qendrore apo lokale, me detyrime ndaj emergjencave civile, hapësirën e nevojshme për të luajtur sa më mirë rolin e tyre para dhe gjatë fatkeqësisë. Nga ana tjetër, ky proces, do të lehtësojë e do të bëjë më të pranueshëm (nga një numër aspektesh) çdo kontribut shqiptar ndaj vendeve të tjera, të prekura nga fatkeqësi të kësaj natyre. Duke pasur parasysh stadin aktual të kapaciteteve shqiptare për nevojat e RRF&MC, si në aspektin institucional ashtu dhe në atë operacional, Shqipëria e ka të pamundur të menaxhojë e vetme një katastrofë madhore. Bile, duke e parë problemin nga pikëpamja “kosto-përfitim”, kjo nuk është as e këshillueshme. Nisur nga ky konstatim, si dhe nga fakti që fatkeqësi të kësaj natyre janë “ndërkufitare” në shtrirjen dhe efektin e tyre, zgjidhja më racionale është një bashkëpunim më i mirë me vendet e tjera të rajonit dhe me organizata ndërkombëtare (OKB, NATO, BE, Banka Botërore, etj.).

Në mënyrë të posaçme, një qasje rajonale në “bashkimin dhe shkëmbimin” e kapaciteteve do të bënte që masat e RRF&MC të ishin jo vetëm më efektive, por edhe me kosto më të ulët për secilin nga vendet e rajonit. Deri tani, bashkëpunimi rajonal i ka munguar niveli i duhur i “pronësisë”. Përfshirja disa iniciativave të sponsorizuara nga OKB-ja, BE-ja apo Banka Botërore, pjesa tjetër e organizimeve rajonale kanë rezultuar më shumë për formë. Në përgjithësi, atyre u mungojnë mekanizmat e nevojshëm për të pasur efekt të ndjeshëm në fatkeqësitë natyrore. Bashkëpunimi rajonal për emergjencat civile mund të fuqizohet nëpërmjet takimeve ndërinstitutionale, planifikimit dhe stërvitjeve të përbashkëta dhe shkëmbimit në mënyrë të vijueshme të informacioneve dhe raporteve. Në esencë, çdo aktivitet i kryer në fazën para emergjencë që krijon besim, miqësi e lidhje profesionale midis personelit e institucioneve kyçe në këtë fushë, shkon në dobi të një reagimi e menaxhimi rajonal efektiv ndaj fatkeqësive. Pavarësisht lidhjeve etnike e kulturore midis Shqipërisë e Kosovës, të cilat kanë nxitur një bashkëpunim bilateral në rritje në një numër fushash, deri tani, bashkëpunimi në fushën e emergjencave civile, pavarësisht nga hapat përpara, ka qenë nën nivelin e pritshëm dhe nuk i ka shfrytëzuar të gjitha potencialet e mundshme. Për shkak të lidhjeve të

sipërpërmendura, por edhe të afërsisë gjeografike, e cila mbart mundësinë që e njëjta fatkeqësi të prekë njëkohësisht të dy vendet, është me rëndësi dhe përfitim reciprok thellimi i bashkëpunimit midis të dy vendeve në të gjithë spektrin e reduktimeve të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile.

Bibliografi


1. Ligji 8756/2001
2. VKM 835/ 2004
3. VKM 664/2002
4. Ligji 8756/2001, amenduar nga Ligji 11/2013
5. VKM 533/2003
6. Projekt-ligji aktual (në pritje të miratimit) në Nenin 10.1 përcakton një listë të "infrastrukturës kritike" në rast emergjencash civile.
7. UN (CADRI) DRR Capacity Assessment, 2011.
8. <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/03/Menaxhimi-i-Emergjencave-Civile-ne-Shqiperi.pdf>
9. Projekt-Strategji për RRF&MC, 2014-2018.
10. Konferenca ndërkombëtare për reduktimin e fatkeqësive, u mbajt në Janar 2005, në Hyogo, Japoni. Ajo adoptoi "Kuarin për aksion 2005-2015"
11. Relacion për projektligjin "Për mbrojtjen civile"
12. <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/03/Menaxhimi-i-Emergjencave-Civile-ne-Shqiperi.pdf>
13. IPA assessment, 2011.
14. Plani Kombëtar i Emergjencave Civile.
15. Nënshkruar në dhjetor 2012, në Prishtinë (DPEC, HFA monitoring report, 2011-2013)
16. Menaxhimi i Emergjencave Civile në Shqipëri IDM Albania.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Problematikat, në efikasitet dhe zbatueshmëri, të ligjit nr. 45/2019, për rastet e ndryshme të emergjencave civile



■ **MSc. Ketjona KAÇUPI**
Ministria e Drejtësisë, Shqipëri
Ketjona.Kacupi@drejtesia.gov.al



■ **MSc. Edvin MORAVA**
Ministria e Drejtësisë, Shqipëri
Edvin.Morava@drejtesia.gov.al

Abstrakt

Vitet e fundit garantimi i një niveli të kënaqshëm mbrojtjeje në rast të një emergjence civile ka qenë në fokus të strukturave ligjzbatuese, medieve dhe subjekteve të tjerë të interesuar. Miratimi në 2019-n i një ligji të ri për mbrojtjen civile, përveç vullnetit politik, evidentoi nevojën për një organizim të mirëfilltë dhe për një ndarje të detyrave ndërmjet autoriteteve shtetërore kompetente, me qëllim përballimin e rasteve praktike të emergjencave. Megjithatë, tërmeti i nëntorit të 2019-s, solli nevojën për miratimin e një akti normativ nga Këshilli i Ministrave dhe një sërë aktesh të tjera me karakter nënligjor, pasi ligji, për shkak të mënyrës së hartimit dhe parashikimeve të shumta deklarative në përmbajtje të tij, ngeli i pazbatueshëm. Në këtë kuadër, ky punim ka si qëllim të japë një pasqyrë të përgjithshme të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile, nivelin e zbatimit të tij në raste konkrete emergjencash civile, si dhe identifikimin e problematikave që dalin gjatë zbatimit në praktikë të tij. Pjesë e punimit do të jenë edhe rekomandime e propozime të mundshme për ndryshim dhe/ose përmirësim të kuadrit ligjor në fuqi, me qëllim rritjen e nivelit të efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së tij, me qëllim përballimit të emergjencave civile në mënyrë dinjitoze.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

emergjenca civile, kuadër ligjor, zbatueshmëri.

1. Hyrje

Nevoja për mbrojtje nga emergjencat civile po merr gjithmonë e më shumë rëndësi me ndodhjen dhe materializimin e situatave faktike, duke nënvlerësuar faktin se rregullimi ligjor duhet të jetë pararendës i çdo situatë të mundshme fatkeqësie, me qëllim minimizimin dhe kur është e mundur parandalimin e pasojave që vijnë prej tyre. Risku ndaj fatkeqësive nuk mund të matet dhe as të parashikohet, çka nënkupton se parashikimet ligjore duhet të jenë të tilla që të zbusin këto pasoja dhe të menaxhojnë situatën që mund të krijohet. Në këto kushte nevoja për një rregullim ligjor të saktë, shterues, të qartë dhe gjithëpërfshirës bëhet edhe më i nevojshëm, sidomos kur bëhet fjalë për shtete si Shqipëria, burimet financiare dhe njerëzore në dispozicion të së cilës nuk janë në vlera apo numra aq të konsiderueshme sa për të përballuar një fatkeqësi, për të cilin parashikimet në ligj mungojnë.

Për përballimin e emergjencave dhe garantimin e mbrojtjes civile kuadri ligjor bazë duket të jetë i vakët. Përmendim ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, i cili ka hedhur bazat kryesisht në fushën e planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, si dhe ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, aktualisht në fuqi, i cili shfuqizon të parin. Efikasiteti i të dy ligjeve vlerësohet në mënyrën e përballimit të fatkeqësive reale, procedurave dhe efikasitetit të tyre, mënyrës së përballimit të pasojave dhe kompensimit sa më të shpejtë të tyre nëse ka të tillë, me qëllim garantimin e sigurisë së shtetasve. Në fakt, realiteti ka treguar se, përtej parashikimeve të bukura dhe marrjes përsipër të detyrave deri diku të paarrtshme, apo për të cilat është e vështirë të realizohet koordinimi i duhur ndërmjet strukturave kompetente, efikasiteti i kuadrit ligjor në fuqi

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**“ Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë ”**

ka qenë minimal. Nevoja për miratim të akteve të tjera gjatë kohës së ndodhjes së fatkeqësisë, mungesa e ndarjes së saktë të kompetencave dhe detyrave, janë rrjedhojë e nevojës për përmirësim në vazhdim të kuadrit ligjor, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe qartësisht të përcaktojë reagimin që duhet të bëhet nga strukturat kompetente, cilat prej tyre duhet të veprojnë më shpejt, etj.¹

Në dekadat e fundit Shqipëria ka pasur si qëllim aplikimin e një qasjeje bashkëkohore në kuadër të përballimit të fatkeqësive qoftë me origjinë natyrore apo nga njeriu, duke i kushtuar rëndësi reduktimit të riskut, për rrjedhojë është përmirësuar dukshëm kuadri ligjor, strukturat operacionale, si dhe institucionet kompetente. Megjithatë, dukshëm ndjehet mungesa e një kulture të mbrojtjes civile, e cila të shërbejë si gur themeli në funksion të parandalimit të rrezikut për një fushë sa më të gjerë fatkeqësish, sikundër edhe vendosja e mekanizmave zbatues, të cilët shërbejnë për realizimin e qëllimit të përmendur edhe më sipër. Pavarësisht nga mbështetja e dhënë nga aktorët ndërkombëtarë, si dhe rezultateve pozitive të saj, duhet të mbahet në konsideratë nevojën për një rregullim të brendshëm, i cili duhet të jetë i plotë dhe t'i vijë në ndihmë të gjithë shtetasve në rastin e përballjes me një fatkeqësi të caktuar. Edhe pse në nivel dypalësh Shqipëria ka bashkëpunim të mirë me shtetet evropiane dhe të rajonit, nevoja për ndërtimin e mureve të brendshme mbrojtës konsiderohet e domosdoshme, në kushtet ku në rast fatkeqësie është shteti i brendshëm që jep/ofron ndihmën i pari, pa “varur shpresat” në ndihmën e të ndërkombëtarëve.

1. Kuadri ligjor për përballimin e emergjencave civile në Shqipëri gjatë harkut kohor 2001-2020

Ligji i parë në fushën e mbrojtjes civile në Shqipëri ka hyrë në fuqi në vitin 2001, me ligjin nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar. Deri në këtë periudhë kohe ka vazhduar të veprojnë dekrete nr. 3824, datë 1.12.1964 i Presidiumit të Kuvendit Popullor “Për mbrojtjen civile të Republikës”. Pavarësisht kalimit në dy sisteme, shoqëruar me ndryshimin e pothuajse të gjithë legjislacionit në fuqi, me qëllim përshtatjen me ndryshimet e reja që po përballej shteti, ligjvënësi i asaj kohe nuk e ka parë të nevojshme ndryshimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile. Një gjë e tillë mendojmë se është diktuar edhe për shkak të situatës së krijuar në vend, ku thelbësore konsiderohej miratimi i ligjeve bazë për organizimin dhe funksionimin e shtetit në tërësi dhe institucioneve përkatëse të tij. Mbi këtë justifikim, u desh viti 2001 që në Shqipëri të miratohej një ligj i mirëfilltë, i cili të fokusohej në çështjet e rëndësishme që lidheshin me emergjencat civile, institucionet kompetente dhe procedurat që do të ndiqeshin në rast se ndodhte një fatkeqësi natyrore.

Pavarësisht nga sa më sipër, fatkeqësitë natyrore nuk kanë munguar në Shqipëri, për shkak edhe të pozitës gjeografike në të cilën shtrihet. Për rrjedhojë, pohojmë se për periudhën kohore nga 1980 deri më 2010 janë regjistruar 23 fatkeqësi, të tilla si: përmbytje, katër tërmete dhe tre goditje nga temperatura ekstreme. Ky efekt i fatkeqësive rritet edhe më tepër për shkak të nivelit të lartë të varfërisë, problematikave lidhur me infrastrukturën, urbanizimin, shfrytëzimi jo efikas i burimeve natyrore, si dhe mungesa e burimeve materiale dhe niveli i ulët i koordinimit midis agjencive që kanë përgjegjësi ligjore në emergjencat civile, në kushtet ku sistemit të edukimit dhe

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*
« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹ http://www.klsh.org.al/web/02_parandalimi_mbrojtja_gadishmeria_4695.pdf. (2018).

informimit i mungon përfshirja e nevojshme dhe influenca në institucionet shtetërore dhe në popullsinë shqiptare në tërësi². Për rrjedhojë Shqipëria konsiderohet si shtet me probabilitet të lartë të goditjes nga një shumëllojshmëri fatkeqësish, e për rrjedhojë edhe humbjet ekonomike konsiderohet të jenë në nivele shumë të larta³. Një gjë e tillë, mendojmë se duhet të shtynte legjislatorin për miratimin e një kuadri ligjor të plotë në drejtim të mbrojtjes civile dhe masave që duhet të merreshin në kuadër të reduktimit të pasojave rrjedhojë të tyre.

Ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, hodhi bazat kryesisht në fushën e planifikimit dhe përbalimit të emergjencave civile, por nuk ka një përcaktim të qartë në përmbajtje të tij lidhur me elemente të tilla si: zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë, paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistenca ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi, si dhe inspektimi. Këto ishin edhe arsyt bazë për rregullimin e të cilave u ndërmor nisma për miratimin e një ligji të ri në fushën e mbrojtjes civile. Një ndërhyrje e tillë kishte si qëllim integrimin e prioritetëve, qëllimeve dhe objektivave të *Kuadrit Sendai për zvogëlimin e rrezikut të fatkeqësive*, në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet hartimit dhe implementimit të strategjisë kombëtare dhe të strategjiave vendore për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, vlerësimeve të rrezikut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile në nivelin qendror, qarku dhe vendor, si dhe masave të tjera⁴. Njëkohësisht e domosdoshme konsiderohej edhe transpozimi i Direktivave dhe vendimeve të BE-së, të miratuara në kuadër të legjislacionit evropian në fushën e zvogëlimin të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile të cilat kanë nevojë për përafrim.

Megjithatë, një sërë problematikash u listuan edhe pas hyrjes në fuqi dhe zbatimit të ligjit nr. 8756/2001, të tilla si nevoja për rritje të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të DPEC-së, nevoja e ngritjes së një sistemi funksional dhe të integruar për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe nevoja për anëtarësimin sa më të shpejtë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian. Duke qenë se Shqipëria renditet në dhjetë vendet e botës me risk më të lartë ekonomik nga fatkeqësitë e shumfishta: 86% e territorit të saj ku prodhohet 88.5% e GDP-së janë të ekspozuara ndaj dy ose më shumë rreziqeve⁵.

Po ashtu, sipas Raportit të Rrezikut Botëror, 2016, të botuar nga Instituti për Mjedisin dhe Sigurinë Njerëzore i Universitetit të Kombeve të Bashkuara, që ka përllogaritur indeksin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2016 në 171 vende të botës, bazuar në ekspozimin, prekshmërinë dhe kapacitetet përbaluese dhe atyre përshtatëse, Shqipëria renditet në vendin e parë në Evropë dhe në vendin e 40-të në botë, gjë që vjen si pasojë e rritjes vit pas viti të prekshmërisë së saj nga fatkeqësitë natyrore, rritjes së ndjeshmërisë ndaj tyre, pamjaftueshmërisë së kapaciteteve përbaluese dhe atyre përshtatëse. Në këto kushte ligjvënës, në 2019 pa të arsyeshme miratimin e një ligji të ri, i cili do të përmbushte një sërë objektivash dhe standardesh të cilat mungonin në

² Foto Duro, “Menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri”, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Tiranë 2015, fq. 2.

³ Në shkallë botërore, Shqipëria zë vendin e 41-të për rrezikun ndaj rrëqitjeve të dheut, të 43-in për tërmetet dhe të 58 për thatësitrat. Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore për Shqipërinë janë: gjeologjike (tërmete, rrëqitje dheu, shkëmbinjsh); hidrometeorologjike (përmytje, shira të rrëmbyer, thatësira, stuhi bore, ortekë apo bllokim nga bora, stuhi ere); bio-fizike (zjarre në pyje, epidemi) ndërsa ato të shkaktuara nga njeriu konsistojnë në: shpërthim digash, përmytje e fatkeqësi teknologjike. Shqipëria ndeshet gjithashtu me një numër problemesh mjedisore, të cilave u shtohet ekzistenca ende e zonave me rrezik të lartë për shkak të ndotjes (hot-spot).

⁴ Për më tepër: <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/51231>.

⁵ Po aty.

përmbajtje të ligjit 8756/2001.

Miratimi i ligjit 45/2019 kishte si qëllim të plotësonte të gjitha mangësitë e ligjit të mëparshëm, duke u mbështetur kryesisht në një sërë objektivash, të tilla si:

- përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga platformat globale, strategjitë, konventat, iniciativat, marrëveshjet dhe dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, etj.;

- rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe atij ndërkombëtar;

- krijimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila, krahasuar me organizimin aktual të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, do të ketë kapacitete më të mëdha administrative, teknike dhe financiare, sikurse autoritet, përgjegjësi dhe kompetenca më të gjera;

- rritjen e rolit të prefektit të qarkut dhe të bashkive në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, dhe për mbrojtjen civile;

- përmirësimin thelbësor të edukimit dhe trajnimit;

- rritjen e rolit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit, alarmit, krijimit dhe të ruajtjes së bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në menaxhimin e fatkeqësive;

- zbatimin e masave të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në nivelin qendror dhe vendor sikurse në subjektet private;

- marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore;

- uljen e numrit të kërkesave për dëmshpërblim si pasojë e menaxhimit më të mirë dhe efikas të situatave emergjente dhe pakësim i shpenzimeve në përgjithësi për menaxhimin e fatkeqësive;

- uljen e kostove gjatë fazës së përgjigjes ndaj fatkeqësive si rezultat i implementimit të masave të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe atyre zbutëse dhe parandaluese ndaj fatkeqësive; si dhe,

- planifikimin buxhetor 2-4% të totalit të buxhetit vjetor për të ministrive dhe bashkive për zvogëlimin e rrezikut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile⁶.

Plotësimi i objektivave të tilla dhe efikasiteti i ligjit të ri nr. 45/2019 do të shërbente si një pikë e rëndësishme për të bërë vlerësimin lidhur me efektin në zbatueshmëri të këtij ligji dhe “aftësinë e tij” për të parandaluar apo minimizuar riskun pasojë të fatkeqësive natyrore apo ato të shkaktuara nga njeriu.

2. Problematikat në zbatueshmëri të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”

Pavarësisht nga vullneti i mirë i ligjvënësit për miratimin e një kuadri të ri ligjor, i cili do të përmbushte objektivat e cituara edhe në paragrafët më sipër, në fakt ka një sërë paqartësish dhe problematikash⁷. Mënyra e formulimit të parashikimeve, si dhe zgjidhjet të cilat priteshin të ofroheshin në kuadër të përballimit të emergjencave civile dhe fatkeqësive qoftë natyrore apo edhe ato të shkaktuara nga njeriu, nuk rezultojnë të jenë efikase në kuadër të zbatimit dhe zgjidhjes së problematikave që mund të krijohen apo

⁶ Për më tepër: <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/51231>. (2019).

⁷ Për më tepër: <https://faktoje.al/emergjencat-civile-buxhet-i-varfer-borxhe-dhe-ligji-i-ri/>. (2020).

lindin në të ardhmen. Struktura e kënaqshme e ligjit në asnjë rast nuk justifikon mungesën e parashikimit të zgjidhjeve efektive për problematikat e krijuara rast pas rasti. Përafrimi me kuadrin ligjor të BE-së konsiderohet vërtetë arritje, në kushtet ku shteti shqiptar ka marrë përsipër një detyrë të tillë, megjithatë duhet të mbahet në konsideratë edhe nevoja për tejkalimin e parashikimeve formale të direktivave apo *acquis* të BE-së në përgjithësi, me qëllim rritjen e nivelit të efikasitetit të ligjit të brendshëm dhe parashikimit në përmbajtje të tij të gjitha elementeve të nevojshme për zbatimin eficient të tij. Vetë neni 2 i ligjit nr. 45/2019 parashikon si mision të tij “krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive...”. Një gjë e tillë nuk mund të realizohet vetëm duke përmendur institucionet përgjegjëse në mënyrë deklarative apo duke krijuar strategji dhe plane abstrakte veprimi, por duhet parë përtej, në drejtim të mjeteve dhe veprimeve konkrete që duhet të ndërmerren me qëllim arritjen e këtyre objektivave në çdo rast specifik.

Në ligjin në fuqi nr. 45/2019, gjendja e fatkeqësisë natyrore parashikohet të vendoset si për rastet e fatkeqësive natyrore, ashtu edhe për fatkeqësi të tjera, të ndryshme nga të parat⁸. Pyetja që natyrshëm mund të shtrohet në një rast të tillë, ka të bëjë me: A mundët që në kuadër të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore të përfshihen edhe fatkeqësi të tjera të tilla si: aksidentet teknologjike, rrugore, lufta apo gjendjet e emergjencës? Lidhur me sa më sipër jemi të mendimit se, për shkak të karakterit që shfaqin secili nga rastet e përmendura më sipër do të konsiderohej efektive ndarja në dy grupe, me qëllim shmangien e problematikave në zbatim të dispozitave ligjore të cilat i referohen vetëm rasteve të fatkeqësive natyrore, si dhe në kuadër të terminologjisë së përdorur, fatkeqësitë e tjera nuk përfshihen në grupin e fatkeqësive që kanë burim natyrën, të cilat dallohen për shkallën e lartë të paparashikueshmërisë në ndodhjen e tyre. Një parashikim më specifik/konkret mund të ishte bërë duke mbajtur në konsideratë parashikimin e dispozitave konkrete të *Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë*⁹.

Kreu II i ligjit nr. 45/2019 ka si qëllim të trajtojë zvogëlimin dhe vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë në përgjithësi. Rregullat e vendosura janë me karakter përshkrues dhe përgjithësues. Në asnjë rast ligji në përmbajtje të tij nuk bën një kategorizim të llojit të fatkeqësive dhe as nuk përcakton rregulla specifike për rregullimin apo shmangien e pasojave që kanë ardhur apo mund të vijnë prej tij (pasoja potenciale). Një gjë e tillë mund të konsiderohet edhe si problematika më e madhe e ligjit në fuqi. Secila nga fatkeqësitë ka elementet përkatëse specifike të saj, që e dallojnë nga të tjerat, qoftë në kuadër të pasojave që shkaktohen, qoftë lidhur me mënyrën efikase të përballimit të tyre. Në këtë kuadër ligji duhet të ishte më i detajuar në specifikimin e tyre dhe rregullave/masave përkatëse që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse sipas rastit. Në mungesë të një parashikimi të tillë, Këshilli i Ministrave u detyrua të miratonte aktin normativ nr. 9/2019 “Për përballimin e fatkeqësive natyrore”, i cili doli me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të fatkeqësive të tjera që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile dhe të autoriteteve të tjera shtetërore dhe për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁸ Pika 12, neni 3, ligji nr. 45/2019.

⁹ Masat e Jashtëzakonshme, Pjesa e Gjashtëmbëdhjetë, nenet 170-176, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

për mbrojtjen civile. Nëse efektiviteti dhe masat e parashikuara në ligjin nr. 45/2019 do të ishin të plota do të shmangej nevoja për një rregullim të posaçëm me një akt normativ. Pavarësisht se në përputhje me teknikën legjislativë ligjet nuk duhet të jenë shumë të detajuara me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta të tyre, në rastin konkret një rregullim i tillë duhet të bëhet në ligj, duke eliminuar në këtë mënyrë vendimmarrjet e shpejta dhe të paanalizuara mirë. Miratimi brenda një periudhe të shkurtër kohe të ligjit dhe aktit normativ, duhet të shërbejë si shqetësim për ligjvënësit gjatë analizës së efikasitetit dhe efikasitetit të kuadrit ligjor në fuqi. Tërmeti i nëntorit të 2019 e gjeti të papërgatitur shtetin Shqiptar, jo vetëm nga ana e burimeve materiale por gjithashtu edhe në kuadër të mungesës së parashikimeve konkrete mbi veprimet dhe masat që duhet të ndërmerreshin në këtë kuadër, me qëllim uljen e pasojave të shkaktuara në burime njerëzore dhe materiale.

Ligji nr. 45/2019 në nenin 16 të tij rendit në mënyrë të plotë institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile. Praktikisht listohen 9 organe/institucione kompetente të cilat veprojnë në rast të një fatkeqësie dhe dhënies së ndihmës/mbrojtjes përkatëse. Duhet të mbahet në konsideratë se, një numër i lartë institucioneve dhe strukturash e vështirësojnë zbatimin e ligjit dhe ngadalësojnë punën dhe veprimtarinë e atyre institucioneve që realisht kanë peshën më të madhe për të vepruar. Një gjë e tillë edhe në kushtet ku në seksionin III, të kreut III, të ligjit nr. 45/2019 njëkohësisht parashikohen ndër të tjera edhe strukturat operacionale të mbrojtjes civile, të cilat njëkohësisht kanë detyrimin për të vepruar në raste fatkeqësish, me qëllim menaxhimin e këtyre të fundit. Detajimi i ligjit në fuqi lidhur me institucionet dhe strukturat përgjegjëse për mbrojtjen civile shkon më tej duke parashikuar ngritjen e sektorëve përgjegjës për mbrojtjen civile, përbërja dhe detyrat e të cilëve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Si rregull, në përputhje me parashikimin e ligjit nr. 9000/2003¹⁰ dhe ligjit nr. 90/2012¹¹ struktura dhe organika e ministrive dhe institucioneve të varësisë miratohen me urdhër të kryeministrit.

Megjithatë pavarësisht nga parashikimi i pikës 3 të nenit 7, të ligjit nr. 9000/2003, në kuadër të parimit "*lex specialis derogat generalis*" dhe "*lex posteriori derogat legi priori*", përbërja e sektorëve të mbrojtjes civile të çdo ministrie të linjës duhet të gjejë rregullim në përmbajtje të një vendimi të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Jemi të mendimit se miratimi i strukturës së secilës prej ministrive të linjës të bëhet nga kryeministri, qoftë në kuadër të ndjekjes së praktikës së deritanishme të përcaktuar nga ligji i përgjithshëm, qoftë me qëllim lehtësimin e punës së Këshillit të Ministrave, i cili ka detyrimin sipas nenit 118 të *Kushtetutës*, në përputhje me dispozitën autorizuese të ligjit nr. 45/2019 të përcaktojë përbërjen dhe detyrat e çdo sektori, pranë çdo ministrie përgjegjëse, në kushtet ku një delegim i mundshëm tek kryeministri ose tek ministrat përgjegjës konsiderohet i pamundur pasi bie ndesh me parashikimin e pikës 3 të nenit 118 të *Kushtetutës*, sipas së cilës "organi i ngarkuar nga ligji për nxjerrjen e akteve nënligjore, nuk mund të delegojë kompetencën e tij një organi tjetër".

Në vijim të sa më sipër, problematike paraqitet edhe ngritja e Komitetit të Mbrojtjes Civile si: "*organi më i lartë, i përhershëm, përgjegjës për zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile*"¹². Nga një parashikim i tillë vështirë se mund të përcaktohet lloji/tipi i organit që do të krijohet, si dhe nuk mund të

¹⁰ Ligji nr. 9000/2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".

¹¹ Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike".

¹² Neni 20, pika 1, ligji nr. 45/2019.

vendoset një emërtim përkatës në përputhje me parashikimin e nenit 4 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Pavarësisht se pika 3 e nenit 20 të ligjit nr. 45/2019 parashikon se organizimi dhe funksionimi i KMC-së rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ligji në vetvete duhet të jepte një indicie mbi llojin e organit të përhershëm që do të krijohet, pa e lënë në diskrecion të Këshillit të Ministrave një çështje të tillë, si dhe me qëllim shmangien e paqartësive të mundshme në zbatimin e kësaj dispozite në momentin e ndërmarrjes së nismës nga ana e ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile. Për më tepër është e paqartë pse krijohet një komitet/strukturë e tillë, në kushtet ku neni 19 i ligjit nr. 45/2019 parashikon se pas çdo rasti të shpalljes së gjendjes së fatkeqësive natyrore, Këshilli i Ministrave krijon Komitetin Ndërmintor të Emergjencave Civile. Fare mirë KMC-ja mund të kryente edhe detyrat e KNEC-së, në rast të ndodhjes së një fatkeqësie natyrore apo të shkaktuar nga njeriu, megjithatë ligjvënasi ka konsideruar si më efektive ngritjen e dy komiteteve, njëri i përkohshëm dhe tjetri i përhershëm, pa përcaktuar në relacionin e ligjit arsyen për një parashikim të tillë, apo efikasitetin që do të sillte ngritja e një strukture të dyfishtë, në thelb të së cilave qëndron zbatimi i politikave dhe marrja e masave konkrete në rast të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Problematiche në përmbajtje të ligjit nr. 45/2019 është edhe mënyra e përcaktimit të detyrave të institucioneve përgjegjëse dhe titullarëve të tyre. Për shembull detyrimet e përcaktuara për Drejtorin e Përgjithshëm të AKMC-së¹³, të cilat për shkak të detyrës së rëndësishme duhet të parashikoheshin në mënyrë të qartë dhe konkrete, pasi nga mënyra e formulimit lënë në pikëpyetje mënyrën e ekzekutimit në praktikë të tyre. Parashikime të tilla si “bashkëpunon me bashkitë”, “siguron funksionimin e sistemit të monitorimit”, “merr masat e nevojshme”, “koordinon forcat operacionale”, etj., janë deklarative dhe nuk parashikojnë në mënyrë specifike veprimet dhe masat konkrete që duhet të ndërmerren. Për shkak të rëndësisë dhe pasojave që gjendja e fatkeqësisë natyrore sjell, secila nga detyrat e listuara në ligj duhet të detajoheshin me qëllim efikasitetin në zbatim të tyre, duke mos e lënë në dorë të titullarit zbatimin apo jo të detyrimeve të njohura nga ligji. E njëjta problematikë shfaqet edhe në nenin 30 të ligjit nr. 45/2019, ku përcaktohen detyrat e bashkive në mënyrë deklarative, pa bërë specifikime dhe detajime për asnjërën nga këto detyra.

Një gjë e tillë e bën ligjin të vështirë për t’u zbatuar, në rastet ku edhe nëse nuk mungon vullneti për t’i realizuar ato, mungon qartësia në formulim dhe dhënia e detajeve shtesë mbi mënyrën e realizimit të këtyre detyrave, sidomos në rastin kur synohen të përcaktohen detyra për strukturat operacionale të mbrojtjes civile, si për shembull për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë¹⁴, apo edhe për Policinë e Shtetit¹⁵, pasi nga përmbajtja e dispozitës konkrete nuk specifikohet as struktura as mënyra e organizimit të saj për realizimin e detyrave të saj në operacionet e shpëtimit dhe të lehtësimit. I njëjti sugjerim blen për të gjithë përmbajtjen e ligjit në tërësi të tij, i cili për shkak të çështjeve me rëndësi që trajton, duhet të përmbante në tërësi të tij parashikime konkrete, të detajuara dhe shteruese me qëllim orientimin e saktë të strukturave përgjegjëse lidhur me detyrat dhe veprimet konkrete që duhet të ndërmerren prej tyre në funksion të dhënies së ndihmës dhe zgjidhjes së pasojave të shkaktuara nga rasti specifik i fatkeqësisë së ndodhur, pavarësisht nga natyra e saj.

¹³ Neni 24, i ligjit nr. 45/2019.

¹⁴ Neni 34, i ligjit nr. 45/2019.

¹⁵ Neni 35, i ligjit nr. 45/2019.

Paqartësi për aplikimin në praktikë përbën edhe neni 38 i ligjit nr. 45/2019, në të cilin parashikohet mundësia për dhënien e kontributit vullnetar të çdo shtetasi të Republikës së Shqipërisë në menaxhimin e fatkeqësive dhe zvogëlimin e pasojave të tyre. Në përmbajtje të këtij neni mungon qoftë mënyra, qoftë organizimi në praktikë i një qëllimi të tillë. Problematika në këtë rast i mëshon faktit nëse forcat vullnetare janë të afta objektivisht të ndihmojnë në menaxhimin e fatkeqësive, në kushtet ku u mungon një specializim përkatës lidhur me sa më sipër? Trajnimi i secilit prej vullnetarëve sipas rastit kërkon kohë, çka realisht mungon në rastin e ndodhjes së një fatkeqësie natyrore, ku masat dhe veprimet duhet të merren në mënyrë të menjëhershme. Përcaktimi në pikën 3 të nenit 38 se trajtimi i vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, e bën edhe më të paqartë përmbajtjen që do të ketë vendimi dhe çfarë përfshihet në kuadër të termit “*trajtim*”.

Ligji nr. 45/2019 parashikon njëkohësisht edhe mundësinë për vendosjen dhe zbatimin e masave të jashtëzakonshme për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë, për institucionet publike, për strukturat operationale, për subjektet private dhe për shtetasit. Të gjitha masat e parashikuara janë me natyrë deklarative, diskrecionale dhe në përmbajtje të tyre mungon një parashikim i qartë se cilat masa merren për secilin prej rasteve të fatkeqësive natyrore. Përdorimi i foljes modale “*mund të vendosen masa të jashtëzakonshme*” pa e specifikuar në mënyrë objektive *kur* vendosen, *si* vendosen, në *çfarë mënyrë* merren këto masa, e bën të paqartë mënyrën e zbatimit në tërësi të nenit 42 të ligjit nr. 45/2019. Një nen i vetëm për përcaktimin e masave të tilla, konsiderohet i pamjaftueshëm për të ndarë punën dhe për të ndërmarrë veprimet konkrete nga institucionet apo strukturat përgjegjëse. Për më tepër, nga përmbajtja e këtij neni ngelet e paqartë mënyra e vendosjes së detyrimeve për subjektet private dhe shtetasit, si dhe organi që ka kompetencë për realizimin e një veprimi të tillë, duke mbajtur në konsideratë se neni 175 i *Kushtetutës* parashikon në mënyrë konkrete dhe të qartë të drejtat të cilat mund të kufizohen në rast të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore¹⁶.

Përmbajtja e ligjit nr. 45/2019 në tërësi të tij parashikon rregulla të përgjithshme dhe detyrime abstrakte, pa specifikuar mënyrën e zbatimit të tyre, afatin, dhe me raste specifike as organin/institucionin përgjegjës për miratimin e tyre. Një gjë e tillë na krijon përshtypjen se ligji përtej formulimeve të bukura në funksion të mbrojtjes dhe parandalimit të pasojave të fatkeqësive natyrore, i lë në pikëpyetje secilin nga institucionet përgjegjëse për veprimet konkrete që ata duhet të ndërmarrin sipas rastit, apo edhe afatin kohor brenda të cilit duhet të veprojnë. Për shembull shkronja “b” e pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr. 45/2019, ku ligji nuk specifikon në asnjë rast afatin brenda të cilit do të realizohet përditësimi i dokumentit të vlerësimit të riskut, neni 44 i ligjit nr. 45/2019 i cili nuk parashikon as afatin as mënyrën e informimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, etj. E paqartë ngelet edhe procedura për aktivizimin e alarmit nga AKMC-ja, si dhe përmbajtja e togfjalëshit “*për marrjen e masave të menjëhershme*”, në kushtet ku neni 50 i ligjit nr. 45/2019 nuk përcakton në mënyrë të detajuar/specifike elemente objektive për identifikimin e tyre.

Kreu VII i ligjit nr. 45/2019 ka si synim të rregullojë bashkëpunimin ndërkombëtar

¹⁶ Për më tepër, pika 2 e nenit 175 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: “Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51”.

në rastet kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Edhe në këtë rast ligjvënësi nuk ka përcaktuar në mënyrë konkrete cilat *dokumente të tjera* iu referohet në pikën 1 të nenit 53 dhe që kanë në thelb të tyre bashkëpunimin ndërkombëtar. Edhe dispozitat e tjera të ligjit nr. 45/2019 kanë karakter deklarativ dhe ngelen në nivel narrativ. Për shkak të kësaj problematike në 16 dhjetor të 2019-s u miratua një akt normativ me fuqinë e ligjit, qëllimi i të cilit ishte përcaktimi i procedurave konkrete mbi mënyrën e veprimit të institucioneve përgjegjëse për përballimin e fatkeqësive natyrore dhe të tjera¹⁷, duke pasur në fokus pasojat e ardhura nga tërmeti i nëntorit dhe nevojën për gjetjen e një zgjidhjeje adekuatë të problematikës së krijuar.

Në këtë kuadër u përcaktuan në mënyrë të qartë subjektet përfituese, autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore, detyrat kryesore të tyre, si dhe mënyrat konkrete nëpërmjet të cilat do të përdoreshin për dhënien zgjidhje të problematikave të krijuara në praktikë. Këto parashikime mungonin në përmbajtje të ligjit nr. 45/2019 ose mënyra e trajtimit të tyre ngelej në terma të përgjithshëm dhe abstraktë, pa bërë në asnjë rast specifikimet konkrete dhe të posaçme mbi nevojat dhe mënyrat konkrete mbi bazën e të cilave do të hidheshin themelet për zgjidhjen e problematikave të krijuara si pasojë e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera. Megjithatë edhe ky akt normativ u hartua kryesisht duke pasur në fokus dhënien e zgjidhjeve të problematikave që kishin lindur tashmë si pasojë e tërmetit, dhe mënyra e ndërtimit dhe strukturës së tij i përshtatet pikërisht përballimit të pasojave që burojnë si pasojë e këtij fenomeni. Duhet të mbahet në konsideratë se tërmetet nuk janë fatkeqësia e vetme natyrore e cila rrezikon Shqipërinë, fakt ky i evidentuar për shkak të pozitës gjeografike në të cilën ndodhet vendi jonë. Për rrjedhojë, është me pikëpyetje mundësia se sa këto parashikime mund të aplikohen në rastin e ndodhjes së fatkeqësie tjetër, pavarësisht nga lloji i saj.

3. Konkluzione

- Nevoja për mbrojtje nga emergjencat civile passjell nevojën për pasjen e një rregullimi ligjor konkret, të plotë, të qartë dhe shterues, i cili të jetë pararendës i çdo situatë të mundshme fatkeqësie, me qëllim minimizimin dhe kur është e mundur parandalimin e pasojave që vijnë prej tyre.

- Detyrimi për miratimin e akteve të tjera gjatë kohës së ndodhjes së fatkeqësisë, mungesa e ndarjes së saktë të kompetencave dhe detyrave, janë rrjedhojë e nevojës për përmirësim në vazhdim të kuadrit ligjor, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe qartësisht të përcaktojë reagimin që duhet të bëhet nga strukturat kompetente, cilat prej tyre duhet të veprojnë më shpejt, etj.

- Mbështetja e dhënë nga aktorët ndërkombëtarë, pavarësisht rezultateve pozitive të saj, nuk justifikon nevojën për një rregullim të brendshëm, i cili duhet të jetë i plotë dhe t'iu vijë në ndihmë të gjithë shtetasve të një shteti në rastin e përballjes me një fatkeqësi të caktuar.

- Shqipëria konsiderohet si shtet me probabilitet të lartë të goditjes nga një shumëllojshmëri fatkeqësish, e për rrjedhojë edhe humbjet ekonomike konsiderohet të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹⁷ Ligji nr. 97/2019 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

jenë në nivele shumë të larta. Për një periudhë kohe nga 1980/2010 janë regjistruar 23 fatkeqësi, të tilla si: përmbytje, katër tërmete dhe tre goditje nga temperatura ekstreme.

- Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8756/2001, u evidentuan një sërë problematikash, të tilla si nevoja për rritje të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të DPEC-së, nevoja e ngritjes së një sistemi funksional dhe të integruar për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, etj.

- Miratimi i ligjit 45/2019 kishte si qëllim të plotësonte të gjitha mangësitë e ligjit të mëparshëm, duke u mbështetur kryesisht në një sërë objektivash, ku më kryesori është përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga platformat globale, strategjitë, konventat, iniciativat, marrëveshjet dhe dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, etj.

- Pavarësisht nga vullneti i mirë i ligjvënësit për miratimin e një kuadri të ri ligjor, i cili do të përmbushte objektivat e cituara edhe në paragrafët më sipër, në fakt ka një sërë paqartësish dhe problematikash. Nevoja për miratimin e një akti normativ, për zgjidhjen e pasojave të ardhura nga tërmeti i 2019, nxori në pah detyrimin e shtetit shqiptar për përmirësim të kuadrit ligjor bazë në fuqi, me qëllim përballimin në mënyrën e duhur të fatkeqësive të mundshme në të ardhmen.

Bibliografia

1. Foto Duro, "Menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri", në: *Konferenca kombëtare, Menaxhimi i Emergjencave Civile në Shqipëri* (Tiranë: IDM, 2015).
2. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar* (Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare, 2016).
3. Ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar.
4. Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile".
5. Ligji nr. 97/2019 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore".
6. Ligji nr. 9000/2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".
7. Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike".
8. <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/51231>. (2019).
9. http://www.klsh.org.al/web/02_parandalimi_mbrojtja_gadishmeria_4695.pdf. (2018).
10. <https://faktoje.al/emergjencat-civile-buxhet-i-varfer-borxhe-dhe-ligji-i-ri/>. (2020).



Shënim i redaktorit

Fjala "risk", e përdorur nga autorët në këtë shkrim, është zëvendësuar me fjalën "rrezik". Nuk është bërë kjo gjë, vetëm në rast citimi të drejtpërdrejtë të një burimi. Gjej me vend të sqaroj, se ky shënim po vendoset për shkak se autorët, kanë përdorur një gjuhë e stil të shkruari korrekt. Për më tepër, në lidhje me këtë term, mund të lexohet në fund të vëllimit të parë të botimit të punimeve të kësaj konference.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Aksesi në drejtësi, në rastet e emergjencave civile



■ **MSc. Ina HASANKOLLI**

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve
inahasankolli@yahoo.com



■ **MSc. Enea SHEQI**

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
enea.sheqi@yahoo.com

Abstrakt

Emergjencat civile janë situata të tilla të cilat shkaktojnë pasoja tepër të rënda për popullsinë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin në të cilin ne jetojmë. Operacionet e ndërhyrjeve dhe masat mbrojtëse të ndërmarra nga shtetet janë plane dhe strategji të cilat mund të prekin dhe cenojnë disa të drejta themelore të njeriut. Një ndër të drejtat që mund të preket është dhe garancia që kanë individët për t'ju drejtuar gjykatave apo organeve të tjera të administratës për një çështje të caktuar. Me anë të kësaj të drejte individët kanë mundësi që të mbrojnë, ndalojnë apo të rivendosin të drejtat e tyre të shkelura. Kjo e drejtë quhet ndryshe edhe si akses në drejtësi. Punimi në thelb do të bëjë një analizë të së drejtës për akses në drejtësi në rastet e emergjencave civile, pengesave që mund të hasen dhe qasjet që duhen dhënë në drejtim të garantimit të së drejtave themelore të njeriut. Gjithashtu në këtë punim do të bëhet një analizë e jurisprudencës ndërkombëtare lidhur me aksesin në drejtësi në rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme.

Fjalëkyçe:

aksesi në drejtësi, emergjencë civile, parandalim, të drejta themelore.

1. Hyrje

Gjendjet e emergjencave civile janë gjendje të cilat shkaktojnë probleme të mëdha jo vetëm ekonomike, sociale, jetike, por edhe ligjore. Në raste të tilla jemi përpara balancave të shumë të drejtave dhe lirive, të cilat nevojitet një studim dhe analizë e mirëfilltë, në mënyrë që të mos cenohen në thelbin e tyre. Një ndër këto të drejta është dhe ajo e aksesit në drejtësi, e cila nevojitet që të bëhen përpjekje të rëndësishme për ta garantuar atë.

Në terminologjinë juridike jemi ndeshur shpesh herë me termin “akses në drejtësi”, por çfarë nënkupton realisht termi “akses në drejtësi”? Aksesit në drejtësi shfaqet edhe si një e drejtë, por në të njëjtën kohë edhe si një garanci procedurale në dorën e individit. Në Shqipëri kjo e drejtë buron që nga kushtetuta, ku në nenin 42 të saj përcaktohet se: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*¹. Kështu aksesit në drejtësi shihet si një aftësi e njerëzve për të arritur zgjidhjen për probleme të caktuara juridike nëpërmjet institucioneve të drejtësisë.² Pra jo vetëm mbrojtja e të drejtave të tyre themelore mund të kërkohet me anë të aksesit në drejtësi, por edhe çdo interes tjetër legjitim mund të adresohet në gjykata të pavarura,

¹ Neni 42, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

² Joniada Musaraj, *Çështje të aksesit në drejtësi dhe të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përvoja shqiptare në vështrim të krahasuar*. Doktoratura, Unitir, Tiranë, 2016, fq. 72.

të paanshme, të caktuara me ligj dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Në vetvete aksesin në drejtësi është një garanci kushtetuese që i mundëson individit të mbrojnë të drejtat e shkelura. Aksesin në drejtësi është një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës dhe rregullimin e tij e gjen në aktet kryesore juridike të një shteti, por edhe në marrëveshjet ndërkombëtare, konventat, traktatet, etj.³ Nëse do t'i referoheshim *Konventës evropiane për të Drejtat e Njeriut*, aksesin në drejtësi është i mishëruar brenda së drejtës për një proces të rregullt ligjor⁴, ku çdo shtet duhet që t'ju garantoj popullsisë së tij të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës, duke funksionuar kështu si shtet i së drejtës. Kjo e drejtë shfaqet njëkohësisht edhe si një detyrim që kanë shtetet për t'ia garantuar mundësinë e aksesit në drejtësi individëve, duke mos e kufizuar atë nëpërmjet akteve të ndryshme. A është kjo liri absolute? Këtu do të ndalet edhe punimi ynë në vijim, ku në rastet e emergjencave civile, vihen re disa karakteristika, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e kësaj të drejte në mënyrë të plotë dhe me efektivitet.

Aksesin në drejtësi nuk duhet kuptuar vetëm në të drejtën për t'ju drejtuar një gjykate të paanshme, të pavarur dhe të caktuar me ligj, por mundëson të drejtën që kanë individët për t'ju drejtuar çdo organi shtetëror, me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre legjitimë apo të drejtave të tjera. Kështu të njëjtat garanci që ofrohen nga mundësia për t'ju drejtuar gjykatës duhet që t'i ofrohen individëve dhe në rastet kur ata i drejtohen organeve dhe institucioneve shtetërore për zgjidhjet e problemeve të tyre. Aksesin në drejtësi, në të njëjtën kohë shoqërohet edhe me disa karakteristika të tjera, të cilat janë thelbësore me qëllim mbarëvajtjen e procesit të rregullt ligjor, siç është transparenca, publiciteti, afati i arsyeshëm kohor, etj.⁵

Ndërsa deri më tani kemi folur për aksesin në drejtësi, një nga përkufizimet që duhet dhënë është dhe ai i emergjencave civile. Emergjencë civile është situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin⁶.

Në termin emergjencë civile përfshihen fatkeqësitë natyrore, ku në të përfshihet gjithashtu edhe fatkeqësitë e shkaktuara nga ana e sëmundjeve infektive. Pra, fatkeqësi natyrore janë fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, *sëmundjet infektive masive* dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin⁷. Koha kur pandemia COVID-19 kaploi gjithë botën duke përfshirë edhe Shqipërinë nuk është e largët, ku dhe u shoqërua me një sërë masash të ndërmarra nga ana e shteteve.

Në Shqipëri një nga gjendjet e fatkeqësive natyrore të vendosura, ka qenë dhe ajo e datës 24.3.2020 me vendimin nr. 243 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore". Kjo gjendje u diktua nga situata e shkaktuar nga epidemia e COVID-19. Pavarësisht se nga ky akt nuk është prekur neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbi aksesin në drejtësi, me anë të akteve të tjera kjo e drejtë është mundësuar në disa forma

³ Koalicioni "Drejtësi për të gjithë", *Aksesin në drejtësi i qytetarëve: Garancitë e Reformës në Drejtësi*, Fletëpalosje, fq.1.

⁴ Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁵ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë- Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, *Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë*, Korrik, 2015, fq.27.

⁶ Neni 3 pika 6 e Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile".

⁷ Neni 3 pika 9 e Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile".

të veçanta. Po ashtu gjatë kësaj kohe janë ndërmarrë disa akte normative nga ana e Këshillit të Ministrave të cilat kanë udhëzuar marrjen e masave gjatë kohës së pandemisë mbi veprimtarinë gjyqësore⁸. Nga analiza që mund t'i bëhet këtyre akteve normative vihet re se në disa aspekte preket apo transformohet edhe e drejta për akses në drejtësi, për të cilën do të flasim në vijim.

2. Kufizimi i aksesit në drejtësi

Jo të gjitha të drejtat kushtetuese janë absolute, ka prej tyre që janë të kufizuara, ku ndër to mund të përmendim të drejtën për aksesin në drejtësi. Pyetja që lind është se si dhe kur mund që të kufizohet kjo e drejtë? Për të analizuar kufizimin e së drejtës për aksesin në drejtësi duhet që t'i referohemi kushtetutës⁹, ku përcaktohet se kufizimet e të drejtave dhe lirive mund të vendosen me ligj, për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Këto kufizime duhet që kurdoherë të jenë në raport me gjendjen që e ka diktuar atë. Ato as nuk duhet që të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe as nuk mundet që të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në *Konventën evropiane të të Drejtave të Njeriut*.

Mënyrat e kufizimit të aksesit në drejtësi mund të jenë të ndryshme, ka nga të cilat vendosin mungesën e juridiksionit apo fillimin e juridiksionit në një nivel të caktuar gjykatë mbi kategori të ndryshme të çështjeve që ato trajtojnë. Disa të tjera vendosin kufizime mbi të drejtën e apelimit mbi disa mosmarrëveshje të caktuara juridike.¹⁰ Mekanizmi i mohimit të aksesit në drejtësi duhet që t'i përgjigjet qëllimit të ligjshëm nga njëra anë dhe raportit të proporcionalitetit nga ana tjetër. Ky detyrim rrjedh nga vetë natyra e kësaj të drejte, si një e drejtë efektive dhe joformale¹¹.

Duke ju rikthyer Kushtetutës në pjesën e 16-të të saj është përcaktuar procedura dhe të drejtat që mund të kufizohen gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme. Kështu këto masa mund të merren gjatë gjendjes së luftës, gjendjes së fatkeqësisë natyrore, apo gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe rrinë në fuqi për sa kohë qëndron dhe kjo gjendje¹². Parimet e veprimtarisë së organeve publike dhe shkalla e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, përcaktohen me ligj¹³.

Nga leximi që i bëhet Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë vihet re se kjo e drejtë nuk mund që të cenohet gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, ndërsa gjatë kushteve të fatkeqësisë natyrore kjo e drejtë mund që të cenohet në formën dhe procedurat e përcaktuara në kushtetutë¹⁴.

Në vendimin nr. 243 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” datë 24.3.2020 u përcaktua dhe se cilat ishin të drejtat që do të kufizoheshin gjatë periudhës së pandemisë, ku përkatësisht u kufizuan nenet 37, 38, 41, pika 4, 49 dhe 51 të *Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë*¹⁵, duke dalë garant në të njëjtën kohë që të respektojë të drejtën për akses

⁸ Akt Normativ Nr.9, Datë 25.3.2020 Për Marrjen E Masave Të Veçanta Në Fushën E Veprimtarisë Gjyqësore, Gjatë Kohëzgjatjes Së Gjendjes Së Epidemisë Së Shkaktuar Nga COVID-19.

⁹ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹⁰ Arta Vorpsi, *Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë*, Maluka, Tiranë, 2011, fq.120.

¹¹ Çështja Albert dhe Le Compte k. Belgjikës, 10 shkurt 1983, Gjykata Eruopiane e të Drejtave të Njeriut.

¹² Neni 170 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹³ <http://akad.gov.al/ash/pdf/Aurela%20Anastasi%20COVID%2019-Shteti%20i%20se%20Drejtjes.pdf> aksesuar për herë të fundit më: 16.02.2021.

¹⁴ Neni 175 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹⁵ Neni 2 i Vendimit Nr.243, Datë 24.3.2020 Për Shpalljen E Gjendjes Së Fatkeqësisë Natyrore.

në drejtësi gjatë kësaj periudhe.

3. Askesi në drejtësi gjatë kohës së pandemisë

Periodha e pandemisë paralizoi në të njëjtën kohë një sërë aktivitetesh ku ndër të tjerash ishte dhe veprimtaria ligjore e gjykatave. Gjykimet administrative, civile dhe penale në disa prej nënkategorive të tyre u kufizuan. Kjo paralizë e sistemit të drejtësisë a ka qenë një cenim i së drejtës për akses në drejtësi? Kjo është një pyetje që është shtruar si në rrafshin kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar. Për shembull në Bashkimin Europian, pavarësisht se është ngritur një diskutim i tillë që në krye të herës, akoma nuk është bërë një studim i mirëfilltë mbi ndikimin që kishte pandemia COVID-19 mbi aksesin në drejtësi dhe performancën e gjykatave¹⁶. Ajo çka është ofruar si zgjidhje në shumë vende të botës ka qenë adoptimi i mjeteve teknologjike, me qëllim mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore, si dhe ndalimi i publicitetit të seancave, etj.

Nëse do të marrim në shqyrtim aktet normative të miratuara gjatë periudhës së pandemisë, përkatësisht aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” dhe aktin normativ nr. 21, datë 27.5.2020 “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, *Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19*”, miratuar me ligjin nr. 30/2020, vëmë re se i janë përshtatur disi qasjeve globale të ofruara në këtë drejtim.

Forma dhe mënyra e organizimit të këtyre seancave gjyqësore kishte për qëllim garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe gjatë periudhës së pandemisë¹⁷. Seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, të planifikuara pranë të gjitha gjykatave u shtynë deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19. Moszhvillimi i seancave gjyqësore të planifikuara gjatë kësaj kohe sigurisht që shkakton një ngarkesë të sistemit gjyqësor me çështjet, por në të njëjtën kohë palëve të interesuara i vonon të drejtën për tu gjykuar brenda afatit kohor të arsyeshëm.

Ajo çka përbënte interes në këtë kohë ishte se çfarë do të ndodhte me raste kur individët do të duhej t’i drejtoheshin gjykatës për një çështje të caktuar. Ky problem u adresua nga pika 2 e Aktit Normativ në fjalë, e cila bëri që të pezulloheshin afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, sipas parashikimeve në këtë akt normativ. Kur afatet fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë. Ky pezullim vashdoi deri në përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme. Megjithatë rregullat e gjykimin dhe të pezullimit nuk zbatoheshin për¹⁸:

- çështjet administrative, me objekt gjykimin e masave të sigurimit të padisë, në rast se gjykata vlerëson se shqyrtimi pas afatit të përcaktuar në nenin 2, të këtij akti normativ, mund të shkaktojë një dëm të rëndë e të pariparueshëm për palët;

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹⁶ <https://eulawlive.com/access-to-justice-in-cross-border-cases-and-covid-19-related-state-of-emergency-litigation-before-the-court-of-justice/> aksesuar për herë të fundit më 18.02.2021.

¹⁷ Neni 2 i Aktit Normativ Nr.9, Datë 25.3.2020 Për Marrjen E Masave Të Veçanta Në Fushën E Veprimtarisë Gjyqësore, Gjatë Kohëzgjatjes Së Gjendjes Së Epidemisë Së Shkaktuar Nga COVID-19.

¹⁸ Neni 3 i Aktit Normativ nr. 9 datë 25.03.2020.

- çështjet familjare, me objekt gjykimi kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë dhe birësimin, masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim, si dhe në ato çështje civile në të cilat, përjashtimisht, gjykata vlerëson se shqyrtimi i vonuar i tyre mund të shkaktojë dëm të rëndë e të pariparueshëm për palët;

- çështjet penale, që lidhen me vleftësimin e arrestit në flagrancë ose ndalimit, caktimin, verifikimin e kushteve e të kriterëve të caktimit dhe nevojat e sigurimit, zëvendësimin, revokimin, bashkimin ose shuarjen e masave të sigurimit të “arrestit në burg” ose të “arrestit në shtëpi”, kur të arrestuarit, të pandehurit ose mbrojtësit e tyre kërkojnë që të vijohet me shqyrtimin e tyre, si 2 dhe në çështjet penale që lidhen me caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive”;

- çështjet penale, në të cilat afatet e kohëzgjatjes maksimale të paraburgimit, sipas pikës 6, të nenit 263, të *Kodit të procedurës penale*, mbarojnë gjatë periudhës së pezullimit;

- çështjet penale të një natyre urgjente, për shkak të nevojës së sigurimit të provës, sipas nenit 316, të *Kodit të procedurës penale*. Urgjenca vlerësohet nga gjykata që shqyrton çështjen;

- çështjet penale në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, kur ndaj tyre është zbatuar masa e arrestit apo e ndalimit, sipas nenit 15, të *Kodit të drejtësisë penale për të mitur*;

- çdo çështje tjetër penale ku i pandehuri është i paraburgosur ose është duke vuajtur dënimin me burgim, në rast se i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkojnë vazhdimin e gjykimit.

Arsyeja e vendosjes së një parashikimi të tillë për vetëm një kategori të caktuar të çështjeve gjyqësore ka të bëjë me vetë natyrën e ngutshme të gjykimit të këtyre çështjeve, të cilat në të kundërt do të sillnin pasojë tepër të rënda për palët në këtë proces gjyqësor, apo për vetë interesin publik.

Po ashtu pika 4 e aktit normativ nr. 9 datë 25.3.2020 vendosi kufizimin e së drejtës së zhvillimit të procesit gjyqësor në mënyrë publike, duke ja lejuar këtë gjë vetëm palëve të cilat duhet që të kryejnë veprimtarinë me urgjencë, apo vetëm palëve që përbëjnë subjektin legjitim për t’iu drejtuar gjykatës. Ndërsa kur ishte e mundur të zhvillohej gjykimi pa praninë e palëve, nëpërmjet mjeteve të përdorimit elektronik.

Përdorimi i mjeteve elektronike u shfaq edhe si një formë për paraqitjen e akteve procedurale apo për dhënien e vendimeve nga gjykata. Mjetet teknologjike të ndërlidhjes në distancë u shfaqën si një mundësi për të vazhduar gjykimin me anë të programeve kompjuterike të posaçme. Më vonë në lidhje me pjesëmarrjen në distancë të palëve u bë një ndryshim me aktin normativ nr. 21, datë 27.5.2020¹⁹, ku sanksionoi se këto mjete të komunikimit do të përdoren vetëm kur është e mundur dhe vetëm pasi të jetë dhënë pëlqimi nga këto palë në proces, brenda një afati të caktuar nga gjykata. Sanksionimi i dhënies së pëlqimit nga ana e palëve në proces ishte i domosdoshëm për të garantuar të drejtën e aksesit në drejtësi, për shkak se mund të lindnin probleme me aksesin në drejtësi të këtyre palëve, pasi jo të gjitha palët mund të kishin akses në këto mjete teknologjike, apo mund të gjendeshin në formën dhe paraqitjen e kërkuar nga ky akt normativ.

¹⁹ Neni 2 i Aktit Normativ Nr.21, Datë 27.5.2020 Për Disa Ndryshime Në Aktin Normativ Nr.9, Datë 25.3.2020, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Marrjen E Masave Të Veçanta Në Fushën E Veprimtarisë Gjyqësore, Gjatë Kohëzgjatjes Së Gjendjes Së Epidemisë Së Shkaktuar Nga COVID-19”, Miratuar Me Ligjin Nr.30/2020.

Roli i teknologjisë, sigurisht që është një rol mbështetës i sistemit gjyqësor, duke ofruar ndihmë në menaxhimin e çështjeve gjyqësore, por që mund të hapë rrugën për implementimin në të ardhmen të programeve dhe sistemeve kompjuterike të veçanta që mundësojnë gjykimin dhe trajtimin e rasteve gjyqësore. Por implementimi i tyre, pavarësisht teorive që e mbështesin atë, pasi rrit qasjen në aksesin në drejtësi, është dhe një çështje e vetë shteteve, për sa i përket mundësive të tyre ekonomike dhe teknologjike.²⁰ Kjo formë e re e aksesit në drejtësi lindi si nevojë e gjendjes së diktuar nga pandemia COVID-19, ku shumë shtete zëvendësuan seancat strikte konservatore me seanca të zhvilluara në platformat *Zoom*, *Cisco*, apo *Microsoft Teams*. Me gjithë mundësinë e shkëlqyer për të ndjekur zhvillimet dhe procedimet në distancë, kjo formë e re e gjykimit shfaq edhe problematika të aksesit në dokumentacione, ekzaminimit dhe ballafaqimit të provave, transparencës që duhet thënë që është kufizuar në maksimum dhe të natyrës së publicitetit të vetë seancave gjyqësore²¹.

Organizata e Kombeve të Bashkuara me anë të Zyrës për Drogat dhe Krimet si dhe Programin për Zhvillim ka hartuar një dokument strategjik i cili mundëson aksesin në drejtësi në kushtet e COVID-19.²² Ky është një dokument i mirëfilltë politikash që synon t'i drejtohet shteteve për të siguruar të gjitha masat e domosdoshme për përgatitjen, përgjigjen dhe rikuperimit të aksesit në drejtësi gjatë gjendjes së pandemisë. Ruajtja e të drejtave të njeriut gjatë gjendjes së pandemisë, shfaqet si një nevojë për të ofruar edhe një garanci juridike mbi funksionimin e sistemit gjyqësor, si pushteti i tretë në çdo vend.

Padyshim që një nga pasojat negative të aksesit në drejtësi gjatë periudhës së pandemisë ka qenë edhe akses i grupeve vulnerabël gjatë kësaj periudhe kohore. Kështu gratë e dhunuara dhe fëmijët u raportuan që të kishin më pak çështje të ngritura në gjykatë gjatë kësaj kohe sesa në të njëjtën periudhë në vitet e kaluara²³.

Diskutimi mbi kufizimet që mund t'i vihen aksesit në drejtësi, por edhe formave të ndryshme që mund të marri kjo e drejtë kushtetuese nuk shfaqen vetëm gjatë gjendjes së pandemisë dhe çdo lloj tjetër gjendjeje të fatkeqësisë natyrore, por mund të shfaqen edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme apo të konflikteve të armatosura (luftës). Në kohën e krizave stabiliteti dhe vazhdimësia e sistemit gjyqësor është esenciale²⁴. Në qoftë se do të rikujtojmë ngjarjen e vitit 2016 në Turqi, pas vendosjes së gjendjes së emergjencës në këtë shtet, ka pasur disa problematika në të drejtën për akses në drejtësi, aksesin në mbrojtje juridike dhe të gjeturi një avokat për t'u mbrojtur, duke cenuar në shumë raste të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe atë të aksesit në drejtësi.

4. Konkluzione

Gjendjet e emergjencave civile janë gjendje të cilat shkaktojnë probleme të mëdha jo vetëm ekonomike, sociale, jetike, por edhe ligjore. Në raste të tilla jemi përpara balancave të shumë të drejtave dhe lirive, të cilat nevojitet një studim dhe analizë e mirëfilltë, në mënyrë që të mos cenohen në thelbin e tyre.

²⁰ <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC7456584/> aksesuar për herë të fundit më: 20.02.2021.

²¹ <https://worldjusticeproject.org/news/understanding-access-justice-covid-19-era> aksesuar për herë të fundit më: 20.02.2021.

²² Ky dokument është hartuar në Maj të vitit 2020.

²³ <https://www.unwomen.org/en/news/stories/2020/11/ehat-happened-after-covid-19-albania> aksesuar për herë të fundit më: 21.02.2021.

²⁴ International Commission of Jurists, *Justice suspended: Access to justice and the state of emergency in Turkey*, Geneva, 2018, fq.14.

Aksesi në drejtësi është një garanci kushtetuese që i mundëson individit të mbrojnë të drejtat e shkelura. Aksesi në drejtësi është një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës dhe rregullimin e tij e gjen në aktet kryesore juridike të një shteti, por edhe në marrëveshjet ndërkombëtare, konventat, traktatet, etj. Nga ana tjetër emergjencë civile është situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

Periudha e pandemisë paralizoi në të njëjtën kohë një sërë aktivitetesh ku ndër të tjerash ishte dhe veprimtaria ligjore e gjykatave. Gjykimet administrative, civile dhe penale në disa prej nënkategorive të tyre u kufizuan. Ajo çka është ofruar si zgjidhje në shumë vende të botës ka qenë adoptimi i mjeteve teknologjike, me qëllim mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore, si dhe ndalimi i publicitetit të seancave, etj. Roli i teknologjisë, sigurisht që është një rol mbështetës i sistemit gjyqësor, duke ofruar ndihmë në menaxhimin e çështjeve gjyqësore, por që mund të hapë rrugën për implementimin në të ardhmen të programeve dhe sistemeve kompjuterike të veçanta që mundësojnë gjykimin dhe trajtimin e rasteve gjyqësore. Por implementimi i tyre, pavarësisht teorive që e mbështesin atë, pasi rrit qasjen në aksesin në drejtësi, është dhe një çështje e vetë shteteve, për sa i përket mundësive të tyre ekonomike dhe teknologjike.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, me anë të Zyrës për Drogat dhe Krimet, si dhe Programin për Zhvillim, ka hartuar një dokument strategjik i cili mundëson aksesin në drejtësi në kushtet e COVID-19. Ky është një dokument i mirëfillt politikash që synon t'i drejtohet shteteve për të siguruar të gjitha masat e domosdoshme për përgatitjen, përgjigjen dhe rikuperimit të aksesit në drejtësi gjatë gjendjes së pandemisë.

Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.
3. Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë- Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë, Korrik, 2015.
4. Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile".
5. Akti Normativ Nr.9, Datë 25.3.2020 Për Marrjen e Masave Të Veçanta Në Fushën E Veprimtarisë Gjyqësore, Gjatë Kohëzgjatjes Së Gjendjes Së Epidemisë Së Shkaktuar Nga COVID-19.
6. Akti Normativ Nr.21, Datë 27.5.2020 Për Disa Ndryshime Në Aktin Normativ Nr.9, Datë 25.3.2020, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Marrjen E Masave Të Veçanta Në Fushën E Veprimtarisë Gjyqësore, Gjatë Kohëzgjatjes Së Gjendjes Së Epidemisë Së Shkaktuar Nga COVID-19", Miratuar Me Ligjin Nr.30/2020.
7. Joniada Musaraj, Çështje të aksesit në drejtësi dhe të gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përvoja shqiptare në vështrim të krahasuar. Doktoratura, Unittir, Tiranë, 2016.
8. International Commission of Jurists, Justice suspended: Access to justice and the state of emergency in Turkey, Geneva, 2018.
9. Arta Vorpsi, Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Maluka, Tiranë, 2011.
10. Koalicioni "Drejtësi për të gjithë", Aksesi në drejtësi i qytetarëve: Garancitë e Reformës në Drejtësi, Fletëpalosje.
11. Çështja Albert dhe Le Compte k. Belgjikës, 10 shkurt 1983, Gjykata Eruopiane e të Drejtave të Njeriut..
12. <https://www.unwomen.org/en/news/stories/2020/11/ehat-happened-after-covid-19-albania>
13. <https://worldjusticeproject.org/news/understanding-access-justice-covid-19-era>
14. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC7456584/>
15. <https://eulawlive.com/access-to-justice-in-cross-border-cases-and-covid-19-related-state-of-emergency-litigation-before-the-court-of-justice/>
16. <http://akad.gov.al/ash/pdf/Aurela%20Anastasi%20COVID%2019-Shteti%20i%20se%20Drejte.pdf>

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

~ *Sesioni III* ~

Qasje praktike dhe shembuj konkret menaxhimi,
në kuadrin e fatkeqësive natyrore
dhe temergjencave civile

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*


« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Sistemi i Zvogëlimit dhe Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Shqipëri – Panoramë dhe analizë e nevojave dhe mangësive strukturore



■ **MSc. Shensi PRENÇI**

*Këshilltar i Presidentit të Republikës
për Mbrojtjen Civile dhe Rendin Publik
pshehsi@yahoo.com*



■ **Dr (proc). Silvana JAKAJ**

*Policia e Shtetit
Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë
silvana.jakaj@asp.gov.al*

Abstrakt

Fatkeqësitë, në disa raste perceptohen si "goditje" të shkaktuara nga faktorë të jashtëm, të pandërruarur nga veprimtaria njerëzore por risku nga fatkeqësitë krijohet në sajë të ndërveprimit kompleks midis proceseve të zhvillimit. Lidhja shkak-pasojë midis proceseve të zhvillimit dhe riskut nga fatkeqësitë, bëhet më e evidente nëse i referohemi treguesve vjetor global të indeksit të riskut, ku nxitësit potencial të tij janë varfëria dhe pabarazia, zhvillimi urban i planifikuar dhe menaxhuar keq, keqmenaxhimi i burimeve natyrore, qasja e paintegruar mjedisore, ndryshimet klimatike si pasojë e efekteve të ngrohjes globale, mungesa e investimeve ose investimet e pamjaftueshme. Fatkeqësitë kërcënojnë zhvillimin, ashtu si zhvillimi krijon risk nga fatkeqësitë. Për të reduktuar dhe menaxhuar riskun nga fatkeqësitë, është e nevojshme që të kuptojmë se çfarë është ai, dhe ky proces i të kuptuarit nis duke pranuar fillimisht faktin që fatkeqësitë janë një tregues i dështimeve të zhvillimit, që do të thotë se risku nga fatkeqësitë është në vetevetë një matës i qëndrueshmërisë së zhvillimit. Qëllimi i këtij punimi është identifikimi, vlerësimi dhe analizimi i nevojave dhe mangësive që ka sistemi struktural mbrojtjes civile dhe sistemi i reduktimit dhe menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në Shqipëri, duke parë edhe sesa janë zbatuar dhe përshtatur politikat dhe praktikat e rekomanduara nga institucionet ndërkombëtare për reduktimin, menaxhimin, administrimin dhe monitorimin e riskut si një paketë e cila ndikon drejtpërdrejt në çështjet e Sigurisë Kombëtare.

Fjalëkyçe:

Menaxhim i riskut, reduktimi i riskut, identifikim, shmangje, vlerësim, ekspozim, çënueshmëri, rrezik.

Risku i lartë nga fatkeqësitë është tregues i zhvillimit të dobët, ndaj zvogëlimi i riskut të fatkeqësive kërkon integrimin e politikës të reduktimit të riskut dhe praktikës së menaxhimit të riskut, në realizimin e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Hyrje

Për shumë dekada, trajtimi i fatkeqësive u përqendrua vetëm në reagimin ndaj emergjencave natyrore, por nga fundi i shekullit të 20-të u evidentua gjithnjë e më shumë fakti se fatkeqësitë janë shumë komplekse dhe se qasja ndaj tyre duhet të jetë e gjithëanshme. Fatkeqësitë kanë pasoja shkatërruese, ato shkaktojnë vdekje, lëndime, sëmundje, shkatërrim të pronës dhe aseteve të tjera, zhvendosje masive, përçarje sociale dhe ekonomike, humbje të infrastrukturës dhe shërbimeve të tjera dhe dëmtim të mjedisit. Shqipëria është e ekspozuar ndaj risqeve natyrore të tilla si përmbytjet, tërmetet, zjarret në pyje dhe rrëshqitja e tokës si dhe ndaj fatkeqësive të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut siç janë zjarret urbane, degradimi i mjedisit, ndotja e ajrit dhe e ujit si dhe shpërthimet e sëmundjeve epidemike. Sidoqoftë, nëse nuk mund të parandalojmë që një risk të ndodhë në territorin e Shqipërisë, ne mund të përdorim zvogëlimin dhe menaxhimin e riskun nga fatkeqësitë për të kuptuar rrezikun, ekspozueshmërinë dhe cenueshmërinë, për të parandaluar që një risk të bëhet fatkeqësi dhe për të zbutur ndikimin e tij duke i bërë njerëzit më elastik. Kjo analizë nënvizon nevojën në rritje për të lëvizur drejt një qasjeje shtetërore, drejt reduktimit dhe mirë-menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë; duke identifikuar boshllëqet në menaxhimin e riskut në shkallë kombëtare nëpërmjet zhvillimit të vlerësimeve lokale të riskut, zhvillimit të metodologjive, planeve të mbrojtjes civile në nivel bashkie, ushtrimeve lokale apo

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

rajonale mbi testimin e gatishmërisë, adoptimit dhe zbatimit të kornizës Sendai për DRR (RRF). Institucionet shqiptare, nga ana konceptuale dhe praktike, priren më tepër drejt masave reaguese sesa proaktive në lidhje me Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Parandalimin e Fatkeqësive, duke u përqendruar më shumë te gatishmëria dhe reagimi, por pak te parandalimi/zbutja dhe riaftësimi. Në përgjigje të fatkeqësive, duhet të përmirësohet edhe komunikimi ndërmjet organeve drejtuese dhe popullsisë vendase. Ndër problemet e tjera janë mangësitë në teknikat e parashikimit të motit dhe në trajnimin e personelit të emergjencave si dhe popullsisë në lidhje me masat parandaluese/mbrojtëse.

Ndër të tjera, duhet theksuar nevoja që Shqipëria ka për të forcuar metodat dhe qasjet, përfshirë menaxhimin e fatkeqësive komplekse, duke llogaritur ndikimet afatgjata të ndryshimeve klimatike dhe presioneve të burimeve natyrore, dhe duke i'u përgjigjur risqeve të reja të shfaqura si flukset e migrantëve dhe refugjatëve, klima dhe zhvendosjet e popullsisë të shkaktuara nga dëmtimi i mjedisit, rezistenca anti-mikrobike dhe humbja e biodiversitetit. Adresimi i duhur i këtyre elementeve, do të ndikonte në zvogëlimin e riskut, do të zvogëlonte ndikimet e ndryshimit të klimës dhe, si pasojë, do të ruajë qëndrueshmërinë e zhvillimit.

1. Sistemi i Reduktimit të Riskut të Fatkeqësive në Shqipëri

Risku nga fatkeqësitë rezultojnë të jetë ndërveprimi kompleks midis proceseve të zhvillimit që gjenerojnë kushte ekspozimi, vulnerabiliteti dhe rreziku. Risku konsiderohet si kombinim i ashpërsisë dhe shpeshtësisë së një rreziku, numrit të njerëzve dhe pasurive të ekspozuara ndaj rrezikut dhe cenueshmërisë së tyre ndaj dëmtimit¹. Risku intensiv shoqërohet me ngjarje me probabilitet të ulët, me ndikim të lartë, ndërsa risku i gjerë shoqërohet me ngjarje me probabilitet të lartë, me ndikim të ulët. (RISK = RREZIK X EKSPOZIM X CËNUESHMERI)

1.1. Profili i Riskut i Shqipërisë

Shqipëria është një vend i ekspozuar ndaj fatkeqësive. Katër risqet kryesore që prekin vendin janë tërmetet, përmbytjet, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e tokës. Baza e të dhënave ndërkombëtare të fatkeqësive (EM-DAT) tregon se, gjatë viteve 1979-2019, përmbytjet llogariteshin për pjesën më të madhe të ngjarjeve të fatkeqësive (38%), të ndjekura nga tërmetet (15%). Sipas Raportit vjetor të Riskut Botëror (BEH-IFHV, 2019), i cili llogarit Indeks të Riskut të Fatkeqësive për 180 vende bazuar në ekspozimin, ndjeshmërinë, cenueshmërinë dhe aftësitë përballuese dhe përshtatëse, Shqipëria renditet e para në Evropë dhe në të 61-tën botë.

Humbjet e mundshme në Shqipëri nga një fatkeqësi me një periudhë mesatare kthimi 250-vjeçare vlerësohen në 2.08 miliardë EUR për tërmetet dhe 1.18 miliardë euro (145.2 milion lekë) për përmbytjet (Banka Botërore, 2014). Shqipëria është në risk të lartë nga zjarret në pyje, veçanërisht në sezonin e thatë të verës. Më shumë se 95% e ngjarjeve nga zjarri janë të vogla (më pak se 100 ha të djegura) dhe përbëjnë më shumë se 40% të zonës totale të djegur, ndërsa ngjarjet e mëdha janë relativisht të rralla

(5% e sipërfaqes totale të djegur). Shqipëria karakterizohet nga paqëndrueshmëria e tokës e shkaktuar nga faktorë natyrorë dhe antropogjenikë. 33.6% e territorit të tij është relativisht e qëndrueshme, dhe 9,8% është e paqëndrueshme ².

1.2. Sistemi i Reduktimit të Riskut të Fatkeqësive

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë përfshin tërësinë e masave të përcaktuara nga ky ligj, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, planet, programet e dokumentet e tjera që kanë për qëllim ³:

a) identifikimin e saktë, vlerësimin periodik dhe monitorimin e riskut nga fatkeqësitë;
b) uljen e efekteve të faktorëve që shkaktojnë ose rrisin risqet nga fatkeqësitë nëpërmjet një menaxhimi të përgjegjshëm dhe të duhur të mjedisit, tokës, ujit dhe burimeve të tjera natyrore, si dhe të zbatimit të masave të përshtatshme teknike dhe të masave të tjera;

c) zbutjen e pasojave negative të fatkeqësive nëpërmjet të kuptuarit sa më mirë të riskut, parandalimit të tij dhe rritjes së gatishmërinë për t'u përgjigjur në mënyrë efektive;

ç) investimin në parandalimin dhe zvogëlimin e risqeve nga fatkeqësitë, duke nxitur investimet publike e private dhe ndërmarrjen e masave strukturore dhe jostrukturore;

d) krijimin e kulturës së sigurisë dhe të aftësisë ripërtëritëse personale e komunitare mbi rreziqet natyrore dhe rreziqet e tjera;

dh) intensifikimin e bashkëpunimit të të gjitha institucioneve e strukturave në nivel qendror dhe vendor, të partneritetit me subjektet private, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe shtetasit, të cilët mund të kontribuojnë në uljen e riskut nga fatkeqësitë;

e) krijimin e procedurave të sakta për shkëmbimin e informacionit dhe të përvojës për zvogëlimin e riskut, për ofrimin dhe marrjen efikase të ndihmës operacionale dhe humanitare ndërkombëtare, për eliminimin e pasojave të rreziqeve natyrore dhe të rreziqeve të tjera, si dhe për fillimin e rindërtimit të zonave të prekura.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (MC) dhe Reduktimit të Riskut nga Fatkeqësitë (RRF) është një draft dokument që ende nuk është aprovuar nga Qeveria qeveritare. Sidoqoftë, parimet kryesore përmbahen në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritetit 2015-2020 ⁴. Në korrik 2019, disa muaj para tërmetit, u miratua ligji i ri "Për mbrojtjen civile" (L. 45/2019), i cili zëvendësoi Ligjin 8756/2001 "Për Emergjencat Civile". Ligji i ri themeloi Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (NCPA), nën Ministrinë e Mbrojtjes (MB). Ky funksion mbahej më parë nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile nën Ministrinë e Brendshme (MPB) deri në vitin 2017, dhe më pas nën MM. Ligji parashikon një kuadër solid për promovimin e zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë dhe kërkon përgatitjen e një vlerësimi të riskut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar dhe lokal brenda dy viteve nga miratimi i tij. Ai gjithashtu kërkon përgatitjen dhe miratimin e strategjive kombëtare dhe bashkiake të RRF-së, si dhe Planet Kombëtare dhe Vendore të Emergjencave Civile, me vëmendje të veçantë dhënë gjinisë, dhe grupeve të marginalizuara dhe të tjera të prekshme. Sidoqoftë, nënligjet, strategjitë, planet dhe aktivitetet në nivel kombëtar, rajonal dhe bashkiak duhet të harmonizohen me ligjin e ri.

² Vlerësimi i Riskut të Fatkeqësive në Shqipëri (UNDP, 2003)

³ Ligji 45/19 "Për mbrojtjen civile"

⁴ VKM 348/2015

Strukturat kryesore operative në përgjigjen ndaj fatkeqësive në vend janë Forcat e Armatosura Shqiptare (AAF), me ekipe të specializuara të Kërkimit Urban dhe Shpëtimit Urban (USAR), Policia e Shtetit Shqiptar (ASP), Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (FP&R) dhe Shërbimi i Urgjencës Mjekësore Shërbimet (EMS). Në rast të një fatkeqësie të madhe, Qeveria qeveritare ka krijuar mekanizma për të kërkuar ndihmë nga Qendra e Përgjigjes dhe Koordinimit të Emergjencave të BE-së (ERCC), Qendra e Koordinimit të Përgjigjes ndaj Fatkeqësive Euro- Atlantike të NATO-s (EADRCC), bilaterale dhe vende të tjera. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH) siguron mallra lehtësimi.

Për sa i përket buxhetit të DRR-së, Ligji 45/2019 përcakton praktikën e mirë që ministritë e linjës të kenë një linjë të veçantë buxhetore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe aktivitetet e mbrojtjes civile që akordojnë 2-4% të buxhetit të tyre vjetor, ndërsa komunat duhet të buxhetojnë jo më pak se 4 %. Shqipëria, së bashku me Serbinë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, po merr pjesë në një Instrument Rajonal të Sigurimit të Riskut nga Katastrofa e filluar nga Banka Botërore dhe partnerë të tjerë në vitin 2010. Sipas përmbledhjes ekzekutive të projektligjit 2016, aktualisht nën rishikim për kushtet e sigurimi i detyrueshëm në banesa kundër tërmeteve dhe përmbytjeve, depërtimi i tregut të sigurimeve nga katastrofa është ende shumë i ulët në Shqipëri; afërsisht 1-2 shtëpi në 100⁵.

Monitorimi i rrezikut të tërmetit, përmbytjes dhe zjarrit në nivelin kombëtar bëhet nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), aktualisht nën Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT).

1.2.1. Identifikimi dhe kuptimi i riskut: themeli i zvogëlimit të riskut

Ndërgjegjësimi, identifikimi, kuptimi dhe matja e risqeve të fatkeqësive janë bazat themelore të menaxhimit të rrezikut të katastrofës⁶.

Për shkak se dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë historike shpesh nuk njihen gjerësisht, dhe për shkak se dëmet dhe humbjet e mundshme që mund të vijnë nga fatkeqësitë e ardhshme (përfshirë ngjarje të rralla, por me ndikim të lartë) mund të mos dihen fare, MRF i jepet një përparësi e ulët . Komunikimi i duhur i informacionit të riskut në kohën e duhur mund të rrisë ndërgjegjësimin ndërveprimin.

1.2.2. Trajtimi i riskut⁷

Trajtimi i riskut ose shmangia e riskut, synon që të modifikojë efektet e një risku. Risku mund të shmanget duke anuluar apo duke mos e nisur aktivitetin që sjell një risk, p.sh. duke eliminuar burimin e tij, duke ndryshuar pasojat, duke ndryshuar gjasat që ai të ndodhë; apo duke e transferuar riskun në subjekte të tjera, si p.sh. në mundësi sigurimi apo kontraktimi. Masa e vetme e aplikueshme për risqet e pranuar apo të mbetura është përballja dhe pakësimi në maksimum i efekteve të një risku në rast se ai ndodh. Risqet e pranuar, si edhe opsionet e përzgjedhura për trajtimin e risqeve, duhet të rishikohen rregullisht. Përzgjedhja e opsioneve për trajtimin e riskut duhet të përfshijë marrjen në konsideratë të avantazheve lidhur me arrijten e objektivave organizative si edhe kostot, përpjekjet dhe disavantazhet e zbatimit të trajtimit. Ndërkohë që vetë trajtimi i riskut mund të prezantojë risqe të reja, monitorimi i vazhdueshëm i nevojave

⁵ Post Disaster Needs Assessment 2019

⁶ UNISDR, 2015

⁷ Ligji 45/19 "Për mbrojtjen civile"

duhet të jetë tipar thelbësor i planit të trajtimit të riskut.

1.2.3. Analiza e riskut

Analiza e riskut zhvillon të kuptuarit e riskut dhe mbështet vlerësimin e riskut dhe vendimmarrjen për trajtimin e risqeve. Në analizimin e risqeve duhet të merren në konsideratë pasiguritë dhe gjasat lidhur me ngjarjet, pasojat, burimet e risqeve dhe skenarët e ndryshëm, si edhe pasojat pozitive dhe negative. Analiza mund të jetë sasiore, gjysmë-sasiore ose cilësore, varësisht nga rrethanat. Pasojat dhe gjasat mund të përcaktohen duke modeluar rezultatet e ngjarjes/ngjarjeve ose përmes ekstrapolimit nga studimet eksperimentale. Ndonjëherë mund të nevojitet më shumë se një përshkrues për të specifikuar pasojat dhe gjasat e tyre. Gjithashtu, risqet mund të paraqiten si një shpërndarje e mundshme e pasojave.

1.2.4. Ndërgjegjësimi

Në vend ka disa aktivitete të ndërgjegjësimit publik dhe disa pjesëmarrje të organizatës së shoqërisë civile në masat RRF. Edukimi për risqet është përfshirë në programet shkollore, por arsimi në menaxhimin RRF ende nuk është integruar. Aktivitetet për zvogëlimin e rrezikut mund të përshkruhen si strukturore⁸, për shembull planifikimi i përdorimit të tokës dhe zbatimi i kodeve të ndërtimit, dhe jo-strukturore, për shembull ngritja e vetëdijes, politikëbërja dhe legjislacioni. Si qeveritë, shoqëria civile dhe aktorët e tjerë organizojnë MRF, për shembull përmes rregullimeve institucionale, legjislacionit dhe decentralizimit, dhe mekanizmat për pjesëmarrje dhe llogaridhënie quhet qeverisja e rrezikut⁹.

1.3. Si e matim riskun?

Identifikimi, vlerësimi dhe kuptimi i riskut është thelbësorë për zvogëlimin e tij. Ne mund të masim riskun nga fatkeqësitë duke analizuar trendet, për shembull, të humbjeve të mëparshme si shkak i fatkeqësisë.

Këto prire mund të na ndihmojnë të vlerësojmë nëse zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë është efektiv. Vlerësimet e riskut prodhohen në mënyrë që të vlerësojnë ndikimet e mundshme ekonomike, infrastrukturore dhe sociale që vijnë nga një risk i veçantë ose risqe të shumta¹⁰.

2. Menaxhimi i Riskut të Fatkeqësive

Menaxhimi i risku (DRM) është zbatimi i politikave dhe strategjive të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, për të parandaluar riskun e ri nga fatkeqësitë, për të zvogëluar riskun ekzistues të fatkeqësitë dhe për të menaxhuar riskun e mbetur, duke kontribuar në forcimin e rezistencës dhe zvogëlimin e humbjeve¹¹.

Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë normohet nga plane dhe strategji. Planet e

⁸ Sipas Raportit të IPA PRO NEWS PROJECT mbi implementimin e komponentit mbi ndërgjegjësimin publik ndaj përmbytjeve: Tek veprimtaria për mbrojtjen e mjedisit, peshën kryesore e zënë aktivitetet me karakter ndërgjegjësuës. Shqipëria nuk ka aktualisht një strategji për ndërgjegjësimin publik, as në nivelin kombëtar e as në atë lokal. Ndaj, për këtë, shihet e arsyeshme bashkpunimi midis strukturave shtetërore dhe NGO-ve që operojnë në fushën e çështjeve mjedisore".

⁹ UNISDR, 2013

¹⁰ GFDRR, 2019

¹¹ UNDRR

menaxhimit të riskut përcaktojnë qëllimet dhe objektivat specifike për zvogëlimin e risqeve të fatkqësive së bashku me veprimet përkatëse për të përmbushur këto objektiva. Ato duhet të drejtohen nga Korniza Sendai për Reduktimin e Riskut nga Fatkqësitë 2015-2030 dhe të konsiderohen dhe koordinohen brenda planeve përkatëse të zhvillimit, alokimit të burimeve dhe aktiviteteve të programit ¹². Planet e nivelit kombëtar duhet të jenë specifike për secilin nivel të përgjegjesisë administrative dhe të përshtaten me rrethanat e ndryshme shoqërore dhe gjeografike që janë të pranishme. Afati dhe përgjegjësitë për zbatim dhe burimet e financimit duhet të specifikohen në plan. Lidhjet me zhvillimin e qëndrueshëm dhe planet e adaptimit të ndryshimeve klimatike duhet të bëhen kur është e mundur.

Rrjedhimisht DRM përfshin strategji të dizajnuara për të shmangni ndërtimin e risqeve të reja, adresuar risqeve para-ekzistuese dhe për të ndarë dhe shpërndajnë riskun mbi parandalimin e humbjeve. DRM përfshin aktivitete të gatishmërisë dhe reagimit ndaj fatkqësive. Zbatimi i këtyre aktiviteteve dhe masave përfshin një numër aktiviteteve shoqërore, përfshirë ¹³:

- Identifikimin dhe matjen e riskut
- Edukimin dhe dërgjësimin
- Përfshirja e DRM në planifikimin dhe investimet kombëtare
- Forcimi i rregullimeve institucionale dhe legjislative
- Sigurimi i mbrojtjes financiare për njerëzit dhe bizneset në rrezik
- Integrimi i DRR në sektorë të shumtë, përfshirë shëndetin, mjedisin, etj.

2.1. Kuadri i menaxhimit të riskut

Aktivitetet e DRM janë krijuar për të rritur qëndrueshmërinë e njerëzve, komuniteteve, shoqërisë dhe sistemeve për t'i rezistuar, thithur, akomoduar dhe për tu rikuperuar dhe përmirësuar mirëqenien përballë rreziqeve të shumta. Aktivitetet për zvogëlimin dhe administrimin e rreziqeve mund të sigurojnë një mënyrë për ndërtimin e rezistencës ndaj rreziqeve të tjera. Përveç zhvillimit, DRM duhet të integrohet në një numër sektorësh, përfshirë ndryshimin e klimës dhe konfliktet. Ndikimi i disa masave DRR mund të mos jetë i menjëhershëm. Mund të duhen dekada që rezultati i rregulloreve të përmirësuara të planifikimit dhe standardeve të ndërtimit të përkthehet në humbje të reduktuara nga fatkqësia, pasi duhet të arrihet një masë kritike e ndërtesave të reja, të ndjeshme ndaj rrezikut dhe zhvillimit urban ¹⁴.

Elementët e kuadrit të menaxhimit të riskut duhet t'i përshtaten mjedisit dhe kërkesave të aplikimit të tyre, posaçërisht ¹⁵:

a) Mandati dhe angazhimi

Synimi i organizatës për t'u angazhuar në menaxhimin e riskut formon bazën e kuadrit; duhet të komunikohet, kuptohet dhe mbështetet qartësisht nga menaxhimi i lartë/zyrtarët më të lartë. Komunikimi dhe konsultimi është një pjesë thelbësore e të gjithë hapave të procesit të menaxhimit të riskut, duke siguruar që të gjithë aktorët kryesorë dhe anëtarët e një organizate të kuptojnë bazën mbi të cilën janë marrë

¹² Kuadri Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkqësitë 2015-2030

¹³ UNISDR, 2017

¹⁴ UNISDR, 2015

¹⁵ Menaxhimi i fatkqësive në Shqipëri, Analiza e Mangësive, OSCE 2017

vendimet ¹⁶. Komunikimi dhe konsultimi synojnë që të lehtësojnë shkëmbimin e informacionit përkatës, të besueshëm dhe të kuptueshëm.

b) Zbatimi i menaxhimit të riskut

Zbatimi i kuadrit duhet të bëhet para zbatimit të procesit të menaxhimit të riskut për të siguruar rezultate optimale. Transferimi i masave ekzistuese të menaxhimit të riskut tek kuadri i ri nuk duhet të përjashtohen. Sipas termave të kuadrit, proceset aktuale të menaxhimit të riskut duhet të përfshihen në të gjithë nivelet dhe procedurat e organizatës.

c) Monitorimi dhe rishikimi

Efikasiteti i kuadrit të menaxhimit të riskut sigurohet përmes aplikueshmërisë së kuadrit në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm, si edhe matjes së performancës së menaxhimit të riskut duke përdorur tregues që rishikohen periodikisht sigurojnë efikasitetin e kuadrit.

d) Përmirësimi i vazhdueshëm

Përmirësimet në kuadrin e menaxhimit të riskut duhet të zbatohen përmes përdorimit të rezultateve të monitorimit dhe rishikimit. Maturia është një koncept i njohur matjeje për të demonstruar progresin në zhvillim dhe për të nënvizuar rezultatet konsistente nga organizata. Në këtë standard, matura i referohet një evolucioni në drejtim të zhvillimit të plotë, aftësive përshtatëse dhe integritetit të proceseve të menaxhimit të riskut lidhur me aktivitetet strategjike, taktike dhe operacionale të një organizate.

e) Regjistrimi i procesit të menaxhimit të riskut

Aktivitetet e menaxhimit të riskut duhet të jenë të gjurmueshme dhe të dhënat e mëparshme janë themeli për përmirësimin e metodave dhe mjeteve.

2.2. Proçesi i menaxhimit të riskut

Proçesi i menaxhimit të riskut duhet të jetë pjesë integrale e menaxhimit, e rrënjosur në kulturën organizative dhe e përshtatur sipas proçesit.

a) Komunikimi dhe konsultimi

Komunikimi dhe konsultimi është një pjesë thelbësore e të gjithë hapave të proçesit të menaxhimit të riskut, duke siguruar që të gjithë aktorët kryesorë dhe anëtarët e një organizate të kuptojnë bazën mbi të cilën janë marrë vendimet. Komunikimi dhe konsultimi synojnë që të lehtësojnë shkëmbimin e informacionit përkatës, të besueshëm dhe të kuptueshëm.

b) Përcaktimi i kontekstit

Mjedisi, apo konteksti, në të cilin ndodhet organizata, mund të dallohet në një kontekst të jashtëm (kultura organizative, rolet dhe përgjegjësitë brenda organizatës, proceset vendimmarrëse). Aspektet që përcaktojnë kontekstin duhet të merren në konsideratë në më shumë hollësi krahasuar me kuadrin e menaxhimit të riskut. Duhet

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹⁶ Konkluzionet e raportit të hartuar nga Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara pas përmbytyjeve të fillimit të shkurtit 2015, në jug të vendit, "Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë/ Post Disaster Risk Assessment". Nga ky raport citojmë, si më poshtë vijon: "Për të qenë në gjendje që të organizojë zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe menaxhimin e tyre në një mënyrë efektive, qeveria duhet të disponojë një sistem, i cili të mund të koordinojë aktivitetet për parandalimin dhe përgatitjen ndaj fatkeqësive dhe ku të rregullohet e drejta për të marrë masat e nevojshme në fazat e paralajmërimit të hershëm dhe përgjigjes ndaj një përmbytyjeje. Në sistemin e tanishëm, e drejta, kapaciteti dhe financimi i organizatave përkatëse është i kufizuar (faqe 74).

të ndahet zbatimi i procesit dhe duhet të përcaktohen kriteret e riskut për të finalizuar kontekstin e organizatës.


2.2.1. Standardi ISO 31.000 në menaxhimin e riskut ¹⁷

ISO 31.000 aktualisht shihet si standard i praktikës së mirë në menaxhimin e riskut. Autorët e këtij raporti janë gjithashtu bashkë-autorë të standardit ISO 31.000. ISO 31.000 përshkruan procesin aktual të menaxhimit të riskut, si edhe kuadrin e menaxhimit të riskut. Ky i fundit trajton ngulitjen e procesit të menaxhimit të riskut në sistemin e menaxhimit të përgjithshëm të një organizate, që është një parakusht thelbësor për efikasitetin e procesit të menaxhimit të riskut. Prandaj, kuadri i menaxhimit të riskut është superior ndaj procesit të menaxhimit të riskut ¹⁸.

2.2.2. Vlerësimi i riskut

Vlerësimi i riskut përfshin nivelet e riskut, të identifikuar gjatë analizës së riskut me përcaktimin e kriterëve të riskut pas marrjes parasysh të kontekstit. Vendosja e vlerësimit të riskut në procesin e *menaxhimit të riskut* tregohet hollësisht në Fig. 1. Për një vlerësim të efektshëm të riskut duhet të merren në konsideratë kushtet ligjore, rregullatore dhe kushte të tjera, si edhe toleranca e riskut nga të gjitha subjektet që me gjasë ndikohen nga risku. Një vlerësim gjithëpërfshirës i riskut merr në konsideratë gamën e plotë të ngjarjeve të mundshme. Zbatimi i kuadrit të menaxhimit të riskut si edhe procesi i menaxhimit të riskut është pjesë e fazës përgatitore të të ashtuquajturit ciklit të jetës së fatkeqësisë, që përfshin planifikimin para se të ndodhë një ngjarje ¹⁹. Vlerësimi i riskut mund të konsiderojë ngjarje të rralla që ndodhin jashtë parashikimeve të risqeve për të ardhmen, por që, bazuar në njohuritë shkencore, mund të ndodhin. Parashikimi i ngjarjeve të rralla kërkon një sërë informacionesh dhe gjetjesh ndërdisiplinore, së bashku me ndërtimin e skenarit dhe simulimet, të cilat mund të plotësohen me ekspertizë nga një gamë e gjerë disiplinash ²⁰.

Figura 1. Vendosja e vlerësimit të riskut në procesin e menaxhimit të riskut



¹⁷ Menaxhimi i fatkeqësisë në Shqipëri, Analiza e Mangësive, OSCE 2017.

¹⁸ ISO/TC 262, ISO 31.000 – Menaxhimi i Riskut – Parime dhe Udhëzime, 2016.

¹⁹ Menaxhimi i fatkeqësisë në Shqipëri, Analiza e Mangësive, OSCE 2017.

²⁰ Po aty.

Vlerësimi i riskut identifikon llojin, karakteristikën dhe prejardhjen e risqeve nga fatkeqësitë, nivelin e ekspozimit dhe të cenueshmërisë, faktorët që e shkaktojnë apo që e rrisin nivelin e mundësisë së rrezikut, si dhe pasojat e mundshme për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Vlerësimi i riskut kryhet në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor, jo më pak se një herë në çdo tre vjet. Vlerësimi i riskut në nivel qendror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit ²¹.

3. Menaxhimi i fatkeqësive

Menaxhimi i fatkeqësive synon të zvogëlojë, ose të shmangë, humbjet e mundshme nga risqet, të sigurojë ndihmë të shpejtë dhe të përshtatshme për të dëmtuarit nga fatkeqësitë. Cikli i menaxhimit të fatkeqësive ilustron procesin e vazhdueshëm me të cilin qeveritë, bizneset dhe shoqëria civile planifikojnë dhe zvogëlojnë ndikimin e fatkeqësive, reagojnë gjatë, menjëherë pas një fatkeqësie dhe marrin masa për t'u rimëkëmbur pas fatkeqësisë.

3.1. Fazat e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive

Cikli i plotë i menaxhimit të fatkeqësisë përfshin formësimin e politikave dhe planeve publike që adresojnë shkaqet e fatkeqësive ose zbutin efektet e tyre mbi popullatën, pronën dhe infrastrukturën dhe përbëhet nga fazat e zbutjes, gatishmërisë, përgjigjes (reagimit) dhe rimëkëmbjes (Fig.2). Katër fazat e menaxhimit të fatkeqësive të ilustruara këtu nuk ndodhin gjithmonë, shpesh fazat mbivendosen dhe gjatësia e secilës fazë varet shumë nga ashpërsia e eventit/ngjarjes.




Figura 2. Katër fazat e menaxhimit të fatkeqësive

²¹ Ligji 45/19 "Për mbrojtjen civile", neni 9.

a) Zbutja

Aktivitetet zbutëse eliminojnë ose zvogëlojnë probabilitetin e ndodhjes së fatkeqësisë. Masat zbutëse përfshijnë; kodet e ndërtimit, rregulloret e përdorimit të ndërtesave, kodet e sigurisë dhe arsimin publik (kurikulat arsimore për mbrojtjen nga fatkeqësitë).

b) Gatishmëria

Qëllimi i programeve të gatishmërisë për emergjencat është të arrijnë një nivel të kënaqshëm të gatishmërisë për t'iu përgjigjur çdo situatë emergjente përmes programeve që forcojnë kapacitetin teknik dhe menaxherial të qeverive, organizatave dhe komuniteteve. Masat e gatishmërisë përfshijnë planet e gatishmërisë, sistemet paralajmëruese, sistemet e komunikimit emergjent, planet e evakuimit dhe trajnimit, marrëveshjet e ndihmës reciproke dhe edukimin publik.

c) Reagimi

Qëllimi i reagimit është të sigurojë ndihmë të menjëhershme për të ruajtur jetën, për të përmirësuar shëndetin dhe për të mbështetur moralin e popullatës së prekur. Reagimi përfshin strehimin e përkohshëm dhe ushqimin, deri në krijimin e vendbanimeve gjysmë të përhershme në kampe dhe riparimet fillestare të infrastrukturës së dëmtuar. Fokusi në fazën e përgjigjes është në plotësimin e nevojave themelore të njerëzve derisa të gjenden zgjidhje të përhershme dhe të qëndrueshme. Organizatat humanitare shpesh janë fuqimisht të pranishme në këtë fazë.

d) Rimëkëmbja

Ndërsa emergjenca vihet nën kontroll, popullata e prekur është e aftë të ndërmarë një numër në rritje të aktiviteteve që synojnë rikthimin e saj në jetën normale. Aktivitetet e rikuperimit vazhdojnë derisa të gjitha sistemet të kthehen në funksionim. Masat për rimëkëmbje, përfshijnë; strehimin e përkohshëm, informacionin publik, kujdesin mjekësor, sigurinë, rindërtimin, programe këshillimi dhe studime mbi ndikimin ekonomik dhe dokumentimin e mësimave të marra.

4. Dobësitë dhe mangësitë ekzistuese të identifikuara në sistemin e Reduktimit dhe Menaxhimit të Riskut dhe Fatkeqësive në Shqipëri

Referuar kuadrit ligjor, institucional, raporteve të mbajtura nga institucionet ndërkombetare dhe mësimave të nxjerra nga fatkeqësia e fundit madhore nga e cila u prek Shqipëria, tërmeti i Nëntorit 2019, mund të listojmë disa nga mangësitë dhe dobësitë e DRR dhe DRM në Shqipëri;

- Burimet e përshtatshme dhe të afta njerëzore të domosdoshme për integrimin e RRF (DRR) në të gjithë sektorët janë të kufizuara në Shqipëri.

- Politikat e qarkullimit nuk mund të garantojnë vazhdimësinë e shërbimeve teknike shumë specifike, si në rastin e një dhome monitorimi 24/7 në IGJEUM e cila ka implikime për lëshimin e një alarmi të menjëhershëm për autoritetet përkatëse në rast të një tërmeti²².

- Nuk ka asnjë provë të trajnimit të nivelit të lartë specifik për “menaxherët / menaxhimin e fatkeqësive;

- Mungesa e pajisjeve të forcës operative moderne dhe homogjene, siç janë ekipet e MZSH-së dhe USAR.

²² Post Disaster Needs Assessment 2019

- Kapaciteti i agjencive teknike për të modeluar, parashikuar, vlerësuar, monitoruar dhe paralajmëruar për risqet që lidhen me rreziqet dhe ndryshimet klimatike mungon dhe ka nevojë për zhvillim në mënyrë që të sigurojë informacionin e duhur që është i arritshëm dhe i kuptueshëm për përdoruesit e fundit dhe që mund të formonë bazën e politikave efektive strukturore dhe jo-strukturore të parandalimit.

- Vlerësimi i ndikimit të riskut nga fatkeqësitë mungon dhe duhet të përfshihet në projektet kryesore të zhvillimit.

- Cenueshmëri shtesë, është se madje edhe kur sigurohen informacione për rreziqe dhe risqe ose këshilla teknike, ai ose përdoret pjesërisht ose nuk përdoret.

- Të gjithë sektorët duhet të integrojnë DRR në politikat dhe planet e tyre mjedisore, përdorimit të tokës dhe ndryshimeve klimatike;

- Mos implementimi i plotë i sistemit të planifikuar të Mbrojtjes Civile dhe DRR për zbatimin e ligjit të ri të mbrojtjes civile dhe përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe palëve të interesuara, përfshirë shoqërinë civile dhe sektorin privat, financimin e DRR në nivelin qendror dhe lokal, etj.

- Vonesa në miratimin e EUROCODE dhe një hartë të re të rrezikut sizmik, e cila do të rezultojë në humbjen e objektivit të planifikimit të sigurtë, projektimi të sigurve dhe rindërtimit të sigurtë.

5. Rekomandime

Kërkohet një proces gjithëpërfshirës identifikimi mësimesh për të menaxhuar riskun në nivele të ndryshme të qeverisë²³. Ekziston nevoja për të forcuar marrëveshjet ekzistuese institucionale, legjislative dhe financiare për menaxhimin gjithëpërfshirës të riskut nga nga fatkeqësitë. Aktet dytësore të Ligjit 45/2019 për Mbrojtjen Civile duhet të zbatohen. Duhet të zhvillohet një doktrinë gjithëpërfshirëse shumë rrezikëshe e operacioneve për të lehtësuar prodhimin e politikave të ndërlidhura dhe procedurave standarde të funksionimit. DRR duhet të jetë i integruar në të gjitha politikat duke i kushtuar vëmendje çështjeve mjedisore, përdorimit të tokës dhe çështjeve që lidhen me ndryshimin e klimës. Ekziston nevoja për të vazhduar përparimin në aplikimin për anëtarësim në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit (UCPM). Duhet të shpërndahen parimet udhëzuese për përdorimin e buxheteve specifike të miratuara për DRR-në në Ligjin 45/2019 dhe të zhvillohet një sistem për të monitoruar shpenzimet dhe rezultatet. Për të lehtësuar dhe mbikëqyrur tërë riparinin dhe rikkualifikimin, dhe përpjekjet e rindërtimit për një periudhë deri në pesë vjet, duhet të krijohet një mekanizëm i duhur, dhe do të duhet të forcohet sistemi ekzistues i qeverisjes dhe zbatimit.

Gatishmëria dhe reagimi duhet të forcohen me masa strukturore dhe jo strukturore. Ndër masat strukturore, ekziston nevoja e qartë për një ndërtesë të përshtatshme për AKMC-në²⁴. Ekziston nevoja për një sallë operacionale emergjence të përshtatshme për të plotësuar ato që menaxhohen nga FA, Policia e Shtetit dhe shërbimet mjekësore. Prefekturat dhe bashkitë kanë nevojë për salla operacionale emergjence të pajisura për të funksionuar me sallën kombëtare operacionale. Mungesa e një qendre kombëtare trainimi për të gjithë aktorët DRR nga reaguesit e vijës së parë deri te menaxhimi i emergjencave është një hendek i qartë. Sigurimi i një qendre trainimi mund të përmirësojë shumë gatishmërinë dhe përgjigjen në të gjitha nivelet.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

²³ Post Disaster Needs Assessment 2019.

²⁴ Po aty.

Të krijohet një program gjithëpërfshirës trajnimi për menaxhimin e fatkeqësive. Ekipet ekzistuese ushtarake USAR dhe MZSH kërkojnë një program kombëtar të standardizuar të trajnimit. Ata janë gjithashtu të pajisur dobët dhe kërkojnë përmirësime të konsiderueshme në pajisjet e tyre. Kjo është për t'i bërë të mundur që ata të kryejnë operacione ditore dhe të jenë më të përgatitur për t'iu përgjigjur emergjencave në shkallë më të madhe. Depot e rezervave shtetërore janë të vendosura në ndërtesa të vjetra dhe të dobëta, të cilat kanë nevojë për rinovim dhe nivelet e rezervave të kërkuara duhet të rishikohen dhe ruhen / monitorohen në përputhje me praktikat moderne. Planet e emergjencës civile në nivel kombëtar, qarku dhe bashkie duhet të zhvillohen ose përmirësohen duke integruar identifikimin / vlerësimin gjithëpërfshirës të riskut dhe duke përfshirë procedurat standarde operationale me shumë aktorë. Institucionet komunikojnë pa një sistem të përbashkët. MZSH dhe Policia nuk janë të lidhura në mënyrë efektive me qendrën kombëtare të trajtimit të thirrjeve të numrave të emergjencës. Një sistem për përpunimin e thirrjeve në një "qendër të trajtimit të thirrjeve emergjente" (112) zbatohet vetëm në Tiranë dhe duhet të futet në zonën e prekur dhe më vonë të shtrihet në të gjithë vendin.

Përmirësimi i Monitorimit të Riskut me shumë rreze, cenueshmërisë dhe Vlerësimit të Riskut, Informacionit të Riskut, Zbutjes/lehtësimit të Riskut, Shpërndarjes dhe Ndërgjegjësimit. Agjensitë teknike duhet të përmirësojnë aftësinë e tyre për të modeluar, parashikuar, vlerësuar dhe monitoruar rreziqet dhe risqet në mënyrë që të sigurojnë të dhëna për qëllime informimi dhe paralajmërimi me identifikim të qartë të zonave me risk të lartë dhe komuniteteve në risk. Informacioni duhet të sigurohet në një formë të arritshme dhe të kuptueshme për përdoruesit përfundimtar. Për ndërtesat ekzistuese, ekziston nevoja për zhvillimin e një programi gjithëpërfshirës të identifikimit të riskut për të identifikuar burimet financiare të kërkuara për të përballuar masat strukturore për zbutjen e risqeve. Më në fund, ekziston nevoja për një përmirësim thelbësor të aktiviteteve ekzistuese të ndërgjegjësimit publik dhe fushatave edukative. Koncepti RRF (DRR) duhet të jetë i integruar në kurrikulat shkollore për të siguruar arsimimin e "aftësive jetësore".

Bibliografia

1. Raporti Botëror i Riskut 2019, ISBN 978-3-946785-08-8, www.worldriskreport.org.
2. Koleksioni Historik i të dhënave për Humbjen e Fatkeqësive në Shqipëri, CIMA (2104)ISBN / ISSN / DOI 97888906 06847.www.preventionweb.net/files/36736_historicalcollectionofdisasterlossd.pdf
3. VKM N. 348/2015 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 –2020", Botimet Zyrtare N. 86, maj 2015
4. VKM N. 9/2019 "Për adresimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", (2019), Botimet Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, N. 172, Dhjetor 2019
5. Ligji N. 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", Gazeta Zyrtare N.113, Gusht 2019
6. Lekkas, E., Mavroulis, S., Filis, C., Carydis, P. (2019), Tërmeti në 21 Shtator 2019, Buletini i Strategjive të Menaxhimit të Mjedisit, Fatkeqësive dhe Krizave, 13, ISSN 2653- 9454 .
7. Vlerësimi i Rrezikut nga Fatkqësitë në Shqipëri, UNDP (2003), Raport Përmbledhës.
8. Banka Botërore, (2014), Projekti AL-DRMAP-ICR, <http://documents.worldbank.org/curat/en/313781468193510916/pdf/ICR29910P110840C0disclosed050210140.pdf>.
9. Raporti i Vlerësimit të Dëmit nga Tërmeti në Shqipëri i Ekipit të Bankës Botërore GPurl D-RAS, (2019), M6.4.
10. Kuadri Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkqësitë 2015-2030.
11. Menaxhimi i fatkeqësive në Shqipëri, Analiza e Mangësive, OSCE 2017.
12. Objektivat e OKB mbi "Zhvillimin e Qëndrueshëm"
13. Marrëveshja e Parisit mbi Ndryshimet Klimatike.
14. "Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030"



Shënim i redaktorit.

Sipas kërkesës së autorëve, ky shkrim botohet i paredaktuar.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Emergjencat civile në nivel vendor: përballimi nëpërmjet rregullave, procedurave dhe koordinimit



■ **MSc. Agron Haxhimalli**
Drejtor Ekzekutiv,
Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
aam@albmail.com

Abstrakt

Pse nevojitet një plan i Emergjencës Civile në nivel vendor? Të gjitha bashkitë përballen me emergjencë. Bashkia nuk është immune ndaj këtyre kërcënimeve. Në shekullin që po jetojmë ne jemi më të prekur nga ndryshimet klimaterike e ngrohja globale e tjerë fenomene, si faktorë natyrorë, që sjellin përmytjet, zjarre, tërmete e të tjera fatkeqësi. Por, njëkohësisht, jemi po aq të rrezikuar sot edhe nga faktori njeri, që shkakton dëme duke mos menduar dhe duke mos vepruar strategjikisht e me plane për të përballuar fenomenet e fatkeqësitë e çdo lloji. Shumica e emergjencave civile menaxhohen pjesërisht në nivel lokal nga njësi të shërbimit të emergjencës, siç janë sektorët apo drejtoritë e emergjencave civile në bashki, ambulancat, shërbimi zjarrfikës dhe policia. Një emergjencë në shkallë më të gjerë kërkon më shumë burime dhe personel sesa mund të përballojnë strukturat e shërbimit të emergjencës përmendur më sipër. Për të qenë në gjendje të përgjigjen dhe koordinohen në mënyrë efektive në rast emergjence, është e domosdoshme që bashkitë të zhvillojnë një program gjithëpërfshirës të menaxhimit të emergjencave. Kjo është më se e nevojshme tashmë, që pas reformës territoriale dhe ligjit "Për vetëqeverisjen vendore" 139/2015, neni 29 i cili kalon në bashki funksionet në fushën e sigurisë publike duke rritur përgjegjësitë e bashkive për planifikimin dhe menaxhimin e situatave emergjente. Por edhe ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", si dhe strategjitë kombëtare, apo konventat e direktivat, duhet të njihen mirë dhe të zbatohen me korrektësi. Elementi kyç i gatishmërisë për përballimin e emergjencave është hartimi i planit të menaxhimit të emergjencave bashkiake. Njësia e emergjencave civile në bashki është njësia kyçe që koordinon trajnimet dhe dhënien e ndihmës në të gjitha aktivitetet në spektrin e menaxhimit të emergjencave duke: punuar drejtpërsëdrejti me të gjitha struktura të tjera bashkiake; bashkëpunuar me agjencitë vullnetare; koordinuar me strukturat rajonale dhe qendrore, për të siguruar udhëzimet dhe ekspertizën e kërkuar për bashkinë.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalë kyçe:

fatkeqësi, bashki, emergjencë, menaxhim, program, mbrojtje civile.

1. Hyrje

Në shekullin e 21-të ne jemi më të prekur nga ndryshimet klimaterike, ngrohja globale që sjell përmytjet dhe dukuri të tjera që shkaktojnë dëme në infrastrukturë dhe njerëz. Të gjitha bashkitë përballen me emergjenca. Bashkia nuk është imune ndaj këtyre kërcënimeve. Shumica e emergjencave civile menaxhohen pjesërisht në nivel lokal nga njësi të shërbimit të emergjencës siç janë sektorët apo drejtoritë e emergjencave civile në bashki, ambulancat, shërbimi zjarrfikës dhe policia. Megjithatë, një emergjencë në shkallë më të gjerë kërkon më shumë burime dhe personel se sa mund të përballojnë strukturat e shërbimit të emergjencës përmendur më sipër.

Për të qenë në gjendje të përgjigjen dhe koordinohen në mënyrë efektive në rast emergjence, është jetike që bashkitë të zhvillojnë një program gjithë përfshirës të menaxhimit të emergjencave. Kjo është më se e nevojshme tashmë që pas reformës territoriale dhe ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” 139/2015, neni 29 i cili kalon në bashki funksionet në fushën e sigurisë publike duke rritur përgjegjësitë e bashkive për planifikimin dhe menaxhimin e situatave emergjente. Elementi kyç i gatishmërisë për përballimin e emergjencave është hartimi i planit të menaxhimit të emergjencave bashkiake. Gjatë hartimit dhe miratimit të një programi emergjence, është i nevojshëm angazhimi i strukturave të bashkisë dhe të zgjedhurve vendorë, marrja e kontributit dhe mbështetja nga dhe agjenci të tjera mbështetëse që do të marrin pjesë në një rast të nevojës për një reagim urgjent. Sapo të miratohet plani, është e nevojshme që ky plan të testohet për të siguruar funksionimin e tij si dhe për të qartësuar personelin e urgjencës me rolet e tyre.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

1.1 Pse nevojitet një model udhëzuesi për përballimin e emergjencave në nivel vendor?

Njësia e emergjencave civile në bashki është njësi kyç që koordinon trajnimet dhe dhënien e ndihmës në të gjitha aktivitetet në spektrin e menaxhimit të emergjencave duke:

- punuar drejtpërsëdrejti me të gjitha struktura të tjera bashkiake;
- bashkëpunuar me agjencitë vullnetare;
- koordinuar me strukturat rajonale dhe qendrore
- për të siguruar udhëzimet dhe ekspertizën e kërkuar për bashkinë.

Miratimi dhe testimi i planit të emergjencës është hapi i parë për t'u kryer sa më shpejt të jetë e mundur. Fatkeqësitë natyrore janë kryesisht të papritura, kështu që është e rëndësishme të kemi një plan të miratuar përpara këtyre fatkeqësive. Planifikimi paraprak siguron që bashkia ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për t'u përgatitur për një emergjencë dhe zvogëlon dëmet në njerëz apo në infrastrukturë. Element kyç i gatishmërisë për emergjencë është zhvillimi i një programi bashkiak të menaxhimit të emergjencave. Në të 61 bashkitë e vendit duhet të organizohet java e gatishmërisë së emergjencave civile (p.sh. gjatë javës së dytë të tetorit/majit). Kjo është një mundësi dhe kohë ideale që bashkitë të punojnë për azhurnimet e planifikimit dhe rivlerësimit të punës së tyre, dhe të demonstrojnë kompetencat dhe fuqinë për të përballuar situata emergjente.

1.2 Zhvillimi i analizës: pse duhet ky udhëzues

Në rastin e Shqipërisë, arsyet për përgatitjen e këtij udhëzuesi janë disa. Së pari, ky udhëzues synon t'u shërbejë bashkive të reja post-reformë, të cilat duhet të marrin përgjegjësi mbi vete për emergjencë civile në çdo kohë, t'i orientojë ato drejt pritshmërisë qytetare për të pasur rol parësor dhe vendimtar në çështje të emergjencave civile, ngritjes së strukturave të qëndrueshme, qendra të shpëtimit dhe evakuimit si dhe tërë mekanizmit zinxhir për një sistem eficient në raste të emergjencave civile vendore.

Nga ana tjetër, referuar dhe praktikave në vendet e zhvilluara lidhur me menaxhimin e emergjencave civile, udhëzuesi vë theksin tek roli dhe përgjegjësitë e përbashkëta të kryetarëve dhe këshillave bashkiake. Vetëm me një bashkëpunim, përfshirje në proces dhe vendimmarrjeje të këshillit, mund të sigurohet ecuri dhe sukses në menaxhimin e emergjencave civile të çdo rasti, qoftë ky i izoluar apo i përhapur.

Gjithashtu, ky udhëzues mund të përdoret dhe zbatohet nga çdo organizatë/institucion që merr dhe ka përgjegjësi të përballimit të emergjencave civile. Ky udhëzues tregon hapat e përgatitjes së planit dhe të marrjes së përgjegjësive në funksion të dhënies dhe ofrimit të shërbimeve të emergjencës, ndaj kujtdo që ndodhet në situatë krize dhe emergjence. Parimet, rrugët, rregullat e përshkruara në këtë udhëzim mund të përshtaten sipas rastit dhe natyrës të bashkisë apo institucionit që do të ngarkohet për kryerjen e detyrave të caktuara në përballimin e emergjencave civile.

2. Metodologjia

Metodologjia e këtij udhëzuesi bazohet kryesisht në praktikat e vendeve të ndryshme për menaxhimin e emergjencave në nivel vendor; plane vendore të menaxhimit të

fatkeqësive natyrore si dhe te hapat që rekomandohen; studimi i literaturës nga bashkitë dhe projektet në fushën e emergjencave civile, si dhe projekte e praktika nga programe të bashkëpunimit ndërkufitar. Gjithashtu, pjesë e metodologjisë është kuadri ligjor dhe institucional në vendin tonë me ndryshimet e fundit dhe përshtatja me rrethanat aktuale, e zbatimi në kushte e rrethana specifike, - por hapat duhet të respektohen. Vlerësimi i nevojave për njohuri dhe kapacitet vendor në këtë fushë, dhe konkluzionet nga takime të këshillit konsultativ me qeverinë qendrore, kanë qenë një burim i përdorur për t'iu qasur këtij dokumenti.

3. Kuadri ligjor dhe institucional

Kuadri ligjor dhe ai institucional për përballimin e emergjencave civile parashikon ndërtimin e një rrjeti kombëtar të institucioneve dhe rolet përkatëse të tyre në rast të një emergjence civile. Pjesa e madhe e këtij legjislacioni është hartuar para miratimit të ndarjes së re territoriale dhe më e rëndësishmja para kalimit të mbrojtjes civile si funksion i bashkive, që ndodhi me miratimin e ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, nr. 139/2015 si dhe ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Për këtë arsye, ne do të shohim kuadrin ligjor në rend kronologjik, duke i dhënë përparësi legjislacionit të miratuar pas reformës territoriale, por gjithsesi do të përfshijmë edhe aktet ligjore më të hershme duke analizuar rolin e bashkive sipas këtij legjislacioni. Më konkretisht, sipas nenit 29 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve në fushën e sigurisë publike:

1. mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
2. garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
3. garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet;
4. parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

4. Analiza: pse duhet plani bashkiak i emergjencës

Qytetarët presin nga bashkia e tyre që ajo të reagojë në mënyrë efektive dhe të koordinuar ndaj situatave emergjente duke minimizuar çdo dëmtim ose humbje për njerëzit, pronën ose mjedisin. Kjo përgjigje do të jetë e mundur vetëm me një planifikim paraprak. Hartimi i një plani për emergjencat civile do të ndihmojë në ndarjen e roleve dhe përgjegjësisë, do të ofrojë udhëzime për personat përgjegjës për zgjidhjen e këtyre situatave, do të përcaktojë rolet dhe detyrat përkatëse, do të identifikojë burimet dhe kontaktet e emergjencës dhe do të përshkruajë operacionet e shpëtimit dhe evakuimit gjatë një emergjence. Në seksionet e mëposhtme do të qartësojmë hapat për hartimin dhe zbatimin e një plani të emergjencave civile dhe se përse na ndihmon ai.

4.1 Vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut është themeli për hartimin e planeve të emergjencës. Megjithatë,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

kryerja e kësaj analize të vlerësimit të rrezikut mund të kërkojë njohuri të specializuara të cilat bashkitë mund t'i përfitojnë nga diskutimet në një nivel më të gjerë rajonal e kombëtar me agjencitë e tjera partnere, bashkitë fqinje apo Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile. Drejtoria/sektori e emergjencave civile në bashki duhet të ndjekë këtë proces. Por kjo strukturë duhet të ngrihet, të funksionojë rregullisht dhe në mënyrë të përhershme jo vetëm në kohë të emergjencave. Kjo strukturë duhet të mbështetet me mjetet e duhura financiare.

4.2 Bashkëpunimi me drejtorinë/sektorin e emergjencave civile për përgatitjen e planit

Hartimi i një plani për përballimin e emergjencave është një proces menaxhimi që përdoret për të identifikuar vështirësitë e mundshme dhe brenda institucionit të bashkisë, eliminimin e këtyre vështirësive duke përmbytur kështu ofrimin e shërbimit në vazhdimësi dhe gjatë kohës së një emergjence civile. Ky plan do të duhet të parashikojë mënyrat e mjete për të adresuar humbjen pjesore ose të përgjithshme të aftësive të saj operacionale, siç mund të jenë stafi ose pajisjet që duhet të shërbejnë në çdo kohë.

4.3 Bashkëpunimi dhe integrimi i planit të emergjencës së bashkisë me organizata të tjera

Në programin gjithëpërfshirës të menaxhimit të emergjencave bashkia ka rëndësi përfshirja dhe integrimi i planeve emergjente të organizatave të tjera. Ky seksion i planit përfshin informacionin e planifikimit dhe operimit për organizata apo subjekte fizikë që mund të kenë një rol kyç në një emergjencë. Kjo mund të përfshijë agjenci joqeveritare si Kryqi i Kuq apo organizata të tjera humanitare me veprimtari në nivel bashkiak, rajonal, kombëtar apo bashkitë fqinje.

4.4 Plani i evakuimit

Çdo bashki duhet të ketë një plan evakuimi si një dokument plotësues për planin e menaxhimit të emergjencave bashkiake. Emergjencat e papritura si p.sh. prania e lëndëve/ mallrave të rrezikshme, zjarret në pyje ose përmytje të shkaktuara (kujto: rasti Shkodër, Vau Dejës, Lezhë, Fier dhe Vlorë ndër vite) mund të kërkojnë që bashkia të evakuojë banorët shpejt dhe për një periudhë të zgjatur kohe. Është shumë më e lehtë të planifikoni se si do të vazhdoni me evakuimin para se të ndodhë emergjenca sesa të prisni që të planifikoni atë sapo të ndodhë.

5. Seksion 2: hapat dhe procesi për të shkruar një plan

10 hapat për të zhvilluar një plan efektiv të reagimit në emergjencë.

Qëllimi i procesit të planifikimit është të prodhojë një vlerësim real të rreziqeve me të cilat ballafaqohet komuniteti juaj dhe të zhvillojë një program për përgjigje emergjente për të përballuar efektivisht këto rreziqe. Kjo gjithashtu do t'ju mundësojë që të përballoni në mënyrë efektive rreziqet e tjera që ju nuk i keni parashikuar.

5.1 Hapi 1: diskutimi, trajtimi dhe vendimi i këshillit bashkiak

Procesi i hartimit të një plani emergjence fillon dhe mbaron me këshillin bashkiak. Këshilli duhet të mbështesë idenë e planifikimit të emergjencave, të sigurojë fonde, dhe të miratojë anëtarët e komisionit vendor të emergjencave. Këto vendime duhet të publikohen sipas ligjit “Për informimin”.

5.2 Hapi 2: formimi i një komision të përhershëm të këshillit

Këshilli bashkiak duhet të emërojë dy ose më shumë anëtarë të këshillit në një komision të përhershëm, i cili do të shërbejë si ekzekutiv në një situatë emergjente dhe do të përfaqësojë shqetësimet aktuale në planifikimin e emergjencës. Komisioni përhershëm do të mbajë lidhje me koordinatorin e menaxhimit të emergjencave në lidhje me çështjet e planifikimit dhe kërcënimet emergjente në zonë.

5.3 Hapi 3: koordinatori i menaxhimit të emergjencave dhe Komisioni për Planifikimin e Menaxhimit të Emergjencave

Komisioni i përhershëm i këshillit duhet të emërojë koordinatorin e menaxhimit të emergjencave bashkiake, i cili ka mbështetjen e punonjësve bashkiakë, administratorëve dhe përfaqësuesve nga agjencitë që marrin pjesë në proceset e planifikimit emergjent. Shmangni një komision më shumë anëtarë. Do të ishte më mirë të ngrihej një grup mbështetës për të ofruar ekspertizë dhe ndihmë për tema të veçanta sipas nevojës. Ky grup mbështetës mund të përfshijë përfaqësues nga:

- Drejtoria e Policisë;
- departamenti i zjarrfikësve;
- ambulanca/qendra shëndetësore/drejtoritë arsimore;
- administrata bashkiake/njësitë administrative/administratorët e lagjeve/kryetarët e fshatrave;
- ndërmarrjet publike bashkiake ujësjellësit;
- shërbimet vullnetare si dhe struktura të tjera siç e kërkon ngjarja.

Shqyrtoni modelin e planit të emergjencës për t’u njohur me përmbajtjen e tij, për të kuptuar rolet dhe përgjegjësitë dhe për tu njohur me operacionet e nevojshme për menaxhimin e një emergjence.

5.4 Hapi 4: cakto qartë rolin dhe përgjegjësitë e drejtorisë/sektorit të emergjencave civile në bashki

Plani është një projekt për t’ju përgjigjur emergjencave. Një pjesë e zhvillimit të projektit përfshin dhënien e roleve dhe përgjegjësiave grupeve ose individëve të caktuar për aspekte të ndryshme të planifikimit ose reagimit emergjent.

5.5 Hapi 5: kryej vlerësimin e rrezikut

Jini realistë. Qëllimi nuk është që të parashikohet çdo rrezik i mundshëm, por të zhvillohen procedura sistematike që sigurojnë një përgjigje efektive ndaj një emergjence

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

të mundshme dhe jo aq të mundshme. Drejtoria/sektori e emergjencave civile në bashki mund dhe duhet të kryejë vlerësimin e rrezikut për bashkinë tuaj.

5.6 Hapi 6: përcaktoni burime për të cilat keni nevojë

Programi i menaxhimit të emergjencave bashkiake është po aq i efektshëm sa aftësia e bashkisë për ta zbatuar atë. Plani është në thelb një projekt për një reagim emergjent.

Konsideroni sa vijon: A mund t'i përgjigjeni më shumë se një emergjence në një kohë? Ku mund të gjeni njerëz shtesë dhe pajisje shtesë nëse është e nevojshme? A keni sistem të besueshëm të komunikimit dhe transportit në vend?

5.7. Hapi 7: hartoni planin e emergjencave

Sapo të gjitha pozicionet të plotësohen dhe burimet të identifikohen, është koha për të bashkuar të gjithë materialet në një pikë të vetme. Ndarja e punës së identifikimit të burimeve me anëtarët e Komisionit të Planifikimit të Menaxhimit të Emergjencave do ta bëjë këtë proces shumë më të lehtë për drejtorinë/sektorin përkatës.

5.8 Hapi 8: trajnimi

Stafi i drejtorisë/sektori të emergjencave duhet të njohë mirë rolet e përgjegjësive të tyre dhe të jenë të përgatitur për të ofruar udhëzime për stafin ose vullnetarët të cilët gjithashtu mund të jenë pjesë e ekipit të reagimit. Kjo strukturë në bashki ofron një sërë programesh trajnimi për menaxhimin e emergjencave bazë dhe të avancuara.

5.9 Hapi 9: testoni planin

Testoni planin tuaj, pjesërisht dhe tërësisht. Testimi i planit të emergjencës është po aq i rëndësishëm sa dhe shkrimi i planit. Ushtrimet mund të jenë stërvitje të vogla, diskutime apo ushtrime në shkallë të gjerë.

5.10 Hapi 10: përditësimi i planit dhe informimi i qytetarëve

Plani duhet të rivlerësohet dhe përditësohet çdo vit. Burimet dhe kontaktet shpesh ndryshojnë dhe zëvendësimi i shpejtë i tyre do të shmangë sfidat gjatë një përballimit të një situatë emergjente. Ndërgjegjësimi dhe mbështetja e publikut janë elemente kritike në planifikimin e emergjencave. Konsultohuni me drejtorinë/sektorin e emergjencave civile në bashki. Këshilli i Bashkisë ose kryetari mund t'i kërkojë drejtorisë/sektorit të emergjencave civile në bashki çështjet e përmendura. Gatishmëria ndaj emergjencave është një aktivitet i vazhdueshëm: shkruani planin tuaj dhe ushtrohuni!

6. Hartimi i planit të evakuimit

Në hartimin e një plani për evakuimin e banorëve dhe gjësë së gjallë duhet pasur parasysh:

kush bën çfarë në rast të një evakuimi, qetësi në ndarjen e detyrave, menaxho kohën dhe stresin. Bashkitë kanë përgjegjësi për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki, bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që ato përgatitin e testojnë.

6.1 Seksioni 3: veprimtaria e komisionit vendor në situata të emergjencave civile

Udhëzimet e planifikimit dhe operimit

Pasi bashkia juaj ka zhvilluar një plan emergjence, hapi tjetër është grumbullimi i komisionit vendor në një ambient sa më të përshtatshëm.

6.1.1 Vendndodhja fizike e komisionit vendor, pajisjet dhe furnizimet

Konsideroni faktorët e mëposhtëm kur të mendoni se ku mund të operojë KV i bashkisë suaj: Projektioni vendndodhjen e komisionit vendor përpara një emergjence. Analizoni rreziqet potenciale dhe merrini ato në konsideratë kur të zgjidhni vendin. Qendra e komisionit vendor, në mënyrë ideale, duhet të jetë në një vend dhe me një strukturë e vetëmjaftueshme dhe vetëmbështetëse që mund të operojë në mënyrë të pavarur për një kohë të arsyeshme me gjeneratorin e vet elektrik, dhe me një sistem të pavarur të furnizimit me ujë dhe kanalizim dhe ventilim të përshtatshëm. Projektimi i qendrës së komisionit vendor për bashkitë e vogla dhe të mëdha mund të ndryshojnë; secila bashki do të bëjë atë që realisht i duhet, të ndërtojë qendrën e komisionit vendor për t'iu përshtatur nevojave dhe kapaciteteve dhe rrethanave të zonës bashkisë.

6.1.2 Pajisja e qendrës së komisionit vendor

Më poshtë është një listë e sugjeruar e pajisjeve themelore për një qendër të grumbullimit të komisionit vendor të emergjencave civile në bashki.

6.4 Inventari i sugjeruar i artikujve për informim

Planet

Planet dhe udhëzimet e listuara më poshtë duhet të mbahen në një kabinet ose në raft librash të veçantë dhe të jenë në dispozicion për përdorim në rast urgjence:

- këndi i prezantimit,
- paraqitni diagramet dhe tabelat e renditura më poshtë në vende të dukshme,
- formati/modeli.

Modele apo forma standarde të dokumenteve të ndryshëm duhet të mbahen në dosje të ndryshme dhe të përdoren në përputhje me rrethanat. Ato përfshijnë informacione të ndryshme. Mbani në dispozicion harta dhe fotografi; hartat e sugjeruara të disponueshme nga sektori i mjedisit, qarkut, ushtrisë, energjisë, pylltarisë dhe bujqësisë. Grupi ekzekutiv i komisionit vendor është përgjegjës për marrjen e vendimeve operacionale për të mbështetur reagimin efikas ndaj një emergjence ose fatkeqësie.

6.1.3 Detyrat kryesore të komisionit vendor të emergjencave civile

Në zbatim të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 8756, dt. 26.3.2001, "Për emergjencat civile", i ndryshuar, në çdo bashki, nën drejtimin e kryetarit të bashkisë, krijohet komisioni vendor për emergjencat civile me detyrë bashkërendimin e veprimeve të autoriteteve të bashkisë ose komunës dhe organizatave vullnetare për planëzimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e vet.

6.1.4 Ekipi i komisionit vendor të emergjencave

Ekzistojnë katër funksione të menaxhimit të nevojshme gjatë një emergjence:

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

- veprime të shpëtimit apo evakuimit: përgjegjës për koordinimin e të gjitha operacioneve juridiksionale në mbështetje të reagimit emergjent nëpërmjet zbatimit të planit të veprimit të incidentit;

- planifikimi: përgjegjës për grumbullimin, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, hartimin e planit të veprimit të juridiksionit dhe përcjelljen e të gjitha burimeve, si dhe mbajtjen e të gjithë dokumentacionit të komisionit vendor;

- logjistika: përgjegjëse për sigurimin e objekteve, shërbimeve, personelit, pajisjeve dhe materialeve për komisionin vendor dhe vendin kur kërkohet;

- financa/administrimi: përgjegjës për aktivitetet financiare dhe aspekte të tjera administrative për komisionin vendor dhe vendin kur kërkohet. Autoriteteve vendore duhet t'u ofrohet mbështetje, koordinim dhe udhëzime për vendimmarrjet dhe politikat.

6.1.5 Personeli i komisionit vendor

Personeli dhe sektorët e përfshirë në komisionin vendor mund të ndryshojnë gjatë gjithë emergjencës. Institucionet dhe organizmat e jashtëm në komision vendor: në varësi të natyrës së emergjencës, përfaqësuesi i komisarit të policisë, që vepron në rajonin e bashkisë mund të marrë pjesë në komision vendor.

6.1.6 Procedurat e emergjencës

Hapi 1: kryeni shpërndarjen e punëve.

Kur ekziston ose mund të ekzistojë një emergjencë, koordinatori i menaxhimit të emergjencave bashkiake, kryetari i bashkisë ose punonjësi i emëruar prej tij, kontakton personat e lartpërmendur.

Hapi 2: aktivizimi i komisionit vendor.

Drejtuesi i komisionit vendor, i mbështetur nga aktorë të tjerë, do të ngrejë qendrën e veprimit të komisionit vendor. Kjo qendër mund të nënkuptojë përshtatjen e zyrës ekzistuese, sallës, dhomës së këshillit etj. në një dhomë ekzekutive, një dhomë operacioni, një dhomë komunikimi, një qendër informacioni publik, zonë sigurie, dhe zona të tjera informacioni.

Komunikimet: pa komunikim të duhur, efektiviteti i reagimit do të rrezikohet seriozisht.

Për publikun: informacionet e rregullta me fakte të sakta dhe informacion në kohë janë të rëndësishme.

Hapi 3: shpërndarja e komisionit vendor

Pasi nuk ka më nevojë për përkrahje shtesë ose kur ekipet bashkiake kanë filluar të pastrojnë vendin, drejtuesi i komisionit vendor duhet të fillojë të marrë në konsideratë shpërndarjen e komisionit vendor deri në mbledhjen e tij të radhës.

Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të komisionit vendor

Drejtuesi i komisionit vendor. Zakonisht është kryetari i bashkisë, por kur kjo nuk është e mundur do të jetë në person i emëruar prej tij që i raporton kryetarit. Përgjegjësia primare e drejtuesit është të bashkërendojë përgjigjen efikase në një situatë emergjence. Drejtuesi i komisionit vendor do të koordinojë dhe menaxhojë të gjitha burimet e nevojshme për emergjencë.

6.2 Seksioni 4: komunikimet në raste krizash

Një plan komunikimi i krizës është një pjesë jetike e gatishmërisë dhe reagimit

emergjent.

6.3 Seksioni 5: shërbimet sociale emergjente

Shërbimet sociale emergjente janë shërbimet esenciale që plotësojnë nevojat e menjëhershme jomjekësore në rast fatkeqësie ose emergjence.

Kur zyrtarët e bashkiakë kanë nevojë për mbështetje në përgjigje të një emergjence, është e rëndësishme që ata të kuptojnë qartë se ku dhe si mund të gjejnë ndihmën.

6.4 Seksioni 6: A jeni të përgatitur? Ushtrime për emergjencat bashkiake

Një stërvitje emergjente është një simulim i një emergjence aktuale. Ushtrimi u mundëson njerëzve të ushtrojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre, të provojnë përdorimin e pajisjeve përkatëse, të rrisin partneritetet me agjencitë e tjera dhe të mësojnë se kujt i raportojnë. Është një mundësi për përgjegjësit që të testojnë planet dhe të identifikojnë boshllëqet pa pasojat që mund të ndodhin në një emergjencë të vërtetë. Suksesi i një stërvitjeje matet nëse krijohet një mjedis realist për të ushtruar një reagim emergjent për të identifikuar gabimet dhe për të ndërmarrë veprime korrigjuese.

7. Gjetjet nga praktikat e mira

Miratimi dhe testimi i planit të emergjencës është hapi i parë për tu kryer sa më shpejt të jetë e mundur. Fatkeqësitë natyrore janë kryesisht të papritura, kështu që është e rëndësishme të kemi një plan të miratuar përpara këtyre fatkeqësive. Planifikimi paraprak siguron që bashkia ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për t'u përgatitur për një emergjencë dhe zvogëlon dëmet në njerëz apo në infrastrukturë. Element kyç i gatishmërisë për emergjencë është zhvillimi i një programi bashkiak të menaxhimit të emergjencave. Në rastin e Shqipërisë, arsyet për përgatitjen e këtij udhëzuesi janë disa. Së pari, kjo udhëzimet synojnë t'u shërbejë bashkive të reja post-reformë, të cilat duhet të marrin përgjegjësi mbi vete për emergjencat civile në çdo kohë, t'i orientojë ato drejt pritshmërisë qytetare, për të pasur rol parësor dhe vendimtar në çështje të emergjencave civile, të ngritjes së strukturave të qëndrueshme, qendrave të shpëtimit dhe evakuimit si dhe tërë mekanizmit zinxhir për një sistem eficient në raste të emergjencave civile vendore.

7.1 Ndikimi dhe konkluzioni

Njësitë e pushtetit vendore do të kenë struktura të ngritura e të gatshme për raste emergjence. Këto struktura do të jeni operacionale, me njohuri dhe praktikë për organizim institucional dhe administrativ. Njësitë e qeverisjes vendore do të jenë të mirëorganizuar nga aspekti i infrastrukturës, me bazë materiale dhe logjistike të gatshme. Njësitë e qeverisjes vendore duke ndjekur këtë udhëzues do të jenë në gjendje të koordinojnë dhe komunikojnë më shpejt dhe me saktësi. Duke ndjekur këtë udhëzim do kemi një bashkëpunim ndër-institucional me të koordinuar. Referuar edhe praktikave në vendet e zhvilluara, lidhur me menaxhimin e emergjencave civile, praktikat udhëzuese vënë theksin tek roli dhe përgjegjësitë e përbashkëta të kryetarëve dhe këshillave bashkiakë. Vetëm me bashkëpunim, përfshirje në proces, përgatitje të strategjive e planeve lokale të mbrojtjes civile, dhe duke i dhënë fuqi nëpërmjet vendimarrjes, këshilli vendor, mund të japë siguri për jetën dhe siguri social-ekonomike.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

7.2 Gjetjet

Zbatimi i rregullave, procedurave ligjore, organizimi institucional në nivel vendore ndihmojnë në përballimin e emergjencave civile në çdo bashki me efektivitet dhe produktivitet. Produktiviteti i rritur nga zbatimi udhëzuesit do të ulë rrezikun për qytetarët dhe ekonominë. Efektiviteti i punës nga ndjekja e këtij udhëzuesi do rrisë dhe nxisë kulturë të re pune dhe ndërhyrjesh, në raste fatkeqësish të ndryshme. Një shkolle e re njohurish dhe kulture mbi menaxhimin e rreziqeve do zhvillohet në njësitë vendore.

Bibliografia

1. Menaxhimi i emergjencave civile nga UNDP, www.undp.org/albania.
2. Menaxhimi i emergjencave civile në nivel lokal, manuali i NALS për vendet e Evropës Juglindore. www.nalas.eu
3. Praktika nga menaxhimi i emergjencave civile në Bashkinë Brindizi; www.hazard.eu
4. Praktika e pune për emergjencat civile në Bashkinë Danilovgrad. www.danilovgrad.me
5. Udhëzues nga projekti "Flood and landslide assistance and training", Ipa Itali-Mali Zi dhe Shqipëri. www.flat-project.org
6. Material dhe informacione të mbledhura nga forumet dhe praktikat e Shoqatës së Bashkive mbi emergjencat civile. www.aam.org
7. Raporti IDM; www.idmalbania.org




AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Roli i Policisë së Shtetit në menaxhimin e krizës shkaktuar nga pandemia COVID-19



■ **Dr. Blerta Dervishi**
Policia e Shtetit,
Drejtorja Vendore e Policisë Tiranë
blerta.dervishi@yahoo.com



■ **MSc. Erlisa Rakipi**
Policia e Shtetit,
Drejtorja e Antiterorrit
erisa.rakipi@asp.gov.al

Abstrakt

Shqipëria, në këto dy vitet e fundit, është përballur me dy kriza të njëpasnjëshme të paprecedentë për shkakt të tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe të shpërthimit të pandemisë COVID-19 që nga marsi 2020 e në vijim. Në mbarë planetin, njerëzimi po përballlet me një fenomen të paparë në njëqind vitet e fundit që ka marrë mbi dy milion e pesëqind mijë jetë njerëzish në mbarë globin, kjo referuar nga seksioni i OKB-së për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzimit. Problemet përzgjidhje, janë jashtëzakonisht komplekse, e të vështira për t'u menaxhuar. Është kjo arsyeja që nuk mund të perceptohet puna e policisë formalisht vetëm në kuadrin e përgjegjësiive tradicionale, siç jemi mësuar të marrim në analizë punën tonë, që është zgjeruar jashtëzakonisht në shtrirje dhe në përmasa. Pandemia kushtëzon konceptimin dhe organizimin e një strukture njerëzore të specializuar. Koordinimi i veprimeve logjistike permanente me grupin e ekspertëve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Shëndetit Publik; me spitalet COVID dhe me spitalet rajonale duhet vlerësuar si parësore. Rreziqet e identifikuar, të vërtetuara nga virulenca e lakores (kurbës) së infeksionit dhe humbjeve të jetëve nga COVID-19, imponojnë domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndër departamenteve për menaxhimin e problemit të gjeneruar nga kjo pandemi. Policia si pjesë përbërëse e Sistemit Kombëtar të Menaxhimit të Emergjencave, ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" e në zbatimin e detyrave të caktuara në menaxhimin e situatës speciale emergjente e gjeneruar nga pandemia COVID-19 duhet të organizojë trajnime të shpejta dhe periodike për njohjen dhe mënyrat e ndërgjegjësimit të popullatës, gjithmonë në zbatim të ligjit. Pandemia COVID-19 ka krijuar një sërë sfidash të paparashikuara dhe të papara për departamentet e policisë në të gjithë botën nga e cila s'mund të shpëtonte as Shqipëria. Qëllimi i këtij shkrimi është të përvijojë në mënyrë të përmblendhur detyrat e Policisë së Shtetit për të përballuar me sukses emergjencat civile dhe fokusimin e punës së policisë.

Fjalëkyçe:

koronavirus, pandemi, menaxhimi për kontrollin e krizës, policia.

1. Hyrje

Koronaviruset (CoV) janë viruse që i përkasin rendit *Nidovirales*, familjes *Coronaviridae*, nënfamiljes *Orthocoronavirinae*, të cilat infektjnë njerëzit dhe një shumëllojshmëri të gjerë të kafshëve (zogj dhe gjitarë). Sëmundja karakterizohet nga simptoma kryesisht në frymëmarrje: ethe, kollë e thatë, frymëmarrje e vështirë me ashpërsi të ndryshme, dhe mund të kalojë në pneumoni intersticiale [me ndërshtresa] bilaterale, dështim të frymëmarrjes ose shqetësim të frymëmarrjes akute (ARDS) që është shkaku kryesor i vdekjes. Në dhjetor 2019, njerëzit e parë të infektuar me virusin SARS-CoV-2 u shfaqën në Wuhan, të provincës Wuhan, në Kinë, nga ku, ky virus u përhap me shpejtësi në shumicën e provincave kineze dhe në shumicën e vendeve të botës, duke shkaktuar një pandemi.

Më 11 mars 2020, sëmundja u shpall pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Në përgjigje të kësaj, si shumica e vendeve qeveria shqiptare përqendroi përpjekjet fillestare në bllokimin e transmetimit, duke karantinuar rastet e konfirmuara dhe izoluar kontaktet. Me rritjen e shpejtë të numrit të individëve të infektuar, qeveria filloi të përdori procedura më kufizuese në lidhje me aktivitetet dhe lëvizjet e popullatës së përgjithshme. Sidoqoftë, efektiviteti i këtyre përgjigjeve ndryshonte për shkak të disa faktorëve të tillë si: afatet kohore, gatishmëria e sistemeve të kujdesit shëndetësor, dhe madje edhe aspektet sociokulturore që ndikuan në vetëdijesimin dhe pajtueshmërinë e publikut.

Në Shqipëri, autoritetet ndoqën rekomandimet e OBSH-së, duke zbatuar në këtë mënyrë masa për përballimin e pandemisë nga koronavirusi i ri. Sidoqoftë, sfidat me të cilat u përball qeveria në kontrollit të epidemisë kaloi në faza të ndryshme, nga që u përball me një numër të madh të qytetarëve që ktheheshin nga jashtë, infrastruktura

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

joadekuate e sistemit të kujdesit shëndetësor dhe përcaktuesit sociokulturorë. Në këtë punim, do përfshihen arritjet në përballjen me COVID-19 në Shqipëri me qëllim që të përgatiten strategjitë e ardhshme në kontekstin e një pandemie vijuese edhe për mjaft kohë. Duke nxjerrë mësim të rëndësishme nga një seri përvojash të ndodhura në Shqipëri, mund të merren si shembull për të ndihmuar menaxhimin e krizave të ardhshme të shëndetit publik dhe për të shtuar efikasitetin e rolit të policisë në mirë menaxhimin e situatave dhe emergjencave afatgjata të pandemisë.

1.1 Historik i shkurtër

Fazat e hershme të pandemisë COVID-19 në Shqipëri

- Më 8 mars 2020, Shqipëria konfirmoi dy rastet e para me koronavirus (babë e bir), të cilët kishin ardhur në Shqipëri nga Firencja, Itali¹. Në të njëjtën ditë, qeveria ndaloi të gjitha fluturimet dhe tragetet që vinin nga zona veriore e Italisë, deri më 3 prill². Qeveria mbylli gjithashtu shkollat, për dy javë; urdhëroi ndalimin e të gjithë grupimeve të njerëzve si dhe u kërkoi federatave të sporteve të pezullonin aktivitetet³. Ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, njoftoi se çdo person që hyn në Shqipëri nga zonat me karantinë të Italisë, duhet të vetizohet, ose do të ndëshkohej⁴.

- Më 10 mars, Presidenti i Shqipërisë, z. Ilir Meta, u bëri thirrje mjekëve të pensionuar që të riktheheshin në punë për të dhënë kontributin e tyre në luftën kundër virusit COVID-19⁵.

- Në mesditën e 11 marsit u shënu vdekja e parë nga koronavirusi në Shqipëri; që ishte një grua 73 vjeç nga Durrësi, e cila pësoi komplikime vaskulare⁶.

- Më 12 mars, Mira Rakacolli, zëvendësministria e Shëndetësisë, deklaroi se në 24 orët e fundit, 145 njerëz u ishin nënshtruar testeve për COVID-19. U rrit numri i të infektuarve me 23; dhe, të 23 personat e infektuar, kishin histori udhëtimi në Itali ose kishin rënë në kontakt me njerëz që kishin qenë në Itali⁷.

- Më 13 mars, Ministria e Shëndetësisë njoftoi se numri i të prekurve me koronavirus kishte shkuar në 33, pas 159 testeve të reja të kryera në 24 orët e fundit⁸. Po atë ditë, qeveria njoftoi mbylljen e qyteteve të mëdha, përfshirë edhe Tiranën, deri të dielën në mesnatë; disa nga masat e marra ishin bllokimi i rrugëve, ndalimi i makinave private dhe mbyllja e të gjithë bizneseve (me përjashtim të farmacive dhe dyqaneve ushqimore)⁹. Të gjithë shtetasve të huaj që u duhej të largoheshin nëpërmjet aeroportit, u duhej të merrnin leje me shkrim nga policia për të përdorur aeroportin¹⁰.

¹ "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale". Facebook. Marrë më 9 mars 2020.

² "Ndalohen fluturimet me 10 destinacione drejt Italisë". TV Klan. 9 mars 2020. Marrë më 10 mars 2020.

³ "Dy raste me covid 19/ Rama jep urdhrin: Mbyllen shkollat për dy javë". Top-Channel.tv. 9 mars 2020. Marrë më 10 mars 2020.

⁴ "Çfarë është karantina e detyruar në shtëpi? Manastirliu sqaron hapat: Do merren masa nëse...". Gazeta Panorama. 9 mars 2020. Marrë më 10 mars 2020.

⁵ "President Calls for Retired Doctors' Involvement in Fighting Coronavirus" [Presidenti bën thirrje për doktorët e pensionuar për t'u përfshirë në luftën ndaj Koronavirusit] (në anglisht). Albanian Daily News. 10 mars 2020. Marrë më 11 mars 2020.

⁶ "Shënohet viktima e parë me koronavirus në Shqipëri! Vdes në reanimacion 73-vjeçarja nga Durrësi, vuante nga zemra". Shqiptarja.com. 11 mars 2020. Marrë më 11 mars 2020.

⁷ "Shkon në 23 numri i të infektuarve me koronavirus në Shqipëri, zgjerohet harta e qyteteve të prekura (VIDEO)". Shqiptarja.com. 12 mars 2020. Marrë më 12 mars 2020.

⁸ "Koronavirusi në Shqipëri, shkon në 33 numri i personave të prekur, 4 raste në Fier". a2news.com. 13 mars 2020. Marrë më 13 mars 2020.

⁹ "Shqipëria në 'shtetprethim'! Bllokohet transporti urban, e premte- e diel s'ka qarkullim as të makinave private e taksive në 8 qarqe, përjashtohen mjekët e pacientët". Shqiptarja.com. 13 mars 2020. Marrë më 12 mars 2020.

¹⁰ "VENDIMI DRASTIK I RAMËS/ Nga e premte deri të dielën në mesnatë, BLOKOHET edhe QARKULLIMI I MAKINAVE PRIVATE". Newsbomb.com. 13 mars 2020. Marrë më 12 mars 2020.

2. Masat e shtetit shqiptar për menaxhimin e krizës shëndetësore të shkaktuar nga COVID-19

Analizuar nga perspektiva e evolucionit të situatës së krizës shëndetësore, e gjeneruar nga infeksioni me koronavirusin e ri në Shqipëri, masat e urdhëruara nga autoritetet shtetërore shqiptare mund të renditen në tre faza, përkatësisht:

a) *faza I*: masat e para emergjente, që korrespondojnë me shfaqjen e rasteve të para të infeksionit dhe fillimin e krizës shëndetësore;

b) *faza II*: masat e mara për menaxhimin e gjendjes së jashtëzakonshme, që përkojnë me rritjen alarmante të rasteve të së infektuarve dhe përkeqësimin e krizës shëndetësore;

c) *faza III*: masat që u morën për rritjen e nivelit të gjendjes së gatishmërisë, që përkuan me uljen të rasteve të infektimeve me koronavirusin e ri dhe efikasiteti në kontrollin e krizës shëndetësore.

1. Më 8 mars, qeveria ndaloi të gjitha fluturimet ajrore dhe lundrimin e tragetave nga zonat e futura në karantinë në veri të Italisë deri më 3 prill¹¹, u bë ndalimi i mësimin në të gjitha shkollat për dy javë, si dhe u urdhërua anulimi i të gjitha tubimeve të mëdha publike dhe iu kërkua federatave sportive të anulonin ndeshjet e planifikuara¹². Ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu njoftoi se kushdo që hyn në Shqipëri nga zonat e karantinuara të Italisë, do të duhej të izolohej, ose të përballej me ndëshkime nëse nuk do të pranonin ta bënin këtë.

2. Më 10 mars, të gjithë qytetarët u njoftuan nga kryeministri Rama që të ndërmerrnin të gjitha veprimet e domosdoshme¹³. Gjithashtu u krye dezinfektimi i të gjitha vendeve publike. Pensionistët morën pensionet e tyre në shtëpi pa pagesë. U urdhërua mbyllja e bareve, restoranteve, palestrave, diskove dhe vendeve me muzikë *live*.

Kryeministri Edi Rama njoftoi gjithashtu zgjerimin e zonave nga cilat prej tyre qytetarët që mbërrinin prej tyre duhet të izolohej, për të përfshirë të gjithë qytetarët shqiptar dhe të huaj që vinin nga Italia, Greqia, dhe urdhëroi policinë të patrullojë rrugët dhe të ndalojnë çdo shkelës dhe t'i ndëshkojë shkelësit e ligjit me një gjobë 5000 euro¹⁴. Ushtria dhe policia u mobilizuan për të patrulluar rrugët dhe për të kërkuar nga çdo qytetar që kishin urdhër izolimi të mos e shkelnin ata.

Deri në datë 12 mars, 500 persona ishin akuzuar për shkelje të ndalimit të udhëtimit¹⁵.

Më 12 mars, kryeministri Edi Rama i shpalli "situatë lufte" për COVID-19, duke njoftuar shumë masa të reja; në mënyrë të veçantë u njoftua shtetërrëthimi 72-orësh, gjatë së cilit do të lejohej dalja nga shtëpia vetëm për nevojat themelore, si ushqimi dhe ilaçet, një pushim kredie tre mujore, dhe u urdhërua mbyllja e detyruar e fabrikave të veshjeve dhe qendrave të thirrjeve (të cilat varen nga tregu italian)¹⁶.

¹¹ "Ndalohen fluturimet me 10 destinacione drejt Italisë". TV Klan. 9 mars 2020. Marrë më 11 mars 2020.

¹² "Albania ha its schools, Italy flights, ferries over coronavirus" (në anglisht). Reuters. 8 mars 2020.

¹³ "Coronavirus, Albania in lockdown" (në anglisht). Tirana Times. 12 mars 2020. Arkivuar nga origjinali origjinali më 11 mars 2020. Marrë më 16 mars 2020.

¹⁴ "Coronavirus, Albania in lockdown" (në anglisht). Tirana Times. 12 mars 2020. Arkivuar nga origjinali origjinali më 11 mars 2020. Marrë më 16 mars 2020.

Government Orders Mandatory Self-Quarantine for Anyone Coming from Italy and Greece" (në anglisht). Exit News. 11 mars 2020.

¹⁵ "Coronavirus, Albania in lockdown" (në anglisht). Tirana Times. 12 mars 2020. Arkivuar nga origjinali origjinali më 11 mars 2020. Marrë më 16 mars 2020.

¹⁶ "Koronavirus/ Shqipëria fillon 3 ditë në 'shtetërrëthim'! 509 shoferë të ndëshkuar, Korça shembull i ndërgjegjësimit". Shqiptarja.com. 13 mars 2020. Marrë më 17 mars 2020.

U mobilizuan, policia dhe ushtria, dhe u ngritën gjithsej 70 postbllqe atë ditë, të shpërndara në të gjithë vendin, për të siguruar që qytetarët ishin korrekt në zbatimin e kërkesave të vetëkarantinimit¹⁷. Në pikat e kontrollit, punonjësit e policisë ishin pajisur me pajisje kompjuterike, për të verifikuar në çast, të dhënat nga sistemi elektronik për identifikimin e qytetarëve që mund të kishin ardhur nga jashtë, ose që vinin kryesisht Italia apo Greqia, që nga data 27 shkurt. Policia, në disa pjesë të vendit, përfshirë Fierin, filloi të ndalojë makinat me targa të huaja, ku përfshiheshin qytetarë nga: Fieri, Tirana dhe Durrësi, u pezullua i gjithë transportin publik dhe u mbyllën të gjitha kafenetë, baret, restorantet, si dhe palestrat dhe zyrat qeveritare dhe sportelet e shërbimeve publike. Të gjitha bankat ishin të mbyllura nga ora 12:00 në orën 16:00, por ATM-të mbetën të hapura.

Në zbatim të ligjit, institucionet fetare njoftuan pezullimin e të gjitha shërbimeve liturgjike për besimtarët dhe u këshilluan nga klerikët e tyre që të kryenin lutje personale duke mbajtur një distancë nga të tjerët¹⁸, duke respektuar rekomandimet e autoriteteve.

3. Nga 13 marsi, Shqipëria ka zbatuar masat e bllokimit të plotë të veprimtarive në qytetet e mëdha në të gjithë vendin, përfshirë Tiranën, gjatë fundjavës deri të Dielën në mesnatë. Rugët që lidhin qytetet e mëdha gjithashtu u mbyllën. Shtetasit e huaj u duhej detyrimisht të pajiseshin me lejen me shkrim nga policia për të përdorur rugët. Të gjitha objektet publike në aeroport u mbyllën, përfshirë restorante dhe bare. Udhëtimi me det nga Greqia dhe Italia u ndaluan, përveç anijeve të mallrave.

Më 15 mars, Shqipëria mbylli të gjithë kufijtë e saj tokësorë deri në një njoftim të mëtejshëm, duke ndaluar të gjithë udhëtimet e shtetasve nga Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Greqia. Institucionet arsimore u urdhëruan të përgatiteshin për ta zhvilluar mësimin *online*. Gjithashtu u mbyllën të gjithë: muzetë, kinematë, teatrot dhe parqet publike. Qeveria shqiptare organizoi fluturime për të sjellë shtetasit shqiptarë që ishin bllokuar në Itali.

4. Më 16 mars, Shqipëria pezulloi pafundësisht të gjitha fluturimet drejt, dhe nga Mbretëria e Bashkuar¹⁹.

Në të vërtetë, vendi filloi të përballlet me probleme të rënda në menaxhimin e situatës nga rritja e numrit të pacientëve me COVID-19.

Akti normativ mbështeste planifikimin dhe forcimin e punës për zbatimin të rregullave, të vendimeve, të urdhrave dhe të udhëzimeve të nxjerra nga organet kompetente, pa përjashtim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin dhe duke planifikuar deri në detaje luftën për pengimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Ky akt normativ vinte si një domosdoshmëri në kushtet kur Organizata Botërore e Shëndetësisë, shpalli pandemi botërore dhe, për pasojë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shpalli gjendjen e epidemisë²⁰.

3. Përparësitë, problematikat, pritshmëria

Si në shumë vende të botës edhe Shqipëria është pjesë listës së shteteve ku është përhapur infeksioni shkaktuar nga COVID-19. Të gjitha strukturat shëndetësore janë të

¹⁷ "Koronavirusi, policia dhe ushtria 70 pika kontrolli në të gjithë vendin". Koha Jonë. 12 mars 2020. Marrë më 17 mars 2020.

¹⁸ "Almarina Gegvataj (12 mars 2020). "Masat ndaj koronaviurit/Kisha Ortodokse: Pezullohen të gjitha shërbesat ditore deri më 3 prill". Agjencia Telegrafike Shqiptare. Marrë më 17 mars 2020.

¹⁹ "Shqipëria ndalon të gjitha fluturimet me Britaninë e Madhe nga 16 marsi". Syri.net. 16 mars 2020

²⁰ Ligji 24/2020

angazhuara maksimalisht për të parandaluar dhe diagnostikuar këtë infeksion. Çdo ditë, në laboratorin e virologjisë në Institutin e Shëndetit Publik, janë realizuar mbi njëmijë teste dhe padyshim numri i personave të prekur vazhdon të rritet. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe në zbatim të udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ka ndërmarrë një sërë masash në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, si më poshtë:

- a) ndalimi dhe kufizimi i lëvizjeve me mjetet e transportit;
- b) mbyllja deri në një njoftim të dytë e të gjitha bareve, lokaleve, restoranteve dhe klubeve në të gjithë vendin;
- c) mbyllja e shkollave, e çerdheve etj.;
- ç) ndalimi i eksportit të barnave;
- d) mbyllja e aktiviteteve, publike dhe jopublike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, si dhe anulimi i të gjitha grumbullimeve masive, në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike;
- dh) vendosja e distancës së siguri ndërmjet punonjësve, prej 1.5 metrash, në të gjitha bizneset që nuk mund të mbyllen për arsye të zinxhirit ekonomik;
- e) reduktimi në maksimum i personelit të *call center*-ve dhe garantimi e respektimit të distancave dhe të kushteve mbrojtëse për çdo punonjës.

Më 16 mars, qeveria miratoi aktin normativ “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”. Këshilli i Ministrave, me aktin normativ “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, vendosi sanksione të rënda për të gjithë ata persona që do të shkelnin masat e marra, në zbatim të këtij akti normativ. Sigurisht, i gjithë ky proces parandalues, kufizues dhe trajtues kërkon përfshirjen e të gjitha strukturave shtetërore, si Policia e Shtetit apo ministrinë përgjegjëse për Rendin, Infrastrukturën, Drejtësinë, Financat etj., për organizimin e veprimtarive përkatëse. Të gjitha këto struktura së bashku po intensifikojnë përpjekjet për këtë “luftë”, në përballjen e së cilës duhet të jemi të fortë. Të gjitha përpjekjet për parandalimin dhe trajtimin e pasojave shëndetësore te personat e infektuar të shkaktuar nga COVID-19 kërkojnë përfshirjen edhe të strukturave jopublike, kryesisht të strukturave jopublike shëndetësore, të cilat kanë qenë në të njëjtën gatishmëri me strukturat publike dhe ka vijuar funksionimi i tyre. Për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, u nxor akti normativ për situatën emergjente nga ku u përcaktuan masat të veçanta që u morën ndaj personave, fizikë/juridikë apo individë, shqiptarë ose të huaj, të cilët shkelën rregullat, vendimet, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga organet kompetente, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Po rikujtoj disa nga nenet e aktit normativ që duhet t’i njohë e zbatojë me korrektësi çdo punonjës i Policisë së Shtetit. Në nenin 3, të aktit normativ, parashikohen masat e veçanta administrative, si më poshtë vijon:

- Subjektet apo individët që organizojnë apo zhvillojnë e aktiviteteve publike dhe jopublike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, apo grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, dënohen me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për organizatorët; dhe ndalimin e aktivitetit.

- Dënohet me gjobë në masën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë:

- a) shtetasi, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk deklaron

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e siguri »

ardhjen e tij, nga zonat e prekura nga infeksioni COVID-19, të deklaruara nga organet kompetente, vendase ose të huaja apo ndërkombëtare;

b) shtetasi, i cili vjen nga zonat e prekura në territorin e Republikës së Shqipërisë, që nuk vetëkarantinohet për një periudhë 14-ditore në ambientet e banesës së tij, si një masë parandaluese për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19;

c) shtetasi, i cili vjen nga zonat e prekura dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetëkarantinimin e detyrueshëm;

ç) Shtetasi, i cili ka rezultuar pozitiv dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetëkarantinimin e detyrueshëm.

- Institucionet arsimore, çerdhjet dhe kopshtet, publike dhe jopublike, që nuk mbyllin aktivitetin.

- Subjektet apo individët, publikë apo privatë, që zhvillojnë aktivitete në ambientet e mbyllura të argëtimit për fëmijë e të rinj, palestrat, qendrat sportive, pishinat, qendrat e internetit, qendrat kulturore, që nuk zbatojnë urdhrin e organit kompetent për mbylljen e tyre, dënohen me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë, dhe në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore.

- Subjektet apo individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrat e dhënë nga organet kompetente për mbylljen e bareve, lokaleve, restoranteve dhe klubeve, dënohen me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e aktivitetit për një periudhë 6-mujore.

- Subjektet dhe individët, publikë apo privatë, të cilët, në kundërshtim me urdhrat e autoriteteve kompetente, lejojnë zhvillimin e aktiviteteve sportive, sociale, kulturore, ekskursionet mësimore të organizuara nga institucionet arsimore, publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit, dënohen me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e aktivitetit për një periudhë 6-mujore.

- Organet e shërbimit postar duhet të garantojnë vazhdimësinë e shërbimit dhe të hartojnë një plan masash për të kufizuar kontaktet e punonjësve me publikun dhe për të shmangur grumbullimin në sportele apo në ambiente të tjera të brendshme. Moszbatimi i këtij detyrimi dënohet me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore.

- Në ambientet e brendshme apo strukturat e veçanta të institucioneve të kujdesit shëndetësor, të poliklinikave, të spitaleve, publike e jopublike, ku zhvillohen vizita dhe konsulta ambulatorë, të merren masa të menjëhershme për ndalimin e grumbullimit të pacientëve. Moszbatimi i këtij detyrimi dënohet me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore.

- Drejtuesit e automjeteve, të cilët nuk zbatojnë “ndalim qarkullimin” e mjeteve të transportit, publik dhe privat, përfshirë automjetet private, në zonat dhe oraret e përcaktuara nga organet kompetente, dënohen me heqje të lejes së drejtimit për një periudhë trevjeçare dhe me bllokim të mjetit. Nga ky rregull përjashtohen personat e autorizuar nga organet kompetente.

Në nenin 4, të aktit normativ, parashikohen organet kompetente për dhënien e masave administrative, si më poshtë vijon:

1. Të drejtën e dhënies së masave administrative, sipas përcaktimeve të nenit 3, të aktit normativ, e ka organi kompetent sipas fushës së përgjegjësisë dhe, në çdo rast, nga Policia e Shtetit.

2. Për rastet e përcaktuara në nenin 3, të aktit normativ, nuk jepet e njëjta masë

administrative njëkohësisht nga dy ose më shumë organe kompetente. Në këto raste zbatohet masa e dhënë nga organi që ka konstatuar i pari shkeljen.

3. Gjjobat e dhëna, sipas këtij akti normativ, përbëjnë titull ekzekutiv dhe modeli i tyre përcaktohet nga organi kompetent sipas fushës së përgjegjësisë dhe, në çdo rast, nga Policia e Shtetit.

4. Gjjobat e mbledhura, sipas këtij akti normativ, derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

5. Shqyrtimi dhe dhënia e masave administrative bëhen në përputhje me parashikimet e kodit të procedurave administrative.

Në nenin 5, të aktit normativ, parashikohet që vendimmarrja e organeve kolegjiale të realizohet edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

Në nenin 6, të aktit normativ, parashikohen kohëzgjatja dhe zbatimi i aktit normativ, si më poshtë vijon:

- Ky akt normativ ka karakter të përkohshëm dhe zbatohet për atë kohë sa zgjat periudha e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

- Zbatimi i këtij akti normativ, për kohëzgjatjen e periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, ka përparësi ndaj dispozitave të akteve të tjera lidhur me masat administrative.

- Në çdo rast, akti normativ nuk përjashton zbatimin e legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive apo akteve të tjera ligjore, për atë sa nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij akti.

4. Policia e Shtetit dhe përballja me sfidat e pandemisë COVID-19

Roli i policisë gjatë kërcënimeve të sigurisë dhe emergjencave është përgjithësisht i përcaktuar mirë. Ai nuk është aspak i qartë gjatë një pandemie COVID-19, e për këtë arsye, duhet hartuar një rregullore shtesë, mbi kompleksin e reagimit të policisë. Në të vërtetë, ndryshe nga shërbimet e shëndetit publik, shumica e planeve të reagimit kombëtar për COVID-19, nuk e konsiderojnë pothuajse fare rolin e policisë, ose vetëm e përmendin pak atë, në terma të gjera dhe të përgjithshme. Kështu, përmendet që, përveç detyrave të zakonshme, policia ka një rol në mbështetjen e luftës kundër sëmundjes dhe në mbrojtjen e njerëzve. Ky rol dytësor që i atribuohet policisë mund të shihet gjithashtu në mbështetjen e shërbimeve, ku përfshihen edhe punonjësit e policisë me shtesë financiare, dhe lloje të tjera shpërblimesh, që duhen rezervuar edhe për policinë nga qeveria, krahasuar me ato që janë planifikuar për punonjësit e sektorit të Shëndetësisë e sektorë të tjerë.

Roli i policisë ka ndryshuar gjithashtu, ashtu si ka evoluar edhe specifika e shërbimeve ndaj qytetarëve, në kontekstin e ndryshimeve të kushtëzuara nga pandemia dhe nevojat e popullsisë e qeverisë. Nevojat për staf të trajnuar e të specializuar të punonjësve të policisë, (nga nevojat për shtimin e kapaciteteve të tyre) mund të ndryshojnë, gjithashtu, gjatë pandemisë, pasi edhe ata e familjet e tyre mund të goditen nga pandemia, së paku në po të njëjtin përpjesëtim me pjesën tjetër të popullsisë. Prandaj, planifikimi i nevojave logjistike dhe reaguese të policisë ndaj COVID-19, është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të trajtuar çështjet që lidhen me zhvillimin e trajnimeve për përgatitjen speciale të tyre, e cila kushtëzon reagimin dhe rimëkëmbjen e shkaktuar nga pandemia.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**“ Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë ”**

Këto sfida në të njëjtën kohë lidhen me kompleksin dhe shkallën e gjerë të aktiviteteve që policisë i kërkohet të kryejë, dhe me ndryshimin e natyrës së rolit të policisë gjatë pandemisë. Në një kohë kur punonjësit e Shëndetësisë shërbejnë në vijën e parë të frontit, policia duhet të njohë për çdo fazë përgjegjësitë e saj, se duam apo s' duam, policia mbetet ndërmjetësi kryesor për zbatimin e ligjit nga qytetarët, por edhe për t'ju përgjigjur nevojave të tyre ashtu si, dhe për të zgjidhur problemet që krijohen prej tyre nga mos respektimi i ligjit. Në këto rrethana, shërbimet e Policisë së Shtetit janë të përfshira në një mision specifik, të mirëplanifikuar, shtesë. Për shkak të situatave të krijuara nga kjo pandemi, ndërlikohet zbatimi konkret i urdhrave nga punonjësit e policisë, që në shumë raste është shumë i prerë, dhe mund të krijojë konflikte me qytetarë që në shumë raste janë shumë të traumatizuar nga kuptimi dhe zbatimi shabllon i ligjit për respektimin e karantinës ose të kufizimeve të udhëtimit, sigurimin e mjediseve të kujdesit shëndetësor, kontrollimin e turmave, ndihmën në trajtimin e fataliteteve masive, mbrojtjen e rezervave kombëtare të vaksinave ose ilaçeve të tjera dhe madje edhe arsimin publik, ku komunikimi joetik bëhet shkak për konflikte që mund të shmangen natyrisht duke përdorur intelgjencën e cila duhet të trajnohet më së paku.

Rëndësia e planifikimit qëndron gjithashtu në rreziqet me reputacion që policia potencialisht mund të ketë humbur gjatë reagimit ndaj qytetarëve në kohën e pandemisë, duke besuar që masat e mara pa vënë në përdorim logjikën dhe sjelljen etike sot, do të ndikojnë në marrëdhëniet në vijimësi, midis policisë dhe popullatës pas pandemisë.

Pikërisht për këtë arsye punonjësit e policisë padyshim duhet të trajnohen për të njohur efektet e të dëmshme të mungesës së etikës në marrëdhënie me qytetarët gjatë përballimit të pandemisë COVID-19 përfundon në sjellje të qytetarëve që dalin jashtë kodeve në ndërtimin e marrëdhënieve me ta. E konsiderojmë si shumë të domosdoshme përgatitjen psikologjike të punonjësve të policisë, për t'u pozicionuar më mirë në vetvete, nga që vetëm kështu mund të sigurohet rritja etike së sjelljes si një nga parametrat e dobishëm në dhënien e shërbimeve për qytetarët.

Policia duhet të marrë parasysh hapësirat që krijohen në nivelet politike dhe sociale të shoqërisë sonë në transicion që orientojnë mendimin qytetar në domosdoshmërinë e zbatimit të ligjit dhe urdhërësave gjatë pandemisë për të futur qytetarët në udhë pa krye me pasoja të pariparueshme. Gjykojmë që duhen bërë hapa të tjera në përsosjen e menaxhimit dhe komunikimit digjital ndërmjet strukturave, në piramidën e policisë sidomos inovacionin në procedurat njohjes së realitetit, ndërtimit të marrëdhënieve me qytetarët dhe sidomos hetimit dhe luftës pa kompromis ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, që mund të ndikojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe pozitive në zhvillimin e aftësive intelektuale të punonjësve të policisë, për dhënien e ndihmesës së tyre gjatë pandemisë që është sigurisht e pranishme pranë nesh. Koordinimi i punës së punonjësve të policisë në situatën e pandemisë.

Policia u angazhua në monitorimin e sjelljeve dhe lëvizjeve të qytetarëve, pas 24 marsit, kur kryeministri Edi Rama shpalli "gjendjen e katastrofës natyrore" në të gjithë vendin, për një periudhë prej 30 ditësh. Shtrirja e masave të kontrollit përmbante: mbylljen e të gjitha shkollave, institucioneve arsimore, mjediseve kulturore, restorante dhe dyqaneve jo të rëndësishme. Vetëm dyqanet e ushqimit, farmacitë dhe institucionet financiare mbetën të hapura.

Nga 13 prilli, u vendos shtetrrethimi i detyrueshëm, nga ora 17:30 deri në orën 05:00. Vetëm një person nga çdo familje lejohej të shkonte për Pazar, në ditë, për një periudhë të kufizuar prej dy orësh. Udhëtime të tjera, përfshirë ato me makinë, lejoheshin

vetëm për punonjësit e autorizuar që shkonin në punë nga ora 05:00 deri në 08:00, dhe ktheheshin nga ora 16:00 deri në 17:30. Në fundjavë, duke filluar nga 10 prilli, ekzistonte një shtetërrehim i rreptë që zgjaste nga ora 17:30 e së premtes deri të hënën në orën 05:00 për të gjithë qytetarët, përfshirë aktivitetet që lejoheshin gjatë javës.

Të moshuarit dhe fëmijët nën dhjetë vjeç, lejoheshin të dilnin vetëm në kohë të caktuara gjatë fundjavës. Përfshirë nga këto rregulla bënte transporti i mallrave dhe ushqimeve, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore, kompanitë mediatike dhe dërgesat.

Më 27 prill, qeveria prezantoi zonat e quajtura "Zonat e gjelbra", të cilat mbulonin qytetet që kishin një rrezik më të ulët se sa pjesa tjetër e vendit, dhe ku qytetarët lejoheshin të lëvizin pa autorizim nga ora 09:30 deri në 17:30, dhe të moshuarit nga 06:00 deri në 08:30. Automjetet personale lejohen të lëvizin brenda zonave, me vetëm një pasagjer përveç shoferit.

Që nga 20 prilli, qeveria lejoi që aktiviteti ekonomik të rifillonte për 600 sektorë si p.sh. bujqësia dhe blegtoaria, prodhimi i ushqimit, miniera dhe industria e tekstilit si dhe sektori i peshkimit.

Më 27 prill, një valë e re e bizneseve ishte në gjendje të rifillonte aktivitetet, duke mundësuar që 27 589 punonjës të ktheheshin në punë. Ato përfshinin dyqane të llojeve të ndryshme si dyqane rrobash, dyqane këpucësh dhe artikujsh lëkure, dyqane mobilesh dhe sendesh shtëpiake, dyqane luleshitësish, ndriçim, pajisje elektronike dhe telekomunikimi.

Shërbimi taksi tani lejohej vetëm për një pasagjer për makinë.

Masat për menaxhimin e zonave kufitare. Të gjitha pikat kufitare në Shqipëri ishin të mbyllura, me disa përjashtime (kryesisht transporti i mallrave, trupi diplomatik). Aeroporti ndërkombëtar i Tiranës ishte i mbyllur për trafikun ajror, përveç fluturimeve shtetërore, ushtarake, mjekësore dhe emergjencave. Udhëtarët që ktheheshin në Shqipëri nga zonat e prekura të COVID-19, i nënshtroheshin një vetëizolimi të detyrueshëm 14-ditor, pavarësisht nga statusi i tyre i qëndrimit. Më 29 mars, Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme në bashkëpunim me stafet diplomatike përfaqësuese të Republikës së Shqipërisë në të gjithë botën, filloi operacionet e riatdhesimit për shtetasit shqiptarë²¹.

5. Konsiderata të përgjithshme

Përcaktuesit sociokulturorë specifikë për Shqipërisë ndikuan në menaxhimin dhe kontrollin e pandemisë COVID-19. Për të rritur ndërgjegjësimin rreth COVID-19, autoritetet filluan një fushatë informacioni në të gjithë vendin përmes kanaleve të ndryshme të medies, përfshirë televizionin dhe mediet sociale. Kjo inkurajoi masa parandaluese të tilla si distancimi shoqëror, mbajtja e maskave të fytyrës dhe përdorimi i dezinfektuesve për duart. Sidoqoftë, gjobat e shumta të lëshuara nga autoritetet gjatë fazave fillestare të epidemisë ilustruan hezitimin e shumë qytetarëve për të respektuar kufizimet në jetën e tyre të përditshme.

Këshilla. Duhet filluar nga njohja dhe kuptimi i plotë i kërcënimit nga COVID 19 para hartimit të urdhërësive, dhe është e domosdoshme të bëhet nga ata që janë përgjegjës për planifikimin lidhur me policinë; duhet që punonjësit e policisë të kenë një kuptim të plotë të kërcënimit, përfshirë ndikimin që mund të ketë pandemia e COVID-19 në komunitet e në aftësinë e punonjësve të policisë për zbatimin e saktë të ligjit e të urdhrave përkatës; duhet të parashikohen pritshmëri reale të rolit të policisë në një

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

skenar pandemik COVID-19; duhet të përdoren planet ekzistuese ku të përfshihen vetëm përjasjet e reja që nevojiten gjatë një pandemie COVID-19.

Planifikimi për një pandemi COVID-19 mund të jetë shumë i ngjashëm me planifikimin për lloje të tjera të emergjencave kritike. Ndërsa ka përbërës specifik pandemik COVID-19 për të cilët duhet të planifikohet (të tilla si parandalimi i transmetimit të sëmundjes në vendin e punës), planet duhet të jenë elastike dhe të zbatueshme për llojet e tjera të urgjencave të shëndetit publik.

6. Konkluzione

Përvojat nënvizojnë nevojën, për t'iu qasur procesit të planifikimit në mënyrë sistematike dhe logjike, duke filluar me një kuptim të plotë të çështjes. Zyrtarët e Policisë Shtetit duhet të përqendrohen në zhvillimin e një plani elastik që bazohet në rekomandimet aktuale të shëndetit publik specifik për një pandemi COVID-19.

Angazhimi dhe edukimi i punonjësit të policisë, si dhe përfshirja në planifikimin ekzistues i përpjekjeve të reagimit ndaj emergjencave në planifikim, do të ndihmojnë në procesin e përsosjes si punës së strukturave të policisë. Siç vë në dukje një zyrtar amerikan, "Procesi i planifikimit është po aq i rëndësishëm sa rezultati; ju duhet të kaloni nëpër procesin logjik të së kuptuarit të rrezikut". Duhet të marrin vëmendjen e duhur elementë të tillë:

- kërcënimet e mundshme penale;
- të drejtat e njeriut dhe policimi gjatë një pandemie COVID-19;
- policimi i përgjegjshëm gjinor COVID-19;
- dhuna në familje;
- dhuna ndërkomunitare;
- paragjykimet dhe dhuna ndaj atyre që dyshohet se kanë COVID-19 si dhe ndaj të huajve, pakicave specifike, refugjatëve dhe grupeve të tjera të pambrojtura;
- trafikimi dhe kontrabanda e njerëzve;
- falsifikimi i ilaçeve dhe mallrave mjekësorë;
- korrupsioni dhe keqpërdorimi i burimeve publike;
- krimi në internet; etj.

6.1 Parandalimi i ekspozimit

1. Nëse jeni i sëmurë, por nuk jeni i sigurt, njoftohet eprori i drejtpërdrejtë; duhet qëndruar në shtëpi dhe të mos shkohet në punë. Konsultohuni me një mjek ose shërbim të certifikuar mjekësor për diagnostikimin dhe këshillat dhe paraqituni tek eprori për vlerësim dhe udhëzim të mëtejshëm.

2. Në marrjen e detyrës duhet pajisur me një maskë kirurgjikale në rast të përdorimit të transportit masiv, apo ndarjes së automjetit me të tjerët.

3. Të mos neglizhohet higjiena e duhur të duarve. Nëse sapuni dhe uji nuk janë në dispozicion, përdorni një pastrues dore me bazë alkooli, me të paktën 60% alkool.

4. Shmangni prekjen e fytyrës, për të shmangur transmetimin e paqëllimtë.

5. Pastrimi dhe dezinfektimi i plotë i sipërfaqeve të prekura shpesh duke përdorur zgjidhje ose peceta të përshtatshme detergjent, dezinfektues, duke përfshirë stacionet e punës, automjetet dhe mjedisin përreth.

6. Kur bashkëveproni me ndonjë individ tjetër, përfshirë një anëtar të publikut që shfaq simptoma të sipërme të frymëmarrjes (teshtitje, kollitje), sigurojuni atyre një maskë

“P-100” ose “N-95” nëse është në dispozicion, ose qëndroni 2 deri 6 metra larg.

7. Të gjithë oficerët e policisë duhet të plotësohen me pajisjet e duhura për “mbrojtjen e personelit”.

8. Në rastin e bashkëveprimit me qytetarë që dyshohet se kanë COVID-19, PPE e duhur është: a) maska “P-100” ose “N-95”.

b) Mbrojtja e syve (syze sigurie ose mburoja e fytyrës).

c) *Nitrile, latex*, doreza gome.

6.2 Procedurat operacionale që duhen ndjekur kur lejoni vizitorët në ambientet e policisë

1. Të gjithë vizitorët duhet të konsiderohen si potencialisht të prekur nga COVID-19, prandaj të gjitha masat parandaluese duhet të merren në përputhje me rrethanat. Sidoqoftë, gjithmonë duhet të merret parasysh respektimi i plotë i parimeve të së drejtave të njeriut.

2. Vizitorët duhet të lejohen të vizitojnë vetëm zona specifike të identifikuara brenda ambienteve të policisë, mundësisht një zyrë të dedikuar vetëm për një qëllim të tillë. Një zonë e tillë duhet të dezinfektohet dhe pastrohet shpesh, idealisht pas çdo vizite, të paktën sipërfaqet e prekura nga vizitorët duhet të pastrohen dhe dezinfektohen pas çdo vizite.

3. Një zonë e veçantë dhe e izoluar e pritjes duhet të identifikohet në rast se më shumë vizitorë janë të pranishëm në të njëjtën kohë, zona e tillë duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e përgjithshme për të parandaluar ndotjen e virusit.

4. Çdo ndërveprim me personelin e policisë dhe të tjerët duhet të ndodhë vetëm në zonën e caktuar.

5. Çdo vizitor para se të hyjë në ambiente duhet të pajiset me një maskë kirurgjikale që duhet të mbajë gjatë gjithë pranisë në ambiente dhe bashkëveprim me oficerët e policisë dhe personat e tjerë.

6. Duhet të identifikohen procedurat për asgjësimin e maskave kirurgjikale që u ofrohen vizitorëve.

6.3 Të drejtat e njeriut dhe policimi gjatë një pandemie COVID-19

1. Përveç ndikimit të pandemisë COVID-19 në të drejtat socioekonomike, të drejtën për shëndetin dhe të drejtën e lëvizjes së lirë, policia duhet të jetë e vetëdijshme për të respektuar të drejtat e njeriut për të shmangur shkeljet që mund të ndodhin gjatë kryerjes së detyrave të tyre për mbrojtjen e popullatës, gjatë pandemisë.

2. Nëse urdhrat dhe ligjet e emergjencës policore bëhen në një mënyrë tepër militariste dhe të dhunshme, pa respektuar parimet e transparencës dhe llogaridhënies, kjo mund të çojë në një mosbesim të publikut ndaj qeverisë dhe policisë, dhe të dëmtojë përgjithmonë reputacionin e tyre.

6.4 Policimi i përgjegjshëm gjinor gjatë një pandemie COVID-19

Policia duhet të marrë masa për të përmbushur nevojat specifike të grave, fëmijëve dhe burrave gjatë një pandemie COVID-19:

- të kuptojë nevojat dhe rreziqet diferenciale në lidhje me burrat dhe gratë;
- vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet grave në qelitë e paraburgimit; policia duhet të sigurojë që gratë në paraburgim të trajtohen në një mënyrë që siguron që nevojat dhe kërkesat e tyre të sigurohen;

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

- pjesëmarrja, përfshirja dhe qasja në informacion dhe shkëmbimi i informacionit mbi mbrojtjen me grupe të cenueshme dhe të marginalizuara, përfshirë gratë.

7. Përfundime

Duhet të sigurohemi që përgjigjet ndaj pandemisë janë proporcionale, të domosdoshme dhe jodiskriminuese. Duke mbajtur parasysh masat paraprake të rekomanduara nga OBSH-ja, dhe duke pasur parasysh që nga policia kombëtare dhe struktura e tjera të zbatimit të ligjit, do të duhet të vazhdohet të trajtohen jo vetëm çështjet e sigurisë publike, por edhe ato që lidhen me shqetësimet e shëndetit publik para, gjatë dhe pas pandemisë COVID-19.

Policia dhe entet e tjera të zbatimit të ligjit, ministritë e tyre përkatëse dhe autoritetet gjyqësore, duhet të marrin në konsideratë dhe nëse është e arsyeshme, të kufizohen arrestimet dhe (ose) ndalimet, përkohësisht, vetëm për ato vepra që paraqesin një kërcënim të menjëhershëm për komunitetin, në mënyrë që të zvogëlohet presioni mbi vendet e paraburgimit dhe burgjet gjatë kësaj periudhe.

Të zhvillohet paraprakisht një strategji të komunikimit publik. Të punohet me zyrtarë të shëndetit publik për të zhvilluar mesazhe dhe strategji për komunikimin e rreziqeve në komunitet. Komunikimet duhet të përfshijnë informacion të saktë dhe në kohë dhe duhet të ndiqen udhëzimet e përgjegjshme duke përsosur mënyrat e komunikimit për të zvogëluar frikën dhe panikun e panevojshëm, si dhe fajin e pajustificuar, duke përsosur etikën e sjelljes për drejtimin e pandemisë

Mesazhet duhet të jenë shumë të qarta në shpjegimin e kërcënimit, duke siguruar udhëzime mbi atë që duhet të bëjë publiku në rast emergjence, dhe duke theksuar rëndësinë dhe përfitimin e drejtpërdrejtë për komunitetin dhe sistemin e tij të shëndetshëm të zbatimit vullnetar të urdhrave të shëndetit publik (të tilla si masat vetjake të karantinës dhe “distancimit shoqëror” që janë krijuar për të parandaluar mbledhjen e njerëzve në kinema, kisha, klube nate, ose hapësira të tjera të mbyllura ku ka mundësi ngjitime).

Në rastin e një pandemie COVID-19, strukturat policore ka të ngjarë të përballen me barrën shtesë të operimit me një fuqi punëtore të reduktuar, pasi disa nga zyrtarët e tyre mund të sëmuren ose të kërkojnë izolim pasi të ekspozohen ndaj personave të infektuar.

Referenca

1. Ashby, M. P. (2020a). 'Initial Evidence on the Relationship between the Coronavirus Pandemic and Crime in the United States.' *Crime Science* 9(1).
2. Ashby, M. P. (2020b). 'Changes in Police Calls for Service during the Early Months of the 2020 Coronavirus

- Pandemic.' 10.31235/osf.io/h4mcu (accessed 30 June 2020).
3. Biswas, D. and Sultana, P. (2020). 'Policing during the Time of Corona: The Indian Context.' *Policing: A Journal of Policy and Practice* 14(4): 1104–1111.
 4. Chen, P. and Kurland, J. (2020). 'The Impact of "Strike Hard" on Repeat and Near-Repeat Residential Burglary in Beijing.' *ISPRS International Journal of Geo-Information* 9(3): 150. Chen, Z. (2016).
 5. 'Measuring Police Role Orientations in China: An Exploratory Study.' *International Journal of Law, Crime and Justice* 44: 43–67. China Daily, Tsinghua University & Peking Union Medical College. (2020).
 6. Report: China's fight against COVID-19. Retrieved 3 June 2020, from <https://covid-19.chinadaily.com.cn/a/202004/21/WS5e9e2c62a3105d50a3d17880.html> (accessed 3 June 2020).
 7. Cuvelier, S. J., Jia, D., and Jin, C. (2015). 'Chinese Police Cadets' Attitudes toward Police Roles
 8. Revisited.' *Policing: An International Journal* 38(2): 250–264. Eligon, J. and MacFarquhar, N. (2020).
 9. 'Coronavirus Devastates Detroit Police, from the Chief on Down.' *The New York Times*, 20 April. <https://www.nytimes.com/2020/04/20/us/coronavirus-detroit-police.html> (accessed 3 June 2020). Foucault, M. (1977).
 10. Discipline and Punish: The Birth of the Prison. London: Allen Lane. Goldsworthy, T. and Lincoln, R. (2020).
 11. 'Explainer: Why Police Will Be Crucial Players in the Battle against Coronavirus.' *The Conversation*. <https://theconversation.com/explainer-why-police-will-be-crucial-players-in-the-battle-against-coronavirus-134392> (accessed 30 June 2020).
 12. Gradon, K. (2020). 'Crime in the Time of the Plague: Fake News Pandemic and the Challenges to Law-Enforcement and Intelligence Community.' *Society Register* 4 (2): 133–148. Liang, B. (2005).
 13. 'Severe Strike Campaign in Transitional China.' *Journal of Criminal Justice* 33(4): 387–399. Ma, Y. X. (2003).
 14. 'Passive Non-Policing Affair: The Forms, Harmfulness, Cause and Containment.' *Journal of Chinese People's Public Security University* 103(3): 83–86.
 15. Mohler, G., Bertozzi, A. L., Carter, J. et al. (2020). 'Impact of Social Distancing during COVID-19
 16. Pandemic on Crime in Los Angeles and Indianapolis. *Journal of Criminal Justice* 68: 101692. <https://doi.org/10.1016/j.jcrimjus.2020.101692> (accessed 15 June 2020).
 17. Peng, X., Gong, M., and Bing, J. (2020). 'Sweeping and Eliminating Evils: A Diachronic Study of Mafia in China.' *International Journal of Legal Discourse* 4(2): 197–216.
 18. Reichner, S. and Stott, C. (2020). 'Policing the Coronavirus Outbreak: Processes and Prospects for Collective Disorder.
 19. 'Policing: A Journal of Policy and Practice 14(3): 569–573. Ren, X. (2020).
 20. 'Pandemic and Lockdown: A Territorial Approach to COVID-19 in China, Italy and the United States.' *Eurasian Geography and Economics* 10.1080/15387216.2020.1762103 (accessed 30 June 2020).
 21. Report of Hu Jintao to the 18th CPC National Congress. (2012).
 22. Firmly March on The Path of Socialism with Chinese Characteristics and Strive to Complete the Building of a Moderately Prosperous Society in All Respects.
 23. http://www.china.org.cn/china/18th_cpc_congress/2012-11/16/content_27137540_7.htm (accessed 3 June 2020). Scoggins, S. (2018).
 24. 'Policing Modern China.' *China Law and Society Review* 3(2): 79–117. Shaw, R., Kim, Y. K., and Hua, J. (2020).
 25. 'Governance, Technology and Citizen Behavior in Pandemic: Lessons from COVID-19 in East Asia.' *Progress in Disaster Science* 6: 100090. Stott, C., West, O., and Harrison, M. (2020).
 26. 'A Turning Point, Securitization, and Policing in the Context of Covid-19: Building a New Social Contract between State and Nation?.' *Policing: A Journal of Policy and Practice* 14(3): 574–578. Sun, I. Y., Cretacci, M. A., Wu, Y., and Jin, C. (2009).
 27. 'Chinese Police Cadets' Attitudes toward Police Role and Work.' *Policing: An International Journal of Police Strategies & Management* 32(4): 758–780. Sun, I. Y., Li, L., Wu, Y., and Hu, R. (2018).
 28. 'Police Legitimacy and Citizen Cooperation in China: Testing an Alternative Model.' *Asian Journal of Criminology* 13(4): 275–291. Sun, Y. C. and Zhang, J. S. (2020).
 29. 'Grid Governance in China's Urban Middle-Class Neighbourhoods.' *The China Quarterly* 241: 43–61. Qu, X. J. (2005).
 30. 'An Analysis of the Strike-Hard Criminal Policy.' *Contemporary Chinese Thought* 36(3): 77–88. 1136 Policing Commentary F. Jiang and C. Xie Downloaded from <https://academic.oup.com/policing/article/14/4/1127/6054277> by guest on 12 March 2021 Wong, K. C. (2001).
 31. 'The Philosophy of Community Policing in China.' *Police Quarterly* 4(2): 186–214. Wong, K. C. (2011). *Police Reform in China*. Boca Raton, FL: CRC Press. Wu, Q. (2015).
 32. Legea nr. 55, din 15 mai 2020 privind unele măsuri pentru prevenirea și combaterea efectelor pandemiei de COVID-19.
 33. Decretul nr. 195, din 16 martie 2020.
 34. Decretul nr. 240, din 14 aprilie 2020.
 35. Ordonanța de urgență nr. 21, din 15 aprilie 2004 (actualizat). Hârjeu C.N.,
 36. *Istoria Armei Geniului*, I.V. Socec, Bucharest, 1902.
 37. www.cnsctb.ro
 38. www.ecdc.europa.eu
 39. www.defenseromania.ro
 40. www.digi24.ro
 41. www.g4media.ro
 42. www.ms.ro
 43. www.hotnews.ro myra

Planifikimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore në qarkun e Shkodrës



■ **MSc. Pëllumb DANI**
Prefektura Shkodër
secdani@yahoo.com



■ **Dr. Bajram IBRAJ**
Akademia Profesionale
e Biznesit, Tiranë.
bajramibraj@yahoo.com

Abstrakt

Dukuritë e natyrës, mund të sjellin reziqe që janë pjesë e jetës, por këto dukuri kthehen në fatkeqësi, vetëm atëherë kur preket jeta dhe mjetet e jetesës së njerëzve. Prekshmëria e komunitetit, po vritet për shkak të aktiviteteve njerëzore, që çojnë në rritjen e varfërisë, në një densitet më të madh urban, në degradimin e mjedisit dhe në ndryshimin e klimës. Prandaj, është mirë, që brenda mundësive tona të bëjmë diçka, lidhur me një vendimmarrje më të mirë, me një planifikim të përmirësuar, me një menaxhim efektiv të rreziqeve dhe me një përtëritje, në aktivitetin e zhvillimit, dhe të mbrojtjes së mjedisit. Për këtë qëllim, vlerësimi i rreziqeve dhe pakësimi i fatkeqësive, duhet të jenë pjesë integrale e të gjithë projekteve dhe politikave të zhvillimit të qëndrueshëm. Vendi ynë radhitet, në nivel botëror, si një ndër tre shtetet, që rrezikohet nga fenomene të natyrës dhe të fatkeqësive natyrore; kjo, për vetë faktin sepse nuk kemi infrastrukturë të konsoliduar, nuk kemi pasur deri sot ligje dhe akte nënligjore bashkëkohore dhe struktura të mirëpërgatitura e reaguese, për të stabilizuar pasojat e fenomeneve. Duke iu referuar njërit prej qarqeve me të rëndësishme të vendit, siç është ai i Shkodrës, që ka një specifikë të veçantë, në aspektin e sigurisë publike, por edhe llojeve të fenomeneve të fatkeqësive natyrore, si: tërmetet, përmbytjet, zjarret, izolimi nga dëbora, shkarjet e dherave dhe destabilizime ekstreme të rendit. Në këtë punim trajtohet kuadri specifik normativ për menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile në Shqipëri; karakteristikat e pozitës gjeografike dhe rreziqeve natyrore të bashkive e njësive administrative të qarkut Shkodër; veprat penale kundër mjedisit në qarkun e Shkodrës, për periudhën 1.1.1990 - 19.3.2021; përshkrim i shkurtër historik i përmbytjeve që kanë prekur qarkun Shkodër; situata e krijuar në periudhën e përmbytjes 20 dhjetor 2020 - 20 shkurt 2021; masat që u morën nga Prefektura e Shkodrës dhe detyrat që dalin për të ardhmen, parashikimi për shtëpi/familje dhe mjetet e transportit për evakuimin e komunitetit.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

dukuritë e natyrës, Shkodra, planifikimi, menaxhimi, aktet ligjore.

1. Hyrje

Shqipëria preket nga katër rreziqe kryesore: zjarret e pyjeve, përmbytjet, tërmetet dhe stuhitë e dëborës. Rreziqe të tjera përfshijnë: rrëshqitje të tokës, thatësira, epidemitë, ekstreme temperaturash, ortehtë, cunami, rreziqet teknologjike, çarja e digave dhe stuhitë. Shqipëria renditet në vendin 41-të në rang botëror në aspektin e ndjeshmërisë ndaj rrëshqitjeve të dheut, e 43-ta në drejtim të tërmeteve dhe e 58-ta në drejtim të rreziqeve ndaj thatësirës¹.

Ndërkohë qarku i Shkodrës është i prekshëm nga rreziqet hidrometeorologjike, dhe për më tepër ultësira e Shkodrës është drejtpërdrejtë nën ndikimin e rrezikut të përmbytjes. Prandaj, parashikimi, planifikimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile në kushtet e një terreni të brishtë infrastrukturor, strukturave reaguese të pakonsoliduara, ligjeve dhe akteve nënligjore të pastandardizuara, por jo vetëm, ndikojnë drejtpërdrejt në dobësimin e sigurisë publike dhe garantimin e jetës së qytetarëve, të komunitetit dhe mbrojtjes së pasurisë private dhe publike.

2. Kuadri specifik normativ për menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë në Shqipëri

Kuadri specifik normativ për menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë në Shqipëri ka qenë përcaktuar në ligjin nr. 8756 i miratuar në vitin 2001, "Për emergjencat civile"²

¹ Raporti global i vlerësimit, UNISDR, 2013.

² Ligj nr.8756, datë 26.3.2001" Për Emergjencën Civile", i ndryshuar me ligjin nr.10137, datë 11.5.2009.

dhe në ligjin nr. 11/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8677”, i miratuar po në të njëjtin vit, i cili trajton se në nivel kombëtar, Këshilli i Ministrave drejton dhe organizon sistemin kombëtar të menaxhimit të emergjencave civile në Shqipëri. Këtu përfshihet miratimi i strategjive, politikave dhe programeve që synojnë parandalimin, zbutjen dhe përgatitjen për reagim ndaj situatave të emergjencave civile. Çdo ministri e linjës përgjigjet për planifikimin dhe trajtimin e emergjencave civile, sipas fushës përkatëse të ekspertizës. Komisioni ndërrikasterial për emergjencat civile bashkërendon veprimet e duhura të të gjitha institucioneve përkatëse gjatë gjithë fazave të reagimit ndaj situatave të emergjencave civile. Po kështu, në vitin 2004, Shqipëria hartoi një plan kombëtar për emergjencat civile,³ në përputhje me legjislacionin aktual.

Ndërkohë, në vitin 2019 është miratuar ligji i ri, nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”⁴ i cili ka përcaktuar në nenin 16, strukturat qendrore të mbrojtjes civile,⁵ ndërsa në Ministrinë e Mbrojtjes, është krijuar Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Në qarqe, prefektët janë përgjegjës për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në nivel qarku. Nën drejtimin e prefektit është i ngritur dhe funksionon komisioni i mbrojtjes civile të qarkut, detyra e të cilit është koordinimi i aktiviteteve të autoriteteve të qarkut dhe të organizatave vullnetare për planifikimin dhe përballimin e emergjencave. Dymbëdhjetë qarqet e Shqipërisë kanë nga një sektor me kohë të plotë që merret me emergjencat civile.

Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në bashki. Nën drejtimin e kryetarit është i ngritur dhe funksionon komisioni i mbrojtjes civile dhe detyra e tij kryesore është të koordinojë të gjitha aktivitetet e njësisë së qeverisjes vendore dhe të organizatave vullnetare, për planifikimin dhe përballimin e emergjencave. Bashkitë kanë punonjësit e tyre për rastet e emergjencave civile, të cilët aktualisht janë nën drejtoritë juridike. Këta punonjës nuk kanë fuqi vendimmarrëse në kuadrin e menaxhimit të emergjencave. Ndërkohë, kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile janë me rëndësi të veçantë, dhe si e tillë, kjo agjenci lypset të përmbushë detyrat dhe kompetencat e saj.

3. Ndikimi i fenomeneve të fatkeqësive natyrore në jetën e komunitetit dhe ekonominë në nivel kombëtar dhe rajonal

Sipas *DesInventar*, në Shqipëri janë regjistruar mbi 4 000 veprimtari, gjatë gjithë periudhës, nga viti 1851 deri në vitin 2013. Ngjarjet hidrometeorologjike janë edhe ato më të hasurat (54 për qind e totalit), pasuar nga ngjarjet klimaterike, kryesisht thatësira dhe ekstreme temperaturash (22 për qind) dhe shkarje dheu (14 për qind). Këto lloj fatkeqësisht mbulojnë 90 për qind të totalit të veprimtarive gjatë periudhës që është marrë në shqyrtim. Njëkohësisht dhe ajo që madje është më e rëndësishme, është fakti që, 74 për qind e të gjitha veprimtarive në bazën e të dhënave, janë regjistruar gjatë 20 viteve të fundit, me një mesatare prej 159 veprimtarish të tilla në vit. Me kalimin e kohës, mbi 95 për qind të komunave shqiptare janë prekur nga së paku një fatkeqësi. Periudha midis viteve 1999-2003 raportohet si periudha me humbjet më të larta ekonomike gjatë 33 viteve të fundit për sa i përket rreziqeve të regjistruara në Shqipëri⁶.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

³ Plani kombëtar për emergjencat civile, 2004.

⁴ Ligji nr.45/2019, datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

⁵ Neni 16 i ligjit nr.45/2019, datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

⁶ Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report for Albania, UNDP BCPR, 2011.

Frekuenca e rreziqeve që lidhen me përmbytjet në Shqipëri është e lartë (një në gjashtë vjet). Afërsisht 10 për qind e popullsisë është e ekspozuar ndaj përmbytjeve dhe tërmeteve⁷.

Faktorët kryesorë që ndikojnë tek cenueshmëria ndaj rreziqeve, të tërmeteve, gjenden në zbatimin e kodeve dhe standardeve të ndërtimit, lidhen me informacionin dhe dijet e inxhinierëve dhe ndërtuesve, si edhe me stimujt për të garantuar që ndërtimet pa planimetri (projekt) të jenë sipas normave të kërkuara. Një nivel rreziku për tërmete, i cili është vështirë të matet nga pikëpamja sasiore është akumuluar për shumë vite në Shqipëri. Ky rrezik duhet të vlerësohet nga pikëpamja sasiore dhe të merret në konsideratë në planet e emergjencave dhe politikat dhe planet e zhvillimit për të ardhmen. Fatkeqësitë që lidhen me ndikimin e rreziqeve natyrore po i kushtojnë me miliarda lek ekonomisë shqiptare po sjellin një ndikim negativ në stabilitetin e jetesës dhe zhvillimit të së ardhurave, si rrjedhojë e rritjes së ekspozimit fizik të burimeve kombëtare dhe të popullsisë, si edhe cenueshmëria ekonomiko-shoqërore.

4. Karakteristikat e pozitës gjeografike dhe rreziqeve natyrore të bashkive e njësive administrative të qarkut Shkodër

Qarku i Shkodrës ka një sipërfaqe prej 3562 km², përbëhet nga 5 bashki: Shkodër, Vau Dejës, Malësi e Madhe, Pukë dhe Fushë-Arrëz; bashkia qendrore e qarkut, është bashkia Shkodër. Qarku Shkodër është ballafaquar me përmbytjet në shtator 1995, nëntor 1996, shtator-tetor 2002, dhjetor 2010-janar-mars 2011, janar-mars 2013, janar-mars, 2018 dhe dhjetor 2020- janar-shkurt 2021. Zjarret në pyje dhe kullota, më të theksuar, kanë qenë në vitet: 2003, 2017, 2018 dhe 2019. Fenomeni i shkarjes së dherave, më i theksuar ka qenë në zonën verilindore të bashkive Pukë dhe Fushë Arrëz. Tërmeti në nëntorin e vitit 2019 dhe pandemia COVID-19, në mars 2020, e cila vijon edhe sot, më 2021, kanë qenë rreziqe të tjera që i janë kanosur qarkut Shkodër.

Praktikat zhvillimore të paqëndrueshme dhe të parregulluara siç duhet, në toka marginalisht produktive dhe rritja e investimeve private në toka të tilla duke përfshirë tokat pranë digave/argjinaturave, veçanërisht në ultësirën e Shkodrës po shndërrohen në vlera që janë objekt i niveleve relativisht më të larta humbesh dhe kostosh zëvendësimi. Po kështu, ka rezultuar një densitet i lartë i popullsisë, në zona të pasigurta, p.sh. në qarkun Shkodër, zona e Obotit dhe e Buzës së Ujit pranë Liqenit të Shkodrës.

5. Veprat penale kundër mjedisit në qarkun e Shkodrës për periudhën 1.1.1990-19.3.2021

Në *Kodin penal të Republikës së Shqipërisë* janë parashikuar figura konkrete të veprave penale kundër mjedisit si edhe dënimet përkatëse për autorët e këtyre veprave penale. Veprat penale kundër mjedisit, së bashku me ndryshimet që kanë hyrë në fuqi më datë 8.10.2019, janë parashikuar në kreun IV të kodit penal aktual, si më poshtë:

⁷ Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report for Albania, UNDP BCPR, 2011.

Nr.	Vepra penale kundër mjedisit	Masa ndëshkimore në varësi të rrezikshmërisë
1	Neni 201- Ndojta e ajrit, e ujërave dhe e tokës	Burg deri në 15 vite
2	Neni 201/a- Menaxhimi i mbetjeve	Burg deri në 15 vite
3	Neni 201/b- Transportimi i mbetjeve	Gjobë deri në burgim 5 vite
4	Neni 201/c - Aktivitetet e rrezikshme	Burg deri në 15 vite
5	Neni 201/c - Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme	Burg deri në 20 vite
6	Neni 202- Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër	Gjobë deri në burgim 7 vite
7	Neni 202/a - Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër	Gjobë deri burgim 3 vite
8	Neni 202/b - Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore	Gjobë deri burgim 5 vite
9	Neni 203- Substancat ozozholluese	Burg nga 1 deri në 7 vite
10	Neni 204- Peshkimi i ndaluar	Gjobë ose burgim deri në 2 vite
11	Neni 205 - Prerja e paligjshme e pyjeve	Gjobë ose burgim deri në 1 vit
12	Neni 206-Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë	Burg deri në 3 muaj
13	Neni 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve	Burg deri në 20 vite
14	Neni 206/b- Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor	Burg deri në 8 vite
15	Neni 207- Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	Gjobë

Tabela 1: Përmbledhje e dënimeve për vepra penale kundër mjedisit.

Dënimet e parashikuara për veprat penale kundër mjedisit, apo për krimet mjedisore, janë të rëndësishme për arritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe parandalimit të përgjithshëm të kësaj veprimtarie kriminale që ka dëmtuar ndjeshëm mjedisin në vendin tonë, infrastrukturën, etj, dhe ka sjellë pasoja për jetët njerëzore dhe dëme të mëdha ekonomike. Më poshtë paraqiten statistika të përgjithshme të veprave penale kundër mjedisit në qarkun e Shkodrës për periudhën 1.1.1990-19.3.2021.

Komisari ati	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCAVE	Evide ntuar	Zbulu ar	Zbuli mi ne %	Autorë të veprave penale					
					Gjit hse j	Masa sigurimi				
						Arre stua r	Ndal uar	Gjykim i lire	Largu ar	Ndrysh me
Shkodër	Krime të tjera	315	227	72.1	432	34	6	375	17	0
	Vepra penale kundër mjedisit	23	21	91.3	231	4	0	227	0	0
	Shkatërrim prone me zjarr	138	54	39.1	60	10	6	30	14	0
	Prerja te paligjshme të pyjeve	154	152	98.7	141	20	0	118	3	0
M. Madhe	Krime të tjera	74	63	85.1	55	1	1	53	0	0
	Vepra penale kundër mjedisit	8	8	100	5	0	0	5	0	0
	Shkatërrim prone me zjarr	15	7	46.7	3	1	1	1	0	0
	Prerja te paligjshme të pyjeve	51	48	94.1	47	0	0	47	0	0
V. Dejës	Krime të tjera	44	30	68.2	58	15	2	31	10	0
	Vepra penale kundër mjedisit	2	2	100	4	0	0	4	0	0
	Shkatërrim prone me zjarr	27	13	48.2	36	15	2	11	8	0
	Prerja te paligjshme të pyjeve	15	15	100	18	0	0	16	2	0
Pukë	Krime të tjera	132	97	73.5	72	4	3	65	0	0
	Vepra penale kundër mjedisit	6	6	100	1	0	0	1	0	0
	Shkatërrim prone me zjarr	47	16	34	5	2	1	2	0	0
	Prerja te paligjshme të pyjeve	79	75	94.9	66	2	2	62	0	0
F. Arrës	Krime të tjera	22	17	77.3	18	1	0	16	1	0
	Vepra penale kundër mjedisit	4	4	100	4	0	0	4	0	0
	Shkatërrim prone me zjarr	6	2	33.3	2	1	0	1	0	0
	Prerja te paligjshme të pyjeve	12	11	91.7	12	0	0	11	1	0
Total Qarku	Krime të tjera	629	454	72.2	636	55	12	540	29	0
	Vepra penale kundër mjedisit	46	44	95.7	246	4	0	241	1	0
	Shkatërrim prone me zjarr	272	109	40.1	106	29	10	45	22	0
	Prerja te paligjshme të pyjeve	311	301	96.8	284	22	2	254	6	0

Tabela 2. Statistika e përgjithshme e veprave penale kundër mjedisit në qarkun e Shkodrës për periudhën 1.1.1990-19.3.2021

Burimi: Përgjigje e shkresës së Drejtorisë së Policisë së qarkut Shkodër, datë 23.3.2021, dërguar nga z. Pëllumb Dani, përgjegjës i sektorit të emergjencave civile dhe krizave, Prefektura e Qarkut Shkodër.

Në mënyrë tabelore paraqiten statistikat e përgjithshme të veprave penale kundër mjedisit në qarkun e Shkodrës për periudhën 1.1.1990-19.3.2021. Kjo tabelë pasqyron veprat penale sipas tendencave, ku pasqyrohen tre kategori të veprave penale sipas kodit penal, si vepra penale kundër mjedisit, veprat penale shkatërrim prone me zjarr dhe veprat penale prerje të paligjshme të pyjeve, dhe në total pasqyron veprat penale krime të tjera, ku është shuma e tre kategorive të veprave penale të mësipërme. Statistikat pasqyrojnë të dhënat sipas komisariateve të policisë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrës. Në Shkodër janë evidentuar 23 vepra penale kundër mjedisit, nga të cilat janë zbuluar 21, ose 91.3%; 231 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilët 4 të arrestuar; 227 të gjykuar në gjendje të lirë; janë evidentuar 138 vepra penale shkatërrim prone me zjarr, nga të cilat janë zbuluar 54, ose 39.1%; 60 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilët 10 të arrestuar; 6 të ndaluar, 30 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 14 autorë të larguar; dhe 154 vepra penale prerje të paligjshme të pyjeve, nga të cilat janë zbuluar 152 ose 98.7%; 141 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilët 20 të arrestuar; 118 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 3 autorë të larguar. Pra, në total, pasqyron veprat penale *krime të tjera*, d.m.th., këto 3 kategori të veprave penale, me 315 vepra penale gjithsej, nga të cilat janë zbuluar 227 ose 72.1%, 432 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilët 34 të arrestuar, 6 të ndaluar, 375 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 17 autorë të larguar.

Në Malësinë e Madhe janë evidentuar 8 vepra penale kundër mjedisit, nga të cilat janë zbuluar 8 ose 100%, 5 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 5 të gjykuar në gjendje të lirë; janë evidentuar 15 vepra penale shkatërrim prone me zjarr, nga të cilat janë zbuluar 7 ose 46.7%, 3 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 1 i arrestuar, 1 i ndaluar, 1 i gjykuar në gjendje të lirë; dhe 51 vepra penale prerje të paligjshme të pyjeve, nga të cilat janë zbuluar 48 ose 94.1%, 47 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 47 të gjykuar në gjendje të lirë. Pra, në total pasqyron veprat penale krime të tjera, pra, këto 3 kategori të veprave penale me 74 vepra penale gjithsej, nga të cilat janë zbuluar 63 ose 85.1%, 55 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 1 i arrestuar, 1 i ndaluar, 53 të gjykuar në gjendje të lirë.

Në Vaun e Dejës janë evidentuar 2 vepra penale kundër mjedisit, nga të cilat janë zbuluar 2 ose 100%; 4 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat të gjykuar në gjendje të lirë; janë evidentuar 27 vepra penale shkatërrim prone me zjarr, nga të cilat janë zbuluar 13 ose 48.2%, 36 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 15 të arrestuar, 2 të ndaluar, 11 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 8 autorë të larguar; dhe 15 vepra penale prerje të paligjshme të pyjeve, nga të cilat janë zbuluar 15 ose 100%, 18 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 16 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 2 autorë të larguar. Pra, në total pasqyrohen veprat *penale krime të tjera*, pra, këto 3 kategori të veprave penale me 44 vepra penale gjithsej, nga të cilat janë zbuluar 30 ose 68.2%, 58 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 15 të arrestuar, 2 të ndaluar, 31 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 10 autorë të larguar.

Në Pukë janë evidentuar 6 vepra penale kundër mjedisit, nga të cilat janë zbuluar 6 ose 100%, 1 autor i veprave penale gjithsej, nga të cilat 1 i gjykuar në gjendje të lirë; janë evidentuar 47 vepra penale shkatërrim prone me zjarr, nga të cilat janë zbuluar 16 ose 34%, 5 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 2 të arrestuar, 1 i ndaluar, 2 të gjykuar në gjendje të lirë; dhe 79 vepra penale prerje të paligjshme të pyjeve, nga të cilat janë zbuluar 75 ose 94.9%, 66 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 2 të arrestuar, 2 të ndaluar, 62 të gjykuar në gjendje të lirë. Pra, në total pasqyron veprat penale krime

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

të tjera, pra, këto 3 kategori të veprave penale, me 132 vepra penale gjithsej, nga të cilat janë zbuluar 97 ose 73.5%, 72 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 4 të arrestuar, 3 të ndaluar, 65 të gjykuar në gjendje të lirë.

Në Fushë-Arrëz janë evidentuar 4 vepra penale kundër mjedisit, nga të cilat janë zbuluar 4 ose 100%, 4 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 4 të gjykuar në gjendje të lirë; janë evidentuar 6 vepra penale shkatërrim prone me zjarr, nga të cilat janë zbuluar 2 ose 33.3%, 2 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 1 i arrestuar, 1 i gjykuar në gjendje të lirë; dhe 12 vepra penale prerje të paligjshme të pyjeve, nga të cilat janë zbuluar 11 ose 91.7%, 12 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 11 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 1 i larguar. Pra, në total pasqyron veprat penale krime të tjera, pra, këto 3 kategori të veprave penale me 22 vepra penale gjithsej, nga të cilat janë zbuluar 17 ose 77.3%, 18 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 1 i arrestuar, 16 të gjykuar në gjendje të lirë, dhe 1 i larguar.

Në qarkun e Shkodrës në total janë evidentuar 46 vepra penale kundër mjedisit, nga të cilat janë zbuluar 44 ose 95.7%, 246 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 4 të arrestuar, 241 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 1 autorë i larguar; janë evidentuar 272 vepra penale shkatërrim prone me zjarr, nga të cilat janë zbuluar 109 ose 40.1%, 106 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 29 të arrestuar, 10 të ndaluar, 45 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 22 autorë të larguar; dhe 311 vepra penale prerje të paligjshme të pyjeve, nga të cilat janë zbuluar 301 ose 96.8%, 284 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 22 të arrestuar, 2 të ndaluar, 254 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 6 autorë të larguar. Pra, në total pasqyron veprat penale krime të tjera, pra, këto 3 kategori të veprave penale me 629 vepra penale gjithsej, nga të cilat janë zbuluar 454 ose 72.2%, 636 autorë të veprave penale gjithsej, nga të cilat 55 të arrestuar, 12 të ndaluar, 540 të gjykuar në gjendje të lirë dhe 29 autorë të larguar.

6. Përshkrim i shkurtër historik i përmbytjeve që kanë prekur qarkun Shkodër

Ndryshimet klimatike janë një tjetër faktor, duke qenë se reshjet e shiut dhe të dëborës në Shqipëri përfaqësojnë një ndër nivelet më të larta të ndryshueshmërisë në Evropë⁸. Ndryshimet e demografisë shoqërore, ndikojnë ndjeshëm në ndryshim të cenueshmërisë në territorin e prefekturës në Shkodër.

Shtator 1995: në bashkinë e Shkodrës u dëmtuan rreth 57 shtëpi banimi dhe janë përmbytur rreth 5435 ha tokë më e theksuar kjo në ish-komunat Dajç dhe Oblike. Në bashkinë e Pukës, nga vërshimi i lumit Fan, dhe përrenjve malor, dëme të konsiderueshme janë konstatuar në bashkinë Fushë-Arrëz, ku u dëmtuan rreth 37 shtëpi banimi nga të cilët 14 u bënë të pabanueshme, 37 km rrugë, 32 ura si dhe dëmtime të tjera në rrjetin elektrik, ujësjellësit, në linjat telefonikë etj. Në ish komunën Iballë u dëmtuan rreth 30 shtëpi banimi, 65 ura si dhe dëmtime të tjera në blegtori etj. Në ish-komunën e Qelzës ka pasur dëmtime të 2 shtëpive, 34 km rrugë automobilistike, 24 ura, etj. Në bashkinë e Pukës ka pasur dëmtime kryesisht të çatave të shtëpive rreth 1200 si dhe të rrugëve që lidhin qendrën e njesisë me fshatrat etj.

Nëntor 1996: Si pasojë e reshjeve të dendura të shiut si dhe të shkarkimeve të

⁸ Albania's Energy Sector: Vulnerable to Climate Change. Nga Jane Ebinger, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore. Banka Botërore, shtator 2010, vol 19.

detyruara nga H/C Vau Dejës, për pasojë ka dalë nga shtrati lumi Drin dhe ka bërë dëme të konsiderueshme në Bashkinë Vau Dejës, ish-komunat Hajmel, Ana e Malit, Bushat, Dajç, Velipojë si dhe në disa lagje të bashkisë Shkodër etj.

Shtator-tetor 2002: gjatë reshjeve të dendura të vitit 2002 në qarkun e Shkodrës u përmbytën rreth 7835 ha toka bujqësore, u larguan rreth 580 persona dhe u përmbytën përafërsisht rreth 400 shtëpi banimi.

Dhjetor 2010-janar-mars 2011, janar-mars 2013, konsiderohet si përmbytja më e madhe e 100 viteve të fundit. Sipërfaqja maksimale e tokës së përmbytur rreth 14130 ha; sasia e shtëpive të përmbytura 4660 copë; sasia e shtëpive të rrethuara nga uji 5540 copë; numri i banorëve të larguar rreth 14210; u transportuan rreth 13645 banorë dhe 1118 krerë bagëti të trasha, e 7804 dele.

Përmbytja e vitit 2018. Nivelet e lumenjve, sipas treguesve të hidrometrave me datat 11 dhe 12.2.2021, kanë kaluar nivelet kritike si më poshtë: Buna, niveli kritik, 8.70 - niveli sot, 9.25; Drini, niveli kritik, 7.50 - niveli sot, 7.55; Dajçi, niveli kritik, 6.30, - niveli sot, 7.00; Nivelet dhe treguesit me të lartë të niveleve të lumenjve, kanë qenë në datë 30.12.2020 dhe 5.6.1.2021, si dhe 13 e 14.2.2021. Nga situata e krijuar, rezulton se: në qarkun Shkodër, sipërfaqja totale e përmbytur vlerësohet në 4224 ha; në 9781 ha, nga të cilat, ka: 63 shtëpi të përmbytura, 321 shtëpi të rrethuara nga uji, 541 shtëpi me prezencë uji në oborre, 27 familje të larguara, 4760 popullsi e prekur; 1062 persona të mbështetur me pako ushqimore dhe me 192 ton mbështetje me bazë ushqimore për bagëtitë.

6.1 Situata e krijuar në periudhën e përmbytjes 20 dhjetor 2020 - 20 shkurt 2021

Periudha e parë e reshjeve: datë 20-31 dhjetor 2020: sasia maksimale, ka qenë 332 mm, në datat 26 e 30 dhjetor; niveli maksimal 84 dhe 79 mm.

Periudha e dytë e reshjeve: datë 24 dhjetor 2020-25 janar, 2021, rreth 23 ditë reshje, sasia maksimale totale ka qenë 353 mm, datë 5 janar 160 mm.

Periudha e tretë e reshjeve: datë 10-11 shkurt 2021, e cila u shoqërua me reshje dëbore, pothuajse në të gjithë territorin e qarkut; sasia mesatare, 215 mm, datë 9 dhe 190 mm. Ndërsa, treguesit e hidrometrave të lumenjve, kanë kaluar nivelet kritike si më poshtë: lumi Bunë, niveli kritik, 8.70, - niveli sot, 9.25; lumi Drin, niveli kritik, 7.50, - niveli sot, 7.55; Dajçi, niveli kritik, 6.30, - niveli sot, 7.00. Treguesit më të lartë të niveleve, kanë qenë në datën 30.12.2020 dhe 5 e 6.1.2021, si dhe më datat 13 e 14.2.2021.

Niveli i hidrocentralit të Fierzës, në datën 28.12.2020, ishte 268.27; më datë 15.2.2021, ishte 294.44. Për një periudhë 1.5 mujore, evidentohet rritje rreth 26.17 m duke iu afëruar pikës kritike 2.6 m. Shkarkimet nga porta, 900 m³/s dhe 450 m³/s; në total 1350 m³/s, konsiderohen si shkarkime normale, në këtë periudhë të vitit; fryrja e përrënjeve malor, brenda vendit dhe në Mal të Zi, lumi Moraça, reflektuan në fryrjen e Liqenit të Shkodrës, lumenjve Drin, Bunë, Kir dhe Gjadër. Si rrjedhojë u përmbytën territore në bashkinë Shkodër (njësia administrative, Dajç dhe Ana e Malit, Rrethina, Berdicë, disa lagje të qytetit Shkodër), dhe në bashkinë Vau Dejës (njësia administrative, Bushat dhe Mnel Vig).

Situata e krijuar: sipërfaqja totale e përmbytur në nivel qarku u vlerësua 4224 ha/ 9781 ha; 63 shtëpi të përmbytura; 321 shtëpi të rrethuara nga uji; 541 shtëpi me

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

prezencë uji në oborre; 27 familje të larguara; rreth 4760, popullsi e prekur, kryesisht fermerë; rreth 1062, mbështetje me pako ushqimore për komunitetin dhe 192 ton mbështetje me bazë ushqimore për bagëtitë.

6.2 Masat që u morën nga Prefektura e Shkodrës

Faza e parë: planifikimi, parandalimi, lehtësimi dhe gjetjet. Në tetor 2020 u zhvillua mbledhja e KMCQ, ku u morën masat e mëposhtme: planmonitorimi/inspektimi i detajuar i cili bëhet çdo vit; u kërkua informacion nga të gjithë institucionet anëtare të KMCQ-së dhe nga bashkitë; u zhvilluan takime me drejtuesit kryesorë të hidrocentraleve, drejtuesit e drejtorët e ujësjellës kanalizimeve, Lezhë, të basenit Drin-Bunë.

Faza e dytë: Paralajmërimi i hershëm, përgatitja. Java e parë e janarit 2021, pas njoftimit nga IGEUM-i dhe QKMC-ja, për situatën e pritshme të reshjeve që ndikonin në fryrjen e lumenjve Drin, Bunë, Kir, Gjadër dhe Liqenin e Shkodrës; njoftimi IGEUM-it, iu delegua për njohje dhe zbatim bashkive/institucioneve anëtarëve të KMCQ-së, ku iu kërkua, rritja e nivelit të gatishmërisë së strukturave. Në mbledhjen e datës 5 janar 2021. Prefektja në rolin e kryetarit të KMCQ-së, nxori urdhrin përkatës, ku u përcaktuan: freskimi i planit të evakuim/shpëtimit të komunitetit, gjësë së gjallë, vendet e akomodimit të përkohshëm, nevojat për ushqime për komunitetin dhe bazën ushqimore për bagëtinë; detyrat operacionale për strukturat mbështetëse, në nivel qarku, për çdo bashki; u përlogariten sasia/lloji i forcave dhe mjetet, për çdo njësi administrative.

Faza e tretë: siguria, reagimi dhe mbështetja, periudha (10 janar - 15 shkurt 2021). Karakteristike e kësaj faze, ishin: takimet e përditshme të kryetarit të KMC-së, të shoqëruara me inspektimet në terren; konstatim i veprimtarisë së strukturave gjatë operacioneve të evakuim-shpëtimit të komunitetit e gjësë së gjallë, në zonën e përmbytur; asistencë shëndetësore; riparimi i defekteve elektrike në zonën e përmbytur dhe ato malore; veprimtaria e strukturave OSHE-së, DSHP-së në zonat e përmbytura dhe zonat e izoluar nga dëborat; u përcaktuan detyrat operacionale të FNSH-së, reparti Vau Dejës, për evakuim/shpëtimin; u evidentua operacioni i shkallës me rrezikshmëri të lartë, siç ishte ajo në Qafë Thore, me datë 26 janar 2021, për shpëtimin e jetës së punonjësit në lokalit dhe një pronari, që rrezikohej nga shembja e çatisë së objektit, ku u bë i mundur shpëtimi i jetës së personit nga ndërhyrja e FNSH-së, ADZ-së dhe banorëve të zonës. Riparimi i argjinaturës së Shirqit, me datë 28 janar 2021, ndërhyrja vendimtare e FNSH-së, për krijimin e kushteve të strukturave të tjera të bashkisë dhe Drejtorisë së Ujësjellës Kanalizimeve, Lezhë, për mbylljen e plotë të argjinaturës, etj.

Prefektja e Qarkut në rolin e kryetares KMCQ-së, ka koordinuar të gjitha agjencitë dhe strukturat në mbështetje të komunitetit, ka gjetur burime dhe donator brenda vendit, krahas kërkesave ndaj institucioneve përkatëse për garantimin e sigurimit të bazës ushqimore për bagëtitë dhe pakove ushqimore për komunitetin. U bë e mundur nxitja e faktorëve të tjerë të qeverisë, për zbatimin e projektit dhe u bë e mundur që të mos kishte dëme në njerëz dhe gjënë e gjallë, pavarësisht situatës shumë të vështirë, në zonat e Nënshkodrës dhe malore nga izolimi i dëborës.

6.3 Parashikimi për shtëpi/familje dhe mjetet e transportit për largimin e komunitetit në qarkun Shkodër

Problematikat dhe nevojat që mund të lindin janë:

a) sigurimi i funksionimit të nënstacionit elektrik në Draçin, mbrojtja nga përmbytja me thasë rëre, motopompë për heqjen e ujit, personel gatishmërie;

b) sigurimi i funksionimit të stacionit të ujësjellësit në Dobraq, mbrojtja nga përmbytja me thasë rëre, motopompe për heqjen e ujit, sigurimi i higjienës së nevojshme (hedhje klori, etj.); c) mbështetja me ndihma, për familjet e lagjeve Ajasem, Bahçallek, Salo Halili, Ahmet Haxhia dhe Kiras (pjesa e livadheve);

d) furnizimi me ushqime blegtorale për kafshët shtëpiake (të identifikuara nga DBUMK-ja) e Problematikat financiare për mbulimin e mbështetjes së akomodimit, fjetje dhe ushqim për familjet që mund të akomodohen në nivel bashkie në hotelet: *Rozafa, Kaduku, Grand Europa, Argenti*, dhe në konviktet e shkollave të mesme, si: konvikti i *Shkollës Industriale*, konvikti i *Shkollës Pedagogjike*, konvikti i *Shkollës Pyjore*. Më poshtë paraqitet parashikimi për shtëpi/familjeve dhe mjete e transportit për evakuimin e komunitetit në qarkun e Shkodrës.

Nr	Njësia vendore	Shtëpi që izolohe nga uji	Biznese që u përmblyten	Numri i Familjeve që mund të evakuhohen	Mjetet e evakuimit	Vendet e akomodimit
1.	Qyteti Shkodër	470	15	300	4 mjete dhe 6 varka të ushtrisë	Në konviktet e shkollave të mesme
2.	Nj. A Dajç	400	6	400	5 mjete dhe 5 varka të ushtrisë	Tek të afërmit dhe në konviktet e shkollave
3.	Nj. A Ana Malit	130		130	3 varka dhe 3 mjete të ushtrisë	Tek të afërmit dhe në konvikte të shkollave
4.	Nj. A Vellipojë	50		50	3 varka dhe 1 mjet i ushtrisë	Tek të afërmit
5.	Nj. A Bërdicë	130	3	130	3 varka dhe 2 mjet të ushtrisë	Tek të afërmit dhe në konviktet e shkollave
6.	Nj. A Guri Zi	260		260	2 mjete dhe 2 varka të ushtrisë	Tek të afërmit dhe në konviktet e shkollave
7.	Nj. A Bushat	100		100	2 Mjete, 3 varka të ushtrisë	Tek të afërmit
8.	Nj. A. Qendër, M. Madhe	70		40	1 mjet i ushtrisë	Tek të afërmit
9.	Nj. A Rrethina	25	2	15	1 mjet i ushtrisë	Tek të afërmit
10.	Nj. A Postribë	25		5	Mjetet e komunës	Tek të afërmit
11.	Nj. Akastrat	80		40	Mjetet e ushtrisë	Tek të afërmit

Tabela 3. Parashikimi për shtëpi/familjeve dhe mjete e transportit për evakuimin e komunitetit në qarkun e Shkodrës.

Në mënyrë tabelore paraqesim parashikimin për shtëpi/familjeve dhe mjete e transportit për evakuimin e komunitetit Njësia vendore në qarkun e Shkodrës, duke filluar nga qyteti Shkodër dhe komunat e fshatrat që patën probleme me përmbytjet, ishin gjithsej 11 njësi vendore, 1750 shtëpi dhe rreth 8700 banorë që izolohe nga uji, 26 biznese që u përmblytën, 1470 familje dhe rreth 4 mijë banorë u parashikuan nga strukturat e mbrojtjes civile që mund të evakuhohen, mjete e evakuimit, 60 mjete transporti dhe 60 varka me 3 rejse, vendet e akomodimit u caktuan, konviktet e shkollave të mesme dhe tek të afërmit në vendet e 11 njësive vendore të mësipërme.

6.4 Përfundime dhe rekomandime

Kompensimi i dëmeve mbetet detyrim; problemet e shfaqura në marrjen, dorëzimin dhe shpërndarjen e ndihmave ushqimore për komunitetin dhe gjënë e gjallë, si dhe duhet të shikohet me përparësi dhe të përcaktohen me një udhëzim të veçantë, mekanizmat përkatës se kush duhet të merret më procedurat që nga burimi i ardhjes deri në ekzekutimin e tyre, në dorëzimin e personave nevojë, pasi janë hasur shumë problematika në marrjen dhe dorëzimin e ndihmave sidomos të bazës ushqimore për bagëtinë. Për realizimin e kësaj detyre të rëndësishme rekomandohet përgatitja dhe miratimi i një akti nënligjor të veçantë.

Gjatë përmbytyjeve të viteve të fundit u konstatua mungesa e mbështetjes së menjëhershme me ushqime për gjënë e gjallë, kjo veçanërisht për bashkitë që tradicionalisht përmbysten, për të cilën duhet të ketë një rezervë shtetërore e cila të paraktrahet nga strukturat private, vetëm për situata të tilla emergjente për t'i ardhur në ndihmë fermerëve. Për realizimin e kësaj detyre të rëndësishme rekomandohet përgatitja dhe miratimi i një akti nënligjor të veçantë.

Bashkia Shkodër duhet të ushtrojë një kontroll në gjithë bllokun e banesave në Dajç. Nga bashkia Shkodër, rekomandohet të pastrohet kanali në krah të rrugës së Dajçit, dhe të bëhet me dimensione më të mëdha, që të përballojë kullimin e këtij blloku banesash. Rekomandohet që nga këshillat bashkiakë të bashkive Shkodër e Vau i Dejës, të rishikohen taksat dhe tarifat vendore për banorët e zonave të përmbytura, duke i përjashtuar nga detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore, për sipërfaqen e tokave të përmbytura, të cilat kanë qenë të kultivuara; korrigjimin e detyrimit për taksën mbi ndërtesat, për periudhën që familjet kanë qenë të larguara nga ndërtesat për shkak të situatës; korrigjimin e detyrimit të tarifës së pastrimit, për familjet e zonave të përmbytura.

Gjatë këtij punimi konstatuan mos zbatim të kompetencave dhe të informimit të ndërsjellët i cili duhet të jetë detyrues nga niveli i Bashkisë me prefekturën sidomos për menaxhimin e emergjencave. Për realizimin e kësaj detyre rekomandohet përgatitja dhe miratimi i një akti nënligjor të veçantë. Gjithashtu, rekomandohet hartimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe rajonale në nivel qarku për reduktimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe mbrojtjes civile.

Masat për zbatimin e ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" janë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme duke konsistuar në: parashikimin, vlerësimin dhe planifikimin i rrezikut në të gjitha nivelet, mbetet një detyrim ligjor i cili duhet të zbatohet sa më shpejt. Rekomandohet përgatitja dhe miratimi i një akti nënligjor për zbatimin sa më të shpejtë të këtij neni të veçantë të ligjit. Vlerësimi dhe kompensimi i dëmeve të shkaktuara tek fermerët apo tek të mbjellat në tokat bujqësore.

Mirëfunksionimi i drejtorive dhe sektorëve të emergjencave, në nivel prefekturë, bashkie, marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe detyrimet ndërinstitucionale për shkëmbim të informacionit të ndërsjellët, për zbatimin e skemave të vrojtimit, lajmërimit, dhe të ndërhyrjes në të gjitha njësitë administrative, fshatrat e zonave që rrezikohen nga përmbytja dhe nga izolimi i dëborës. Duke qenë se janë evidentuar të meta dhe mangësi në këtë drejtim, rekomandohen: shfrytëzimi kapaciteteve logjistike e njerëzore në çdo institucion/bashki, bashkëpunimi me kompanitë private, mjetet e kalueshmërisë së lartë, si dhe organizimi i lëvizjes së transportit për evakuimin e familjeve, apo udhëtarëve që

janë rrezikuar nga përmbytja/izolimi dëborës. Duhet të përcaktohen me akte nënligjore, se kur duhet, dhe si, të lëvizin. Shpallja e fatkeqësisë natyrore, kriteret dhe procedurat e shpalljes për një zonë të caktuar, njësi administrative, bashki, nënprefekturë etj. Roli i nënprefektëve për bashkëpunimin, monitorimin e mbikëqyrjen dhe informimin periodik të institucionit të prefektit për mbledhjet e KMC-së në nivel bashkie. Organizimi dhe funksionimi i KMCQ-së, dhe përcaktimi i marrëdhënieve me KMCB-së, bashkive apo institucionet të tjera, në varësi të precipitimit të situatave, marrja e masave, delegimin e urdhrave dhe udhëzimeve për përballimin e situatës, për të cilat duhet të ketë akte nënligjore dhe detyruese për zbatimin e tyre nga të gjitha nivelet e pushteteve dhe institucioneve.

Koordinimi dhe bashkëpunimi, kontaktet me të gjitha strukturat me AKMC-së, Qendrën Kombëtare Operacionale të Mbrojtjes Civile (QKOMC). Mbështetja konkrete nga MM-ja, AKMC-ja, për të mirëfunksionuar mekanizmat përkatës në mirëmenaxhimin e situatave emergjente të ardhshme duke respektuar dhe zbatuar përgjegjësitë ndërinstitucionale të bashkive, institucionin e prefektit dhe institucionet e tjera anëtare të KMC-së. Për realizimin e këtyre detyrave rekomandohet përgatitja dhe miratimi i një akti nënligjor të veçantë. Të hartohet vendimi i qeverisë shqiptare për rolin e këshillit të qarkut në kuadrin e koordinatorit dhe nënkryetarit të KMCQ-së bashkëpunimin me administratat e bashkive/institucioneve anëtare të KMC-së, për marrjen e shkëmbimin e informacionit të ndërsjellët si dhe kontributin aktual të dhënë në ndihmë dhe në mbështetje të situatës. Për realizimin e këtyre detyrave rekomandohet përgatitja dhe miratimi i një akti nënligjor të veçantë.

Domosdoshmëria e planifikimit të strategjive në të gjithë dinamikën e planifikimit, monitorimit, parandalimit dhe reagimit për zbutjen e rrezikut ndaj fatkeqësive natyrore, i cili duhet të konsistojë në disa aktivitete parësore, si: rishikimi i planit kombëtar të emergjencave të mbrojtjes civile dhe shprehja e tij në planin e veprimit që do të hartohet për zbatimin e kësaj strategjie; njohja, zbërthimi dhe zbatimit i ligjit, nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” ku përfshihen elementet kyçe konceptore të hartimit të planit të rrezikut dhe të emergjencave në lidhje me menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë, dhe garantimi që baza nënligjore, si për shembull, për sektorë, si uji, planifikimi i përdorimit të tokës dhe komunikimi, miratimi i planeve lokale në përshtatje me atë rajonal dhe kombëtar, rajonal, lokal për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, të jenë në përputhje dhe të kontribuojnë me uljen e rrezikut nga fatkeqësitë. Nxitja e forcimit profesional të roleve dhe përgjegjësive të strukturave në nivel qarku dhe bashkie, përgatitjen për t’u bërë ballë dhe për të reaguar ndaj emergjencave, brenda territoreve të tyre.

Përpilimin e hartave të rrezikut për specifikën e territorit dhe llojit të fatkeqësisë. Planifikimi dhe forcimi i sistemit në nivel kombëtar, qarku, bashkie të paralajmërimit të hershëm, me procedura standarde operative për rrezikun e shumëfishtë, duke u përqendruar fillimisht tek përmbytjet dhe zjarret në pyje dhe fuqizimi për integrimin rajonal të sistemit të paralajmërimit të hershëm të kapaciteteve të institucioneve kryesore përgjegjëse për identifikimin e rrezikut koordinimi ndërmjet tyre nga lart poshtë dhe paralel, si p.sh. që nga Instituti i Gjeoshkencës, Energjetikës, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) dhe përcaktimi i bashkëpunimit me prefekturën, bashkitë dhe institucionet bazë.

Nxitja dhe fuqizimi i mbledhjes së të dhënave të hapura nivel qarku e bashkie për rreziqet, duke përfshirë bazën e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë, bazuar mbi vlerësimet për dëmet dhe humbjet, ndër vite. Ulja e niveleve ekzistuese të cënueshmërisë përkundrejt rreziqeve sizmike në vend, përmes përshtatjes së infrastrukturës kritike

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

publike (si p.sh: shkolla, spitale, korridore logjistike etj.). Zbatimi i masave për uljen dhe kontrollin e rrezikut nga përmblytjet në komunitetet që përballen me rrezikun tradicional ndër vite, të prekjes prej tyre. Nxitja e miratimit të kodeve të përditësuara të ndërtimit, bazuar në konsiderata të rrezikut sizmik, si edhe fuqizimi i institucioneve publike për zbatimin e tyre dhe përfshirja e kriterëve në planifikimin urban, përdorimin e tokës, analizën e rrezikut në proceset e planifikimit të programeve të investimeve publike në nivel fushatash ndërgjegjësimi dhe zgjimi ndjeshmërie, për reduktimin e rrezikut; programet mësimore, informimi publikut nëpërmjet rrjetit elektronik: gazetave, emisioneve TV, në kuadrin edhe të ditës ndërkombëtare të zvogëlimit të rrezikut ndaj fatkeqësive natyrore.

Fuqizimi i shërbimeve të gatishmërisë dhe strukturave reaguese të mbrojtjes civile, përditësimi i të dhënave të burimeve njerëzore dhe logjistike, forcimi kapaciteteve ekzistuese, ndryshimi dhe forcimi i tyre, hartimi planeve konkrete në të gjitha nivelet.

Mbështetja dhe stimulimi i kontributit në nivel qarku e bashkie për sa i përket lehtësimit të sigurimit ndaj rreziqeve katastrofike në territoret e rrezikut, zgjerimi i mbulesës së sigurimit për pronarët e shtëpive, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe fermerët për të përfshirë mbulimin nga përmblytjet dhe tërmetet, vlerësimi i nevojave financiare për emergjencat për emergjencat në shkallë të ulët dhe mesatare dhe sigurimin e lehtësive për fonde rezervë, bazuar në ligjin “Për mbrojtjen civile”.

Bibliografia

1. Raporti global i vlerësimit, UNISDR, 2013.
2. Disaster Risk Reduction Capacity Assessment Report for Albania, UNDP BCPR, 2011.
3. Albania's Energy Sector: Vulnerable to Climate Change. Nga Jane Ebinger. Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore. Banka Botërore. Shtator 2010, Vol 19.
4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, i përditësuar.
5. Ligj nr. 103/2014, datë 31.7.2014 “Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë”.
6. Ligj nr. 8756, datë 26.3.2001 “Per Emergjencen Civile”, i ndryshuar me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009.
7. Ligj nr. 45/2019, datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.
8. Ligj nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.
9. Ligj nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
10. Ligj Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
11. Ligj nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”.
12. Raport i posaçëm i IPCC për ngjarjet ekstreme (IPCC/SREX, 2011).
13. Urdhër i Kryeministër të Shqipërisë, nr. 27, datë 3.2.2020, “Për miratimin e strukture dhe të organikës të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
14. “Plan kombëtar për emergjencat civile” 2004.
15. Përgjigje e shkresës së Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër të datës 23.03.2021 të dërguar nga Msc Pëllumb Dani, Përgjegjës Sektori i Emergjencave Civile dhe Krizave pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Pasojat e lumit Shkumbin, në territorin e bashkisë së Rrogozhinës



■ **MSc. Taulant SULA**
Policia e Shtetit
taulantsula94@gmail.com

Abstrakt

Lumi, i cili ndan Shqipërinë në Jug dhe Veri është pikërisht Shkumbini. Ai përshkruan disa qytete dhe fshatra deri në derdhjen e tij në Detin Adriatik. Zona e sektorit të poshtëm të tij përshkruan bashkinë e Rrogozhinës, e cila njëkohësisht, kufizon atë me bashkitë: Peqin, Lushnjë dhe Divjakë. Mund të themi se, zonat që lagen nga ky lum, janë të bekuara me plot kuptimin e fjalës. Krahas të mirave që ai ofron, në disa raste, nga keqpërdorimi ynë, me vullnet apo, pa vullnet, janë shtuar një sërë pasojash dhe rreziqesh për banorët që jetojnë pranë këtij lumi, por jo vetëm. Në këtë studim, falë disa metodave të ndjekura, jemi munduar që të eidentojmë pasojat e ndryshme që shfaq lumi Shkumbin në këtë sektor, qofshin ato negative apo edhe pozitive. Ndër pasojat më të prekshme, do të përmendim: erozionin, përmytjet, prezencën e madhe të mbeturinave etj. Një nga shkaktarët më përcaktues i këtyre pasojave mund të cilësojmë “gërmimet pa kriter të inerteve nga subjektet të ndryshme”, ku jo rrallë herë kanë vepruar në kundërshtim me aktet ligjore. Në vitet e fundit, vihet re që masat e reja ligjore e kanë vështirësuar vazhdimin e këtij fenomeni, por sërish, sipas të dhënave nga hulumtimet e kryera në terren, ai vazhdon të mbetet “gangrena” kryesore e këtyre pasojave, shpesh, edhe fatale për komunitetet e pasuritë e tyre. Cilat janë strategjitë më efikase për parandalimin e fatkeqësive natyrore që shkaktohen nga ky lum? Kjo pyetje kërkimore ka nxitur interesin e përbashkët për të vlerësuar mënyrën e bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese dhe komuniteteve për të gjetur zgjidhjet frytdhënëse për të ardhmen.

Fjalëkyçe:

Lumi Shkumbin, përmytje, erozion, komunitet, strategji, gërmime.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

1. Hyrje

Pasojat e lumit Shkumbin në territorin e bashkisë së Rrogozhinës, janë të mira por edhe të këqija. Në studim i kemi trajtuar të dy aspektet, por më tepër jemi ndalur tek aspektet negative, sepse janë shumë shqetësuese për të gjithë banorët të cilët jetojnë në luginën e Shkumbinit, por jo vetëm, ndikimi është edhe më i gjerë. Problematikat më kryesore janë përmbytjet, erozioni edhe ndotja. Jemi ndalur në detaje për secilin problem, edhe për të bërë të mundur të japim disa strategji për minimizimin apo edhe të eliminimit të plotë të këtyre fenomeneve. Pjesë e studimit janë bërë një numër i madh personash dhe me profesione apo lidhje të ndryshme që kanë lidhje direkt apo indirekt me lumin Shkumbin.

Punimi është i ndarë në disa nëntema:

a. Veçoritë e përgjithshme të lumit Shkumbin dhe karakteristikat e tij në zonën e bashkisë së Rrogozhinës: nëntema ku është diskutuar për karakteristikat e lumit Shkumbin. Janë përmendur karakteristika të përgjithshme që lidhen me gjatësinë, sasinë mesatare të prurjeve të ujit, prurjet e mëdha të inerteve, të cilat kryesisht janë zhavorre; por edhe karakteristika të veçanta që karakterizojnë sektorin e poshtëm, ku bën pjesë dhe bashkia e Rrogozhinës, - për të cilin do të theksojmë se ka shumë *meandrime* (zigzage), - që është zona që përfshihet më tepër në përmbytje, ku gjenden edhe pasojat më të mëdha të erozionit.

b. Metodologjia e kërkimit: nëntema ku është trajtuar metodologjia e cila është përdorur në këtë studim. Kryesisht është përdorur intervista gjysmë të strukturuar. Një tipar tjetër që duhet të theksojmë është se janë përfshirë një numër i konsiderueshëm personash, e me profesione të ndryshme, ku një pjesë nuk e ka ditur qëllimin e intervistës.

c. Pasojat dhe rreziqet që paraqet lumi Shkumbin në sektorin e poshtëm të tij: në

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

këtë nëntemë janë përmendur pasojat pozitive dhe ato negative. Jemi ndalur në detaje për secilën pasojë, por më tepër tek ato negativet, sepse kërkojnë ndërhyrje, - “sa më shpejt, aq më mirë do të ishte”.

d. Strategjitë dhe siguria e nevojshme për parandalimin e fatkeqësive natyrore nga lumi Shkumbin: pas konsultimit me të gjithë grupet e interesit edhe me specialistë të fushave përkatëse, kemi arritur në konkluzionin e dëshiruar për të dhënë disa strategji të cilat janë mjaft të vlefshme dhe kërkojnë implementim të menjëhershëm. Këto strategji janë mjaft të vlefshme edhe në lumenjtë të tjerë që kanë po të njëjtat problematika si ato të lumit Shkumbin.

e. Rekomandimet, janë mjaft të domosdoshme. Në fakt, e gjithë puna kërkimore është përgatitur për t'i shërbyer banorëve si dhe institucioneve që kanë atributin dhe përgjegjësin ligjore për të vepruar.

2. Veçoritë e përgjithshme të lumit Shkumbin dhe karakteristikat e tij në zonën e bashkisë së Rrogozhinës

Shkumbini është nga lumenjtë më të mëdhenj në Shqipërinë Qendrore. Është 181 km i gjatë, me sipërfaqe të pellgut 2444 km², dhe lartësinë mesatare mbi nivelin e detit e ka 753 m. Prurja mesatare shumëvjeçare e Shkumbinit është 61.5 m³/sek. Ai transporton mesatarisht 5.8 milionë tonë lëndë të ngurta në vit¹. Bashkia Rrogozhinë bën pjesë në sektorin e poshtëm ose të ulët të Shkumbinit. Lartësia nuk i kalon 50 m mbi nivelin e detit. Një karakteristikë tjetër që vihet re është prezenca të shumtë të zigzageve/meandrimëve [“meandro”/kthesa, zigzage]. Sektori i poshtëm është zona më akumuluese (depoziton material); në fakt, kjo është një ndër veçoritë që shquhet dhe bën diferencën me lumenjtë e tjerë të Shqipërisë, sepse këto lëndë të ngurta janë të shumta, të pastra, por edhe të pasura kryesisht me zhavorre që vijnë që nga fillimi i lumit, si dhe nga përrenjtë e shumtë që derdhen në këtë lumë. Delta e lumit ka një sipërfaqe të vogël, dhe ka shumë vite që nuk është vendosur dorë nga institucionet përkatëse, por është në gjendje natyrale. Ku, dhe për shkak të prurjeve të mëdha të inerteve, si dhe baticat e zbaticat e detit, kanë bërë që delta e lumit është e vogël.

Lumi	Gjatësia km	Pellgu km ²	Prurja mesatare m/s	Moduli i prurjes l/s/km ²	Raproti i prurjes Maks/Min	Mineralizimi mg/l
Buna	41	5'187	320	-	5.3	-
Drini	285	14'173	352	24.8	5.1	257
Mati	115	2'441	103	42.6	9.3	222
Ishmi	74	673	20.9	31.0	5.9	461
Erzeni	109	760	18.1	24.0	11.2	-
Shkumbini	181	2'441	61.5	25.2	13.2	317
Semani	281	5'649	95.7	16.9	13.7	440
Vjosa	272	6'706	195	29.1	7.2	335

Tabela 1: Veçoritë kryesore hidrologjike të lumenjve më të mëdhenj shqiptarë (Pano et al., 1984; Kabo, 1990-91)

Lumi Shkumbin e kufizon në pjesën jugore të saj bashkinë e Rrogozhinës me bashkitë Peqin, Lushnje dhe Divjakë. Një fakt tjetër që duhet theksuar është se Shkumbini e ka ndërruar disa herë grykëderdhjen e tij. Ka të dhëna se grykëderdhja ka qenë në afërsi të

¹ ALB-RIVERS-WEB-PDF/009-28, “Kreu I: Pasuritë ujore shqiptare”, f. 19.

² Qiriaz, Perikli, Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Botimet: Afërdita, 2001.

BASENI UJËMBLEDHËS I SHKUMBINIT

(Me vendvendosjen e stacioneve të monitorimit)

The map illustrates the Shkumbini River Basin, which is shaded in light blue. The river is depicted with a blue line, and its tributaries are shown with thinner blue lines. Three monitoring stations are marked with red dots: Rrogozhinë, Labinot, and Proptisht. The map also shows the coastline of Albania, with the sea to the east. A legend at the bottom explains the symbols used: a blue line for 'Rrjedhë lumore' (River flow), a red dot for 'Stacion monitorimi' (Monitoring station), a blue arrow for 'Profil jashtë funksioni' (Out of function profile), a blue outline for 'Liqen' (Lake), a grey line for 'Kufi tokësor' (Land border), and a light blue area for 'Baseni i Shkumbinit' (Shkumbini Basin).

SHPJEGUES

	Rrjedhë lumore		Liqen
	Stacion monitorimi		Kufi tokësor
	Profil jashtë funksioni		Baseni i Shkumbinit

Shkumbini e ka ndërruar grykëderdhjen për herë të fundit pak vite mbrapa se erdhi pluralizmi në vend, ku filloi të lulëzoi edhe ekonomia e marrjes dhe përpunimit të inerteve të lumit. Ku në lumin Shkumbin pati dhe ka me dhjetëra subjekte që operojnë në këtë sektor.

Arsyet që na shtyn të punojmë e të thellohemi në këtë studim, janë të lidhura ngushtë me vendin ku jemi rritur dhe ku jetojmë. Kemi vënë re që ka pasur dhe studime të mëparshme për sa i përket lumit të Shkumbinit, por jo të thelluara në aspektin e fatkeqësive natyrore dhe më konkretisht për zonën administrative të bashkisë së Rogozhinës. Ky studim në fakt do tu vlejë të gjithë banorëve të kësaj bashkie, por jo vetëm, sepse, siç e kemi përmendur edhe më lart, lumi e kufizon bashkinë Rogozhinë edhe me tri bashki të tjera që janë pjesë e sektorit të poshtëm. Por, studimi vlen edhe për më gjerë, duke pasur parasysh se ne jemi një shtet shumë i pasur në aspektin hidrik, si në sipërfaqe edhe në nëntokë; studimi u vlen edhe lumenjve që kanë karakteristika të ngjashme me ato të Shkumbinit, por për fat të keq kanë edhe problematika të ngjashme.

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Metodologjia e përdorur në këtë studim është kryesisht intervista gjysmë e strukturuar. Kampioni ka qenë i larmishëm dhe i përzgjedhur në rrugë joprobabilitare, por i rastësishëm sipas nevojës sepse edhe tema është mjaft e gjerë. Por, edhe ndikimi e problematikat janë po ashtu të shumta, për fat të keq. Në këtë studim janë përfshirë ato kategori, të cilat janë nënshtruar në mënyrë të vetëdijshme, por edhe të pavetëdijshme gjatë intervistës.

Kategoritë janë si më poshtë:

1) banorë që janë të prekur në mënyrë direkt (që kanë tokat afër, ato që kanë humbur sipërfaqe toke, si edhe që janë përmbytur);

2) biznese që operojnë në sektorin e nxjerrjes dhe përpunimit të inerteve të lumit;

3) peshkatarë;

4) agronomë;

5) inxhinierë;

6) historianë e gjeografë;

7) specialistë të emergjencave civile në bashkinë e Rrogozhinës;

8) ambientalistë;

9) subjektet që operojnë me bilance (zënë peshk me rrjeta që tërhiqen me elektromotor);

10) operatorë dhe subjekte që operojnë në turizëm.

Interesi ka qenë mjaft i gjerë, si edhe bashkëpunimi po ashtu. Pothuajse shumica e kategorive që u bënë pjesë e këtij studimi, presin të ketë rezultate, por edhe implementimin e tyre, duke parë edhe vetë rëndësinë që ka për të gjithë grupet e interesit, si dhe nevojën e menjëhershme.

4. Pasojat dhe rreziqet që paraqet lumi Shkumbin në sektorin e poshtëm të tij

Një thënie mjaft e përdorur nga populli, thotë se: “Ku ka ujë, ka jetë”. Realisht, uji është mjaft jetik për të gjithë banorët që banojnë rreth luginës së Shkumbinit. Pasojat janë me ndikim, si pozitiv, edhe negativ.

4.1 Pasojat pozitive që sjell lumi Shkumbin

